

KOMBET E
BASHKUARA



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje
të Rënda të së Drejtës Humanitare
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-
Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr.: IT-03-66-A

Data: 27 shtator 2007

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN E APELIT

Para: Gjykatësit Fausto Pocar, Kryegjykatës
Gjykatësit Mohamed Shahabuddeen
Gjykatëses Andréia Vaz
Gjykatësit Theodor Meron
Gjykatësit Wolfgang Schomburg
Sekretari: Z. Hans Holthuis

Aktgjykim i datës: 27 shtator 2007

PROKURORJA

kundër

**FATMIR LIMAJT
HARADIN BALËS
ISAK MUSLIUT**

PUBLIK

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit:

Zj. Helen Brady Zj. Shelagh Mccall	Z. Steffen Wirth Zj. Kristina Carey	Zj. Katharina Margetts Zj. Barbara Goy
<u>Avokatëve të Fatmir Limajt:</u>	<u>Avokatëve të Haradin Balës:</u>	<u>Avokatëve të Isak Musliut:</u>
Z. Michael Mansfield Q.C. Z. Karim A.A. Khan	Z. Gregor D. Guy-Smith Z. Richard Harvey	Z. Michael Topolski Q.C. Z. Steven Powles

PASQYRA E LËNDËS

I. HYRJE	1
II. STANDARDI PËR SHQYRTIMIN E APELIMEVE.....	3
III. APELI I HARADIN BALËS.....	6
A. PIKA E PARË E APELIT TË HARADIN BALËS: PRETENDIMI PËR IDENTIFIKIM JO TË SAKTË TË HARADIN BALËS SI ROJA I BURGUT “SHALA”	6
1. A e zbatoi Dhoma Gjyqësore parimin <i>in dubio pro reo</i>	7
(a) A kufizohet zbatimi <i>in dubio pro reo</i> në konkludimin përfundimtar të fajësisë	7
(b) Zbatimi i parimit <i>in dubio pro reo</i>	9
22. Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Haradin Bala ka vërtetuar që Dhoma Gjyqësore keqzbatoi parimin <i>in dubio pro reo</i> për identifikimin e tij si roja i njohur si Shala. Dhoma Gjyqësore i vlerësoi të tëra provat në mënyrë të arsyeshme, ndër të cilat edhe mosidentifikimin e Haradin Balës prej tre dëshmitarëve pamorë, alibinë e tij dhe gjendjen e tij shëndetësore në periudhën përkatëse dhe konkludoi se “nuk kishte mbetur asnjë dyshim i arsyeshëm” se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala pavarësisht gjasave për identifikime të gabuara.	9
2. A e zhvlerësoi Dhoma Gjyqësore detyrimin e provës.....	9
3. A gaboi Dhoma Gjyqësore në shfrytëzimin e identifikimeve në salën e gjyqit.....	10
4. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u kushtoi rëndësi mosidentifikimeve	12
5. A gaboi Dhoma Gjyqësore në përmbledhjen e dëshmive	13
B. PIKA E DYTË E APELIT TË HARADIN BALËS: PRETENDIMI PËR PËRFUNDIM TË GABUAR SE HARADIN BALA MORI PJESË NË VRASJET NË MALET E BERISHËS	14
1. Argumentet e palëve.....	14
2. Diskutim	17
C. PIKA E KATËRT E APELIT TË HARADIN BALËS: PRETENDIMI PËR PËRFUNDIM TË GABUAR SE HARADIN BALA SHKAKTOI TRAJTIM MIZOR NDAJ DËSHMITARIT L12.....	20
D. PIKA E GJASHTË E APELIT: REFUZIMI I ALIBISË TË HARADIN BALËS PREJ DHOMËS GJYQËSORE.....	21
1. A e ndryshoi Dhoma Gjyqësore kahun e detyrimit të provës për dëshminë nëpërmjet alibisë	21
(a) Argumentet e palëve	21
(b) Pretendimi për gabimi ligjor në ndryshimin e kahut të detyrimit të provës	24
(c) Pretendim për gabime faktuale në vlerësimin e alibisë	25
2. Vendimi i Haradin Balës për mosdhënie të dëshmisë me betim.....	27
3. A dështoi Dhoma Gjyqësore në dhënien e një arsyetimi për refuzimin e alibisë së Haradin Balës	30
E. PIKA E TETË E APELIT TË HARADIN BALËS: PRETENDIM PËR GABIM NË PËRCAKTIMIN SE DËSHMITARËT L04 DHE L06 JANË TË BESUESHËM	30
IV. APELI I PROKURORISË NË LIDHJE ME HARADIN BALËN.....	34
A. PIKA E PARË E APELIT: PRETENDIM PËR PËRGJEGJËSINË PENALE TË HARADIN BALËS SI PJESËMARRËS NË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT KRIMINALE NË KAMP-BURGUN E LLAPUSHNIKUT	34
1. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk u identifikuan në masë të mjaftueshme.....	35
(a) Identifikimi i anëtarëve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale: pretendim për gabim ligjor.....	35
(b) Identifikimi i anëtarëve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale: pretendim për gabim faktual	37

(c) A ishte përfundim i arsyeshëm i nxjerrë prej Dhomës Gjyqësore se krimet mund të jenë kryer nga “vizitorë të rastësishëm”, të cilët nuk mund të identifikoheshin si anëtarë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale sistemore	41
(i) A mund të ketë patur elementë “të pakontrolluar” të UÇK-së ose “vizitorë të rastësishëm” të cilët mund të kenë kryer krime jashtë planit të përbashkët	43
(ii) A mund të ketë Haradin Bala përgjegjësi penale si ndihmës dhe inkurajues për krime të kryera nga “vizitorë të rastësishëm”	47
2. Përfundim	47
B. PIKA E DYTË E APELIT: DËNIMI.....	47
1. Standardi për shqyrtimin apelues të dënimit	48
2. Pretendim për gabim në lidhje me mosgjykimin e duhur të rëndesës së krimeve të Haradin Balës	49
3. Krahasim me raste të ngjashme.....	50
4. Pretendim për gabim në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.....	52
5. Përfundim	53
V. APELI I PROKURORISË LIDHUR ME FATMIR LIMAJN	54
A. PIKA E PARË E APELIT E APELIT: PRETENDIM PËR PJESËMARRJEN PERSONALE TË FATMIR LIMAJT NË KAMP-BURGUN E LLAPUSHNIKUT	55
1. A kreu Dhoma Gjyqësore gabim ligjor dhe/ose faktual kur i fragmentoi provat në mënyrë artificiale.....	55
2. A zbatoi Dhoma Gjyqësore standardin e “vërtetimit jashtë çdo dyshimi”.....	57
(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore në shqyrtimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07	58
(i) Pretendim për gabim në refuzimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07 për shkak të “ndikimit të pavetëdijshëm”	58
(ii) Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë identifikuese të Dëshmitarit L07 duke marrë parasysh dëshminë e Shukri Bujës.	60
(iii) Pretendim për moskonfirmimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07.....	61
(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur shqyrtoi përshkrimet fizike të dëshmitarëve për personin që ata pretendojnë se e identifikuan si Fatmir Limaj.....	71
(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk mori parasysh praninë e shpeshtë të Fatmir Limajt në fshatin Llapushnik dhe në afërsi të kamp-burgut.....	73
3. Përfundim	75
B. PIKA E DYTË E APELIT: POZITA E PRETENDUAR KOMANDUESE DHE KONTROLLUESE E FATMIR LIMAJT	75
1. A gaboi Dhoma Gjyqësore me mosshqyrtimin e të tëra provave përkatëse	76
2. A gaboi Dhoma Gjyqësore me mosshqyrtimin e duhur të provave përkatëse	77
(a) Pretendimi për konfirmim midis dëshmive të Shukri Bujës, Ramadan Behlulit, Ramiz Qeriqit, Shefqet Kabashit dhe Dëshmitarit L64.....	77
(b) Dëshmia e Dëshmitarit L64, përfshirë ditarin e tij	83
(c) Dëshmia e Jan Kickert në lidhje me takimin e datës 30 korrik 1998	85
(d) Prova materiale P34	86
(e) Provat lidhur me fletëlibrimet e të burgosurve	87
(f) Dëshmia e Fatmir Limajt	88
3. A kreu Dhoma Gjyqësore gabim ligjor ose faktual kur vlerësoi dëshminë lidhur me pretendimin mbi aftësinë e Fatmir Limajt për imponimin e disiplinës ndaj ushtarëve të UÇK-së në kamp	89
4. Përfundime	91
C. PIKA E TRETË E APELIT: NDËRMARRJA E PËRBASHKËT KRIMINALE	91
VI. APELI I PROKURORISË NË LIDHJE ME ISAK MUSLIUN.....	92
A. PIKA E PARË E APELIT E APELIT: PRETENDIM PËR PJESËMARRJEN PERSONALE TË ISAK MUSLIUT NË KAMP-BURGUN E LLAPUSHNIKUT	92
1. A bëri Dhoma Gjyqësore gabim ligjor dhe/ose faktual nëpërmjet fragmentimit artificial të provave	92

2.	A zbatoi Dhoma Gjyqësore standardin e “vërtetimit jashtë çdo dyshimi”	94
(a)	Mosmarrje e duhur në konsideratë e faktit se Isak Musliu njihej si “Çerçizi”	94
(b)	Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë së Karpuzit se kishte parë Isak Musliun në kamp.....	96
(c)	Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmimeve të Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12 se kishin parë Isak Musliun në kamp-burg.....	97
(d)	Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë së Dëshmitarit L64 se Isak Muslim mund të hynte dhe hyri në kamp-burg	100
(e)	Pretendim për vlerësim të gabuar të identifikimit të Isak Musliut prej Dëshmitarit L96 në kamp.....	100
(f)	Pretendim për mosmarrjen në konsideratë të pranisë së Isak Musliut në fshatin Llapushnik, në kamp-burg dhe rrethinë	102
3.	Përfundim	103
B.	PIKA E DYTË E APELIT: PRETENDIMI PËR KOMANDËN DHE KONTROLLIN E MUSLIUT NDAJ USHTARËVE TË UÇK-SË NË KAMP-BURG	103
1.	Pretendime për gabime ligjore dhe faktuale.....	104
(a)	A administrohej kamp-burgu i Llapushnikut nga njësia Çeliku 3	104
(i)	Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e UÇK-së në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë	104
(ii)	As njësia Pëllumbi, as “vizitorë të rastësishëm” nuk mund ta kenë përdorur kampin ...	105
(iii)	Pretendim për gabim në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm: prova të drejtpërdrejta.....	107
(iv)	Pretendim për gabim në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm në lidhje me një pjesë të caktuar të provave.....	108
(b)	A morën pjesë në funksionimin e kampit ushtarët e njësisë Çeliku 3	110
2.	Përfundim	113
C.	PIKA E TRETË E APELIT: NDËRMARRJE E PËRBASHKËT KRIMINALE.....	114
VII.	VENDIM	115
VIII.	DEKLARATA E GJYKATËSIT SHAHABUDEEN	117
IX.	MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES DHE I VEÇANTË DHE DEKLARATA E GJYKATËSIT SCHOMBURG.....	120
A.	STANDARDI I SHQYRTIMIT APELUES	120
B.	PËRGJEGJËSIA E ISAK MUSLIUT	121
C.	PËRGJEGJËSIA E HARADIN BALËS.....	122
D.	PARIMI <i>IN DUBIO PRO REO</i>	124
X.	SHTOJCA A: HISTORIA PROCEDURALE.....	126
A.	NJOFTIME TË APELIT	126
B.	PËRBËRJA E DHOMËS SË APELIT.....	126
C.	DORËZIMI I DOSJEVE TË APELIT	127
D.	KËRKESA PËR LIRIM TË PËRKOHSHËM	127
E.	MOCION PËR PRANIMIN E NJË FAKTI TË PRANUAR DHE PËR PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PROCESIT	128
F.	KONFERENCAT MBI GJENDJEN.....	128
G.	SEANCA E APELIT.....	128
XI.	SHTOJCA B: FJALORI.....	129
A.	LISTA E VENDIMEVE TË TRIBUNALIT DHE TË TJERA.....	129
1.	Tribunali Ndërkombëtar	129
2.	TPNR	134
B.	LISTA E SHKURTIMEVE.....	135

I. HYRJE

1. Dhoma e Apelit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali Ndërkombëtar”), është informuar për dy apeline¹ ndaj Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore II të 30 nëntorit 2005, në çështjen *Prokurorja kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut*, Lënda Nr. IT-03-66-T (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore”).

2. Në Aktakuzën e ndryshuar për herë të dytë dorëzuar më 6 nëntor 2003 (“Aktakuza”), Fatmir Limaj, lindur më 4 shkurt 1971 në Banjë në komunën e atëhershme të Suharekës në krahinën autonome të Kosovës (“Kosova”), Isak Musliu, lindur më 31 tetor 1970 në Reçak në komunën e Shtimes në Kosovë, dhe Haradin Bala, lindur më 10 qershor 1957 në Koroticën e Epërme në komunën e Glllogocit në Kosovë, u akuzuan për përgjegjësi penale individuale bazuar në Nenin 7(1) të Statutit ndër të tjera, nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale që pretendohet se ekzistonte para majit 1998 dhe vazhdoi së paku deri në gusht 1998. Në Aktakuzë pretendohet se qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte shënjestrimi i civilëve serbë dhe shqiptarëve të cilët konsideroheshin bashkëpunëtorë dhe zbatimi i trajtimit mizor, torturave dhe vrasjeve ndaj këtyre individëve në shkelje të Nenit 3 të Statutit (shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës) dhe Nenit 5 të Statutit (krime kundër njerëzimit).

3. Aktakuza e rëndon Fatmir Limajn me përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, me pretendimin se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonjë mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi krimet e lartpërmendura. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen e tyre në pyetje, sulme, keqtrajtim dhe tortura ndaj tyre, dhe se planifikoi, nxiti dhe urdhëroi vrasjen e të burgosurve në kamp-burg dhe rreth tij si dhe në malet e Berishës. Fatmir Limaj akuzohet gjithashtu për përgjegjësi eprore sipas Nenit 7(3) të Statutit lidhur me këto shkelje, e cila pretendohet se buron prej pozitës së tij komanduese dhe kontrolluese mbi anëtarët e UÇK-së përgjegjës për funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut.

4. Haradin Bala u akuzua për përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, me pretendimin se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonjë mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi

¹ Bala Notice of Appeal, 30 December 2005; Prosecution Notice of Appeal, 30 December 2005/Njoftim për Apel i Balës 30 dhjetor 2005, Njoftim për Apel i Prokurorisë, 30 dhjetor 2005.

krimet e lartpërmendura. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve në kamp-burgun e Llapushnikut, në marrjen e tyre në pyetje, në sulme, keqtrajtimin dhe torturat ndaj tyre, si dhe në vrasjen e të burgosurve në kamp-burg dhe në Malet e Berishës. Haradin Bala nuk u akuzua sipas Nenit 7 (3) të Statutit.

5. Aktakuza e ngarkoi Isak Musliun me përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit, me pretendimin se ai kreu, planifikoi, nxiti, urdhëroi ose në ndonjë mënyrë tjetër ndihmoi dhe inkurajoi krimet e lartpërmendura, përveç vrasjeve të kryera në Malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date. Pretendohet se ai mori pjesë personalisht në zbatimin e burgimit të civilëve, si dhe në marrjen e tyre në pyetje, në sulmet, keqtrajtimin, torturat dhe vrasjen e të burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithashtu Isak Musliu u akuzua për përgjegjësi si epror sipas Nenit 7(3) të Statutit lidhur me disa nga këto shkelje, e cila pretendohet se buron prej pozitës së tij komanduese dhe kontrolluese mbi ushtarët e UÇK-së të cilët shërbyen si rojë në kamp-burgun e Llapushnikut.

6. Më 30 nëntor 2005, Dhoma Gjyqësore e shpalli Haradin Balën fajtor bazuar në Nenin 7(1) të Statutit për veprat penale të torturës, trajtimit mizor dhe vrasjes si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës në bazë të Nenit 3 të Statutit (Pikat 4, 6 dhe 10). Për sa u përket të tëra pikave të tjera të Aktakuzës, Dhoma Gjyqësore e shpalli Haradin Balën të pafajshëm. Në lidhje me krimet për të cilat u shpall fajtor, Haradin Bala u dënua me 13 vjet burgim. Fatmir Limaj dhe Isak Musliu u shpallën të pafajshëm për të tëra pikat e Aktakuzës. Prokuroria ka apeluar shpalljen e pafajësisë për Fatmir Limajn, Isak Musliun dhe Haradin Balën. Gjithashtu Prokuroria ka apeluar dënimin e përcaktuar nga Dhoma Gjyqësore ndaj Haradin Balës për krimet në lidhje me të cilat u shpall fajtor.² Haradin Balaj ka apeluar kundër fajësimit dhe dënimit të tij.³

7. Dhoma e Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të Palëve në lidhje me këto apele më 5 dhe 6 qershor 2007. Pasi ka shqyrtuar parashtrimet gojore dhe me shkrim prej Prokurorisë dhe të Akuzuarve, Dhoma e Apelit do të shqiptojë Vendimin e saj

² See Prosecution Appeal Brief, 15 March 2006/Shih Dosjen e Apelit të Prokurorisë, 15 mars 2006

³ See Bala Appeal Brief, 9 May 2006/Shih Dosjen e Apelit të Balës, 9 May 2006.

II. STANDARDI PËR SHQYRTIMIN E APELIMEVE

8. Në apel, argumentet e palëve duhet të përqëndrohen në gabimet ligjore që shfuqizojnë aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore dhe në gabime faktuale që shkaktojnë dështimin e drejtësisë sipas kuptimit të Nenit 25 të Statutit. Këto kritere janë të mirëpërcaktuara prej Dhomave të Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar⁴ dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”).⁵ Në rrethana të veçanta, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë edhe apeline ku një palë ka ngritur një problem ligjor që nuk e shfuqizojnë aktgjykimin, mirëpo gjithsesi është i një rëndësie më të gjerë për jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar.⁶

9. Pala që pretendon ekzistencën e gabimit ligjor duhet të identifikojë gabimin e pretenduar, të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimit të vetë dhe të shpjegojë arsyen pse gabimi shfuqizon aktgjykimin. Pretendimi i një gabimi ligjor që nuk ka asnjë mundësi të ndryshojë rezultatin e një aktgjykimi mund të hidhet poshtë për këtë arsye.⁷ Edhe sikur argumentet e palës të jenë të pamjaftueshme në mbështetje të pretendimit të gabimit, gjithsesi Dhoma e Apelit për arsye të tjera mund konkludojë se ekziston gabim ligjor.⁸

10. Dhoma e Apelit shqyrton përfundimet ligjore të Dhomës Gjyqësore për të përcaktuar nëse janë ose nuk janë të sakta.⁹ Nëqoftëse Dhoma e Apelit gjen një gabim ligjor në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore që buron prej zbatimit të standardit të gabuar ligjor prej Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit do të qartësojë standardin e saktë ligjor dhe rrjedhimisht do të shqyrtojë përfundimet përkatëse faktuale të Dhomës Gjyqësore.¹⁰ Në këtë mënyrë, Dhoma e Apelit jo vetëm

⁴ See, e.g., *Blagojević and Jokić* Appeal Judgement, para 6; *Brdanin* Appeal Judgement, para. 8; *Galić* Appeal Judgement, para. 6; *Stakić* Appeal Judgement, para. 7; *Kvočka et al.* Appeal Judgement, para. 14; *Vasiljević* Appeal Judgement, paras 4-12; *Kunarac et al.* Appeal Judgement, paras 35-48; *Kupreškić et al.* Appeal Judgement, para. 29; *Čelebići* Appeal Judgement, paras 434-435; *Furundžija* Appeal Judgement, paras 34-40; *Tadić* Appeal Judgement, para. 64./Shih për shembull Aktgjykimin e Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 6; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 6; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafi 14; Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragrafët 4-12; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafët 35-48; Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 29; Aktgjykimi i Apelit Čelebiqi dhe të tjerët, paragrafët 434-435; Aktgjykimi i Apelit Furungjija, paragrafët 34-40; Aktgjykimi i Apelit Tadiq, paragrafi 64.

⁵ Shih Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 6; *Kajelijeli* Appeal Judgement, para. 5;/Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli* paragrafi 5; *Semanza* Appeal Judgement, para. 7;/Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, paragrafi 7;/ *Musema* Appeal Judgement, para. 15;/Aktgjykimi i Apelit *Musema*, paragrafi 15;/ *Akayesu* Appeal Judgement, para. 178;/Aktgjykimi i Apelit *Akayesu*, paragrafi 178;/ *Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgement, paras 177, 320./Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, paragrafët 177, 320. Në Statutin e TPNR-së/Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën/. dispoziata përkatëse është Neni 24.

⁶ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 6; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 6; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 22; Aktgjykimi i Apelit Tadiq, paragrafi 247.

⁷ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 7; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafi 16 ku citohet Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac/Krnojelac* paragrafi 10.

⁸ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 7; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafi 16; Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe *Çerkez/Kordić and Čerkez*/ paragrafi 16; Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragrafi 6; Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 26; Shih edhe Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura*, paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit *Kambanda*, paragrafi 98.

⁹ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 8; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, paragrafi 10.

¹⁰ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiq, paragraf 8; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafi 17; Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe *Çerkez* paragrafi 17; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq/ Blaškić*, paragrafi 15.

që korigjon gabimin ligjor por gjithashtu zbaton standarin e saktë ligjor në lidhje me provat e administruara gjatë procesit gjyqësor kurdoherë që nevojitet dhe përcakton nëse është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me përfundimin faktual të kundërshtuar prej Mbrojtjes para konfirmimit të këtij përfundimi në apel.¹¹ Dhoma e Apelit nuk do të shqyrtojë në tërësi dokumentacionin e procesit gjyqësor sërish. Në fakt, ajo përgjithësisht do të shqyrtojë vetëm provat e përmendura nga Dhoma Gjyqësore në aktgjykim ose në një poshtëshënim përkatës, provat e administruara gjatë procesit gjyqësor dhe të cilave u referohen palët dhe provat shtesë të pranuar në apel.¹²

11. Në lidhje me pretendimet e një gabimi në një çështje ligjore, Dhoma e Apelit gjykon se standardet e shqyrtimit janë të njëjta për apelimet prej Mbrojtjes dhe Prokurorisë. Pala apeluese e cila pretendon se Dhoma Gjyqësore kreu gabim në një çështje ligjore, duhet të provojë se gabimi e bën të pavlefshëm aktgjykimin.¹³

12. Në shqyrtimin e gabimeve të pretenduara faktuale në apeline nga Mbrojtja, Dhoma e Apelit do të përcaktojë nëse një gjykues i arsyeshëm i fakteve do të mund të arrinte në verdiktin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.¹⁴ Dhoma e Apelit zbaton të njëjtin standard arsyeshmërie ndaj gabimeve të pretenduara faktuale pavarësisht faktit nëse vërtetimi i faktit u bazua në prova të drejtpërdrejta apo rrethore.¹⁵ Për të përcaktuar nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të kishte arritur ose jo në përfundimin e Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit “nuk do t’i ndryshojë aspak përfundimet faktuale të Dhomës Gjyqësore”.¹⁶ Dhoma e Apelit kujton si parim të përgjithshëm, qëndrimin e mbajtur nga Dhoma e Apelit në *Kupreshkiq*, ku u deklarua

Bazuar në jurisprudencën e Tribunalit, detyra e dëgjimit, vlerësimit dhe peshimit të provave të paraqitura në gjyq i është lënë kryesisht Dhomës Gjyqësore. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit duhet të demonstrojë një farë respekti në lidhje me përcaktimin e një fakti prej Dhomës Gjyqësore. Vetëm nëqoftëse provat e shfrytëzuara nga Dhoma Gjyqësore nuk do të mund të pranoheshin prej asnjë gjykuesi të arsyeshëm faktesh ose nëqoftëse vlerësimi i provave është “tërësisht i gabuar”, Dhoma e Apelit mund ta zëvendësojë përfundimin e Dhomës

¹¹ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragraf 8; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 17; Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Çerkez paragrafi 17; Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 15.

¹² Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 15; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 8; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Çerkez paragrafi 21, poshtëshënim 12.

¹³ Shih Aktgjykimin e Apelit *Bagilishema*, paragrafi 9.

¹⁴ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragraf 9; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 18; Aktgjykimi i Apelit Kordiq dhe Çerkez paragrafi 18; Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 16; Aktgjykimi i Apelit Çelebiq, paragrafi 435; Aktgjykimi i Apelit Furungjija, paragrafi 37; Aktgjykimi i Apelit Aleksovski, paragrafi 63; Aktgjykimi i Apelit Tadiq, paragrafi 64.

¹⁵ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragrafi 226; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 220; Aktgjykimi i Apelit Çelebiq, paragrafi 458. Po ashtu nuk ka rëndësi nëse provat janë të drejtpërdrejta ose rrethore në lidhje me standardin e vërtetimit në gjyq, ku i akuzuari mund të shpallet fajtor për një krim vetëm nëqoftëse Prokuroria ka provuar çdo element të atij krimi dhe kategorinë përkatëse të përgjegjësisë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Shih Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 219; Aktgjykimi i Apelit Çelebiq, paragrafi 458.

¹⁶ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Furungjija, paragrafi 37 që i referohet Aktgjykimit të Apelit Tadiq, paragrafi 64. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 19; Aktgjykimi i Apelit Kërmojelac paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit Aleksovski, paragrafi 63; Aktgjykimi i Apelit *Musema*, paragrafi 18.

Gjyqësore me përfundimin e saj,¹⁷

13. Dhoma e Apelit e TPNR-së në çështjen *Rutaganda* dhe *Bagilishema* përcaktoi se edhe në rastin e apelimit të Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë zbatohet i njëjti standard arsyeshmërie dhe i njëjti respekt ndaj përfundimeve faktuale të Dhomës Gjyqësore. Dhoma e Apelit do të konkludojë se është kryer gabim faktual vetëm kur konkludon se asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të mund të arrinte në përfundimin e kundërshtuar.¹⁸ Sipas Nenit 25(1)(b) të Statutit, Prokuroria po ashtu si të Akuzuarit duhet të provojë “një gabim faktual që shkaktoi dështimin e drejtësisë”. Që gabimi të shkaktojë dështim të drejtësisë, ai duhet të ketë qenë “kyç në vendimin e marrë”.¹⁹ Duke marrë parasysh se Prokuroria ka detyrimin që gjatë gjyqit të provojë fajësinë e të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, rëndësia e gabimit faktual që shkakton dështim të drejtësisë është disi e ndryshme ndërmjet apelimit të Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë dhe apelimit prej Mbrojtjes kundër fajësimin. I Akuzuari duhet të provojë se gabimet faktuale të Dhomës Gjyqësore krijojnë dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë e tij. Prokuroria duhet të provojë se marrja parasysh e gabimeve faktuale të kryera prej Dhomës Gjyqësore, eliminon çdo dyshim të arsyeshëm të fajësisë së të akuzuarit.²⁰

14. Në apelim një palë nuk mund të përsërisë thjesht argumentet që nuk patën sukses gjatë gjykimit, nëqoftëse pala nuk mund të provojë se refuzimi i tyre prej Dhomës Gjyqësore shkaktoi një gabim të tillë që përlligj ndërhyrjen e Dhomës së Apelit.²¹ Argumentet e një pale që nuk kanë gjasë të shkaktojnë shfuqizimin ose rishikimin e aktgjykimit të kundërshtuar hidhen poshtë menjëherë prej Dhomës së Apelit dhe nuk është e nevojshme të shqyrtohen vlerat e tyre.²²

15. Që Dhoma e Apelit të vlerësojë argumentet e palëve në apel, pritet që pala apeluese të ofrojë referenca të sakta të faqeve përkatëse të transkriptit ose paragrafëve në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore ndaj të cilave janë bërë kundërshtime.²³ Gjithashtu, “nuk mund të pritet që Dhoma e

¹⁷ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 9; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 14; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 19 ku citohet Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 30. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Kordi dhe Çerkez paragrafi 19 psh 11; Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafët 17-18.

¹⁸ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 9.

¹⁹ Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq, paragrafi 29.

²⁰ Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda* paragrafi 24; Aktgjykimi i Apelit *Bagilishema* paragrafët 13-14. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 9; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 14.

²¹ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 10; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 16; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli* paragrafi 6 ku citohet Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, paragrafi 9. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, paragrafi 18.

²² Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 10; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 16; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit *Niagerura*, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, paragrafi 6 ku citohet Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, paragrafi 9; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, paragrafi 18.

²³ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Joki, paragraf 11; Practice Direction on Appeals Requirements, para 4(b)/Udhëzim për Praktikën Kushtetive në lidhje me Apelit/, paragrafi 4(b). Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 15; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 12; Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 13; Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragrafi 11; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli* paragrafi 7; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, paragrafi 10; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, paragrafi 19; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, paragrafi 137.

Apelit të shqyrtojë në hollësi argumentet e një pale nëqoftëse ato janë të paqarta, kundërthënëse, të mjegullta ose kanë mangësi të tjera formale dhe të dukshme”.²⁴

16. Duhet rikujtuar se Dhoma e Apelit ka kompetencë të vetvetishme në përzgjedhjen e argumenteve që meritojnë një arsytim të hollësishëm me shkrim.²⁵ Për më tepër, Dhoma e Apelit, pa dhënë arsytim të hollësishëm, mund të hedhë poshtë argumente të cilat janë dukshëm të pabazuara.²⁶

III. APELI I HARADIN BALËS

17. Haradin Bala paraqet pesë arsye për apelim:²⁷ së pari se Dhoma Gjyqësore e identifikoi atë pasaktësisht si Shala, rojë burgu në kamp-burgun e Llapushnikut;²⁸ së dyti se Dhoma Gjyqësore gaboi në përcaktimin se ai ishte i pranishëm dhe mori pjesë personalisht në vrasjet e kryera në Malet e Berishës;²⁹ së treti se Dhoma Gjyqësore gaboi në përcaktimin se ai shkaktoi trajtim mizor ndaj Dëshmitar L12;³⁰ së katërti se Dhoma Gjyqësore gabimisht hodhi poshtë mbrojtjen e tij nëpërmjet alibisë;³¹ dhe së pesti se Dhoma Gjyqësore gjykoj gabimisht se Dëshmitarët L04 dhe L06 ishin të besueshëm, përcaktim që shkaktoi gabime faktuale dhe dështim të drejtësisë.³² Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në asnjë prej këtyre përfundimeve

A. Pika e parë e apelit të Haradin Balës: pretendimi për identifikim jo të saktë të Haradin Balës si roja i burgut “Shala”

18. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor dhe faktual kur konkludoi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ishte roja “Shala” i cili kreu krimet për të cilat u fajësua. Haradin Bala pretendon katë gabime në kontekstin e pikës së parë të apelit të tij. Së pari, se duke mos u kushtuar rëndësi mosidentifikimeve prej tre dëshmitarëve pamorë, Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi parimin *in dubio pro reo*;³³ së dyti, se mosdhënia rëndësi e mosidentifikimit përbën

²⁴ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragraf 11; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragraf 11; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragraf 12; Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragraf 12; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafët 43, 48; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragraf 10; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura*, paragraf 13; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, paragraf 7; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, paragraf 10.

²⁵ Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragraf 16; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragraf 12; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragraf 13; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragraf 47; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragraf 10; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura*, paragraf 14; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, paragraf 8.

²⁶ Aktgjykimi i Apelit Bllagojeviq dhe Jokiç, paragraf 11; Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragraf 16; Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragraf 12; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragraf 13; Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragraf 12; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragraf 48; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragraf 10; Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura*, paragraf 14; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, paragraf 8; Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*, paragraf 11; Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*, paragraf 19.

²⁷ Bala nuk vazhdon më tej me pikën e tretë, të pestë, të shtatë dhe të nëntë të apelit të tij të parashtruara në Njoftimin për Apel; Notice of Withdrawal of Grounds of Appeal, 9 May 2006/Njoftim për Heqjen e Pikave të Apelit, 9 maj 2006.

²⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 14-125.

²⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 126-176.

³⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 177-182.

³¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 183-244.

³² Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 245-266.

³³ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 28-46.

shfuqizim të detyrimit të provës;³⁴ së treti, se Dhoma Gjyqësore u mbështet gabimisht në identifikimet në sallën gjyqësore;³⁵ dhe së katërti se në vlerësimin e provave, Dhoma Gjyqësore nuk mori parasysh forcën e dëshmive, veças dhe në tërësi dhe i shqyrtoi provat vetëm në mbështetje të identifikimit të duhur të Shalës dhe jo kundër tij.³⁶

1. A e zbatoi Dhoma Gjyqësore parimin *in dubio pro reo*

19. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor kur nuk i kushtoi rëndësi paaftësisë së tre dëshmitarëve pamorë, Vojko Bakraç, Dëshmitari L04 dhe Dëshmitari L06, për ta identifikuar atë si roja i njohur si Shala në një fotomontazh, me pasjë moszbatimin ose keqzbatimin e parimit *in dubio pro reo*.³⁷ Ai argumenton se në mungesë të provave shpjeguese pse dëshmitarët nuk qenë në gjendje ta identifikonin atë si roja i njohur si Shala, Dhoma Gjyqësore duhej të kishte proceduar mbi një pandehmë në dobi të tij.³⁸ Rrjedhimisht duhej të kishte konkluduar se arsyeja që dëshmitarët nuk e identifikuan atë në fotomontazh ishte sepse ata nuk e njohën atë si roja i njohur si Shala.

20. Prokuroria përgjigjet se i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirrte Dhoma Gjyqësore ishte se Haradin Bala u identifikua në mënyrën e duhur si roja i njohur si Shala.³⁹ Gjithashtu ajo argumenton se parimi *in dubio pro reo* nuk zbatohet për pjesë të veçanta të dëshmive, por vetëm për elementë të veprës penale dhe konkludimin përfundimtar të fajësisë.⁴⁰ Rrjedhimisht argumentohet se Dhoma Gjyqësore nuk keqzbatoi standardin e provës kur bazuar në tërësinë e provave, konkludoi se Haradin Bala u identifikua në mënyrën e duhur si roja i njohur si Shala.⁴¹ Duke u mbështetur në Aktgjykimin Dënues të çështjes *Tadiq*, Haradin Bala kundërpërgjigjet se zbatimi i parimit *in dubio pro reo* “nuk është kufizuar asnjëherë në konkludimin përfundimtar të fajësisë.”⁴²

(a) A kufizohet zbatimi *in dubio pro reo* në konkludimin përfundimtar të fajësisë

21. Dhoma e Apelit është e bindur se parimi *in dubio pro reo* si rrjedhojë e supozimit të pafajësisë dhe detyrimit të vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm⁴³, gjen zbatim në përfundimet

³⁴ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 47-55.

³⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 63-95.

³⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 96-122. Shih edhe AT 34-37 dhe 81-82 (5.6.2007).

³⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 28.

³⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 32, 45.

³⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 1.31.

⁴⁰ Prosecution Response Brief/Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 1.33-1.34

⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 1.37.

⁴² Bala Reply Brief/Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 6. Shih edhe AT 48-49 (5.6.2007)

⁴³ Shih Aktgjykimin Çelebiqi, paragrafi 601. Shih edhe Christine V.D. Wyngaert (ed.), Criminal Procedure Systems in the European Community/Sistemet e Procedurës Penale në Bashkësinë Evropiane/ Butterworths, London (1993) në 21 (Belgjikë), 148 (Gjermani), 324 (Portugali),

e nevojshme për përcaktimin e fajësisë të tilla si përbërësit e elementëve të krimit të akuzuar. Kjo përjasje është në përputhje me jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar dhe është logjike duke marrë parasysh se në kontekstin e çështjeve faktuale, parimi është kryesisht vetëm një prej aspekteve të kushtit të përcaktimit të fajësisë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁴⁴ Në *Naletiliq dhe Marinoviq*, Dhoma e Apelit pranoi zbatueshmërinë e këtij parimi në lidhje me gjendjen mendore kriminale të kërkuar për dijeninë e ekzistencës së konfliktit të armatosur.⁴⁵ Edhe Dhoma Gjyqësore në *Naletiliq dhe Marinoviq* e zbatoi parimin në kontekstin e krimit të torturës: Ajo konkludoi se provat nuk i mundësonin Dhomës të bënte dallim midis rrahjeve të kryera me një qëllim të caktuar, kusht për përcaktimin e krimit të torturës, dhe rrahjeve që mund kenë qenë thjesht mizori, por pa synim të caktuar. Për pasojë në lidhje me parimin *in dubio pro reo*, Dhoma Gjyqësore konkludoi se synimi i caktuar i nevojshëm për torturë nuk ishte vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁴⁶ Gjithashtu, parimi *in dubio pro reo* nuk gjen zbatim në pjesë të caktuara të provave dhe përcaktimit të fakteve të cilat nuk i shërbejnë aktgjykimit. Për shembull, në *Kvoçka dhe të tjerët.*, Dhoma e Apelit e hodhi poshtë argumentin e Përçaqit se Dhoma Gjyqësore nuk iu përmbajt parimit kur konkludoi se Përçaq ishte ndihmës administrativ në kampin Oharska.⁴⁷ Dhoma e Apelit gjykoj se përfundimi se Përçaq ishte ndihmës administrativ nuk ishte fakt që synonte fajësimin ose një element të krimit të akuzuar, dhe rrjedhimisht parimi *in dubio pro reo* nuk ishte i zbatueshëm.

dhe Christoph J. M. Safferling, *Towards an International Criminal Procedure/Drejt një Procedure Penale Ndërkombëtare*, OUP, New York (2001) në 260.

⁴⁴ Shih Aktgjykimin e Apelit Naletiliq dhe Martinoviq/ *Naletilić and Martinović*, paragrafi 120; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafët 102-103, Aktgjykimi Dhomës Gjyqësore Naletiliq dhe Martinoviq, poshtëshënimi 1100. Shih edhe *Tadić* Appeal Decision on Jurisdiction/Vendimi i Apelit Tadiq në lidhje me Juridiksionin, paragrafi 143.

⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Martinoviq, paragrafi 120.

⁴⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Naletiliq dhe Martinoviq, poshtëshënimi 1100.

⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafët 623-624

(b) Zbatimi i parimit *in dubio pro reo*

22. Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Haradin Bala ka vërtetuar që Dhoma Gjyqësore keqzbatoi parimin *in dubio pro reo* për identifikimin e tij si roja i njohur si Shala. Dhoma Gjyqësore i vlerësoi të tëra provat në mënyrë të arsyeshme, ndër të cilat edhe mosidentifikimin e Haradin Balës prej tre dëshmitarëve pamorë,⁴⁸ alibinë e tij dhe gjendjen e tij shëndetësore në periudhën përkatëse⁴⁹ dhe konkludoi se “nuk kishte mbetur asnjë dyshim i arsyeshëm”⁵⁰ se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala pavarësisht gjasave për identifikime të gabuara.

2. A e zhvlerësoi Dhoma Gjyqësore detyrimin e provës

23. Më tej Haradin Bala argumenton se mosmarrja parasysh e tre mosidentifikimeve fotografike prej Vojko Bakraçit, Dëshmitarit L04 dhe Dëshmitarit L12 nga ana e Dhomës Gjyqësore e shfuqizoi detyrimin e provës e për pasojë shkaktoi një gabim ligjor.⁵¹ Haradin Bala argumenton se detyrimi i provës kërkon që Prokuroria të vërtetojë çdo element të akuzës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm;⁵² rrjedhimisht Prokurorisë duhej t’i ishte kërkuar të provonte se mosidentifikimet nuk u shkaktuan prej faktit se dëshmitarët nuk e njohën atë.⁵³ Prokuroria përgjigjet se detyrimi i provës zbatohet për provat në tërësi dhe jo për çdo fakt në veçanti.⁵⁴

24. Në Aktgjykimin e saj, Dhoma Gjyqësore gjatë diskutimit të detyrimit të provës për Prokurorinë për vërtetimin e identifikimit të të Akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, me të drejtë deklaroi se:

Pesha përfundimtare që i jepet çdo elementi të rëndësishëm të dëshmive, duke përfshirë çdo identifikim të veçantë pamor ku më shumë se një dëshmitar ka identifikuar një të Akuzuar, nuk mund të përcaktohet ndarasi. Megjithëse çdo identifikim pamor dhe çdo element tjetër përkatës i dëshmive, trajtuar ndarasi, mund të mos jenë të mjaftueshëm për të plotësuar detyrimin e provës që ka Prokuroria, është efekti plotësues i dëshmive, pra tërësia e dëshmive që lidhet me identifikimin e një të Akuzuarit, që duhet të vlerësohet për të vendosur nëse Prokuroria ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se çdo i Akuzuar është kryes sipas akuzave të bëra⁵⁵

Rrjedhimisht Prokurorisë nuk iu kërkuar të përcaktonte arsyet për mosidentifikimin me fotomontazh sepse Dhoma Gjyqësore ishte e bindur se ndikimi konfirmues/përsëritës i provave të tjera në identifikimin e Haradin Balës si roja, Shala, e vërtetonte këtë fakt jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

⁴⁸ Trial Judgement/Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 627-628.

⁴⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 649-650.

⁵⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 650.

⁵¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 47-55.

⁵² Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 47, 50

⁵³ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 50

⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 1.33

⁵⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 20 citon nga Prokurorja kundër Kunaracit, Decision on Motion for Acquittal/Vendim në lidhje me Mocionin për Lirimin prej Akuzave, Lënda Nr. IT-96-23-T, 3 korrik 2000, paragrafi 4: “Një tribunal faktesh kurrë nuk duhet të marrë parasysh dëshminë e çdo dëshmitari ndarazi sikur të ekzistonte në një kuti të mbyllur dhe të vulosur; është tërësia e *krejt* dëshmive për një çështje që duhet marrë në konsideratë”.

Detyrimi që Prokuroria të vërtetojë faktet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nuk kërkon domosdoshmërisht që Prokuroria të vërtetojë se çdo provë në veçanti vërteton në mënyrë të pavarur faktin përkatës në bazë të standardit.

3. A gaboi Dhoma Gjyqësore në shfrytëzimin e identifikimeve në sallën e gjyqit

25. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur u mbështet në identifikimet e tij si roja i njohur si Shala në sallën e gjyqit, prej Dëshmitarëve L04, L06, L07, L10, L12 dhe L96, me përjashtim vetëm të një identifikimi “të panjollësor” prej Ivan Bakraçit.⁵⁶ Ai gjithashtu argumenton se identifikimeve në sallën e gjyqit nuk u duhet dhënë vlerë provuese për shkak të mosaktësisë së tyre.⁵⁷ Gjithashtu ai pretendon se në veçanti katër rrethana e bëjnë më të theksuar mosbesueshmërinë e këtyre identifikimeve. Së pari fakti se të tërë dëshmitarët të cilët bënë identifikime në sallën e gjyqit e kishin parë atë në televizion para se të jepnin dëshminë;⁵⁸ së dyti, se Dëshmitarët L04, L06, L10 dhe L12 kanë lidhje familje ose njohje me njeri-tjetrin dhe kishin mundësinë dhe motivimin që ta diskutonin çështjen para dhënies së dëshmisë;⁵⁹ së treti se Dhoma Gjyqësore nuk duhej t’u kishte kushtuar rëndësi identifikimeve në sallën e gjyqit prej Dëshmitarëve L04 dhe L12 duke qenë se më parë ata nuk kishin mundur ta identifikonin atë si roja i njohur si Shala në fotomontazh;⁶⁰ dhe së katërti ai argumenton se gabimisht Dhoma nuk mori parasysh tre mosidentifikimet nga fotomontazhi.⁶¹ Gjithashtu Haradin Bala thekson se në përgjigje Prokuroria pranoi se Vojko Bakraçit iu tregua e njëjta fotografi e cilësisë së lartë e Haradin Balës që iu tregua edhe Ivan Bakraçit. Rrjedhimisht bie e vetmja arsye e Dhomës Gjyqësore për mosdhënien rëndësi të këtij mosidentifikimi prej Vojko Bakraçit të Haradin Balës si roja i njohur si Shala, gjegjësisht se fytyra e Haradin Balës në këtë fotografi thuhetse nuk dallohej.⁶²

26. Prokuroria pranon se identifikimeve në sallën e gjyqit nuk duhet t’u jepet vlerë provuese,⁶³ dhe pranon se megjithëse në një masë të vogël, Dhoma Gjyqësore u kushtoi një farë rëndësie identifikimeve në sallën e gjyqit.⁶⁴ Mirëpo Prokuroria argumenton se ky gabim nuk e shfuqizon përfundimin,⁶⁵ duke qenë se prova të tjera vërtetojnë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Haradin

⁵⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 64, Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 9.

⁵⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 65 ku citohet Aktgjykimi i Apelit Kamahunda, paragrafi 243; Vendimi në lidhje me Mocionin për Lirimin prej Akuzave Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 19; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 320; Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 3. Shih edhe AT 39-42 (5.6.2007)

⁵⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 67.

⁵⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 69.

⁶⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 70, Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafët 19, 28.

⁶¹ Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafët 10-28.

⁶² Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 18.

⁶³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para 1.4.

⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para 1.6.

⁶⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 1.6, 1.10. Shih edhe AT 47 (5.6.2007).

Bala ishte roja i njohur si Shala.⁶⁶ Konkretisht Prokuroria i referohet identifikimeve në fotomontazh prej Ivan Bakraçit dhe Dëshmitarit 96 si prova që tregojnë se pseudonimi i Haradin Balës ishte Shala dhe si prova që identifikojnë Haradin Balën si Shala në bazë të përshkrimit. Më tej Prokuroria i referohet dëshmisë së Dëshmitarit L07 në lidhje me takimin e tij me Shalën i cili u vetidentifikua si Haradin Bala dhe si provë e pranisë së Haradin Balës në fshatin Llapushnik. Prokuroria pretendon se këto prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala.⁶⁷

27. Dhoma e Apelit pajtohet me të dyja palët se identifikimeve në sallën e gjyqit nuk duhet t'u kushtohet vlerë provuese.⁶⁸ Ashtu si u arsyetua edhe prej Dhomës Gjyqësore *Kumaraç* identifikimet në sallën gjyqësore prej natyre janë të pasakta “sepse të tëra rrethanat e procesit gjyqësor pashmangshmërisht e bëjnë një dëshmitar të tillë të identifikojë personin në gjyq”.⁶⁹ Kjo është konfirmuar në Aktgjykimet e Apelit *Kunarac* dhe *Kamuhanda*.⁷⁰

28. Për rastin në fjalë, Dhoma Gjyqësore deklaroi se ishte “shumë e ndërgjegjshme se identifikimi i të Akuzuarit në sallën gjyqësore fare mirë mund të ndikohet në mënyrë të papërshtatshme dhe të pavetëdijshme prej vendndodhjes fizike të të Akuzuarit dhe faktorëve të tjerë që e vënë të Akuzuarin në qendër të vëmendjes në sallën gjyqësore.”⁷¹ Gjithashtu në lidhje me identifikimet në gjyq bërë prej Dëshmitarëve L04 dhe L12, Dhoma Gjyqësore theksoi se ata mund të kenë gabuar për shkak të mosidentifikimeve të mëparshme prej Dëshmitarëve të Haradin Balës si roja i njohur si Shala në një fotomontazh.⁷² Dhoma gjithashtu mori parasysh faktin se të tërë dëshmitarët që bënë identifikimin në gjyq të Haradin Balës si roja i njohur si Shala, e kishin parë Haradin Balën në televizion para dhënies së dëshmisë dhe deklaroi se nuk ishte e bindur mbi bazën e dëshmive të dëshmitarëve të veçantë se Haradin Bala ishte identifikuar si roja Shala jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁷³ Gjithsesi, pavarësisht problemeve të saktësisë së identifikimeve në gjyq, Dhoma Gjyqësore pranoi dëshminë e secilit prej gjashtë dëshmitarëve të cilët bënë identifikim në gjyq (Dëshmitarët L04, L06, L07, L10, L12 dhe L96) si prova që mund të përdoren së bashku me prova të tjera identifikuese dhënë nga dëshmitarë të tjerë. Gjithashtu në nxjerrjen e përfundimit se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala, Dhoma Gjyqësore nuk bëri dallime midis

⁶⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 1.10-1.13.

⁶⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 1.13. Shih po aty paragrafin 1.12 që i referohet Aktgjykimet të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 603-632. Shih edhe AT 49-63 (5.6.2007).

⁶⁸ Gjithsesi mosidentifikimi i një të akuzuarit në gjyq mund të shërbejë si arsye për mosbazimin në dëshminë e një dëshmitari identifikues. Shih në lidhje me këtë Aktgjykimin e Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 473.

⁶⁹ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 562.

⁷⁰ Aktgjykimin i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 320; Aktgjykimin i Apelit Kamuhanda, paragrafi 243;

⁷¹ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 18 ku citohet Profesori Willem Wagenaar. T. 7410; prova materiale. DM7; shih edhe Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore Vasiljeviq, paragrafi 19.

⁷² Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 627.

⁷³ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 607, 610, 611, 613, 614, 616, 627, 631.

identifikimeve në gjyq dhe provave të tjera të dhëna nga dëshmitarët, përfshirë këtu edhe përshkrimet e tyre për Haradin Balën gjatë dhënies së dëshmisë. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore u kushtoi një farë rëndësie identifikimeve në gjyq dhe për aq sa u dha rëndësi, bëri gabim.⁷⁴ Ndikimi i këtij gabimi mbi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala do të përcaktohet më vonë në këtë Aktgjykim.⁷⁵

4. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk u kushtoi rëndësi mosidentifikimeve

29. Tre dëshmitarë - Vojko Bakraç, Dëshmitari L04 dhe Dëshmitari L12 nuk ishin në gjendje të vinin gishtin mbi Haradin Balën si roja i njohur si Shala në një fotomontazh ku ishte edhe fotografia e tij.⁷⁶ Tre dëshmitarë të tjerë (Ivan Bakraç, Dëshmitari L96 dhe Dëshmitari L64) zgjodhën Haradin Bala si roja i njohur si Shala në fotomontazh, megjithëse Dhoma Gjyqësore ishte mosbesuese ndaj ndershmërisë dhe besueshmërisë së dy prej këtyre tre dëshmitarëve - Dëshmitarit L96 dhe Dëshmitarit L64. Dëshmitarët L06, L07 dhe L10 identifikuan Haradin Balën në gjyq si roja Shala, pa iu kërkuar më parë ta identifikonin Shalën në fotomontazh.⁷⁷ Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk u kushtoi rëndësi këtyre mosidentifikimeve.⁷⁸

30. Në shqyrtimin e këtij pretendimi Dhoma e Apelit kujton përfundimin e saj në *Kupreshkiq dhe të tjerët*.

se një Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme duhet të marrë parasysh vështirësitë që lidhen me provat identifikuese në një çështje dhe duhet të shqyrtojë çdo provë të tillë, para se ta pranojë si baza e vetme e fajësisë. Sistemet shtetërore të së drejtës penale në mbarë botën njohin nevojën e kujdesit të jashtëzakonshëm në procedimin mbi fajësinë e një personi të akuzuar bazuar në dëshminë identifikuese të një dëshmitari bërë në rrethana të vështira. Parimet e përpunuara në këto juridiksione i pranojnë mangësitë e perceptimit njerëzor dhe rrezikun tepër serioz se dështimi i drejtësisë mund të burojë prej mbështetjes edhe në dëshmitarin më vetëbesues i cili pretendon se e ka identifikuar të akuzuarin pa patur mundësinë e mjaftueshme për verifikimin e vëzhgimeve të tyre.⁷⁹

Pas krahasimit të disa sistemeve shtetërore të së drejtës penale në lidhje me çështjen e dëshmimeve identifikuese, Dhoma e Apelit deklaroi në *Kupreshkiq dhe të tjerët*:

Gjykatat shtetërore kanë identifikuar faktorët vijues si të rëndësishëm në lidhje me përcaktimin prej një gjykatë nëse vendimi i një gjykuesi faktesh për t'u mbështetur në dëshmi identifikuese ishte i paarsyeshëm ose e bën dënimin të pabazuar; identifikimi i të akuzuarit prej dëshmitarëve të cilët e panë të akuzuarin vetëm kalimthi ose patën pamje të kufizuar të të akuzuarit; identifikime të bëra në errësisë dhe si rezultat i një përvoje tronditëse të

⁷⁴ Dhoma e Apelit thekson se megjithëse Dhoma Gjyqësore "pranoi ndershmërinë e shtatë dëshmitarëve identifikues," ajo më parë konkludoi se nuk ishte e bindur për ndershmërinë e Dëshmitarit L96 dhe rrjedhimisht u kushtoi rëndësi vetëm pjesëve materiale të dëshmisë së tij të cilat u konfirmuan prej dëshmimeve të të tjerëve: Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 26, 613.

⁷⁵ Shih më poshtë, paragrafi 33.

⁷⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 55. Shih provën materiale P83 "Fotomontazh"

⁷⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 71. Shih edhe Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 610, 611, 614.

⁷⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 23-27. Shih edhe AT 37-39 (5.6.2007).

⁷⁹ Aktgjykimin i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 34. Shih edhe Vendimi në lidhje me Mocionin për Lirimin prej Akuzave Kunarac dhe të tjerët, 3 korrik 2000, paragrafi 8.

dëshmitarit; dëshmi mospërputhëse ose e pasaktë mbi tiparet fizike të të akuzuarit në kohën e ngjarjes; keqidentifikim ose mohim i mundësisë së identifikimit pasuar prej identifikimit të mëvonshëm të të akuzuarit prej një dëshmitari; ekzistenca e dëshmimeve të papajtuësme të dëshmitarit; dhe një rikthim i vonuar i kujtesës së dëshmitarit në lidhje me të akuzuarin së bashku me “mundësinë e qartë” prej rrethanave që dëshmitari të jetë ndikuar prej sugjerimeve të të tjerëve.⁸⁰

Gjithashtu Dhoma e Apelit konstaton se dëshmitë identifikuese mund të ndikohen prej kohëzgjatjes së periudhës midis krimit dhe ballafaqimit.⁸¹

31. Në lidhje me tre mosidentifikimet dhe identifikimet në sallën gjyqësore, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore gjeti një dëshmi identifikuese veçanërisht bindëse; atë të Ivan Bakraçit. Konkretisht Dhoma Gjyqësore përcaktoi se Ivan Bakraçi ra në sy midis dëshmitarëve të tjerë për “kujdesin, ndershmërinë, zotësinë dhe [...] saktësinë që ai demonstroi në dhënien e dëshmisë dhe për shkak të mundësive që ai kishte patur në 1998 për të parë nga afër rojën në kamp-burg të cilin ai e njohu si Shala.”⁸² Ajo gjithashtu theksoi se Ivan Bakraçi “menjëherë dhe pa mëdyshje” e njohu Haradin Balën në një fotomontazh që iu tregua në 2003 dhe e identifikoi si roja që ai njihnte si Shala.⁸³

32. Dhoma e Apelit ka konkluduar më lart se Dhoma Gjyqësore nuk e shfuqizoi detyrimin e provës apo shkeli parimin *in dubio pro reo* kur pasi kishte shqyrtuar të tëra dëshmitë ndër të cilat edhe mosidentifikimin e Haradin Balës si roja i njohur si Shala nga Vojko Bakraçi, Dëshmitari L04 dhe Dëshmitari L12, përcaktoi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se në fakt Haradin Bala ishte Shala. Gjithashtu në vlerësimin e të tëra dëshmimeve në lidhje me identifikimin e Haradin Balës,⁸⁴ Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme i kushtoi rëndësi të konsiderueshme dëshmisë së Ivan Bakraçit dhe vetëm vlerë të pakët provuese dëshmimeve të identifikimit në gjyq. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk gjykon se Dhoma Gjyqësore do të kishte nxjerrë përfundim tjetër nëqoftëse nuk do të kishte marrë në konsideratë identifikimet në gjyq.

5. A gaboi Dhoma Gjyqësore në përmbledhjen e dëshmimeve

33. Gjithashtu Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi në përmbledhjen e dëshmimeve dhe nuk e zbatoi drejt standardin e vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm sepse nuk mori në konsideratë peshën në veçanti dhe tërësi të provave. Më tej ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi tërësinë e dëshmimeve por u përqëndrua vetëm në provat në dobi të identifikimit të tij në

⁸⁰ Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 40 (pa poshtëshënimet e brendshme)

⁸¹ Shih Corpus Juris Secundum, XXXIV. Identification Evidence in General, section 1095, updated November 2006./Provat identifikuese në Përgjithësi, kapitulli 1095, përditësua nëntor 2006.

⁸² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 624.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 20.

mënyrën e duhur si roja i njohur si Shala dhe jo kundër këtij identifikimi.⁸⁵ Ai argumenton se dëshmitë e pasakta nuk mund të bëhen thjesht të sakta vetëm se konfirmohen prej dëshmive të tjera të pasakta.⁸⁶ Po ashtu ai argumenton se Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e bilancit të gjasave në vend të vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në identifikimin e tij si Shala.⁸⁷ Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore i mori në konsideratë të tëra rrethanat, ndër të tjera edhe dëshmitë që kishin lidhje me shëndetin dhe alibinë e Haradin Balës dhe pasi i vlerësoi këto prova veç e veç dhe së bashku me dëshmitë identifikuese, përcaktoi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala.⁸⁸

34. Dhoma e Apelit thekson se ky argument thjesht përsërit argumentin e mëparshëm të Haradin Balës se Dhoma Gjyqësore keqzbatoi parimin *in dubio pro reo* dhe detyrimin e vërtetimit jashtë çdo dyshimi. Dhoma e Apelit tashmë ka konkluduar se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në këtë drejtim.

35. Si rezultat, me gjithë gabimin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me rëndësinë që iu kushtua identifikimeve në gjyq, pika e parë e apelit të Haradin Balës hidhet poshtë

B. Pika e dytë e apelit të Haradin Balës: pretendimi për përfundim të gabuar se Haradin Bala mori pjesë në vrasjet në Malet e Berishës

1. Argumentet e palëve

36. Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor dhe faktual kur konkludoi se ai ishte i pranishëm dhe mori pjesë personalisht në nëntë vrasje në Malet e Berishës më 25 ose 26 korrik 1998 dhe pretendon se gabimi përbën dështim të drejtësisë dhe shfuqizon Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore.⁸⁹ Konkretisht ai pretendon se pjesëmarrja e tij në këto vrasje nuk u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm duke qenë se në dobi të tij ishte një deduksion i logjikshëm që Dhoma nuk e mori në konsideratë.⁹⁰ Ai sjell në vëmendje prova “të pakundërshtueshme” se terreni në Malet e Berishës ishte i vështirë për ecje për “një njeri në gjendje fizike optimale”; se në atë kohë ai ishte në gjendje të ligësht shëndetësore; dhe se kushtet e motit ishin të skajshme gjatë periudhës përkatëse.⁹¹ Ai pretendon se këto prova të marra së bashku çojnë në përfundimin e

⁸⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 98.

⁸⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 100-102.

⁸⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 115-117.

⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para 1.57.

⁸⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 130.

⁹⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 132-133, ku citohet Aktgjykimi i Apelit Çelebiqi, paragrafi 458.

⁹¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 144.

arsyeshëm se ai nuk ishte në gjendje të shoqëronte të burgosurit për në Malet e Berishës dhe se nuk mund të ketë qenë i pranishëm në kohën kur ndodhën nëntë vrasje.⁹²

37. Alternativisht, Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor duke ia ndërruar kahun detyrimit të vërtetimit dhe duke i kërkuar të provonte se ai nuk ishte në gjendje fizike të merrte pjesë në nëntë vrasje.⁹³ Po ashtu në lidhje me pretendimin e tij të mësipërm, ai deklaroi se në gjyq ai paraqiti prova të pakundërshtueshme që ngrinin dyshime të arsyeshme në lidhje me identifikimin e tij si ushtari i UÇK-së që shkoi deri në Malet e Berishës, dhe se Prokuroria nuk mundi të provojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ky ushtar ishte ai.⁹⁴ Alternativisht ai argumenton se një deduksion tjetër i arsyeshëm për Dhomën Gjyqësore do të kishte qenë se kur ai u largua prej grupit të të burgosurve të mbetur ata ishin ende gjallë dhe nuk ishte i pranishëm kur këta të burgosur u ekzekutuan.⁹⁵ Gjithashtu ai pretendon se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të kishte konkluduar se ai ishte fajtor për vrasjet pa u mbështetur në dëshminë e Dëshmitarit L96, të cilin Dhoma Gjyqësore e konsideroi jo të besueshëm.⁹⁶

38. Në lidhje me pretendimin për përfundimin të gabuar të Dhomës Gjyqësore për pjesëmarrjen e tij personale në vrasje,⁹⁷ Haradin Bala argumenton se provat balistike mundësojnë deduksionin logjik se në pushkatim morën pjesë më shumë se dy persona.⁹⁸ Ai gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore keqzbatoi parimin *in dubio pro reo* kur konkludoi se “provat e kriminalistikës [...] as nuk konfirmojnë dhe as nuk përjashtojnë praninë vepruese të një rojeje të tretë në Malet e [Berishës] në kohën e ekzekutimit”, sepse faktikisht Haradin Bala mund të mos ketë hapur zjarr ndaj të burgosurve, faktor që mund të kishte ndikuar ndjeshëm në dënim.⁹⁹ Haradin Bala gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshminë e pakonfirmuar të Dëshmitarit L96 në lidhje me ngjarjet pas lirimit të grupit të parë të të burgosurve, megjithëse Dhoma Gjyqësore u shpreh qartazi se nuk do të mbështetej në dëshminë e tij në lidhje me çështjet thelbësore nëqoftëse dëshmia nuk konfirmohej.¹⁰⁰

39. Prokuroria përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk e ndërroi kahun e detyrimit të provës dhe se përfundimet e saj u mbështetën në mënyrë të arsyeshme mbi provat në tërësi.¹⁰¹ Prokuroria

⁹² Shih po aty AT 42-45 (5.5.2007)

⁹³ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 145.

⁹⁴ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 148-150.

⁹⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 158.

⁹⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 159.

⁹⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 161.

⁹⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 163-165.

⁹⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 166 (që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 453) dhe paragrafët 167-168

¹⁰⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 170-173.

¹⁰¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.1.

argumenton se Dhoma Gjyqësore pranoi dëshmi të besueshme të pesë dëshmitarëve se Shala/Haradin Bala dhe një ushtar tjetër, Murrizi, i marshuan të burgosurit e mbetur në kamp-burg për në Malet e Berishës.¹⁰² Gjithashtu Prokuroria i referohet gjendjes së ligësht shëndetësore të të burgosurve të cilët u ngjitën në mal pasi u ishin nënshtruar kushteve të mjera në kamp,¹⁰³ dhe në lidhje me Haradin Balën, argumenton se dëshmitë mjekësore të Zeqir Gashit dhe Fitim Selimit nuk konfirmojnë përfundimin se Haradin Bala nuk ishte në gjendje fizike që të shoqëronte të burgosurit.¹⁰⁴ Sa i përket pretendimit për ndërrimin e kahut të detyrimit të provës, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore me të drejtë konkludoi se “nuk kishte mbetur asnjë dyshim i arsyeshëm” se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala në kamp dhe i shoqëroi të burgosurit në Malet e Berishës, pasi kishte shqyrtuar dëshmitë identifikuese, dëshminë e alibisë dhe dëshmitë në lidhje me shëndetin e Haradin Balës, veçasi dhe së bashku.¹⁰⁵ Në lidhje me këtë kundërpërgjigjja e Haradin Balës është se dëshmitë në lidhje me shëndetin e tij duhej të ishin shqyrtuar veç nga dëshmitë për identifikimin dhe nga alibia.¹⁰⁶

40. Argumenteve të Haradin Balës mbi pjesëmarrjen e tij personale në vrasjet, Prokuroria u përgjigjet se dëshmia pamore e Dëshmitarit L96 u mbështet prej dëshmime provuese: Dëshmitari L96 mundi t’i çonte hetuesit në vendin e vrasjeve ku u zbuluan kufomat;¹⁰⁷ dëshmitarë që mbijetuan dëshmuar se Haradin Bala shoqëroi grupin e të burgosurve në Malet e Berishës;¹⁰⁸ provat balistike as nuk vërtetuan dhe as nuk përjashtuan gjasën se në ekzekutim mori pjesë një ushtar i tretë i UÇK-së; roli i përbashkët i Haradin Balës dhe Murrizit në lirimimin e grupit të parë të të burgosurve (duke i lënë të burgosurit e mbetur, ndër të cilët edhe Dëshmitarin L96, me Haradin Balën dhe Murrizin); dhe kufomat e të tërë burgosurve të mbetur (me përjashtim të treve) u gjetën më vonë në rrethinë.¹⁰⁹

41. Gjithashtu Prokuroria argumenton se pretendimi se Haradin Bala mund të jetë larguar nga vendi i krimit para ekzekutimit është thjesht spekulim duke qenë se nuk pati asnjë dëshmi në mbështetje të këtij sugjerimi.¹¹⁰ Përsa i përket pranisë së mundshme të një ushtari të tretë të UÇK-së në ekzekutim, përgjigjja e Prokurorisë është se Dëshmitarët L96 dhe L10 identifikuan Haradin Balën dhe një ushtar të tretë se kishin armë automatike ose “Kallashnikovë”, dhe Murrizi kishte një “pushkë”.¹¹¹ Rrjedhimisht, Prokuroria argumenton se edhe sikur provat balistike të ngrinin një

¹⁰² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.2.

¹⁰³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafët 2.3-2.4.

¹⁰⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.7.

¹⁰⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.17, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 649-650.

¹⁰⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 41.

¹⁰⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.30.

¹⁰⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafët 2.23-2.30.

¹⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.23.

¹¹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.27.

¹¹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, para grafi 2.36.

dyschim të arsyeshëm nëse ishte përdorur një armë e tretë, këta dy dëshmitarë dëshmuar se Haradin Bala dhe ushtari i tretë i UÇK-së kishin Kallashnikovë, dhe plumbat e gëzhojat e gjetura në vendin e ekzekutimit u përcaktuan se ishin qitur prej së paku dy Kallashnikovëve të veçantë.¹¹²

2. Diskutim

42. Thelbi i argumentit të parë të Haradin Balës është nëse ishte apo nuk ishte i arsyeshëm përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ai iu ngjiti malit me gjithë gjendjen e tij shëndetësore. Në Aktgjykimin e saj, Dhoma Gjyqësore bëri një vlerësim rrënjësor të dëshmive në lidhje me shëndetin e Haradin Balës. U mbajt në konsideratë fakti se Haradin Bala kishte patur probleme shëndetësore para vitit 1998; se ai vuante nga *angina pectoris* dhe merrte mjekim; se kishte tension të lartë dhe aritmi të zemrës dhe merrte mjekime për aritminë, dhe se mjeku e kishte këshilluar të shmangte tejloshjen.¹¹³ Në shqyrtimin e provave të shëndetit të Haradin Balës, Dhoma Gjyqësore i kushtoi vëmendje të posaçme faktit se megjithë shqetësimet shëndetësore Haradin Bala hyri në UÇK dhe shërbeu si ushtar dhe madje në disa raste mori pjesë edhe në aksione ushtarake.¹¹⁴ U konkludua se ky fakt tregonte “se me gjithë gjendjen e tij shëndetësore ai ishte i aftë të merrte pjesë në veprimtari të mundimshme luftarake, ose se jo gjithmonë u bëri bisht kërkesave fizike të shërbimit në UÇK për shkak të gjendjes së tij fizike, një prej këtyre përfundimeve ose të dy së bashku.”¹¹⁵ Përfundimi bazuar në “rrethanat e përgjithshme” ishte se Shala bashkë me Murrizin dhe ndoshta edhe një ushtar të tjetër të UÇK-së ishin të pranishëm dhe pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në pushkatimin e nëntë të burgosurve shqiptarëve kosovarë në Malet e Berishës më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date. Rrethanat e përgjithshme të përmendura prej Dhomës Gjyqësore ishin:

tërësia e dëshmive në lidhje me rolin e Shalës dhe të Murrizit në kamp-burg, fakti se kur Llapushniku u sulmua nga serbët, të dy personat i shoqëruan të burgosurit e mbetur gjatë ecjes në Malet e Berishës, roli i tyre i përbashkët në lirin e grupit të parë të të burgosurve, duke i lënë të burgosurit e tjerë, duke përfshirë edhe L96-ën, me Shalën dhe Murrizin, dhe se më vonë në rrethinë u zbuluan kufomat e të gjithë të burgosurve, me përjashtim të L96-ës, Hetem Rexhajt dhe Xheladin Ademajt.¹¹⁶

43. Mbi bazën e të tëra provave të shqyrtuara, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk kishte asnjë dyschim të arsyeshëm se Haradin Bala kreu nëntë vrasjet në Malet e Berishës megjithëse ishte shëndetlig.¹¹⁷

¹¹² Po aty, Shih edhe AR 68-79 (5.6.2007). Për Kundërpërgjigjen e Balës shih edhe AT 80-81 (5.6.2007)

¹¹³ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 648.

¹¹⁴ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 648.

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 454.

¹¹⁷ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 650, 461, 471, 476, 482, 487, 492, 501 dhe 506.

44. Bazuar në provat e shqyrtuara prej Dhomës Gjyqësore se Haradin Bala ishte anëtar aktiv i UÇK-së pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore, Dhoma e Apelit gjykon se refuzimi i Dhomës Gjyqësore ndaj sugjerimit të paraqitur prej Haradin Balës se ai nuk ishte në gjendje t'i shoqëronte të burgosurit për në Malet e Berishës, nuk ishte i paarsyeshëm.¹¹⁸ Megjithëse rrugëtimi në mal mund të mos ketë qenë i këshillueshëm për Haradin Balën nga pikëpamja mjekësore, ai tashmë kishte treguar se gjendja e tij shëndetësore nuk e kishte penguar të merrte pjesë në disa detyra fizike në shërbim të UÇK-së, ndër të cilat edhe detyra si rojë në kamp-burg. Konkretisht provat tregojnë se megjithëse kishte tension të lartë dhe aritmi të zemrës që prej vitit 1998, ai kishte marrë pjesë në aksione ushtarake duke patur këto probleme shëndetësore.¹¹⁹ Prova të tjera mbështesin arsyeshmërinë e përfundimit të Dhomës Gjyqësore. Këtu përfshihen provat identifikuese se Haradin Bala ishte roja i njohur si Shala (siç është përmendur më lart); dëshmitë se rojet Shala dhe Murrizi mblodhën të burgosurit në kamp dhe iu prinë atyre drejt maleve, me Shalën që shoqëronte fundin;¹²⁰ dhe dëshmitë se Shala thirri emrat e afërsisht dhjetë të burgosurve dhe më pas i liroi.¹²¹ Bazuar në këto prova, Haradin Bala nuk vërteton se përfundimi i Dhomës Gjyqësore se ai ishte fizikisht i aftë që t'i shoqëronte të burgosurit në Malet e Berishës dhe ishte i pranishëm në kohën e vrasjeve, është i palogjikshëm.

45. Dhoma e Apelit nuk pajtohet as me pretendimin e Haradin Balës se Dhoma Gjyqësore e ndryshoi në mënyrë të papërshtatshme kahun e detyrimit të provës duke i kërkuar atij të provonte se ishte fizikisht i paaftë për pjesëmarrje në nëntë vrasje. Dhoma e Apelit thekson se Haradin Bala nuk i plotëson kushtet e apelimit duke qenë se ai nuk përcakton ku ndodhet gabimi i pretenduar në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, por thjesht paraqet një pretendim të përgjithshëm se Dhoma Gjyqësore ndryshoi kahun e detyrimit të provës sepse nuk pranoi dëshminë e alibisë paraqitur prej tij.¹²² Për më tepër, Haradin Bala nuk provon se Dhoma Gjyqësore nuk ishte e bindur se Prokuroria kishte përmbushur detyrimin e saj për eliminimin e çdo dyshimi të arsyeshëm se ai ishte “fizikisht i paaftë për pjesëmarrje në veprimet e akuzuara në Aktakuzë”.

46. Në lidhje me pretendimin e Haradin Balës se në gjyq ai ofroi prova të pakundërshtueshme të mjaftueshme për ngritjen e dyshimit të arsyeshëm se ishte ai ushtari i UÇK-së që iu ngjiti Maleve të

¹¹⁸ Shih Aktgjykimin e Apelit Galiq, paragrafi 218. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët, paragrafi 303; Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 219; Aktgjykimi i Apelit Çelebiq, paragrafi 458.; Aktgjykimi i Apelit Ntagerura dhe të tjerët, paragrafët 304-306.

¹¹⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 648 ku citohet Elmi Topi T. 6746-6747 (3.5.2005).

¹²⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 448.

¹²¹ Dëshmitari L06, T. 1028-1030 (26.11.2004); Dëshmitari L12, T. 1815-1818 (13.12.2004); Dëshmitari L10, T.2962-2965 (3.2.2005)

¹²² Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 145-150. Shih edhe Aktgjykimin e Apelit Galiq, paragrafët 7, 11.

Berishës, dhe se Prokuroria nuk mundi të provojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ky ushtar ishte ai, kjo pikë e apelit hidhet poshtë për arsytet e lartpërmendura.¹²³

47. Në lidhje me nënpikën e apelit të Haradin Balës se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se ai mori pjesë personalisht në vrasje, Dhoma e Apelit gjykon se Haradin Bala nuk ka vërtetuar ndonjë gabim. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore i peshoi me kujdes provat kur konkludoi se Haradin Bala (me pseudonimin Shala) dhe Murrizi “ishin të pranishëm dhe pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në pushkatimin e të burgosurve”, duke e nxjerrë këtë përfundim nga

nga roli i Shalës dhe Murrizit në kamp-burg, nga fakti se kur Llapushniku u sulmua nga serbët, të dy personat i shoqëruan të burgosurit e mbetur gjatë ecjes në Malet e Berishës, nga roli i tyre i përbashkët në lirim e grupit të parë të të burgosurve, duke i lënë të burgosurit e tjerë, duke përfshirë edhe L96-ën, me Shalën dhe Murrizin, dhe se më vonë në rrethinë u zbuluan kufomat e të gjithë të burgosurve, me përjashtim të L96-ës, Hetem Rexhajt dhe Xheladin Ademajt.¹²⁴

Më tej Dhoma Gjyqësore konkludoi se

Shala dhe Murrizi dhe ndoshta një ushtar i tretë i UÇK-së, vepruan së bashku, kur shtinë dhe vranë të gjithë të burgosurit e mbetur me përjashtim të L96-ës, Xheladin Ademajt dhe ndoshta Hetem Rexhajt.¹²⁵

Më tej në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se

Haradin Bala mori pjesë fizikisht në elementët materialë të kimit të vrasjes bashkë me Murrizin dhe ndoshta me një ushtar të tretë të UÇK-së. Siç është përmendur më parë duke marrë parasysh rrethanat e vrasjes dhe pozicionin e viktimave, Dhoma ka përfunduar se Haradin Bala veproi me synimin për kryerjen e vrasjes gjatë pjesëmarrjes së tij në vrasjen e këtyre viktimave. Ai është përgjegjës si kryes i drejtpërdrejtë në vrasjen e nëntë të burgosurve.¹²⁶

48. Dhoma e Apelit thekson se dëshmia e Dëshmitarit L96 në lidhje me ekzekutimin mbështetet prej dëshmisë së tij se ai iu priu hetuesve të Seksionit të Hetimeve të Krimeve të UNMIK-ut (“CCIU”) në vendngjarje, dhe prej deklaratës së Xhudi Tomasit/Judy Thomas/, police kanadeze në CCIU, e cila deklaroi se dy civilë e çuan në vendin e ekzekutimit në gusht 2001.¹²⁷ Megjithëse Xhudi Tomas nuk deklaroi se Dëshmitari L96 ishte njëri prej këtyre dy civilëve, Dhoma Gjyqësore gjykoj se deklarata e tij në lidhje me vendndodhjen e vendit të varrit “përgjithësisht përputhet me dëshmitë e të burgosurve, ndër të cilët edhe L96.”¹²⁸ Ky ishte përfundim i arsyeshëm bazuar mbi dëshmitë e Xhudi Tomasit dhe Dëshmitarit L96. Dhoma e Apelit gjithashtu gjykon se Dhoma Gjyqësore veproi logjikisht bazuar në dëshmitë e ofruara nga Dëshmitarët L04, L06, L10, L12 dhe L96 në lidhje me rolin e Balës në procesin e lirit të grupit të parë të të burgosurve në Malet e

¹²³ Shih më sipër paragrafi 45.

¹²⁴ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 454 (pa poshtëshënime të brendshme).

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 664.

¹²⁷ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 457, që i referohet Xhudi Tomasit/Judy Thomas/ prova materiale P10 “Statements of Judy Thomas and exhibits”/Deklaratat e Xhudi Tomasit dhe provat materiale/, paragrafi 18.

¹²⁸ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 457.

Berishës.¹²⁹ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur e gjykoi rolin e Haradin Balës në kamp-burg dhe në shoqërimin e të burgosurve për në Malet e Berishës si provë përcaktuese në vërtetimin e pjesëmarrjes së tij në vrasjen e të burgosurve të grupit të dytë.

49. Megjithëse Dhoma Gjyqësore përcaktoi se provat balistike as nuk vërtetuan dhe as përjashtuan se një ushtar i tretë i UÇK-së mori pjesë në vrasje, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk kishte në dispozicion asnjë dëshmi që do të sugjeronte se Haradin Bala u largua prej vendit të ekzekutimit para vrasjeve dhe rrjedhimisht mosdiskutimi i kësaj pike prej Dhomës Gjyqësore nuk përbën gabim faktual. Gjithashtu dëshmitë e Dëshmitarëve L10 dhe L96 se Shala u pa me armë automatike, lloji i të cilës u përcaktua prej provave balistike si e përdorur në vrasje, mbështesin përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Shala/Haradin Bala mori pjesë në vrasjen e të burgosurve të grupit të dytë.

50. Duke marrë parasysh të tëra këto arsye, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në lidhje me pjesëmarrjen personale të Haradin Balës në vrasjen e të burgosurve të grupit të dytë në Malet e Berishës.

51. Për pasjë, pika e dytë e apelit të Haradin Balës hidhet poshtë.

C. Pika e katërt e apelit të Haradin Balës: pretendimi për përfundim të gabuar se Haradin Bala shkaktoi trajtim mizor ndaj Dëshmitarit L12

52. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor duke e ndryshuar në mënyrë të palejueshme kahun e detyrimit të provës dhe duke i kërkuar atij të vërtetonte se kishte qenë fizikisht i paaftë për pjesëmarrje personale në trajtimin mizor të Dëshmitarit L12, duke e shfuqizuar në këtë mënyrë Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore.¹³⁰ Ndryshe, ai argumenton se Dhoma Gjyqësore kreu gabim faktual kur nuk mori në konsideratë prova të pakundërshtueshme se ai ishte fizikisht i paaftë për trajtim mizor të Dëshmitarit L12.¹³¹ Konkretisht ai pretendon se nëqoftëse i akuzuari ofron mbrojtje konfirmuese në lidhje me pamundësinë fizike dhe paraqet prova të arsyeshme në mbështetje të kësaj mbrojtjeje, atëherë Prokurorisë i kërkohet që të provojë se këto prova janë të rreme, gjë që Prokuroria nuk e bëri.¹³²

¹²⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 450.

¹³⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 177.

¹³¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 178-180.

¹³² Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 180.

53. Prokuroria përgjigjet se Haradin Bala e tepron rëndësinë e provave mjekësore paraqitur Dhomës Gjyqësore.¹³³ Ajo deklaron se provat mbështesin vetëm përfundimin se për një person në gjendjen shëndetësore të Haradin Balës nuk ishte e logjikshme që të merrte pjesë në mundim fizik të vazhdueshëm.¹³⁴

54. Të dy argumentet e Haradin Balës në lidhje me mbrojtjen e tij bazuar në pamundësinë fizike u hodhën poshtë në diskutimin e mëparshëm në lidhje me pjesëmarrjen e tij në vrasjen e të burgosurve në Malet e Berishës.

55. Rrjedhimisht bazuar në arsyet përkatëse, Dhoma e Apelit hedh poshtë pikën e katërt të apelit.

D. Pika e gjashtë e apelit: refuzimi i alibisë të Haradin Balës prej Dhomës Gjyqësore

56. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur refuzoi mbrojtjen e tij nëpërmjet alibisë dhe pretendon tre nëngabime ligjore dhe faktuale. Së pari ai pretendon se Dhoma Gjyqësore pasaktësisht ndryshoi kahun e drejtimit të detyrimit të provës drejt tij në vend që t'i kërkonte Prokurorisë eliminimin e çfarëdo mundësie të arsyeshme të vërtetësisë së dëshmisë së alibisë;¹³⁵ ai gjithashtu argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual në vlerësimin e dëshmisë së alibisë bazuar në një standard padrejtësisht të lartë.¹³⁶ Së dyti ai argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke e konsideruar vendimin e tij për mosdhënie dëshmie me betim kundër tij.¹³⁷ Së treti ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mundi të ofronte një arsyetim të refuzimit të alibisë së tij.¹³⁸

1. A e ndryshoi Dhoma Gjyqësore kahun e detyrimit të provës për dëshminë nëpërmjet alibisë

(a) Argumentet e palëve

57. Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore ndryshoi kahun e drejtimit të provës duke i kërkuar atij të vërtetonte se alibia e tij ishte “përputhëse dhe e besueshme” në vend që t'i kërkonte

¹³³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 3.2.

¹³⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 3.2. Shih edhe AT 76(5.6.2007).

¹³⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 187.

¹³⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 196.

¹³⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 234, 236, 240, 241.

¹³⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 226.

vetëm që ai të vërtetonte “një mundësi të arsyeshme që dëshmia e alibisë është e vërtetë.”¹³⁹ Ai argumenton se arsyetimi i Dhomës Gjyqësore se “dëshmitë e shumicës së dëshmitarëve të Mbrojtjes së Haradin Balës jo domosdoshmërisht mohojnë provat se Haradin Bala mbeti në Llapushnik pas fundit të majit”,¹⁴⁰ tregon se Dhoma Gjyqësore ndryshoi kahun e detyrimit të provës. Ai pretendon se “nuk kërkohet që dëshmia e alibisë të mohojë provat e Prokurorisë, por më saktë provat që synojnë dobësimin e alibisë të përjashtojnë mundësinë që Haradin Bala u largua në fund të majit ose fillim të qershorit 1998.”¹⁴¹ Haradin Bala argumenton se ky gabim ligjor shfuqizon Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore sepse ai do ta kishte plotësuar detyrimin e vërtetimit nëqoftëse Dhoma Gjyqësore do të kishte zbatuar detyrimin e duhur të vërtetimit për mbrojtjen nëpërmjet alibisë. Haradin Bala pretendon se në mungesë të këtij gabimi ligjor Prokuroria nuk do të kishte mundur të vërtetonte pretendimin e vetë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe ai nuk do të ishte shpallur fajtor.¹⁴²

58. Gjithashtu Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabime faktuale kur konkludoi se ai ishte në Llapushnik deri në fund të korrikut 1998,¹⁴³ dhe nëpërmjet vlerësimit të dëshmisë së alibisë mbi bazën e një standardi padrejtësisht të lartë, që shkaktoi dështim të drejtësisë.¹⁴⁴ Ai pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri vlerësim të ndryshëm të provave kur ato ishin të dobishme për Prokurorinë krahasuar me rastet kur provat ishin të dobishme për Mbrojtjen, veçanërisht në lidhje me mospërputhjet në kujtimin e datave të ngjarjeve.¹⁴⁵ Gjithashtu ai argumenton se mospërputhjet e pretenduara midis deklaratës së tij pa betim dhe dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes vijnë si pasojë ose e mungesës së saktësisë, keqësimit të kujtesës pas shtatë vjetësh prej ngjarjeve ose prej karakterit tejet stresues të ngjarjeve.¹⁴⁶ Konkretisht ai kundërshton përfundimet e Dhomës në lidhje me datën e ardhjes së tij në Llapushnik, largimin e tij nga Llapushniku dhe datën e çeljes së klinikës së Dr. Zeqir Gashit. Ai argumenton se po të vlerësohen drejtësisht dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët Ferat Sopi, Elmi Sopi, Ruzhdi Karpuzi, Skënder Bylykbashi, Avdullah Puka, Dr. Selimi dhe prej tij në deklaratën e tij pa betim, ato të paktën do të ngrinin një dyshim të arsyeshëm në lidhje me praninë e tij në vendin e krimit në qershor dhe korrik 1998.¹⁴⁷ Së fundi ai argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mundi të ofronte një arsyetim për refuzimin e alibisë së tij se ai nuk ishte në Llapushnik në qershor ose korrik 1998.¹⁴⁸

¹³⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 187, ku citohet Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore Vasiljeviq, paragrafi 15; Aktgjykimin i Apelit Çelebiqi, paragrafi 581; Aktgjykimin i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 625.

¹⁴⁰ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 647.

¹⁴¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 220.

¹⁴² Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 228.

¹⁴³ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 208.

¹⁴⁴ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 230-231.

¹⁴⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 199, 209-210, 214.

¹⁴⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 230-231., paragrafët 193, 194, 196 ku citohet Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore Simba, paragrafi 345.

¹⁴⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 211-212.

¹⁴⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 197-199, 226

59. Gjithashtu Haradin Bala pretendon gabim faktual në konkluzionin e Dhomës Gjyqësore se dëshmia e Elmi Sopit “nuk është qenësisht e ndryshme” nga dëshmia e Dr. Zeqir Gashit se klinika e tij në Llapushnik u hap në fillim të qershorit dhe se Haradin Bala e vizitoi klinikën më pas.¹⁴⁹ Duke qenë se Elmi Sopi deklaroi se Haradin Bala nuk ishte në Llapushnik pas 29 majit 1998,¹⁵⁰ Haradin Bala argumenton se konkluzioni i Dhomës Gjyqësore zbulon një vlerësim të padrejtë të provave. Ai deklaron se gabimet e pretenduara faktuale shkaktuan dështim të drejtësisë sepse Dhoma Gjyqësore nuk do ta kishte refuzuar dëshminë e alibisë së tij nëqoftëse do ta kishte vlerësuar këtë dëshmi më paanaësisht.¹⁵¹

60. Prokuroria përgjigjet se argumenti i Haradin Balës thjesht ripohon detyrimin e provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.¹⁵² Ajo argumenton se Dhoma Gjyqësore zbatoi standardin e duhur të vlerësimit të dëshmisë së alibisë, kur konkludoi se nuk ngrinte dyshim të arsyeshëm.¹⁵³ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore u mbështet në dëshmitë e viktimave të kampit dhe jo në pavërtetësinë e dëshmisë së alibisë për të vërtetuar se Haradin Bala ishte në Llapushnik në qershor dhe korrik 1998.¹⁵⁴

61. Në lidhje me gabimet e pretenduara faktuale Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore pati të drejtë kur përcaktoi mospërputhje midis deklaratës pa betim të Haradin Balës dhe dëshmive të dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes. Dëshmia e Elmi Sopit dhe deklarata pa betim e Haradin Balës në lidhje me kohën kur Haradin Bala u largua nga Llapushniku ndryshojnë me së paku gjashtë ditë.¹⁵⁵ Një ndryshim i tillë sipas Prokurorisë nuk është pa ndikim dhe është më shumë se “mungesë saktësie”.¹⁵⁶ Gjithashtu Prokuroria argumenton se përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me datën e ardhjes së Haradin Balës në Llapushnik, largimit të tij nga Llapushniku dhe datën e hapjes së klinikës së Dr. Zeqir Gashit nuk ishin të paarsyeshme. Përkundrazi, thekson Prokuroria “Dhoma parashtrroi një bazë të hollësishme për përfundimet e veta në lidhje me provat e alibisë, duke shpjeguar arsyen për konkluzionin se provat nuk ishin të besueshme, ishin të gabuara, ose në fakt jopërputhëse me tërësinë e provave që vërtetonin praninë e Balës në Llapushnik gjatë qershorit dhe korrikut 1998.”¹⁵⁷

¹⁴⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 197-199.

¹⁵⁰ Elmi Sopi, T. 6747 (31.5.2005)

¹⁵¹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 230-231.

¹⁵² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.8.

¹⁵³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.10. Shih edhe AT 63-66 (5.6.2007).

¹⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.17.

¹⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.38.

¹⁵⁶ Po aty.

62. Prokuroria argumenton se konstatimi i Dhomës Gjyqësore se dëshmia e Elmi Sopit “nuk është qenësisht e ndryshme” nga dëshmia e Dr. Zeqir Gashit është gabim shtypi¹⁵⁸ dhe se Dhoma Gjyqësore e kishte fjalën për dëshminë e Ferat Sopit. Ferat Sopi vlerësoi se klinika e Dr. Zeqir Gashit u hap midis 20 dhe 25 majit 1998, por ishte i sigurtë vetëm se klinika ishte hapur në maj.¹⁵⁹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se “kjo fare mirë mund të jetë për [...] ditët e fundit të majit.”¹⁶⁰ Sipas Prokurorisë, rrjedhimisht nuk do të kishte qenë e paarsyeshme që Dhoma Gjyqësore të kishte vërejtur se dëshmia e Ferat Sopit “nuk është qenësisht e ndryshme” nga dëshmia e Dr. Zeqir Gashit se klinika u hap në fillim të qershorit 1998.¹⁶¹

(b) Pretendimi për gabimi ligjor në ndryshimin e kahut të detyrimit të provës

63. Dhoma e Apelit thekson dhe pajtohet me përfundimin e Dhomës së Apelit të TPNR-së në çështjen *Kamuhanda* në lidhje me detyrimin e provës ndaj alibisë se:

alibia [...] synon të ngrejë dyshime të arsyeshme në lidhje me praninë e të akuzuarit në vendin e krimit, element i aktakuzës së prokurorisë, rrjedhimisht detyrimi i provës është i prokurorisë.¹⁶²

Në mënyrë të ngjashme, Dhoma e Apelit e TPNR-së në çështjen *Kajelijeli* konkludoi se

detyrimi i vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm të fakteve të akuzuara mbetet katërcipërisht i Prokurorisë. Në të vërtetë është detyrë e Prokurorisë të vërtetoja jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se me gjithë alibinë, faktet e pretenduara gjithsesi janë të vërteta.¹⁶³

Mirëpo Prokurorisë nuk i kërkohet që të hedhë poshtë konkretisht çdo dëshmi alibie të dëshmitarëve jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Më saktë detyrimi i provës është të provohet fajësia e të akuzuarit në lidhje me krimet e pretenduara jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm pavarësisht alibisë së deklaruar.

64. Bazuar në sa më lart, Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore konkludoi me të drejtë se:

Në qoftë se dëshmitë ofrojnë një bazë faktuale për alibinë, i Akuzuari nuk ka detyrim të vërtetë alibinë; është detyrë e Prokurorisë të “përfundojë çdo mundësi të arsyeshme se dëshmitë e alibisë janë të vërteta”. Më tej, siç u vendos nga një Dhomë tjetër Gjyqësore, vërtetimi se një alibi është e rreme, nuk “provon në vetvete të kundërtën

¹⁵⁷ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.64.

¹⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.40.

¹⁵⁹ Ferat Sopi, T. 7051-7052 (9.6.2005).

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 644.

¹⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.40.

¹⁶² Aktgjykimi i Apelit Kamuhanda, paragrafi 167. Shih edhe Aktgjykimi i Apelit Kajelijeli, paragrafët 41-42 dhe Aktgjykimi i Apelit Kayishame dhe Ruzindana, paragrafi 111.

¹⁶³ Aktgjykimi i Apelit Niyitegeha, paragrafi 60 (pa poshtëshënimet e brendshme). Shih edhe Aktgjykimin e Apelit Çelebiqi, paragrafi 581; Aktgjykimi i Apelit Musema, paragrafi 202 (ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 625); Aktgjykimi i Apelit Kayishame dhe Ruzindana, paragrafi 113.

e pretendimit”. Duhet që Prokuroria jo vetëm të hedhë poshtë vlefshmërinë e alibisë, por edhe të vërtetojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të Akuzuarit sipas pretendimit të Aktakuzës.¹⁶⁴

65. Në vlerësimin e dëshmive të alibisë së Haradin Balës, Dhoma Gjyqësore theksoi se “dëshmitë e shumicës së dëshmitarëve të Mbrojtjes së Haradin Balës jo domosdoshmërisht mohojnë provat se Haradin Bala mbeti në Llapushnik pas fundit të majit.”¹⁶⁵ Përdorimi i frazës “mohojnë provat” mund të interpretohet në kuptimin se Dhoma Gjyqësore i kërkoi Haradin Balës të hidhte poshtë provat e Prokurorisë se Haradin Bala mbeti në Llapushnik pas fundit të majit 1998, duke e ballafaquar efektivisht Haradin Balën me detyrimin që të vërtetonte alibinë e tij. Mirëpo Dhoma Gjyqësore pohoi saktësisht se Prokuroria duhej të eliminonte çdo mundësi të arsyeshme për vërtetësinë e provave të alibisë. Si pasojë, Dhoma e Apelit gjykon se në nxjerrjen e përfundimit se provat e alibisë nuk “mohonin provat” e Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore nuk deklaroi një kusht ligjor por shpjegoi arsyet e përfundimit të saj se alibia e Haradin Balës nuk ngrinte një dyshim të arsyeshëm në argumentin e Prokurorisë. Dhoma Gjyqësore bëri të qartë se ajo e hidhte poshtë alibinë e Haradin Balës pasi kishte shqyrtuar në tërësi provat.:

dëshmitë në lidhje me nëse është provuar se i Akuzuari Haradin Bala ishte rojë e UÇK-së në kamp-burg në Llapushnik në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën veçanërisht lidhur me identifikimin prej viktimave dhe të tjerëve, alibinë dhe shëndetin e Haradin Balës, të cilat u shqyrtuan veças dhe së bashku dhe duke marrë parasysh të tëra rrethanat, Dhoma është e bindur dhe nxjerr përfundimin se në të vërtetë i Akuzuari Haradin Bala ishte ushtar i UÇK-së dhe rojë burgu i njohur si Shala i cili veproi në kamp-burgun e UÇK-së në Llapushnik midis 9 majit 1998 dhe 25 ose 26 korrikut 1998.¹⁶⁶

Rrjedhimisht Haradin Bala nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor gjatë vlerësimit të alibisë së tij.

(c) Pretendim për gabime faktuale në vlerësimin e alibisë

66. Dhoma e Apelit gjithashtu nxjerr përfundimin se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në përfundimet e veta faktuale në lidhje me datën e ardhjes së Haradin Balës në Llapushnik, largimin e tij nga Llapushniku, dhe datën e hapjes së klinikës së Dr. Zeqir Gashit.

67. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore u kushtoi shumë më tepër rëndësi mospërputhjes midis deklaratës së tij pa betim dhe dëshmive të dëshmitarëve të tjerë të Mbrojtjes në lidhje me datën e ardhjes së tij në Llapushnik, edhe pse mospërputhja ishte një ose dy ditë. Në lidhje me largimin e tij nga Llapushniku, Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të gabuar përcaktoi një mospërputhje midis deklaratës së tij pa betim se ai u largua prej

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 11 ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Vasiljeviq, paragrafi 15, poshtëshënimi 7.

¹⁶⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 647.

¹⁶⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 649.

Llapushnikut pas dy javësh, dhe dëshmisë së dëshmitarit të Mbrojtjes Elmi Sopi se Haradin Bala u largua pas luftimit më 28 maj 1998.¹⁶⁷ Gjithashtu Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore përdori standard të ndryshëm të vlerësimit të dëshmive kur ato ishin në dobi të Prokurorisë krahasuar me rastin kur ishin në dobi të Mbrojtjes, sepse nuk i kushtoi rëndësi thelbësore mospërputhjes midis dëshmisë së dëshmitarit të Prokurorisë Dr. Zeqir Gashi, i cili dëshmoi se klinika mjekësore u çel në fillim të qershorit 1998 dhe se Haradin Bala shkoi dy herë në klinikën e tij më pas, dhe dëshmisë së Elmi Sopit i cili dëshmoi se Haradin Bala nuk u kthye në Llapushnik pas fundit të majit 1998.¹⁶⁸

68. Dhoma e Apelit gjykon se konstatimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me dëshmitë mospërputhëse për datën e ardhjes së Haradin Balës nuk zbulojnë ndonjë gabim të bërë nga Dhoma Gjyqësore. Në lidhje me datën e largimit të tij nga Llapushniku, mospërputhjet e lartpërmendura nuk e bëjnë të paarsyeshëm përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Haradin Bala mbeti në Llapushnik pas fundit të majit, veçanërisht duke marrë parasysh të tëra dëshmitë që vërtetonin praninë e tij në kamp-burg të dhëna nga dëshmitarë të cilët ishin të burgosur pas majit 1998.¹⁶⁹ Gjithashtu Dhoma e Apelit thekson se dëshmitarët në të cilët u mbështet Mbrojtja në pretendimin e saj se Haradin Bala u largua nga Llapushniku për në Luzhnicë në fund të majit 1998,¹⁷⁰ nuk dëshmuuan se e kishin panë atë faktikisht në Luzhnicë në atë kohë.¹⁷¹

69. Dhoma e Apelit gjithashtu nuk gjen asnjë gabim në përfundimin e Dhomës Gjyqësore se klinika e Dr. Zeqir Gashit u hap në Llapushnik më 31 maj 1998.¹⁷² Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi dëshminë e Dr. Zeqir Gashit¹⁷³ së bashku me dëshminë e Ferat Sopit dhe Proven Materiale P217¹⁷⁴ dhe bazuar në të tëra këto dëshmi, përfundimi i Dhomës Gjyqësore se klinika u hap më 31 maj 1998 ishte i arsyeshëm.

70. Në lidhje me vërejtjen e Dhomës Gjyqësore se dëshmia e Elmi Sopit “nuk është qenësisht e ndryshme” nga përfundimi i saj se klinika e Dr. Zeqir Gashit u çel më 31 maj 1998,¹⁷⁵ Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore e kishte fjalën për dëshminë e Ferat Sopit dhe jo Elmi

¹⁶⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 189-194 me referencë Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 636-637.

¹⁶⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 197-198 me referencë Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 645.

¹⁶⁹ Shih Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 647.

¹⁷⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 637; Defence Final Brief/Dosja Përfundimtare e Mbrojtjes, paragrafi 645.

¹⁷¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 639; Shih po aty, paragrafët 647, 640.

¹⁷² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 645.

¹⁷³ Dr. Zeqir Gashi, T. 5603-5604 (11.4.2005), T. 5642-5645 (11.4.2005), T. 5654-5655 (11.4.2005). Prova materiale DB7 “92bis statement of Howard Tucker”/Deklarata 92bis e Haurard Takerit”, paragrafi 10.

¹⁷⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 644-645; prova materiale P217 “List of Administered Injections”/Lista e Injeksioneve të Bëra”. Shih edhe Ferat Sopi, T. 7051-7052 (9.6.2005).

¹⁷⁵ Po aty.

Sopit.¹⁷⁶ Pasi u vërtetua se ishte një gabim shtypi, Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore nxorri përfundimin e arsyeshëm se dëshmia e Ferat Sopit nuk ishte “qenësisht e ndryshme” nga përfundimi i saj se klinika e Dr. Zeqir Gashit u çel më 31 maj 1998. Për më tepër Haradin Bala nuk ka vërtetuar se ky gabim ndikoi mbi vendimin

71. Dhoma e Apelit i gjykon të pabazuara pretendimet faktuale të kësaj pike të apelit.

2. Vendimi i Haradin Balës për mosdhënie të dëshmisë me betim

72 Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke e përdorur kundër tij vendimin për mosdhënie dëshmie me betim. Dhoma Gjyqësore arsyetoi se “mungesa e dëshmisë me betim prej të Akuzuarit [...] ka efektin e privimit të Mbrojtjes së Haradin Balës prej provave që mund të kishin ofruar një bazë të sigurtë dhe bindëse për alibinë”.¹⁷⁷ Haradin Bala argumenton se ky arsyetim zbulon se Dhoma Gjyqësore e përdori kundër tij vendimin e tij për të mos dëshmuar.¹⁷⁸ Gjithashtu ai pretendon se Dhoma Gjyqësore përdori standard të dyfishtë në vlerësimin e deklaratës së tij pa betim.¹⁷⁹ Ai deklaroi se Dhoma Gjyqësore bëri të qartë se deklaratat e tij pa betim nuk ishin dëshmi dhe në këtë mënyrë nuk përbënte bazë bindëse për alibinë mirëpo më tej e përdoi deklaratën e tij pa betim si provë kundër tij disa herë. Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore ose duhej të kishte shqyrtuar deklaratën pa betim si dëshmi dhe të shpjegonte sa rëndësi do t’i kushtonte ose ta hidhte poshtë tërësisht si dëshmi. Duke u mbështetur në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore *Akayesu*, Haradin Bala gjithashtu argumenton se vlera provuese që i jepet një deklaratë pa betim duhet të jetë më e vogël se vlera që i jepet dëshmisë me betim që i nënshtrohet kundërekzaminimit. Rrjedhimisht Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përdoi deklaratën e tij pa betim në hedhjen poshtë të dëshmive me betim të dëshmitarëve që mbështetën alibinë e tij.¹⁸⁰

73. Prokuroria përgjigjet se në fakt Dhoma Gjyqësore e trajtoi deklaratën pa betim të Haradin Balës si dëshmi, në përputhje me Rregullën 84bis të Rregullores. Kjo Rregullë përcakton se “Dhoma Gjyqësore vendos në lidhje me vlerën provuese të një deklaratë.” Rrjedhimisht Prokuroria argumenton se “nuk do të ishte e nevojshme të përcaktohet vlera provuese e diçkaje që nuk është dëshmi.”¹⁸¹ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi standard të dyfishtë në vlerësimin e deklaratës pa betim; në fakt ajo kishte të drejtë t’u kushtonte rëndësi disa pjesëve të

¹⁷⁶ Shih Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 644, 647.

¹⁷⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 635.

¹⁷⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 234.

¹⁷⁹ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 235-239.

¹⁸⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 243.

¹⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.24. Shih edhe AT 66-67 (5.6.2007).

deklaratës por jo të tjerave.¹⁸² Për më tepër Prokuroria argumenton se referimi i Haradin Balës ndaj Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore *Akayesu* është pa vend duke qenë se përfundimi i Dhomës Gjyqësore në atë çështje kishte lidhje me deklaratatë të mëhershme mospërputhëse të të njëjtit dëshmitar i cili më vonë dha dëshmi me betim në gjyq. Për shkak se problemi në këtë çështje ka të bëjë me mospërputhjet midis deklaratës pa betim të Haradin Balës dhe dëshmimeve në gjyq me betim të dëshmitarëve të tjerë, Prokuroria argumenton se Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Akayesu* nuk ofron referencë në lidhje me këtë pikë.¹⁸³

74. Paraprakisht Dhoma Gjyqësore thekson se Haradin Bala nuk shpjegon në çfarë mënyre e bën të pavlefshëm aktgjykimin gabimi i pretenduar ligjor dhe thjesht pretendon se vlerësimi i deklaratës së tij prej Dhomës Gjyqësore ishte i papërshtatshëm.¹⁸⁴ Mirëpo Dhoma e Apelit pranon se vlerësimi i deklaratës pa betim të Haradin Balës prej Dhomës Gjyqësore pati një farë ndikimi mbi vendimin e saj për refuzimin e alibisë dhe një vlerësim i ndryshëm mund të kishte ndryshuar rezultatin e aktgjyimit. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit do të shqyrtojë këtë nënpikë të apelit.¹⁸⁵

75. Në Rregullën 84*bis*(A) të Rregullores përcaktohet se i akuzuari mund të zgjedhë që të bëjë një deklaratë fillestare e cila nuk do të bëhet me betim ose nuk do t'i nënshtrohet kundërzaminimit. Kur bën një deklaratë me ose pa betim, i akuzuari pranon se Dhoma Gjyqësore “vendos në lidhje me vlerën provuese të deklaratës” sipas Rregullës 84*bis*(B) të Rregullores. Rrjedhimisht vlerësimi i deklaratave pa betim sipas Rregullës 84*bis*(B) varet prej gjykitimit të Dhomës Gjyqësore. Përgjithësisht deklaratave të tilla u jepet disi më pak rëndësi se dëshmimeve me betim që u nënshtrohen pyetjeve nga pala kundërshtare dhe pyetjeve nga trupi gjykues.¹⁸⁶

76. Dhoma e Apelit nuk është bindur se Dhoma Gjyqësore e përdori kundër Haradin Balës vendimin e tij për mosdhenie dëshmie. Dhoma Gjyqësore deklaroi konkretisht se “Haradin Bala vendosi të mos dëshmonte nën betim, që është një e drejtë ligjore e tij dhe kundër tij nuk mund të nxirret asnjë përfundim për shkak të kësaj.”¹⁸⁷ Në diskutimin e alibisë së tij, Dhoma Gjyqësore deklaroi se mungesa e dëshmisë nën betim prej të Akuzuarit kishte efektin e “privimit të Mbrojtjes së Haradin Balës prej provave që mund të ofronin një bazë të sigurtë dhe bindëse për alibinë dhe

¹⁸² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.28 ku citohet Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Kvočka dhe të tjerët, paragrafët 618, 623, 612, 614 dhe 678-681; Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafët 535-540, 581-585.

¹⁸³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.29.

¹⁸⁴ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 244.

¹⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët, paragrafi 16 ku citohet Aktgjykimi i Apelit Kërnojelac, paragrafi 10.

¹⁸⁶ See *Blagojević and Jokić*, Decision on Vidoje Blagojević's Oral Request, 30 July 2004, p. 7./Shih Vendimin Bllagojeviq dhe Jokiq në lidhje me Kërkesën Gojore të Vidoje Bllagojeviqit, 30 korrik 2004, f.7.

¹⁸⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 635.

për pretendimin e tij shëndetësor.”¹⁸⁸ Kjo deklaratë nuk sugjeron në asnjë mënyrë se vendimi i Haradin Balës për të mos dëshmuar u përdor kundër tij. Ajo thjesht përfaqëson pikëpamjen e Dhomës Gjyqësore se provat që pati Dhoma Gjyqësore ishin të pamjaftueshme për përcaktimin se alibia dhe gjendja shëndetësore e Haradin Balës ngrinin një dyshim të arsyeshëm se ai kishte kryer krimet për të cilat u shpall fajtor.¹⁸⁹ Rrjedhimisht Haradin Bala nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore përdori kundër tij vendimin e tij për mosdhënie dëshmie.

77. Gjithashtu Dhoma e Apelit nuk e pranon argumentin e Haradin Balës se Dhoma Gjyqësore përdori standard të dyfishtë në vlerësimin e deklaratës së tij pa betim duke e refuzuar si dëshmi në një rast dhe duke e përdorur si dëshmi kundër tij në raste të tjera. Haradin Bala deklaroi se “Dhoma Gjyqësore bëri të qartë se deklarata pa betim nuk ishte dëshmi”¹⁹⁰ kur deklaroi se “mungesa e dëshmisë nën betim prej të Akuzuarit [...] ka efektin e privimit të Mbrojtjes së Haradin Balës prej provave që mund të ofronin një bazë të sigurtë dhe bindëse për alibinë”.¹⁹¹ Mirëpo në kontekstin e Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore është e qartë se Dhoma Gjyqësore nuk e trajtoi si dëshmi deklaratën pa betim. Menjëherë pas kësaj deklarate të kundërshtuar, Dhoma Gjyqësore deklaroi se “Mbrojtja e Haradin Balës duhet të mbështetet në një deklaratë fillestare të dhënë pa betim dhe dëshmi të tjera [...]”¹⁹² Në paragrafët e mëtejshëm Dhoma Gjyqësore vlerësoi deklaratën e Haradin Balës së bashku me dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët nën betim.¹⁹³ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk përdori standard të dyfishtë në vlerësimin e deklaratës pa betim të Haradin Balës.

78. Gjithashtu Haradin Bala pretendon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke e vlerësuar deklaratën e tij pa betim kundrejt dëshmitëve të dëshmitarëve me betim që mbështetën alibinë e tij. Dhoma e Apelit gjykon se formulimi i Rregullës 84bis të Rregullores e lë në gjykimin e Dhomës Gjyqësore përcaktimin e vlerës provuese të një deklarate pa betim. Dhoma e Apelit gjykon se Haradin Bala nuk provon se Dhoma Gjyqësore keqpërdori kompetencën e saj në krahasimin e përmbajtjes së deklaratës së tij pa betim me dëshmitë e ofruara prej dëshmitarëve të tjerë të mbrojtjes, veçanërisht Elmi Sopi, Avdullah Puka dhe Ruzhdi Karpuzi.¹⁹⁴

79. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në vlerësimin e deklaratës pa betim të Haradin Balës.

¹⁸⁸ Po aty.

¹⁸⁹ Po aty.

¹⁹⁰ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 235.

¹⁹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 635.

¹⁹² Po aty (theksimi është shtuar)

¹⁹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 636-637.

3. A dështoi Dhoma Gjyqësore në dhënien e një arsytimi për refuzimin e alibisë së Haradin Balës

80. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk mundi të jepte një arsytim për refuzimin e alibisë së tij se ai nuk ishte në Llapushnik në qershor dhe korrik 1998.¹⁹⁵ Prokuroria deklaroi se ky pretendim duhet hedhur poshtë menjëherë si i pambështetur në prova.¹⁹⁶

81. Kërkesat e Statutit për një proces gjyqësor të drejtë përfshijnë të drejtën e të akuzuarit për të patur një mendim të arsyetuar prej Dhomës Gjyqësore bazuar në Nenin 23 të Statutit dhe Rregullën 98ter(C) të Rregullores.¹⁹⁷ Mendimi i arsyetuar garanton të drejtën për apel të të akuzuarit dhe mundësinë që Dhoma e Apelit të kryejë detyrën e vetë statutores bazuar në Nenin 25 për shqyrtimin e këtyre apeleve.¹⁹⁸ Mirëpo kushti për mendimin e arsyetuar ka të bëjë me aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore dhe jo me çdo parashtrim të bërë gjatë procesit gjyqësor.¹⁹⁹

82. Dhoma Gjyqësore në një pjesë nëntëfaqëshe të Aktgjykimit të saj të titulluar “Alibia e Haradin Balës”, shqyrtoi imtësisht provat e alibisë së Haradin Balës, së pari duke trajtuar alibinë se ai nuk ishte në vendin e krimit kur u kryen krimet²⁰⁰ dhe më tej se ai ishte fizikisht i paaftë në kryerjen e këtyre krimeve.²⁰¹ Aty u përshkruan parashtrimet e tij,²⁰² u vlerësuan dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët Kadri Dugolli, Elmi Sopi, Shefki Bala, Skënder Bylykbashi, Avdullah Puka, Dr. Zeqir Gashi, Ferat Sopi, dhe Ruzhdi Karpuzi; u shpjegua nëse dëshmitë e dëshmitarëve u gjykuan të besueshme dhe bindëse dhe nëqoftëse jo arsye dhe u përmendën mospërputhjet.²⁰³ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore ka ofruar një mendim të arsyetuar për refuzimin e alibisë së Haradin Balës.

83. Si pasojë, pika e gjashtë e apelit të Haradin Balës hidhet poshtë.

E. Pika e tetë e apelit të Haradin Balës: pretendim për gabim në përcaktimin se Dëshmitarët L04 dhe L06 janë të besueshëm

¹⁹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 647.

¹⁹⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 226.

¹⁹⁶ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.19.

¹⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Matinoviç, paragrafi 603; Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 23; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 41.

¹⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Matinoviç, paragrafi 603; Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët, paragrafi 41.

¹⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Matinoviç, paragrafi 603; Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 23.

²⁰⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 634-647.

²⁰¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 648-649.

²⁰² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 634, 636, 639, 642, 643, 646, 648.

²⁰³ Shih Aktgjykimin e Apelit Çelebiq, paragrafi 581.

84. Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual kur i përcaktoi Dëshmitarët L04 dhe L06 si të besueshëm duke qenë se kishte mospërputhje të dukshme midis intervistave të tyre pas dhënies së dëshmisë dhënë Prokurorisë dhe deklaratave të tyre të vitit 1998 dhënë autoriteteve serbe.²⁰⁴ Veçanërisht ai pretendon se si Dëshmitari L04 po ashtu dhe Dëshmitari L06 “gënjyen haptazi” në intervistat e 9 janarit 2005 kur deklaruan se intervistat e tyre të vitit 11998 me autoritetet serbe nuk kishin zgjatur më shumë se dhjetë minuta, duke qenë se të dhënat e intervistave tregojnë se çdo intervistë zgjati tri orë.²⁰⁵ Haradin Bala argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk duhej t’u kishte dhënë intervistave të tyre asnjë vlerë si dëshmi ose të paktën duhej të kishte shpjeguar në Aktgjykim arsyet që e bënë ti konsideronte Dëshmitarët L04 dhe L06 të besueshëm me gjithë shpjegimet e tyre të njëjta dhe mangëta për Prokurorinë.²⁰⁶ Së fundi Haradin Bala argumenton se Dhoma e Apelit është në një pozitë të njëjtë në vlerësimin e problemit të besueshmërisë duke qenë se provat përkatëse për këtë apelim u zbuluan pas dhënies së dëshmisë së dëshmitarëve në gjyq.²⁰⁷ Haradin Bala pretendon se ka ndodhur dështim i drejtësisë duke qenë se dëshmitë e Dëshmitarit L04 dhe atij L06 u shfrytëzuan për vërtetimin e fajësisë së tij për trajtim mizor nëpërmjet mosveprimit për mbajtjen dhe zbatimin e kushteve të burgimit, për ndihmë dhe inkurajim në trajtimin mizor të Dëshmitarit L04 dhe për trajtim mizor duke i detyruar Dëshmitarët L04, L10 dhe një individ të tretë që të varrosnin tre persona në mes të cilëve Agim Ademi.²⁰⁸

85. Prokuroria përgjigjet se këto argumente tashmë janë paraqitur në Dosjen Përfundimtare Gjyqësore të Haradin Balës dhe se ato nuk provojnë gabim faktual.²⁰⁹ Pohohet se Dhoma Gjyqësore në fakt i mori parasysh provat materiale P203 dhe P204, prova materiale përkatëse të intervistave të vitit 1998 të Dëshmitarëve L04 dhe L06 me autoritetet serbe.²¹⁰ Dhoma Gjyqësore konkludoi në mënyrë të arsyeshme se Dëshmitarët L04 dhe L06 ishin të besueshëm me gjithë provat se secili prej tyre kishte ndryshuar deklaratën në lidhje me gjatësinë e intervistave të mëparshme.²¹¹ Duke qenë se besueshmëria e dëshmitarëve duhet shqyrtuar në kontekstin e procesit gjyqësor në tërësi, Dhoma Gjyqësore është në një pozitë më të mirë në vlerësimin e besueshmërisë së këtyre dy dëshmitarëve sesa Dhoma e Apelit.²¹² Dhoma Gjyqësore nuk i anashkaloi deklaratat e Dëshmitarëve L04 dhe L06 në lidhje me intervistat e vitit 1998,²¹³ dhe Haradin Bala nuk ka vërtetuar se çfarë ndikimi do të

²⁰⁴ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 247-248.

²⁰⁵ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 248.

²⁰⁶ Dosja e Apelit të Balës, paragrafët 259-260; Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafët 50-52.

²⁰⁷ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 261; Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës, paragrafi 48.

²⁰⁸ Dosja e Apelit të Balës, paragrafi 262.

²⁰⁹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.6, 5.14.

²¹⁰ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.9.

²¹¹ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.9, 5-23-5.29.

²¹² Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 5.11.

²¹³ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.15-5.22.

kishte mbi dënimin e tij nëqoftëse dëshmitë e Dëshmitarëve L04 dhe L06 do të ishin gjykuar jo të besueshme.²¹⁴

86. Dhoma e Apelit kujton se një Dhomë Gjyqësore nuk ka nevojë të përmendë dëshminë e çdo dëshmitari apo çdo provë që është dokument i procesit gjyqësor “nëqoftëse nuk ka shenja se Dhoma Gjyqësore shpërfilli tërësisht një provë të caktuar.”²¹⁵ Një shpërfillje e tillë vërtetohet “kur Dhoma Gjyqësore nuk ka shqyrtuar në arsyetimin e saj prova që kanë qartësisht lidhje me përfundimet.”²¹⁶

87. Dhoma e Apelit thekson se intervistat e vitit 1998 të Dëshmitarëve L04 dhe L06 me autoritetet serbe iu bënë të njohura Haradin Balës më 29 dhjetor 2004, dhe deklaratat e dhëna Prokurorisë më 9 janar 2005,²¹⁷ u zbuluan më 1 shkurt 2005. Megjithëse dëshmitarët tashmë kishin dëshmuar, palët pranuan që të paraqisnin si prova intervistat e vitit 1998 me autoritetet serbe dhe intervistat kundërthënëse të vitit 2005 me Prokurorinë, në vend të rithirrjes së dëshmitarëve.²¹⁸ Të dy dëshmitarët L04 dhe L06 deklaruan në intervistat e tyre të vitit 2005 me Prokurorinë se intervistat e tyre të vitit 1998 kishin zgjatur afërsisht 10 minuta, megjithëse përmbledhja e informacionit të intervistave të vitit 1998 me autoritetet serbe tregon se ato kishin zgjatur tri orë. Dhoma Gjyqësore diskutoi besueshmërinë e të dy Dëshmitarëve L04 dhe L06, mirëpo nuk e trajtoi menjëherë këtë msopërputhje të qartë dhe të njëjtë në tregimet e tyre përkatëse në lidhje me kohëzgjatjen e intervistave të tyre të vitit 1998.²¹⁹

88. Gjithsesi Dhoma e Apelit nuk do t'i ndryshojë përfundimet e Dhomës Gjyqësore mbi besueshmërinë e Dëshmitarëve L04 dhe L06. Provat në lidhje me kohëzgjatjen e intervistave të vitit 1998 megjithëse nuk u përmendën prej Dhomës Gjyqësore nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në arsyetimin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me krimet në fjalë, por në fakt ndikojnë në përgjithësi në besueshmërinë e dy dëshmitarëve. Dhoma Gjyqësore i përcaktoi dëshmitë e dëshmitarëve në lidhje me Haradin Balën si të ndershme dhe të besueshme²²⁰ pasi kishte shqyrtuar me kujdes dëshmitë e tyre dhe fakte të shumta lidhur me besueshmërinë e tyre. Veçanërisht, Dhoma Gjyqësore diskutoi gjerësisht dhe me kujdes intervistën e vitit 1998 të Dëshmitarit L06 në lidhje me identifikimin e Haradin Balës duke pohuar se “do të shqyrtohet me kujdes”.²²¹ Në lidhje me Dëshmitarin L04,

²¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.30-5.31.

²¹⁵ Aktgjykimi i Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 23.

²¹⁶ Po aty.

²¹⁷ Prova Materiale. P203. “(2) ICTY statement of L04 of 9 January 2005”/Deklaratë (2) për TPNJ-në e L04-ës më 9 janar 2005”; Prova Materiale. P204. “(2) ICTY statement of L06 of 9 January 2005”/Deklaratë (2) për TPNJ-në e L06-ës më 9 janar 2005”

²¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 5.12-5.13.

²¹⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 606, 607, 614, 615.

²²⁰ Dëshmitari L04: Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 398, 407, 627, 631; Dëshmitari L06: Aktgjykimi o Dhomës Gjyqësore, paragrafët 615, 631.

²²¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 615.

Dhoma Gjyqësore konkludoi se “i la mbresë sjellja e L04-ës gjatë dëshmisë së tij dhe pranon se tregimi i tij ishte i çiltër dhe i besueshëm”.²²² Në këtë kontekst “ekziston jurisprudencë e provuar e Tribunalit Ndërkombëtar se gjykuesi i fakteve ka mundësinë më të mirë për vlerësimin e dëshmisë në tërësi si dhe të sjelljes së dëshmitarit.”²²³ Duke marrë parasysh përfundimet e mësipërme në lidhje me besueshmërinë e Dëshmitarëve L04 dhe L06, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore pranoi në mënyrë të logjikshme ndershmërinë e dëshmitëve të tyre, veçanërisht duke u bazuar në dëshmitë e Dëshmitarëve L07, L10, L12, L96 dhe Vojko e Ivan Bakraçit të cilat konfirmuan pjesën më të madhe të tyre. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se një gjykues i arsyeshëm faktesh mund t’i përcaktonte Dëshmitarët L04 dhe L06 si të besueshëm pavarësisht pretendimit në lidhje me kohëzgjatjen e intervistave të tyre me autoritetet serbe në 1998.

89. Rrjedhimisht pika e tetë e apelit të Haradin Balës hidhet poshtë.

²²² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 398.

²²³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 21, poshtëshënimi 12.

IV. APELI I PROKURORISË NË LIDHJE ME HARADIN BALËN

A. Pika e parë e apelit: pretendim për përgjegjësinë penale të Haradin Balës si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale në kamp-burgun e Llapushnikut

90. Në lidhje me të gjithë të Akuzuarit Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur nuk konkludoi se të tre ishin anëtarë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe rrjedhimisht individualisht përgjegjës për krime të kryera në vazhdimin e mëtejshëm të sistemit të keqtrajtimit në kamp-burgun e Llapushnikut dhe për çfarë ishte logjikisht e parashikueshme si pasojë e mundshme e këtij sistemi.²²⁴

91. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktual në përfundimin se ajo nuk u bind se ishte vërtetuar “ekzistenca ose shkalla e ndërmarrjes së përbashkët kriminale” në kamp-burgun e Llapushnikut.²²⁵ Prokuroria argumenton se plotësoheshin të tëra kushtet për një ndërmarrje të përbashkët kriminale sistemore, konkretisht:²²⁶

- (1) kamp-burgu drejtohej nga UÇK-ja dhe viktimat u mbajtën të burgosur prej UÇK-së;
- (2) kushtet e kampit përbënin krimin e trajtimit mizor dhe rrjedhimisht ekzistonte një plan i përbashkët (që përbënte ose ku përfshihej kryerja e trajtimit mizor dhe tortures) dhe sistemi i keqtrajtimit; dhe
- (3) ushtarët e UÇK-së në kamp të cilët i mbajtën njerëzit duhet të kenë qenë në dijeni të kushteve të mbajtjes së viktimave dhe meqenëse ata synonin këto kushte, ata synonin vazhdimin e sistemit të keqtrajtimit.²²⁷

92. Haradin Bala përgjigjet²²⁸ se argumentet e Prokurorisë nuk janë të vlefshme dhe se përfundimi i Dhomës Gjyqësore ishte i saktë dhe duhet lënë në fuqi.²²⁹ Gjithashtu ai pretendon se Prokuroria nuk ka përmbushur detyrimin që të vërtetonte se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor ose faktual ose edhe sikur të identifikohej gabime faktuale, se ata ishin të dëmshëm ndaj

²²⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 1.6.

²²⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.230, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 666-669.

²²⁶ Shih edhe AT 128 (6.6.2007).

²²⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.231, 2.295, 2.301; Shih edhe AT 137-138 (6.6.2007).

²²⁸ Veç argumenteve të tija, nëpërmjet referencës Haradin Bala adopton argumentet e parashtruara nga Fatmir Limaj dhe Isak Mustiu në lidhje me ndërmarrjen e përbashkët kriminale për aq sa kanë lidhje me të dhe i japin të drejtën e masës korrigjuese (Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi 1, poshtëshënimi. 1).

rezultatit në atë masë sa të shkaktonin dështim të drejtësisë.²³⁰ Po ashtu Mbrojtja e Limajt dhe Mbrojtja e Musliut përgjigjen se nuk ekziston asnjë bazë që mund të mbështeste përfundimin e pjesëmarrjes së Fatmir Limajt dhe Isak Musliut në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, duke qenë se Dhoma Gjyqësore përcaktoi me të drejtë se ata nuk kishin planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe ndihmuar dhe inkuruajuna asnjë prej krimeve të Aktakuzës.²³¹

1. A gaboi Dhoma Gjyqësore kur konkludoi se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk u identifikuan në masë të mjaftueshme

(a) Identifikimi i anëtarëve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale: pretendim për gabim ligjor

93. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur kërkoi “dëshmi që tregonin se një grup individësh, *identitetet* e të cilëve mund të vërtetoheshin të paktën duke iu referuar kategorisë së tyre si grup [...] mbështetën një plan të përbashkët” si një element i nevojshëm për përcaktimin se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale.²³² Prokuroria pretendon se nuk është e nevojshme që anëtarët e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të identifikohen nëpërmjet emrit ose anëtarësisë në një grup të caktuar veç pjesëmarrjes së tyre në grupin që përbënte një ndërmarrje të përbashkët kriminale dhe u argumentua në Aktakuzë.²³³ Ajo argumenton se në përputhje me jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar, është e nevojshme të provohet vetëm ekzistenca e një bashkësie personash, e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët që përbën ose përfshin kryerjen e një krimi të përcaktuar në Statut, dhe pjesëmarrja e të akuzuarve në projektin e përbashkët.²³⁴

94. Prokuroria argumenton se identifikimi i anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale veç anëtarësisë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, nuk është element shtesë i nevojshëm në vërtetimin e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²³⁵ Pretendohet se çështjet e përmendura prej Dhomës Gjyqësore në këtë kontekst kishin të bënin me *argumentimin* e ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe se Dhoma Gjyqësore gabimisht imponoi kushtet për

²²⁹ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi. 4.

²³⁰ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi. 24.

²³¹ Limaj Response Brief/Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 112-114; Musliu Response Brief/Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafët 89-91. Për përgjigjen e Musliut shih edhe AT 189-190 (6.6.2007). Për kundërpërgjigjen e Prokurorisë shih edhe AT 205-206 (6.6.2007).

²³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.232, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 669 (theksi është shtuar) shih edhe AT 128-129 (6.6.2007).

²³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.232. Shih edhe AT 130 (6.6.2007).

²³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.234. Shih edhe AT 128-129 (6.6.2007).

²³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.235.

argumentimin si elementë thelbësorë në vërtetimin e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²³⁶ Gjithashtu Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore *nuk* ishte e pakënaqur me argumentimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në Aktakuzë që i identifikonte në masë të mjaftueshme anëtarët e ndërmarrjes së pretenduar kriminale.²³⁷ Gjithashtu argumentohet se identifikimi i tyre nuk ishte tejet i përgjithshëm dhe në çështjet që përmendi Dhoma Gjyqësore u pranuan identifikime më të gjera ose të ngjashme.²³⁸

95. Haradin Bala përgjigjet se Prokuroria pasaktësisht hamendëson se Dhoma Gjyqësore imponoi një element të papërshtatshëm ligjor në lidhje me konceptin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale; në fakt Dhoma Gjyqësore kërkoi prova në lidhje me identifikimin e anëtarëve të ndërmarrjes së pretenduar të përbashkët kriminale me qëllim vlerësimin mbi një bazë objektive nëse ekzistonte një bashkësi personash me një plan të përbashkët.²³⁹

96. Gjithashtu Haradin Bala përgjigjet se nuk ka asgjë në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore që tregon se Dhoma Gjyqësore konkludoi që Aktakuza nuk ishte argumentuar në masë të mjaftueshme.²⁴⁰ Dhoma Gjyqësore nuk përcaktoi si problem argumentimin, por mangësitë në provat e ofruara në mbështetje të akuzave të bëra në Aktakuzë.²⁴¹ Ajo konkludoi se provat e paraqitura në gjyq “ishin të përgjithshme në atë shkallë sa që nuk mund të ofronin një kategorizim të mjaftueshëm për identifikimin e pjesëmarrësve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale”.²⁴² Gjithashtu Mbrojtja e Haradin Balës pretendon se autoritetet mbi të cilët mbështetet Prokuroria ku Dhoma e tjera Gjyqësore konkluduan se “identifikimi i anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar në lidhje me ato çështje ishin argumentuar në masë të mjaftueshme në Aktakuzë ende kishte nevojë për prova në gjyq për të vërtetuar nëse identifikimi në aktakuzë u mbështet ose jo prej provave në gjyq”.²⁴³

97. Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Prokuroria ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor kur shqyrtoi kushtin e identifikimit të pjesëmarrësve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

²³⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.236 që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore Bërgjanin, paragrafi 346: “Aktakuza ndër të tjera duhet të informojë të akuzuarin për identitetin e pjesëmarrësve në ndërmarrje për aq sa njihet identiteti i tyre, por së paku nëpërmjet kategorizimit të tyre si grup” (theksi i parë i shtuar). *Prosecutor v. Milorad Krnojelac*, Case No 97-25-PT, Decision on Form of Second Amended Indictment, 11 May, /Prokurori kundër Milorad Krnojelacit, Lënda Nr. 97-25-PT, Vendim në lidhje me Formën e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë, 11 maj 2000, paragrafi 16: “Të akuzuarit duhet të informohen prej aktakuzës për identitetin e pjesëmarrësve në ndërmarrje për aq sa njihet identiteti i tyre, por së paku nëpërmjet kategorizimit të tyre si grup” (theksi i shtuar).

²³⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.238-2.240.

²³⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.240-2.242.

²³⁹ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafët 26, 31, 34.

²⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi 32.

²⁴¹ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi 33.

²⁴² Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi 33.

²⁴³ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafi 33.

98. Fillimisht, Dhoma e Apelit konstaton se në Aktgjykim nuk tregohet se Dhoma Gjyqësore nuk ishte e bindur me argumentimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në Aktakuzë. Rrjedhimisht nuk ngrihet çështja nëse përgjegjësia e ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishte argumentuar mjaftueshmërisht në Aktakuzë dhe nuk do të merret në shqyrtim prej Dhomës së Apelit

99. Për sa i përket elementëve thelbësorë për vërtetimin e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kapitulli i Aktgjykimit i titulluar “Kuatru ligjor në lidhje me përgjegjësinë e akuzuar” parashton saktësisht kushtet e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale sipas përkufizimit të jurisprudencës së Tribunalit.²⁴⁴ Në shqyrtimin e pjesëmarrjes së tre të Akuzuarve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

Në *mungesë të provave* që tregojnë se një grup individësh identitetet e të cilëve së paku mund të provoheshin duke iu referuar kategorisë së tyre si grup, në kuptimin e përcaktuar në jurisprudencë, zbatuan një plan të përbashkët, dhe duke marrë parasysh *mungesën e provave* në lidhje me objektivin e një plani të tillë, nuk janë provuar elementët kryesorë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁴⁵

Një interpretim i thjeshtë i këtij përfundimi është se Dhoma Gjyqësore nuk u bind se Prokuroria kishte paraqitur prova të mjaftueshme për identitetin e pjesëmarrësve të pretenduar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale me qëllim që të vërtetone ekzistencën e një bashkësie personash që kishin një plan të përbashkët. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit nuk u bind se Dhoma Gjyqësore përdori një qasje të kufizuar ligjore në lidhje me kushtin ligjor të “identifikimit” siç u argumentua nga Prokuroria.

(b) Identifikimi i anëtarëve të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale: pretendim për gabim faktual

100. Ndryshe Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual kur nuk mundi të konkludonte se i vetmi përfundim i arsyeshëm nga provat ishte se anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore u identifikuan në masë të mjaftueshme nëpërmjet kategorisë së tyre si grup, konkretisht, *ushtarët e UÇK-së në kampin e Llapushnikut*, ndër të të cilët edhe tre të Akuzuarit.²⁴⁶

²⁴⁴ Aktgjyrimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 511.

²⁴⁵ Aktgjyrimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 669 (theksi shtohet)

²⁴⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.245, 2.253; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 4.12-4.15.

101. Prokuroria parashton se përcaktimet e Dhomës Gjyqësore e mbështesin këtë përfundim. Ajo konkludoi se, së pari UÇK-ja drejtoi kamp-burgun në Llapushnik dhe rrjedhimisht pranoi se ushtarët e UÇK-së kryen krime në kamp;²⁴⁷ së dyti, “dëshmitë e të tërë dëshmitarëve përputhen në lidhje me praninë e rojeve në atë territor”;²⁴⁸ dhe së treti, së paku dy roje, Haradin Bala dhe “Murrizi”, ishin të identifikueshëm prej emrit.²⁴⁹ Në lidhje me keqbërësit “pa emër” të cilët kryen krime në kamp, Prokuroria argumenton se këta keqbërës mund të identifikoheshin prej përkatësisë së tyre si ushtarë të UÇK-së në kamp, duke qenë se dëshmitë nuk mbështesin ekzistencën e “elementëve të pakontrolluar” ose keqbërësve “të rastësishëm” që vepronin në kamp.²⁵⁰

102. Në Aktgjykim Dhoma Gjyqësore konkludoi se “ishin disa njerëz që u përfshinë në kryerjen e veprimeve kriminale të vërtetuara në këtë vendim” dhe se “provat mund të mbështesin deduksionin [...] se duhet të ketë ekzistuar një farë forme e ndërmarrjes së përbashkët kriminale e përbërë prej personash të panjohur të cilët ishin anëtarë të UÇK-së”.²⁵¹ Mirëpo nga ana tjetër Dhoma konkludoi se “nuk ekzistonin prova që tregonin se një grup individësh identitetet e të cilëve mund të përcaktoheshin së paku duke iu referuar kategorisë së tyre si grup në kuptimin e identifikimit në jurisprudencë, mbështetën një plan të përbashkët”.²⁵² Dhoma Gjyqësore konkludoi se nuk mund të përcaktonte identitetin e personave pjesëmarrës në funksionimin e kampit, me përjashtim të Haradin Balës.²⁵³

103. Për arsyet e poshtështjelluara Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk bëri gabim faktual kur konkludoi se provat ishin të pamjaftueshme për identifikimin e një bashkësie personash të cilët mbështetën një plan të përbashkët për trajtimin mizor në kamp-burgun e Llapushnikut.

104. Dhoma Gjyqësore përcaktoi se “të tërë dëshmitarët dëshmuuan se rojet e kamp-burgut ishin Shala ose Shala dhe Murrizi”.²⁵⁴ Për të dy u vërtetua se ishin ushtarë të UÇK-së,²⁵⁵ dhe Dhoma Gjyqësore konkludoi se kamp-burgu u drejtua prej UÇK-së dhe ekzistoi afërsisht për gjashtë javë.²⁵⁶ Jurisprudenca e Dhomës së Apelit ofron udhëzime të qarta në lidhje me faktin se çfarë konsiderohen prova të mjaftueshme për përcaktimin e identifikimit të pjesëmarrësve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Në *Krnjelac* i akuzuari u gjykua fajtor si bashkëkryes në një

²⁴⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.246, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 282. Shih edhe Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.247, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 291, 666, 296-297 (Dëshmitari L07); 300 (Dëshmitari L10); 310-311 (Dëshmitari L04); 336 (Fehmi Xhema).

²⁴⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.246, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276.

²⁴⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.246, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 666.

²⁵⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.248-2.51; Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 4.16-4.29.

²⁵¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 666.

²⁵² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 669, 666.

²⁵³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 666.

²⁵⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276. Shih po aty paragrafi 666.

²⁵⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 454.

ndërmarrje të përbashkët kriminale sistemore për kryerjen e krimeve në objektin e burgimit KP Dom në Foça.²⁵⁷ Megjithëse Dhoma e Apelit gjykoi se “keqbërësit kryesorë që përbënin synimin e përbashkët [...] duhen [...] identifikuar sa më saktësisht që të jetë e mundur”,²⁵⁸ ajo konkludoi se për përcaktimin e identifikimit ishte e mjaftueshme të vërtetohej se keqbërësit kryesorë ishin “autoritete civile dhe ushtarake dhe/ose roja dhe ushtarë të pranishëm në KP Dom”.²⁵⁹ Po ashtu në *Vasiljeviq*, Dhoma e Apelit pranoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale për kryerjen e përndjekjeve megjithëse dy prej tre pjesëmarrësve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale ishin persona të paidentifikuar.²⁶⁰ Në *Kërstiq* Dhoma e Apelit pranoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se ekzistonte një ndërmarrje e përbashkët kriminale për kryerjen e genocidit, megjithëse “Dhoma Gjyqësore nuk identifikoi anëtarë të veçantë të Shtabit të Përgjithshëm të VRS-së/Ushtria e Republikës Serbe/ si pjesëmarrës kryesorë në një fushatë genocidiale”.²⁶¹ Bazuar në të njëjtën arsye Dhoma e Apelit në *Stakiq* konkludoi se ndër pjesëmarrësit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale “ishin drejtues të organeve politike, të ushtrisë dhe të policisë të cilët kishin pushtet në komunën e Prijedorit”, pa identifikim të mëtejshëm.²⁶² Gjithashtu në *Bërdanin*, Dhoma e Apelit përcaktoi se megjithëse Dhoma duhet të “identifikojë bashkësinë e personave pjesëmarrës në NPK [...] nuk është e nevojshme të identifikojë me emër çdo person pjesëmarrës”.²⁶³ Bazuar në këto përfundime, Dhoma e Apelit është bindur se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të konkludonte se ishte e pamundur “të përcaktohej identiteti i personave të përfshirë në funksionimin e kamp-burgut me përjashtim të të Akuzuarit Haradin Bala”.²⁶⁴ Përkundrazi, përfundimi i vetëm i arsyeshëm prej provave dhe prej konkluzioneve të lartpërmendura të Dhomës Gjyqësore është se edhe roja i UÇK-së i njohur si Murrizi ishte i identifikueshëm si pjesëmarrës në funksionimin e kamp-burgut bashkë me Haradin Balën.

105. Në lidhje me çështjen nëse anëtarë të tjerë të UÇK-së që kryen krimet e trajtimit mizor dhe torturës në kamp-burgun e Llapushnikut u identifikuan si të përfshirë në funksionimin e kamp-burgut, Dhoma Gjyqësore konkludoi se:

²⁵⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 282.

²⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit Kërnojelac, paragrafët 108-112

²⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit Kërnojelac, paragrafi 116.

²⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit Kërnojelac, paragrafi 116.

²⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, paragrafët 130, 142.

²⁶¹ Aktgjykimi i Apelit Kërstiq/ *Krstić*, paragrafi 143.

²⁶² Aktgjykimi i Apelit Stakiq, paragrafi 69.

²⁶³ Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 430.

²⁶⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 666.

- 1) Të burgosurit rriheshin prej ushtarëve të UÇK-së thujse për ditë, kryesisht gjatë natës;²⁶⁵
- 2) Dëshmitari 07 u rrah prej një personi me maskë dhe prej “një personi tjetër në uniformë ushtarake”;²⁶⁶
- 3) Dëshmitari 10 u rrah dy herë prej rojeve të UÇK-së;²⁶⁷
- 4) Dëshmitari L06 u godit me shkop në shpinë në mënyrë të përsëritur, sipas tij prej Ramadan Behlulit dhe u godit në qafë prej Ali Gashit, të dy ushtarë të UÇK-së;²⁶⁸ duke qenë se kjo u bë “për një qëllim të caktuar”, konkretisht për ndëshkimin dhe/ose marrjen e informacionit prej tij në lidhje me të ashtuquajturit “spiunë”, Dhoma Gjyqësore gjykoi se ishin vërtetuar elementët e torturës;²⁶⁹
- 5) Dëshmitari L04 pa të burgosur të tjerë që u rrahën vazhdimisht prej ushtarëve të UÇK-së. Ai vetë u keqtrajtua prej anëtarëve të UÇK-së, për dy prej të cilëve tha se ishin “Tamuli” dhe “Çerçizi”.²⁷⁰
- 6) Dëshmitari L12 u lidh me zinxhir pas një muri dhe u rrah me shkop prej Haradin Balës të cilin dëshmitari e përmendi si “Shala” dhe i cili ishte ushtar i UÇK-së;²⁷¹ duke qenë se kjo u bë për të nxjerrë informata prej tij, Dhoma Gjyqësore përcakttoi ekzistencën e elementëve të torturës.²⁷²
- 7) Stamen Genovi u rrah me kondakë pushkësh dhe u shkelmua prej ushtarëve të UÇK-së;²⁷³ gjithashtu Dhoma Gjyqësore gjykoi se kjo u bë për ta ndëshkuar dhe hetuar atë për shkak të përkatësisë së tij ushtarake. Rrjedhimisht u konkludua në ekzistencën e elementëve të torturës.²⁷⁴

²⁶⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 291, 300, 311, 424.

²⁶⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 296-297.

²⁶⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 300.

²⁶⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 245, 304, 666.

²⁶⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët, 304, 306.

²⁷⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 310-311.

²⁷¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët, 315, 649, 658.

²⁷² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët, 316, 318.

²⁷³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 365.

²⁷⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët, 365-366, 373.

- 8) Shaban Hoti u rrah dhe u keqtrajtua egërsisht prej ushtarëve të UÇK-së për dy ditë; përsëri Dhoma Gjyqësore konkludoi se u vërtetuan elementët e torturës.²⁷⁵

Këto përfundime bëjnë të qartë se ushtarët e UÇK-së i rrahën sistematikisht të burgosurit, duke kryer krimin e trajtimit mizor dhe torturës në kamp.

106. Mirëpo në lidhje me çështjen nëse këta ushtarë të UÇK-së ishin të identifikueshëm si pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale sistemore, Dhoma Gjyqësore konkludoi se

megjithëse parë nga një këndvështrim i mundshëm provat mund të mbështesin përfundimin se duhet të ketë ekzistuar një formë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale e përbërë prej personash të panjohur të cilët ishin anëtarë të UÇK-së, kjo është kaq e përgjithshme saqë nuk mund të ofrojë kategorizim të mjaftueshëm për identifikimin e pjesëmarrësve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.²⁷⁶

Kjo u bazua në përfundimet e Dhomës Gjyqësore se nuk mund të përjashtohet mundësia që persona të cilët nuk ishin të përfshirë në funksionimin e kampit, ose “vizitorë të rastësishëm”, kryen krime për qëllime personale si për shembull hakmarrje, dhe jo në bazë të një praktike apo plani të UÇK-së me objektiv civilët serbë dhe shqiptarët kosovarë të konsideruar bashkëpunëtorë.²⁷⁷ Me fjalë të tjera, Dhoma Gjyqësore nuk u bind se Prokuroria kishte vërtetuar që Haradin Bala, Murrizi dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së ishin pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët sistemore kriminale me një plan të përbashkët për shënjestrimin e civilëve serbë dhe shqiptarë kosovarë të konsideruar bashkëpunëtorë në kamp-burg. Më poshtë shqyrtohet fakti nëse një gjykues i arsyeshëm faktesh do të kishte nxjerrë të njëjtin përfundim.

(c) A ishte përfundim i arsyeshëm i nxjerrë prej Dhomës Gjyqësore se krimet mund të jenë kryer nga “vizitorë të rastësishëm”, të cilët nuk mund të identifikoheshin si anëtarë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale sistemore

107. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor dhe faktual kur konkludoi se “[nuk mund] të përjashtohet” që “persona të përfshirë në funksionimin e kampit ose ‘vizitorë të rastësishëm’ në kamp [...] për arsye personale si hakmarrje, keqtrajtuat ose vranë armiq të vjetër [dhe/ose] të burgosur për arsye të tjera dhe jo si zbatim i politikës së UÇK-së.”²⁷⁸ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore ose kreu gabim ligjor - kur konkludoi se motivet personale përjashtojnë një krim të kryer në zbatimin e një plani të përbashkët ose bëri gabim faktual kur

²⁷⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 424-425.

²⁷⁶ Po aty, paragraf 666

²⁷⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668.

²⁷⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.254-2.255 që i referohen Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 667-668.

konkludoi se ekzistonte mundësi e arsyeshme që “elementë të pakontrolluar” ose “vizitorë të rastësishëm” mund të kenë kryer krime në kamp për motive thjesht personale.²⁷⁹

108. Në lidhje me pretendimin për gabim ligjor, Prokuroria argumenton se motivet personale nuk përjashtojnë synimin e keqbërësit për mbështetjen e një sistemi keqtrajtimesh, nëqoftëse keqbërësi kishte *gjithashtu* synim mbështetjen e këtij sistemi keqtrajtimesh.²⁸⁰

109. Dhoma e Apelit thekson se përgjithësisht motivi nuk është element i përgjegjësisë penale. Dhoma e Apelit ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur “papërcaktueshmërinë e motiveve në të drejtën penale” në lidhje me përgjegjësinë, kur synimi [...] është i qartë”.²⁸¹ Në lidhje me *gjendjen mendore kriminale* të ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore kërkohet prova e dijenisë personale të pjesëmarrësit të sistemit të keqtrajtimit, si dhe synimit për mbështetjen e këtij sistemi.²⁸²

110. Gjithsesi Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk i ngatërroi nocionet e motivit dhe të synimit kur kërkoi si provë për ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore që plani i përbashkët të shënjestronte civilë serbë dhe shqiptarë kosovarë të konsideruar si bashkëpunëtorë. Megjithëse motivi nuk është element i *gjendjes mendore të fajshme* në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, ekzistenca dhe objektivi i një plani të përbashkët është pjesë e *sjelljes së fajshme*. Rrjedhimisht shënjestrimi i këtyre grupeve të përcaktuara ishte pjesë e *veprimeve të fajshme* të ndërmarrjes së përbashkët kriminale së pretenduar në Aktakuzë.²⁸³ Si rezultat, në Aktgjykimin e vetë Dhoma Gjyqësore nuk mund ta zgjeronte dhe nuk e zgjeroi objektivin e planit të përbashkët, duke mos përfshirë kryerjen e krimeve kundër *çfarëdo* të burgosuri në kamp, pavarësisht faktit se bëhej fjalë për civilë serbë apo shqiptarë kosovarë të konsideruar si bashkëpunëtorë.

111. Në lidhje me pretendimin për gabim faktual, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur konkludoi se nuk mund të përjashtohet mundësia që disa keqbërës në kamp u nxitën *vetëm* prej motiveve personale, dhe se këto krime nuk u kryen në mbështetje të një plani të

²⁷⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.255. Shih edhe AT 129, 135-137 dhe 205-206(6.6.2007).

²⁸⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.256-2.257 që i referohen Aktgjykimin të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668.

²⁸¹ Aktgjykimin e Apelit Jelisiq/ Jelisić, paragrafi 71, i referohet Aktgjykimin të Apelit Tadiq, paragrafi 269. Shih edhe Aktgjykimin e Apelit Kvpeka, paragrafi 106. Motivi mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në dhënien e dënimit si rrethanë lehtësuese ose rënduese, Aktgjykimin e Apelit Tadiq, paragrafi 269.

²⁸² Aktgjykimin e Apelit Tadiq, paragrafët 202, 220, 228.

²⁸³ Gjithashtu në çështjen *Stakiq* Dhoma e Apelit konkludoi se “qëllimi i përbashkët u sendërtua nëpërmjet një fushate diskriminuese për spastrimin etnik të komunës së Prijedorit me dëbimin dhe përndjekjen e muslimanëve bosnjakë dhe kroatëve bosnjakë *për vendosjen e kontrollit serb* (“Qëllimi i Përbashkët”).” (Aktgjykimin e Apelit Stakiq, paragrafi 73, është shtuar theksi). Si pasojë më shqyrtimin e synimit të Z. Stakiq për mbështetjen e Qëllimit të Përbashkët, Dhoma e Apelit mori parasysh përfundimet e Dhomës Gjyqësore se Z. Stakiq bashkëpunonte me pjesëmarrës të tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale “për zbatimin e planit të iniciuar prej SDS-së për konsolidimin e pushtetit dhe autoritetit serb në komunë”, dhe se “ai ishte i vetëdijshëm se mund të pengonte objektivin e arritjes së një komune serbe [...]” (po aty., paragrafi 82). Pra Qëllimi i Përbashkët nuk

përbashkët.²⁸⁴ Gjithashtu Prokuroria argumenton se bazuar në përfundimet e vetë Dhomës Gjyqësore, e vetmja çështje e “grindjeve personale” e pretenduar prej Mbrojtjes nuk pati asnjë ndikim mbi ngjarjet në kamp.²⁸⁵ Në shqyrtimin e këtyre çështjeve, Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse ishte e arsyeshme të konkludohej se elementë të pakontrolluar *brenda* UÇK-së mund të kenë kryer krime jashtë planit të përbashkët,²⁸⁶ dhe a ishte e arsyeshme të konkludohej se “vizitorë të rastësishëm” *jashtë* UÇK-së mund të kenë ardhur në kamp dhe kryen krime që nuk përfshiheshin në planin e përbashkët.²⁸⁷

(i) A mund të ketë patur elementë “të pakontrolluar” të UÇK-së ose “vizitorë të rastësishëm” të cilët mund të kenë kryer krime jashtë planit të përbashkët

112. Dhoma Gjyqësore konkludoi se “bazuar në provat në disponim nuk është i mundur përfundimi se të tëra krimet në lidhje me kamp-burgun u kryen prej pjesëmarrësve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale [sepse] nga dëshmitë shihet se gjatë periudhës përkatëse disa ushtarë të UÇK-së ndaluan njerëz për arsye të tjera dhe jo në zbatim të politikës së UÇK-së për të luftuar bashkëpunimin me autoritetet serbe.”²⁸⁸

113. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore konkludoi se “disa ushtarë të UÇK-së” mund të kenë arrestuar njerëz për arsye të tjera të ndryshme nga “zbatimi i ndonjë praktike apo plani të UÇK-së për shënjestrimin e civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar si bashkëpunëtorë.”²⁸⁹ Ky përfundim u bazua në një diskutim të mëparshëm në të cilin Dhoma Gjyqësore përmendi “raste rrëmbimesh faktori motivues i të cilave ishte hakmarrja personale e anëtarëve të veçantë të UÇK-së”.²⁹⁰ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore përmendi dëshminë e dhënë nga Susanne Ringgaard Pedersen, anëtare e Misionit Verifikues të Kosovës (“MVK”) në periudhën dhjetor 1998 - mars 1999 në mbështetje të përfundimit të vetë se disa elementë “të pakontrolluar” të UÇK-së mund të kenë mbajtur të burgosur për arsye personale.²⁹¹ Dhoma e Apelit thekson se në pjesën e cituar nga Dhoma Gjyqësore, ajo u pyet nëse “MVK-ja mori informacion në lidhje me rrëmbimet prej UÇK-së, *përfshirë edhe të ashtuquajturit bashkëpunëtorë*”, dhe nëse kjo ishte bërë prej “elementëve të

kufizohej në kryerjen e krimeve statutores, por përfshinte edhe synimin që do të realizohej nëpërmjet kryerjes së krimeve, ose me fjalë të tjera, një motiv.

²⁸⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë., paragrafi 2.258, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 667-669.

²⁸⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë., paragrafi 2.263, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 31 - 312, 668.

²⁸⁶ Shih Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668.

²⁸⁷ Shih Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 667.

²⁸⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 667-668 (theksi I shtuar). Shih po aty., paragrafi 216.

²⁸⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668.

²⁹⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 668 dhe 216 që ndër të tjera i referohen Jakup Krasniqit, T. 3441 (14.2.2005).

²⁹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668. poshtëshënimi 2265.

pakontrolluar” ose në zbatim të një “praktike më të gjerë”.²⁹² Ajo u përgjigj se sipas informacionit që kishte MVK-ja në atë kohë “ekzistonin elementë të pakontrolluar dhe *herë pas here* [UÇK-ja] e kishte të vështirë të kontrollonte të tëra incidentet e hakmarrjes personale dhe raste të ngjashme”.²⁹³ Gjithashtu dëshmitarët Jan Kickert dhe Shukri Buja ofruan dëshmi për ekzistencën e “elementëve të pakontrolluar të UÇK-së”.²⁹⁴ Ndërsa Jan Kickert përmendi “fraksione të shkëputura të UÇK-së” në Kosovën perëndimore,²⁹⁵ Shukri Buja dëshmoi se ai dëgjoi për raste kur njerëzit u arrestuan ose mbajtën të burgosur për hakmarrje personale në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja. Ai shtoi më tej se “veçanërisht gjatë ofensivës në korrik kishte thashethemeve rreth këtyre ngjarjeve”.²⁹⁶

114. Më tej Dhoma Gjyqësore shqyrtoi edhe dëshminë e Jakup Krasniqit, në atë kohë zëdhënës i UÇK-së,²⁹⁷ dhe Peter Bouckaert në atë kohë hulumtues i Vëzhguesit për Të Drejtat e Njeriut/Human Rights Watch/.²⁹⁸ Dhoma Gjyqësore konkludoi “se [Peter Bouckaert] nuk pa asnjë urdhëresë të lëshuar prej UÇK-s për anëtarët e saj për shënjestrimin e civilëve të pafajshëm ose për plaçkitjen apo shkatërrimin e pronave serbe.”²⁹⁹ Gjithashtu u pranua deklarata e Jakup Krasniqit se “politika ushtarake apo civile e UÇK-së nuk përfshinte rrëmbimin, torturimin apo vrasjen e civilëve të pafajshëm.” Mbi bazën e këtyre dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “provat nuk vërtetojnë apo madje as nuk sugjerojnë *ekzistencën e një praktike të përgjithshme* të shënjestrimit të civilëve si të tillë, qofshin serbë apo shqiptarë kosovarë.”³⁰⁰ Së fundi Dëshmitari L12 dëshmoi se në një rast atij iu lidhën sytë nga Haradin Bala dhe u çua në një kamp-burg ku u rrah prej dy grave. Me gjasë, kjo tregon praninë e “vizitorëve të rastësishëm” në kamp.³⁰¹

115. Bazuar në këto prova, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se “nuk mund të vërtetohet bindshëm se këto krime [në kamp] në fakt u kryen në kontekstin e zbatimit të ndonjë praktike apo plani të UÇK-së për shënjestrimin e civilëve serbë dhe shqiptarëve të konsideruar bashkëpunëtorë”.³⁰²

116. Prokuroria argumenton më tej se cilido anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore që kontribuoi në krimin e një “të jashtmi” duhet të konsiderohet gjithashtu se e kreu këtë

²⁹² Susanne Ringgaard Pedersen, T. 3532 (15.2.2005) (theksi i shtuar).

²⁹³ Po aty, Shih po aty., T.3534 (15.2.2005).

²⁹⁴ Limaj Defense, Answers to Questions Posed by Appeals Chamber on 30 May 2007, 6 June 2007./Mbrojtja e Limajt, Përgjigje për Pyetjet e bëra nga Dhoma e Apelit më 30 maj 2007, 6 qershor 2007.

²⁹⁵ Jan Kickert, T. 676 (23.11.2004).

²⁹⁶ Shukri Buja, T. 4042-4044 (9.3.2005).

²⁹⁷ Jakup Krasniqi, T. 3311 (10.2.2005).

²⁹⁸ Peter Bouckaert, T. 5458(8.4.2005).

²⁹⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 215, që i referohet Peter Bouckaert, T. 5564-5565 (8.4.2005).

³⁰⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 215 (theksi është shtuar)

³⁰¹ Aktgjykimi i Apelit Kvoçka, paragrafi 599. Dhoma e Apelit konkludoi se megjithëse në përgjithësi një pjesëmarrjes i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale nuk ka nevojë të japë kontribut thelbësor në të, në lidhje me “vizitorë të rastësishëm”, nevojitet kontribut thelbësor në lidhje me efektin tërësor të kampit për vërtetimin e përgjegjësisë në pajtim me doktrinën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale”, *po aty*.

krim së bashku me të jashtmin në një ndërmarrje të përbashkët kriminale klasike.³⁰³ Mirëpo Dhoma e Apelit gjykon se Haradin Balës nuk iu dha njoftim i mjaftueshëm në lidhje me këtë ndërmarrje të përbashkët kriminale klasike si alternativë. Në Aktakuzë nuk pretendohet se ai bëri marrëveshje me ndonjë “të jashtëm” për kryerjen e krimeve statutore,³⁰⁴ dhe kjo nuk u argumentua as gjatë procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk e konsideron të përshtatshme të shqyrtojë vlerat e këtij argumenti. Referimi ndaj Aktgjykimit të Apelit Blashkiq prej Prokurorisë ku Dhoma e Apelit konkludoi se në aktakuzë duhen argumentuar “veprimet e të akuzuarit, dhe jo veprimet e atyre personave për veprimet e të cilëve pretendohet përgjegjësia e tij”,³⁰⁵ nuk ka asnjë ndikim në lidhje me këtë çështje. Ashtu si dhe në çështjen Blashkiq Dhoma e Apelit konkludoi se “Prokurorisë mund t’i kërkohet ‘të bëjë të ditur shprehimisht dhe saktësisht në lidhje me çdo akuzë të veçantë, natyrën e përgjegjësisë së akuzuar’, me fjalë të tjera të provojë një formë të caktuar pjesëmarrjeje”.³⁰⁶

117. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore logjikisht konkludoi se nuk mund të përjashtohet mundësia që krimet në kamp të jenë kryer prej “të jashtëmëve” të cilët nuk ishin pjesë e planit të përbashkët për vënien në shënjestër të civilëve serbë dhe shqiptarëve kosovarë të konsideruar si bashkëpunëtorë. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit është e bindur se prej provave mund të nxirret përfundimi i arsyeshëm se veç krimeve për të cilat u dënua Haradin Bala, nuk mund të identifikoheshin kryesit e krimeve në kamp. Si pasojë, në lidhje me këto krime, Dhoma Gjyqësore logjikisht arriti në përfundimin se keqbërësit nuk mund të identifikoheshin si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale sistimore.

118. Në lidhje me përgjegjësinë penale të Haradin Balës, Dhoma e Apelit nuk e gjykon të nevojshme të rishqyrtojë çështjen nëse ai ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale sistimore. Kjo është rrjedhojë e përfundimit të Dhomës së Apelit se deduksioni i nxjerrë prej provave i Dhomës Gjyqësore se “të jashtëm” të pidentifikuar kryen krime në kamp, nuk është i paarsyeshëm.³⁰⁷ Rrjedhimisht fakti nëse Haradin Bala ishte ose nuk ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe nëse kjo ndërmarrje ekzistonte nuk ka aspak lidhje me përgjegjësinë e tij penale për krimet e “të jashtëmëve”.³⁰⁸

³⁰² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 668.

³⁰³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.276.

³⁰⁴ Shih në veçanti Aktakuzën, paragrafët 9, 13.

³⁰⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 4.34, që i referohet Aktgjykimit të Apelit Blashkiq, paragrafi 210, dhe çështja Kvoçka ku nuk pati argumente se veprimet e Zhigiqit i atribuoheshin Kvoçkës i cili gjithsesi u ngarkua me përgjegjësi për këto veprime.

³⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit Blashkiq, paragrafi 212.

³⁰⁷ Dhoma e Apelit në Kvoçka dhe të tjerët konkludoi se “nuk do të ishte e përshtatshme që të ngarkoheshin me përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të tërë vizitorët në kamp të cilët kryen krime”. Shih Aktgjykimin e Apelit Kvoçka dhe të tjerët, paragrafi 599.

³⁰⁸ Dhoma e Apelit thekson se kryesit të cilët kryen krimet të cilat Haradin Bala i ndihmoi dhe inkurajoi - torturimi i Dëshmitarit L12 dhe episodi i trajtimit mizor të Dëshmitarit L04 - nuk mund të identifikoheshin. Rrjedhimisht nuk mund të vërtetohet se këto krime u kryen nga pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale sistimore.

119. Gjithashtu argumenti i Prokurorisë se vrasja ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale sistemore³⁰⁹ nuk kërkon që Dhoma e Apelit të përcaktojë nëse Haradin Bala ishte anëtar i një ndërmarrjeje të tillë të përbashkët kriminale sistemore. Përgjithësisht në rast të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të kategorisë së tretë, krimet duhet të kryhen nga anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.³¹⁰ Duke qenë se Dhoma Gjyqësore konkludoi logjikisht se nuk mund të vërtetohej me siguri të mjaftueshme se të tëra krimet në kamp-burg u kryen në zbatim të një plani të përbashkët, nga provat nxirret deduksioni i arsyeshëm se vrasjet e Fehmi Xhemës, Jefta Petkoviçit dhe Agim Ademit përfshirë në Pikën 8 të Aktakuzës,³¹¹ nuk u kryen prej anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore. Për pasojë Haradin Bala nuk mund të mbartë përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të kategorisë së tretë për këto vrasje. Gjithashtu Dhoma e Apelit thekson se Prokuroria nuk argumenton në apelim se ai mbart përgjegjësi penale për këto krime si ndihmues dhe inkurajues.³¹²

120. Për më tepër Dhoma e Apelit konkludon se edhe sikur Haradin Bala të ishte anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale sistemore, ai nuk mund të dënohej për shfrytëzimin e “të jashtëmëve” për kryerjen e krimeve në kamp. Në këtë kontekst Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e vetë në *Bërdanin* se

për ngarkimin e përgjegjësishë një anëtari të NPK-së përgjegjës për krimet e kryera nga joanëtarët e ndërmarrjes, duhet provuar se krimi mund t’i atribuohet një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe se ky anëtar -në rast se është fjala për një keqbërës kryesor- veprimi në përputhje me planin e përbashkët. Ekzistenca e një lidhjeje të tillë duhet shqyrtuar rast pas rasti.³¹³

Gjithsesi Dhoma e Apelit konstaton se as gjatë procesit gjyqësor dhe as në apelim nuk u argumentua nëse mund të ngarkohej Haradin Bala me përgjegjësi të ndërmarrjes së përbashkët kriminale sistemore për krime të kryera nga joanëtarë të ndërmarrjes. Për më tepër Dhoma i referohet përfundimit të saj në *Bërdanin* se parashtrimi i fajësive të tjera do të ishte i padrejtë në atë çështje me arsyen se nuk kërkohet që keqbërësit kryesorë të jenë anëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke qenë se kjo nuk u argumentua gjatë procesit gjyqësor.³¹⁴ Ky arsyetim është i vlefshëm edhe në këtë çështje

³⁰⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.290(a)(iv), 3.157 dhe 4.7.

³¹⁰ Shih Aktgjykimin e Apelit Tadiq, paragrafi 220.

³¹¹ Aktakuza, paragrafët 8, 28, 31-32 dhe Shtojca II. Pika 8 përfshinte edhe pretendimin për vrasjen e Zvonko Marinkoviçit dhe Vesel Ahmetit. Mirëpo Dhoma Gjyqësore konkludoi se në lidhje me të dy ata nuk ishin vërtetuar elementët e vrasjes

³¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 4.12

³¹³ Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 413.

³¹⁴ Aktgjykimi i Apelit Bërgjanin, paragrafi 361.

(ii) A mund të ketë Haradin Bala përgjegjësi penale si ndihmës dhe inkurajues për krime të kryera nga “vizitorë të rastësishëm”

121. Ndryshe Prokuroria argumenton se në lidhje me përgjegjësinë penale të Haradin Balës si anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale ai ndihmoi dhe inkurajoi në trajtimin mizor dhe torturimin e të burgosurve në kamp-burg.³¹⁵

122. Dhoma e Apelit vëren se në Aktakuzë Haradin Bala akuzohet për përgjegjësi penale bazuar në Nenin 7(1) të Statutit, ndër të tjera për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e këtyre krimeve.³¹⁶ Kjo formë pjesëmarrjeje është diskutuar në procesin gjyqësor dhe Dhoma Gjyqësore e shpalli Haradin Balën fajtor për ndihmë dhe inkurajim në torturimin e Dëshmitarit 12 dhe në një rast të trajtimit mizor të Dëshmitarit L04. Gjithsesi Dhoma Gjyqësore nuk e shpalli penalisht përgjegjës për ndihmë dhe inkurajim në ndonjë rast tjetër të trajtimit mizor ose torturimit.³¹⁷

123. Gjithsesi Dhoma e Apelit nuk është e bindur se i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat është se veç fajësimeve prej Dhomës Gjyqësore për ndihmë dhe inkurajim, Haradin Bala mbart përgjegjësi penale për ndihmë dhe inkurajim në raste të tjera të trajtimit mizor dhe torturimit të të burgosurve në kamp-burgun e Llapushnikut. Megjithëse përfundimet e Dhomës Gjyqësore tregojnë rolin kyç të Haradin Balës në funksionimin e kamp-burgut,³¹⁸ për një gjykes faktesh ishte i qartë konkluzioni se provat nuk treguan jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Haradin Bala ofroi ndihmë të qenësishme me vetëdije si ndihmës dhe inkurajues në lidhje me çdo trajtim mizor dhe torturë në kamp-burg. Veç provave në lidhje me pjesëmarrjen e Haradin Balës ose si ndihmës dhe inkurajues në raste konkrete të trajtimit mizor dhe torturës, të cilat Dhoma Gjyqësore i shqyrtoi në mënyrën e duhur në paragrafët 654-663 të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, prej provave mund të nxirret përfundimi i arsyeshëm se Haradin Bala nuk ofroi ndihmë të qenësishme në lidhje me krime të tjera.

2. Përfundim

124. Rjedhimisht arsyeja e parë e apelit të Prokurorisë hidhet tërësisht poshtë.

B. Pika e dytë e apelit: Dënimi

³¹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 4.12.

³¹⁶ Aktakuza, paragrafi 13.

³¹⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 653-663.

³¹⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 247, 251, 276 dhe 652.

125. Si alternativë ndaj pikës së parë të apelit Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi në përcaktimin e dënimit duke i dhënë Haradin Balës një dënim qartësisht të pamjaftueshëm me 13 vjet burgim.³¹⁹ Prokuroria argumenton se gabimi i Dhomës Gjyqësore ishte në tre aspekte. Së pari dënimi nuk pasqyron peshën e krimeve të Haradin Balës.³²⁰ Së dyti Dhoma Gjyqësore gaboi në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.³²¹ Së treti dënimi është qartësisht i pamjaftueshëm krahasuar me dënimet e dhëna për raste të ngjashme.³²² Rrjedhimisht Prokuroria kërkon dhënien e një dënimi më të gjatë për Haradin Balën.³²³

1. Standardi për shqyrtimin apelues të dënimit

126. Dispozitat përkatëse në lidhje me dënimin janë Nenet 23 dhe 24 të Statutit dhe Rregullat 100-106 të Rregullores. Neni 24 i Statutit dhe Rregulla 101 e Rregullores përmbajnë udhëzime të përgjithshme për Dhomën Gjyqësore që e detyrojnë atë të marrë parasysh këta faktorë në dhënien e dënimit; rëndësinë e veprës penale ose tërësinë e sjelljes së fajshme; rrethanat personale të personit fajtor; praktikën e përgjithshme në lidhje me dënimet me burgim të gjykatave në ish-Jugosllavi; dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.³²⁴

127. Apelimet ndaj dënimeve si apeline kundër një aktgjykimi janë apeline *stricto sensu*; ata kanë karakter korigjues dhe nuk janë gjykime *de novo*.³²⁵ Dhomat Gjyqësore janë mvëshur me kompetencë të gjerë për përcaktimin e dënimit të përshtatshëm për shkak të detyrimit të tyre për individualizimin e dënimeve në përshtatje të rrethanave të të akuzuarit dhe peshës së krimit.³²⁶ Në përgjithësi Dhoma e Apelit nuk e rishikon një dënim n.q.s. Dhoma Gjyqësore nuk ka bërë “gabim të dukshëm” në ushtrimin e kompetencës së saj ose nuk ka zbatuar ligjin përkatës.³²⁷ Është detyrë e apeluesit të tregojë se Dhoma Gjyqësore ka tejkaluar kompetencat e veta në dhënien e dënimit.³²⁸

128. Për të provuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm në ushtrimin e kompetencave të veta “Apeluesi duhet të provojë se Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi faktorëve të jashtëm ose pa lidhje, nuk u kushtoi rëndësi ose rëndësi të mjaftueshme faktorëve përkatës, bëri gabim të qartë faktual në ushtrimin e kompetencave të veta ose se vendimi i Dhomës Gjyqësore ishte kaq i

³¹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 4.15.

³²⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.20-4.36.

³²¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.20, 4.37-4.43.

³²² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.20, 4.44-4.49.

³²³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 4.50.

³²⁴ Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 392, me referenca të mëtejshme.

³²⁵ Po aty., paragrafi 393, me referenca të mëtejshme.

³²⁶ Po aty., me referenca të mëtejshme.

³²⁷ Po aty., me referenca të mëtejshme.

³²⁸ Po aty., me referenca të mëtejshme.

paarsyeshëm apo thjesht i padrejtë saqë Dhoma e Apelit mund të konkludojë se Dhoma Gjyqësorë duhet të ketë dështuar në ushtrimin e duhur të kompetencave të veta.³²⁹

2. Pretendim për gabim në lidhje me mosgjykimin e duhur të rëndesës së krimeve të Haradin Balës

129. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk i kushtoi rëndësi të mjaftueshme rëndesës së krimeve të Haradin Balës dhe rolit të tij në kryerjen e këtyre krimeve.³³⁰ Në veçanti pretendohet se Dhoma Gjyqësore gaboi në përcaktimin e peshës së vetvetishme të krimeve për të cilat u fajësua Haradin Bala duke theksuar një dallim në dobi të Haradin Balës midis sjelljes së tij dhe krimeve të tjera “më të dhunshme” të kryera nga të tjerët.³³¹ Për më tepër Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi duke mos i dhënë rëndësi të mjaftueshme rolit të Haradin Balës si kryes ose si ndihmës i krimeve për të cilat u fajësua.³³² Gjithashtu pretendohet se Dhoma Gjyqësore gaboi kur i kushtoi rëndësi të tepruar përfundimit të vetë në lidhje me vrasjet në Malet e Berishës se Haradin Bala veproi me urdhër të një autoriteti më të lartë,³³³ dhe duke marrë parasysh si rrethanë lehtësuese mungesën e motivit sadist.³³⁴

130. Haradin Bala përgjigjet se Dhoma Gjyqësore përcaktoi saktësisht peshën e krimeve për të cilat u shpall fajtor, në veçanti peshën e tyre të vetvetishme dhe formën dhe shkallën e pjesëmarrjes së tij në to si edhe ndikimin lehtësues prej mungesës së motivit sadist.³³⁵

131. Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se në krahasim me krimet për të cilat u fajësua Haradin Bala “anëtarë të tjerë të UÇK-së morën pjesë në incidente më të dhunshme keqtrajtuese se Haradin Bala”.³³⁶ Dhoma Gjyqësore e konkretizoi këtë krahasim duke deklaruar se “roli i Haradin Balës shpesh ishte ai i një pjesëmarrësi të thjeshtë që dukej se vepronte me kërkesën e të tjerëve”.³³⁷ Prokuroria nuk provoi se ky krahasim përbën një gabim të dukshëm në dënim.

132. Në lidhje me argumentin e Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi të pamjaftueshme rolit të Haradin Balës si kryes apo si ndihmës dhe inkurajues i krimeve, Dhoma e

³²⁹ Po aty., paragrafi 394, me referenca të mëtejshme.

³³⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.21-4.36. Shih edhe AT 139-141 (6.6.2007)

³³¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.22-4.26.

³³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.27-4.32

³³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.27, 4.33.

³³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.27, 4.34-4.36.

³³⁵ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafët 93-120.

³³⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 726.

³³⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 726.

Apelit rikujton se Dhomat Gjyqësore janë mveshur me kompetencë të gjerë në përcaktimin e dënimit të duhur. Thjesht argumenti se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësi të pamjaftueshme rolit të Haradin Balës si kryes ose si ndihmës dhe inkurajues nuk tregon se Dhoma Gjyqësore tejkaloi kompetencën e saj dënuese. Prokuroria nuk provon se Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi faktorëve të jashtëm ose pa lidhje në këtë aspekt ose se nuk u kushtoi rëndësi të mjaftueshme faktorëve përkatës, ose bëri një gabim të dukshëm në lidhje me faktet mbi të cilat u bazua në gjykimin e vetë ose se vendimi i Dhomës Gjyqësore ishte kaq i parsyeshëm ose thjesht i padrejtë sa që mund të konkludohet se Dhoma Gjyqësore nuk e ka ushtruar kompetencën e vetë në mënyrë të duhur.

133. Prokuroria argumenton më tej se në vlerësimin e krimeve të Haradin Balës, Dhoma Gjyqësore gaboi kur i kushtoi rëndësi të tepruar pretendimit lehtësues të veprimit nën urdhrat e të tjerëve dhe mungesën e motivit sadist. Dhoma e Apelit rikujton se në vlerësimin e peshës së krimit, “Dhoma Gjyqësore duhet të marrë parasysh peshën e vetvetishme të krimit dhe sjelljen kriminale të të akuzuarit, përcaktimi i të cilave *kërkon shqyrtim të rrethanave të veçanta të rastiit dhe të krimeve për të cilat i akuzuari u shpall fajtor [...]*”.³³⁸ Dhoma e Apelit konstaton se në pjesën në lidhje me rrethanat lehtësuese Dhoma Gjyqësore nuk i mori në konsideratë faktin e veprimit në bazë të urdhrave prej të tjerëve dhe mungesën e motivit sadist. Këta faktorë u morën parasysh si rrethana të veçanta gjatë vlerësimit të peshës së krimeve. Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Prokuroria ka provuar se Dhoma Gjyqësore kreu gabim të dukshëm në lidhje me këtë aspekt.

3. Krahasim me raste të ngjashme

134. Prokuroria pretendon se dënimi i Haradin Balës është qartasi i pamjaftueshëm në krahasim me dënimet e dhëna për Esad Lanxhon (15 vjet), Dushko Tadiqin (20), Zlatko Aleksovskin (7 vjet) dhe Mitar Vasijleviqin (15 vjet).³³⁹ Haradin Bala përgjigjet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në analizën e saj të hollësishme krahasuese të fakteve dhe rrethanave të krimeve në lidhje me kamp-burgun, të ngjashme me çështjen në fjalë.³⁴⁰

135. Dhoma e Apelit rikujton përfundimet e veta në çështjen *Dragan Nikoliq* në lidhje me udhërrëfimin që mund të ofrohet prej dënimeve të mëparshme në Tribunalin Ndërkombëtar

Udhërrëfimi që mund të ofrohet prej dënimeve të mëparshme të Tribunalit Ndërkombëtar dhe TPNR-së jo vetëm që është “shumë i kufizuar” por gjithashtu nuk është mënyrë e përshtatshme për kundërshtimin e përfundimeve të

³³⁸ Aktgjykimi i Apelit Galiq, paragrafi 409.

³³⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.44-4.49; AT 140 (6.6.2007).

³⁴⁰ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafët 129-133.

Dhomës Gjyqësore në ushtrimin e kompetencës së saj për dhënie e dënimit. Arsyeja është e dyfishtë. Së pari, megjithëse një krahasim i tillë me rastet e mëparshme mund të bëhet vetëm kur bëhet fjalë për të njëjtat vepra penale, të cilat janë kryer në rrethana thelbësisht të ngjashme, n.q.s. ndryshimet janë më të qenësishme se ngjashmëritë ose ka ndryshime në faktorët lehtësues dhe rëndues, janë të përligjura edhe dënimet e ndryshme. Së dyti Dhoma Gjyqësore si gjykues të fakteve kanë si detyrim parësor përcaktimin e një dënimi në përshtatje me rrethanat konkrete të të akuzuarit dhe peshën e krimit, duke mbajtur parasysh çështjen në tërësi. Dhoma e Apelit rikujton se ajo nuk funksionin si Dhomë e dytë Gjyqësore që drejton një proces gjyqësor të ri dhe nuk do të korrigjojë një dënim n.q.s. Apeluesi nuk provon se Dhoma Gjyqësore ka bërë një “gabim të dukshëm” në ushtrimin e kompetencës së vetë.³⁴¹

136. Dhoma Gjyqësore iu referua shprehimisht dënimeve të Esad Lanxhos dhe Dushko Tadiqit.³⁴² Dhoma e Apelit nuk i gjykon bindëse përpjekjet e Prokurorisë për gjetjen e gabimit të dukshëm në krahasimin e Dhomës Gjyqësore të rastit të Haradin Balës me dy të tjerët. Në lidhje me Esad Lanxhon, Dhoma e Apelit konstaton se Dhoma Gjyqësore *Çelebiqi* konkludoi se krimet e tij - ndër të cilat tri vrasje si krime kundër njerëzimit - karakterizoheshin prej “dhimbjeve, vuajtjeve dhe lëndimeve të konsiderueshme” që ai iu shkaktoi viktimave.³⁴³ Gjithashtu u përcaktua se krimet ishin kryer “shtazërisht” dhe u gjykua se Esad Lanxho kishte shfaqur “prijje veçanërisht sadiste”,³⁴⁴ ndër të tjera duke ngulur një tokëz metalike në kokën e një viktime që nuk mund të ecte dhe që vdiq pas disa orësh si rezultat i lëndimeve.³⁴⁵ Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore iu referua shprehimisht në veçanti karakterit barbar të krimeve të kryera nga Esad Lanxho dhe se mori parasysh mungesën e motivit sadist në krimet e Haradin Balës.³⁴⁶ Si pasojë, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se Prokuroria ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur vlerësoi dënimin e Haradin Balës në krahasim me atë të Esad Lnxhos.

137. Në lidhje me dënimin e dhënë Dushko Tadiqit, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi akuzat bazë faktuale dhe ligjore të çështjes dhe mori parasysh se ai u dënua me 20 vjet burgim për kryerjen dhe ndihmë e inkurajim në trajtimin mizor, veprime çnjerëzore, përndjekje, tortura, duke shkaktuar qëllimisht vuajtje të mëdha ose lëndime të rënda trupore ose shëndetësore dhe vrasje bazuar në Nenet 2, 3 dhe 5 të Statutit.³⁴⁷ Dhoma e Apelit gjykon se fajësimi i Tadiqit është aq i pangjashëm me Haradin Balën sa të mjaftojë për nxjerrjen e përfundimit se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi gjatë krahasimit të dënimit të Dushko Tadiqit me atë të Haradin Balës.

138. Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore iu referua gabimisht dënimit me shtatë vjet burgim për Zlatko Aleksovskin.³⁴⁸ Në referencën ndaj këtij dënimi Dhoma Gjyqësore

³⁴¹ *Dragan Nikolić* Judgement on Sentencing Appeal, para. 19 (internal quotations omitted)./Aktgjykimi *Dragan Nikolić* në lidhje me Apelin e Dënimit, paragrafi 19 (pa citimet e brendshme).

³⁴² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 735.

³⁴³ Shih Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 826.

³⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 826.

³⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 826.

³⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 565.

³⁴⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 736.

³⁴⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 736.

deklaroi se “gjithesi në këtë rast është domethënës fakti se nuk u përcaktua fajësi për vdekje”.³⁴⁹ Kjo tregon se Dhoma Gjyqësore ishte e vetëdijshme për mosngjashmërinë thelbësore midis rastit të Zllatko Aleksovskit dhe çështjes aktuale dhe Prokuroria nuk ka provuar se interpretimi i dënimit të Zllatko Aleksovskit prej Dhomës Gjyqësore ishte i gabuar.

139. Së fundi Prokuroria iu referua dënimit me 15 vjet burgim dhënë Mitar Vasiljeviqit që nuk u shqyrtua prej Dhomës Gjyqësore.³⁵⁰ Gjithsesi Dhoma Gjyqësore konstaton se Mitar Vasiljeviq ndër të tjera u shpall fajtor për ndihmë dhe inkurajim në përndjekje, krim kundër njerëzimit.³⁵¹ Rrjedhimisht fajësimet për Mitar Valiljeviqin dhe Haradin Balën janë qenësisht të ndryshme dhe Prokuroria nuk provon se Dhoma Gjyqësore bëri gabim të dukshëm kur nuk krahasoi rastin e Haradin Balës me atë të Mitar Valiljeviqit.

4. Pretendim për gabim në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese

140. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore shpërfilli në mënyrë të gabuar pambrojtshmërinë e viktimave si faktor rëndues, sepse statusi i tyre si civilë tashmë ishte marrë parasysh në kapitullin mbi peshën e krimeve. Argumentohet se ekziston një ndryshim midis statusit të një civili dhe të një viktime të pambrojtur.³⁵² Për më tepër Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gabimisht e vlerësoi dyfish rolin vartës të Haradin Balës gjatë vlerësimit të peshës së krimeve dhe faktorëve lehtësues.³⁵³

141. Haradin Bala përgjigjet se Dhoma Gjyqësore mori parasysh si duhet pambrojtshmërinë e viktimave gjatë vlerësimit të peshës së krimeve.³⁵⁴ Gjithashtu ai argumenton se Prokuroria i keqinterpretoi përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me statusin e tij të ulët dhe pretendimi i saj se Dhoma Gjyqësore e vlerësoi dyfish këtë faktor është i pasaktë.³⁵⁵

142. Dhoma e Apelit gjykon se Prokuroria e shtrembëron pohimin e Dhomës Gjyqësore kur argumenton se arsyeja e vetme e Dhomës Gjyqësore për shpërfilljen e pambrojtshmërisë së të burgosurve si rrethana rënduese ishte statusi i tyre si civilë. Në fakt Dhoma Gjyqësore konkludoi se pambrojtshmëria e të burgosurve nuk duhej marrë parasysh si faktor rëndues sepse ajo tashmë ishte marrë parasysh gjatë vlerësimit të rëndësisë së krimeve. për të cilat Haradin Bala u shpall fajtor.³⁵⁶

³⁴⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 4.49.

³⁵⁰ AT 140 (6.6.2007).

³⁵¹ Aktgjykimi i Apelit Vasiljeviq, Vendimi

³⁵² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.37-4.40.

³⁵³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 4.37, 4.41-4.43.

³⁵⁴ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafët 121-123.

³⁵⁵ Dosja e Përgjigjes së Balës, paragrafët 124-128.

³⁵⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 731.

Në pjesën pëkatëse të Aktgjykimit lexohet si vijon: “Natyrisht të burgosurit ishin të pambrojtur sepse ishin robër dhe në mëshirën e tij”.³⁵⁷ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në shpërfilljen e pambrojtshmërisë së të burgosurve si rrethanë rënduese.

143. Në lidhje me argumentin e Prokurorisë se roli vartës i Haradin Balës u mor dyfish në konsideratë gjatë vlerësimit të rëndësisë së krimeve dhe gjatë përcaktimit të faktorëve lehtësues, Dhoma e Apelit rikujton se në kontekstin e dënimeve, vlerësimi i dyfishtë është i palejueshëm.³⁵⁸ Në pjesën mbi rëndësinë e krimeve, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “Haradin Bala nuk ishte në pozitë komanduese” dhe se roli i tij ishte “roje”.³⁵⁹ Ngjashmërisht, në pjesën lidhur me “rrethanat rënduese dhe lehtësuese”, Dhoma Gjyqësore konkludoi se Haradin Bala “nuk ishte person me rol komandues ose pushtetor në ngritjen e kampit, dhe kryesisht kreu detyra që iu ngarkuan, përgjithësisht si “njeri i thjeshtë”.³⁶⁰ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore gaboi në marrjen dy herë në konsideratë në lehtësimin e rolit vartës së Haradin Balës.

144. Kur Dhoma Gjyqësore bën një gabim të dallueshëm gjatë përcaktimit të dënimit, ky automatikisht përbën shpërdorim të kompetencës. Në rrethana të tilla Dhoma e Apelit mund të modifikojë dënimin e dhënë nga Dhoma Gjyqësore pa e përcjellë çështjen.³⁶¹ Në rast se dëmi është i vogël në atë masë sa që është i padëmshëm, Dhoma e Apelit mund të lërë në fuqi dënimin e dhënë nga Dhoma Gjyqësore: që vlen për këtë rast. Dhoma e Apelit ka shqyrtuar me kujdes arsyetimin e Dhomës Gjyqësore dhe mendon se në fakt gabimi i vlerësimit të dyfishtë prej Dhomës Gjyqësore ishte aq i parëndësishëm sa që Dhoma Gjyqësore do të kishte dhënë të njëjtin dënim prej trembëdhjetë vjetësh edhe po të mos kishte bërë këtë gabim.

5. Përfundim

145. Si rezultat dhe me gjithë gabimin e kryer nga Dhoma Gjyqësore në lidhje me vlerësimin e dyfishtë të rolit vartës së Haradin Balës, hidhet tërësisht poshtë pika e dytë e apelit të Prokurorisë.

³⁵⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 726.

³⁵⁸ *Deronjić* Judgement on Sentencing Appeal, para. 107./Aktgjykimi *Deronjić* në lidhje me Apelin e Dënimit, paragrafi 107.

³⁵⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 726.

³⁶⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 732.

³⁶¹ Shih Aktgjykimin e Apelit *Krstić*, paragrafi 266; Aktgjykimi i Apelit *Vasiljević*, paragrafi 181; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*

V. APELI I PROKURORISË LIDHUR ME FATMIR LIMAJN

146. Prokuroria argumenton se shpallja e pafajësisë së Fatmir Limajt nga ana e Dhomës Gjyqësore buroi nga keqzbatimi i standardit të provës.³⁶² Së pari, në vlerësimin e provave, Dhoma Gjyqësore përdori gabimisht një përjasje fragmentare, duke e zbatuar standardin e provës në lidhje me fakte të veçanta për të cilët nuk ishte e nevojshme të vërtetoheshin “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.”³⁶³ Së dyti, Dhoma Gjyqësore zbatoi një standard prove i cili nuk ishte “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm,” por një standard prove i cili ishte jashtë çdo dyshimi, duke përfshirë gabime jo të bazuara mbi prova, logjikë dhe gjykim të shëndoshë.³⁶⁴ Prokuroria argumenton se këto gabime bënë që Dhoma Gjyqësore të arrinte në një numër të konsiderueshëm përfundimesh faktuale të cilat, duke marrë parasysh tërësinë e provave, ishin krejtësisht të paarsyeshme.³⁶⁵

147. Në veçanti, Prokuroria argumenton se gabimet e pretenduara ligjore bënë që Dhoma Gjyqësore të mos nxirrte përfundimet faktuale që duhej të kishte nxjerrë një gjykues i arsyeshëm i fakteve, konkretisht: Fatmir Limaj mori pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut (pika e parë e apelit);³⁶⁶ gjatë majit deri më 26 korrik 1008, Fatmir Limaj kishte pozitë komanduese dhe kontrolluese në UÇK, duke përfshirë komandën mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burg (pika e dytë e apelit);³⁶⁷ dhe Fatmir Limaj, si anëtar i një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, ishte përgjegjës personalisht për të gjithë krimet të kryera në mbështetjen e sistemit të keqtrajtimit në kamp-burg si dhe të atyre krimeve të cilat normalisht mund të parashikoheshin si pasojë e mundshme e sistemit të keqtrajtimit (pika e tretë e apelit).³⁶⁸ Si pasojë, Prokuroria argumenton se Dhoma e Apelit duhet ta shpallë Fatmir Limajn fajtor për të gjitha krimet e kryera në kamp-burgun e Llapushnikut dhe ta dënojë për këto shkelje.³⁶⁹

148. Fatmir Limaj përgjigjet se gabimet e pretenduara prej Prokurorisë bazohen më shumë mbi përfundimet faktuale të Dhomës Gjyqësore se sa mbi parime ligjore të veçanta dhe përbëjnë një përpjekje të Prokurorisë për rihapjen e procesit.³⁷⁰ Ai pretendon se apeli i Prokurorisë është “qartësisht pa vlerë”³⁷¹ dhe se Dhoma Gjyqësore vendos më së miri për besueshmërinë dhe saktësinë e dëshmitarëve gojorë.³⁷² Duke iu referuar Aktgjykimit të Apelit *Tadiq*, Fatmir Limaj argumenton se Dhoma e Apelit mund të ndryshojë përfundimet e Dhomës Gjyqësore dhe t'i

³⁶² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 1.6(a), 2.1-2.29, e cila i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 531-565 dhe 600. *Shih edhe* AT 87-89 (6.6.2007) dhe AT 195-198 (6.6.2007).

³⁶³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.19-2.28.

³⁶⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.2, 2.4-2.18, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit *Rutaganda*, paragrafi 488.

³⁶⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 1.4. *Shih edhe* AT 89 (6.6.2007).

³⁶⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 1.6(a), 2.3 dhe 2.29. *Shih edhe* AT 87 (6.6.2007).

³⁶⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 1.6(b) dhe 2.29. *Shih edhe* AT 87 (6.6.2007).

³⁶⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 1.6(c).

³⁶⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 1.7.

³⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 17. *Shih edhe* AT 142-143 (6.6.2007).

³⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 13.

zëvendësojë me përfundimet e veta vetëm nëse provat e përdorura nga Dhoma Gjyqësore nuk mund të pranoheshin nga një gjykues i arsyeshëm i fakteve, ose ku vlerësimi i saj ka qenë “thellësisht i gabuar”.³⁷³ Ai pretendon se Prokuroria duhet të vërtetojë se vendimi i Dhomës Gjyqësore për shpalljen e pafajësisë ishte një vendim të cilin “asnjë gjykatë e arsyeshme e fakteve nuk mund të kishte arritur” dhe nuk e ka bërë këtë.³⁷⁴

A. Pika e parë e apelit e apelit: Pretendim për pjesëmarrjen personale të Fatmir Limajt në kamp-burgun e Llapushnikut

1. A kreu Dhoma Gjyqësore gabim ligjor dhe/ose faktual kur i fragmentoi provat në mënyrë artificiale

149. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore kreu gabim ligjor dhe/ose faktual kur e zbatoi standardin e provës “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm,” së pari ndaj provave të veçanta të shqyrtuara veçasi prej tërësisë së provave të cilat nuk ishte e nevojshme të provoheshin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, dhe më pas ndaj përcaktimit përfundimtar të elementëve të veprës /veprave penale dhe fajësisë së të akuzuarit.³⁷⁵ Ky fragmentim artificial i provave bëri që Dhoma Gjyqësore të mos marrë parasysh dëshmitë e identifikimit pamor, të cilat vërtetojnë pjesëmarrjen e Fatmir Limajt në kamp-burg së bashku me provat për rolin e tij komandues³⁷⁶ dhe me provat se Fatmir Limaj njihej si “Çeliku”/ Çelik³⁷⁷ ose “Komandant Çeliku”.³⁷⁸ Prokuroria argumenton gjithashtu se Trupi Gjyqësor nuk mori parasysh sa duhet efektin konfirmues të provave identifikuese në tërësi.³⁷⁹

150. Fatmir Limaj përgjigjet se apeli nuk është proces gjyqësor *de novo*.³⁸⁰ Ai pretendon se qasja e Dhomës Gjyqësore ndaj provave është e përcaktuar qartë në Aktgjykim: vendimi për t’u shpallur të pafajshëm nga çdo pikë e aktakuzës u bazua në tërësinë e të gjitha dëshmive, duke përfshirë *emrin e tij të luftës* “Çeliku” dhe praninë e “njësive të Çelikut”³⁸¹. Më tej ai pretendon se në të vërtetë Prokuroria kundërshton përfundimet e Dhomës Gjyqësore, jo qasjen e saj ndaj

³⁷² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 21, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit të *Furunxhisë*, paragrafi 37.

³⁷³ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 22, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit të *Tadiqit*, paragrafi 64.

³⁷⁴ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 25, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit të *Çelebiqit*, paragrafi 434 (theks në origjinal). *Shih edhe* AT 143-146 (6.6.2007), i cili citon Aktgjykimin e Apelit *Rutaganda*, paragrafi 24.

³⁷⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 1.4, 2.2, 2.19, 2.21-2.23, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 10.

³⁷⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.25.

³⁷⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.38.

³⁷⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.36, 2.39, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 560, 561, dhe 565. *Shih edhe* AT 98-99 (6.6.2007).

³⁷⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.27. *Shih edhe* AT 108-110 (6.6.2007)

³⁸⁰ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 19-20, e cila citon Aktgjykimin e Apelit të *Erdemoviqit*, paragrafi 15.

³⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 26-33, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 10, 16-17, 20, 561, 563, 601. *Shih edhe* Dosjen e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 79, 81. *Shih edhe* AT 146-150, 153-154 dhe 163 (6.6.2007)

provave.³⁸² Si përmbledhje, Fatmir Limaj argumenton se shpallja e pafajësisë së tij ishte plotësisht e justifikuar mbi bazën e provave³⁸³ dhe se apeli i Prokurorisë duhet të hidhet poshtë.³⁸⁴

151. Së pari, Dhoma e Apelit vëren se nuk ka kundërshtim midis palëve se Fatmir Limaj përdori pseudonimet “Çeliku” ose “Komandant Çeliku” gjatë periudhës në fjalë: Ndërsa Prokuroria paraqiti prova që dëshmonin se ai njihej gjithashtu si “Çeliku”/“Çelik”³⁸⁵ ose “Komandant Çeliku”, vetë Fatmir Limaj deklaroi se në fund të prillit 1998 ai përdorte pseudonimin “Çeliku” për qëllime komunikimi ndërkohë që njihej nga ushtarët si “Daja”.³⁸⁶

152. Për arsyet e përmendura më poshtë, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk aplikoi një qasje të gabuar fragmentare kur zbatoi standardin e vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm ndaj provave për pjesëmarrjen personale të Fatmir Limajt në kamp-burg.

153. Dhoma Gjyqësore theksoi rëndësinë e provave të identifikimit pamor të çdo të Akuzuari në kamp-burg.³⁸⁷ Megjithatë, shqyrtimi i dëshmimeve nga Dhoma Gjyqësore nuk u kufizua në çështjet e identifikimit pamor, por përfshiu edhe dëshmitë lidhur me pseudonimin e Fatmir Limajt.³⁸⁸ Për shembull, kur vlerësoi dëshminë e Dëshmitarit L10, Dhoma Gjyqësore konstatoi se nuk ishte e qartë se personi që ai kishte takuar në kamp ishte “Çeliku”.³⁸⁹ Rrjedhimisht Dhoma vendosi tërthorazi lidhje midis “Çelikut” dhe Fatmir Limajt. I njëjti arsyetim u përdor kur Dhoma Gjyqësore vlerësoi dëshmitë e Dëshmitarit L07,³⁹⁰ Dëshmitarit L04³⁹¹ dhe Dëshmitarit L96.³⁹² Më tej Dhoma Gjyqësore argumentoi se i kishte marrë parasysh “të gjitha dëshmitë e tjera të rëndësishme” në arritjen e përfundimeve të veta³⁹³, siç është Prova Materiale P30, një fletore shënimesh e gjetur në depon e banesës së Fatmir Limajt në të cilën përmendej emri i një viktime të kamp-burgut të

³⁸² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 34.

³⁸³ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 35. *Shih edhe* AT 164 (6.6.2007).

³⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 26, 36.

³⁸⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.36-2.41. *Shih edhe* AT 107-108, 110 dhe 114 (6.6.2007). Dhoma e Apelit vëren se kur shqyrtoi Provën materiale P34 “Video Dokumentare për UÇK-në në fshatin e Llapushnikut gjatë pranverës dhe verës së 1998,” Dhoma Gjyqësore konstatoi se “në këtë kontekst Skënder Shala e përmendi dy herë “komandant Çeliku”. Po të pranohet se kur përmendet Çeliku është fjala për Fatmir Limajn, gjë për të cilën mungojnë prova të drejtpërdrejta [...]”, Aktgjykim, paragrafi 594. Dhoma Gjyqësore e mbështeti konstatimin e saj në transkriptin anglisht të Provës materiale P34 (Prova materiale P34. 1a, “Transkripti i Videos Dokumentare” ku përmendet disa herë emri “Çeliku” (faqet 4, 11, 12), një herë “Dajë” dhe “Komandant Limaj” dhe dy herë emri “Çelik” (faqet 8-9, kur intervistohet Skënder Shala). Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se “shqyrtimi i krejt intervistës zbulon se Fatmir Limajt herë përmendet si “Daja”, herë si “Çeliku”, apo “komandant Limaj”; [...] ushtarët e tij herë pas here përmenden si të “njësisë Çeliku” apo të “Brigadës 121”, Aktgjykim, paragrafi 595, në lidhje me Provën materiale P34, faqet 8, 11, 12-13 dhe 14. Për këtë arsye, konstatimi në paragrafin 594 se “Çeliku” nuk i referohet Limajt është i kufizuar te dëshmia e Skënder Shalës e dhënë gjatë intervistës. Si rrjedhojë, Dhoma Gjyqësore nuk presupozoi se “Çelik” dhe “Çeliku” janë persona të ndryshëm. Përveç kësaj, Dhoma e Apelit vëren se “Çelik” është forma e pashquar e “Çelikut”. *Shih* Fjalor shqip-anglisht (Pavli Qesku, botues) Tiranë, 1999, faqet 13, 140.

³⁸⁶ Fatmir Limaj, T. 6255-6256 (24.5.2005) (theksim i shtuar). *Shih edhe*, Fatmir Limaj, T. 5938 (18.5.2005) dhe Aktgjykim, paragrafi 598 (në kuadrin e përgjegjësisë së tij të pretenduar të komandimit në kamp-burgun e Llapushnikut). *Shih edhe* Fatmir Limaj, T. 6257 (24.5.2005) (theksim i shtuar). *Shih edhe* Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 79 dhe 81. *Shih edhe* AT 166 (6.6.2007).

³⁸⁷ Aktgjykimi, paragrafi 16.

³⁸⁸ *Shih* Aktgjykimin, paragrafët 539, 544, 547, 553.

³⁸⁹ Aktgjykimi, paragrafi 539.

³⁹⁰ Aktgjykimi, paragrafi 547.

³⁹¹ Aktgjykimi, paragrafi 544.

³⁹² Aktgjykimi, paragrafi 553, i cili i referohet Dëshmitarit L96, T2416-2418; 2437-2442 (26.1.2005)

³⁹³ *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 563.

Llapushnikut.³⁹⁴ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore shqyrtoi provat në lidhje me pretendimin për rolin e tij komandues³⁹⁵ si dhe dëshminë e dhënë nga vetë Fatmir Limaj.³⁹⁶ Në këtë mënyrë, Dhoma Gjyqësore konstatoi me të drejtë se:

Pesha përfundimtare që i jepet çdo elementi të rëndësishëm të dëshmive, duke përfshirë çdo identifikim pamor ku më shumë se një dëshmitar ka identifikuar një të Akuzuar, *nuk mund të vendoset ndarazi*. Megjithatë çdo identifikim pamor dhe çdo element tjetër përkatës i dëshmive, trajtuar ndarazi, mund të mos jenë të mjaftueshëm për të plotësuar detyrimin e provës që ka Prokuroria, është *efekti plotësues i dëshmive*, pra tërësia e dëshmive që lidhet me identifikimin e një të Akuzuari, që duhet të vlerësohet për të vendosur nëse Prokuroria ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se çdo i Akuzuar është kryes sipas akuzave të bëra.³⁹⁷

154. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gjykoi mbi bazën e tërësisë së provave, dhe jo vetëm mbi bazën e provave të identifikimit pamor, kur konkludoi se Prokuroria nuk arriti të vërtetonte se Fatmir Limaj kishte marrë pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut në Llapushnik.³⁹⁸

2. A zbatoi Dhoma Gjyqësore standardin e “vërtetimit jashtë çdo dyshimi”

155. Prokuroria pretendon se në shumë raste kur shqyrtoi çështjen nëse Fatmir Limaj u identifikua si pjesëmarrës në kamp-burgun, standardi i provës i zbatuar nga Dhoma Gjyqësore nuk ishte “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm,” por standardi i cili nënkuptonte *çdo* dyshim, duke përfshirë dyshime jo të bazuara mbi provat, logjikë dhe gjykim të shëndoshë.³⁹⁹ Prokuroria argumenton se kjo kundërshton jurisprudencën e pranuar, sipas të cilës “standardi i provës është i tillë sa që nuk përjashton çdo hipotezë apo mundësi pafajësie, por çdo hipotezë të drejtë apo racionale e cila mund të nxirret nga provat, përveç asaj të fajësisë.”⁴⁰⁰

156. Prokuroria e kujton përfundimin e Dhomës së Apelit të TNPR-së në çështjen *Rutaganda* që

standardi i dyshimit të arsyeshëm në të drejtën penale nuk mund të jetë dyshim imagjinar apo jo serioz bazuar mbi simpati apo paragjykim. Ai duhet të bazohet mbi logjikë dhe gjykim të shëndoshë, duhet të ketë një lidhje racionale me provat, mungesën e provave apo mospërputhshmëritë në prova.⁴⁰¹

157. Prokuroria u referohet më tej sistemeve juridike shtetërore të Gjermanisë, Skocisë, Anglisë, Kanadasë dhe të Shteteve të Bashkuara lidhur me standardin e mjaftueshëm të fajësimit.⁴⁰² Ajo argumenton

³⁹⁴ Prova Materiale P30 "Fletorja e Shënimeve", Aktgjykimi, paragrafi 564.

³⁹⁵ *Shih*, për shembull, Aktgjykimin, paragrafi 532.

³⁹⁶ Aktgjykimi, paragrafi 557.

³⁹⁷ Aktgjykimi, paragrafi 20 (theksime të shtuara).

³⁹⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 565.

³⁹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.2, 2.4.

⁴⁰⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.17-2.18, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit *Tadiq*.

⁴⁰¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.16 (e cila e citon Aktgjykimin e Apelit *Rutaganda*, paragrafi 488).

⁴⁰² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.8-2.14.

se standardi i provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm apo standardi i mjaftueshëm i fajësimit nuk garanton siguri të plotë. Vetëm kur merret parasysh tërësia e provave, mund të bindesh që i akuzuari e ka kryer krimin, edhe sikur të ekzistojnë teori të tjera.⁴⁰³

158. Prokuroria argumenton më tej se Dhoma Gjyqësore keqzbatoi standardin e provës dhe parimin *in dubio pro reo* në dobi të të Akuzuarit.⁴⁰⁴

159. Gjithashtu ose përndryshe, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore kreu gabim *faktual* kur nuk konkludoi se Fatmir Limaj mori pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut sepse, së pari, nuk mori parasysh prova qartësisht të rëndësishme, së dyti, nuk mori parasysh efektin konfirmues të provave, dhe së treti, vlerësoi provat gabimisht.⁴⁰⁵ Duke qenë se argumentet e Prokurorisë në lidhje me gabimin e pretenduar ligjor janë pjesë përbërëse e argumentit të saj në lidhje me gabimet e pretenduara faktuale, ato do të trajtohen bashkërisht.

(a) A gaboi Dhoma Gjyqësore në shqyrtimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07

(i) Pretendim për gabim në refuzimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07 për shkak të “ndikimit të pavetëdijshëm”

160. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shqyrtoi dëshminë identifikuese të Dëshmitarit L07.⁴⁰⁶ Megjithëse Dhoma Gjyqësore gjykoi se Dëshmitari L07 ishte dëshmitar i ndershëm dhe i besueshëm,⁴⁰⁷ ajo hodhi poshtë në mënyrë të paarsyeshme identifikimin pamor të Fatmir Limajt prej tij në kamp-burg,⁴⁰⁸ në televizion⁴⁰⁹ dhe në sallën e gjyqit,⁴¹⁰ sepse mundësia e gabimit për shkak të daljes së tij të shpeshtë në televizion dhe në gazeta (“ndikim i pavetëdijshëm”) dhe të mjedisit “sugjestionues” të sallës së gjyqit rezultuan në identifikim jo të sigurtë.⁴¹¹

161. Prokuroria argumenton se ndikimi i pavetëdijshëm mund të ndodhte vetëm nëse Dëshmitari L07 e kishte parë [Fatmir Limajn] për herë të parë në kamp-burg dhe pastaj e pa pamjen e tij dhe iu kërkua t’u identifikonte.⁴¹² Mirëpo Dëshmitari L07 dëshmoi se e kishte parë fotografinë e Fatmir

⁴⁰³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.15 dhe 2.8-2.14.

⁴⁰⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.18. *Shih edhe* AT 111-113 (6.6.2007).

⁴⁰⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.30-2.32 dhe 2.34, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 531-565; Njoftimi i Prokurorisë për Apel, paragrafët 5-6. *Shih edhe* AT 89 (6.6.2007).

⁴⁰⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.55. *Shih edhe* AT 101-104 (6.6.2007).

⁴⁰⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.56, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 550.

⁴⁰⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.58, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 549.

⁴⁰⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.58.

⁴¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.62.

⁴¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.58-2.59, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 550. *Shih edhe Po aty.*, paragrafët 2.57, 2.61 dhe 2.63. *Shih edhe* AT 110-111 (6.6.2007).

⁴¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.63. *Shih edhe* AT 199-200 (6.6.2007).

Limajt në shtyp para burgimit të tij dhe pastaj e njohu në kamp-burg.⁴¹³ rrjedhimisht, kur Dëshmitari L07 e identifikoi Fatmir Limajn në kamp, ai ishte tashmë person “i njohur.” për të.⁴¹⁴

162. Fatmir Limaj përgjigjet se Dhoma Gjyqësore e vlerësoi me kujdes dëshminë e Dëshmitarit L07 në sallën e gjyqit⁴¹⁵ dhe logjikisht e hodhi poshtë identifikimin e pretenduar.⁴¹⁶ Dhoma Gjyqësore me të drejtë vuri re se rrethanat e identifikimit të pretenduar të “Çelikut” para burgimit të Dëshmitarit L07 nuk u paraqitën hollësisht gjatë dëshmisë.⁴¹⁷ Fatmir Limaj nuk ishte qendra e vëmendjes në asnjë video ku doli, dhe intervista që ai i dha televizionit të Tiranës më 3 qershor 1998 u transmetua vetëm si incizim zanor.⁴¹⁸ Përveç kësaj, Dhoma Gjyqësore me të drejtë mori në konsideratë “mundësinë e shtuar” që Dëshmitari L07 mund të ketë besuar në mënyrë të pavetëdijshme se e njohu Fatmir Limajn për shkak të paraqitjes së tij publike të shpeshtë të mëvonshme në televizion dhe në gazeta.⁴¹⁹

163. Në përfundimin e kundërshtuar, Dhoma Gjyqësore konkludoi si më poshtë:

Për më tepër në këtë rast ekziston edhe mundësia tjetër që L07 pa vetëdije mund të ketë pretenduar se ka njohur të akuzuarin Fatmir Limaj për shkak të daljeve të tij të shumta publike në televizion dhe gazeta, veçanërisht pas ngjarjeve në Llapushnik. Pasi i ka shqyrtuar me kujdes të gjithë këta faktorë, Dhoma mendon se, megjithëse L07 ishte i ndershëm në dëshminë e tij me gjithë vështirësitë e hasura dhe ndonëse identifikimi i tij mund të jetë i saktë, Dhoma nuk mund të bindet se është i besueshëm identifikimi i Fatmir Limajt prej tij si personi të cilin ai e njohu në kamp-burgun e Llapushnikut si komandant Çeliku.⁴²⁰

164. Përdorimi i shprehjeve “për më tepër” dhe “pasi i ka shqyrtuar me kujdes të gjithë këta faktorë” tregon se kundërshtimi i dëshmisë identifikuese të Dëshmitarit L07 nuk bazohej vetëm në mundësinë “e shtuar” të ndikimit të pavetëdijshëm por u mbështet mbi faktorë të tjerë të marrë në konsideratë nga Dhoma Gjyqësore, konkretisht: mospërputhje “të dukshme” midis rrëfimit të Dëshmitarit L07 dhe të Shukri Bujës,⁴²¹ mungesa e provës se “komandanti” të cilin Dëshmitari L07 e takoi në kamp ishte vërtet Fatmir Limaj, i njohur gjithashtu si “Çeliku”⁴²² dhe mundësia e një identifikimi të gabuar në sallën e gjyqit për shkak të mjedisit sugjestionues.⁴²³

165. Për sa i përket mundësisë së ndikimit të pavetëdijshëm, aktekspertiza e Profesor Wagenaar që u pranua si provë dhe u përdor nga Dhoma Gjyqësore,⁴²⁴ shpjegoi rregullat e provave të identifikimit për persona të panjohur⁴²⁵ si më poshtë:

⁴¹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.60, 2.110, e cila i referohet *Po aty.*, paragrafët 2.57-2.65.

⁴¹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.60-2.65.

⁴¹⁵ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 70, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 545-550.

⁴¹⁶ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 70, e cila i referohet ndër të tjerat Aktgjykimit, paragrafi 547. *Shih edhe* AT 161-162 dhe 165 (6.6.2007).

⁴¹⁷ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 71.

⁴¹⁸ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 71, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 549.

⁴¹⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 72, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 549.

⁴²⁰ Aktgjykimi, paragrafi 550 (theksimi i shtuar).

⁴²¹ Aktgjykimi, paragrafi 547.

⁴²² *Po aty.*, në lidhje me Dëshmitarin L07, T. 794 (24.11.2004, seancë e mbyllur). Dhoma e Apelit vëren se Prokuroria deklaroi se nuk është e paarsyeshme të bazohesh mbi dëshminë e dorës së dytë. Dhoma e Apelit përfundon se kjo nuk ka rëndësi duke qenë se kryesorja është nëse përfundimet e Dhomës Gjyqësore janë të arsyeshme apo jo, dhe jo nëse do të ishte qenë e paarsyeshme të të veprohej ndryshe.

⁴²³ Aktgjykimi, paragrafi 550.

⁴²⁴ Aktgjykimi, paragrafi 550, që duhet të lexohet në lidhje me *Po aty.*, paragrafi 19 *in fine*. *Shih edhe Po aty.*, paragrafi 537 dhe shënim 1769.

Rregulla 1. [...] Dëshmitari nuk duhet ta ketë parë keqberësin asnjëherë para ballafaqimit në vendin e krimit.⁴²⁶

Rregulla 2. [...] Pas krimit dëshmitari nuk duhet të ketë parë asnjë fotografi të të dyshuarit.[...]. Kjo dukuri quhet ndikim i pavetëdijshëm [...] ⁴²⁷

166. Në vendimin e kundërshtuar të saj, Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të arsyeshme mori parasysh Rregullën 2 në lidhje me mundësinë e ndodhisë së ndikimit të pavetëdijshëm kur dëshmitari e shikon fotografinë e keqberësit *pas* kryerjes së krimit. Gjithashtu ky vendim mori logjikisht në konsideratë Rregullën 1 për nevojën e shmangjes së kontaktit *para* krimit: Dhoma Gjyqësore konstatoi se Dëshmitari L07 dëshmoi se e njohu “komandant Çeliku” menjëherë si Fatmir Limaj kur e takoi në kamp, sepse e kishte parë në shtypin e asaj kohe.⁴²⁸ Për sa u përket rasteve kur e pa në shtyp, Dhoma Gjyqësore theksoi se:

a) disponon dëshmi se Fatmir Limaj ishte njëri prej dy ushtarëve të cilët qëndronin pranë Jakup Krasniqit kur ai dha deklaratën e parë publike si zëdhënës i UÇK-së,⁴²⁹ në Kleçkë në qershor 1998. Gjithashtu Fatmir Limaj u pa në kolonën e ushtarëve gjatë një procesioni mortor më 16 qershor 1998, i cili u transmetua.⁴³⁰ Gjithsesi në këto video Fatmir Limaj nuk është objekti i vetëm ose objekti kryesor i vëmendjes së shikuesit. Së fundi, duket se më 3 qershor 1998, Fatmir Limaj i dha një intervistë një gazetari të televizionit të Tiranës, por duket se kjo intervistë pati vetëm transmetim zanor. Më vonë, L07 nxorri përfundimin prej mediave se komandant Çeliku ishte Fatmir Limaj.⁴³¹

167. Duke marrë parasysh rrethanat ku thuhet se u pa Fatmir Limaj, Dhoma e Apelit nuk bindet se i vetmi shpjegim i arsyeshëm nga kjo dëshmi është se Fatmir Limaj ishte person *i njohur* për Dëshmitarin L07 para se të takoheshin në kamp.

168. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se dëshmia e Dëshmitarit L07 – se e njohu Fatmir Limajn si person që e kishte takuar në kamp-burg si “Komandant Çeliku” – ndër të tjera mund të jetë si rezultat i mundësisë së ndikimit të pavetëdijshëm.

(ii) Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë identifikuese të Dëshmitarit L07 duke marrë parasysh dëshminë e Shukri Bujës.

⁴²⁵ Prova DM 7 “1) Curriculum Vitae i Profesorit Wagenaar dhe 2) Aktekspertiza e Profesorit Wagenaar “Report to the ICTY, IT-03-66, Against Fatmir Limaj, Haradin Bala and Isak Musliu” /Raport për TPNJ-në, IT-03-66, Kundër Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut/, me datë 22 maj 2005,” paragrafi 6 dhe 8.

⁴²⁶ *Po aty.*, Rregulla 1, paragrafi 10.

⁴²⁷ *Po aty.*, Rregulla 1, paragrafi 11.

⁴²⁸ Aktgjykimi, paragrafi 549, në lidhje me Dëshmitarin L07, T. 794 (24.11.2004, seancë e mbyllur).

⁴²⁹ Fatmir Limaj, T. 5956 (18.5.2005).

⁴³⁰ Prova Materiale P35, “Video Recording of TV Documentary about Fatmir Limaj, after his Arrest, /Videoincizimi i filmit dokumentar televiziv për Fatmir Limajn, pas arrestimit të tij./” Fatmir Limaj T 6299-6301 (25.5.2005).

⁴³¹ Aktgjykimi, paragrafi 549, në lidhje me Proven materiale P37 “FBIS Article Dated 3 June 1998 re. Interview with Mr Çeliku, “UÇK Commander Tells Tirana Television Death or Liberty” /Artikulli i FBIS-it me datën 3 qershor 1998 lidhur me intervistën me Z. Çeliku, “Komandanti i UÇK-së i deklaroi televizionit të Tiranës , Ja Vdekje, ja Liri’/” Fatmir Limaj, T 6268 (24.5.2005).

169. Prokuroria argumenton se, pas ardhjes se tij ne kamp-burg, Dëshmitari L07 pa Shukri Bujën dhe Komandant Çeliku,⁴³² dhe se është e papërfytyrueshme që Dhoma Gjyqësore të ketë përdorur dëshminë e Shukri Bujës se Fatmir Limaj *nuk* ishte i pranishëm gjatë takimit me Dëshmitarin L07, për të hedhur dyshim mbi dëshminë e Dëshmitarit L07.⁴³³ Faktikisht Dhoma Gjyqësore vuri në dyshim besueshmërinë e dëshmisë së Shukri Bujës me gjasë si të bazuar në besnikërinë e tij ndaj UÇK-së në përgjithësi dhe Fatmir Limajt në veçanti.⁴³⁴ Prokuroria argumenton më tej se dëshmia e Bujës nuk duhet besuar sepse ai tha se Dëshmitari L07 nuk u burgos në kamp por në një shtëpi tjetër, kurse Dhoma Gjyqësore përfundoi se Dëshmitari L07 u burgos për dy-tri ditë në fllanikun e kampit.⁴³⁵

170. Fatmir Limaj përgjigjet se Dhoma Gjyqësore me të drejtë theksoi se Dëshmitari L07 nuk pretendoi se Shukri Buja apo dikush tjetër i pranishëm gjatë takimit e kishte përmendur “komandantin” si “Çeliku.”⁴³⁶ Fatmir Limaj përgjigjet gjithashtu se përndryshe Prokuroria kërkon të diskreditojë dëshminë e Shukri Bujës, dëshmitarin e saj, dhe më vonë të përdorë dëshminë e tij në një kontekst tjetër.⁴³⁷ Prokuroria kundërpërgjigjet se është e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të pranojë dëshminë e dëshmitarit vetëm pjesërisht.⁴³⁸

171. Pasi ka konkluduar se dëshmia e Shukri Bujës për burgimin dhe lirimën e Dëshmitarit L07 nuk është e besueshme,⁴³⁹ Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore gaboi kur e mori këtë dëshmi parasysh në mbështetjeje të mospranimit të saj të dëshmisë identifikuese të Dëshmitarit L07. Mirëpo, Dhoma e Apelit nuk bindet se Prokuroria ka vërtetuar se ky gabim shkaktoi dështim të drejtësisë, sepse kundërshtitë midis rrëfimit të Dëshmitarit L07 dhe rrëfimit të Shukri Bujës përbëjnë vetëm një prej arsyeve mbi bazën e të cilave Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë, në mënyrë të arsyeshme, besueshmërinë e dëshmisë identifikuese të Dëshmitarit L07.⁴⁴⁰

(iii) Pretendim për moskonfirmimin e dëshmisë së Dëshmitarit L07

172. Lidhur me Ivan Bakraçin, Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore nuk duhej të kishte hedhur poshtë identifikimin e Fatmir Limajt prej tij duke marrë parasysh përfundimin e saj se periudha gjatë së cilës Ivan Bakraçi supozohet se identifikoi Fatmir Limajn ishte një “periudhë

⁴³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.94.

⁴³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.95.

⁴³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.95, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 547.

⁴³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.95, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 297.

⁴³⁶ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 73, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 549.

⁴³⁷ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 70 *in fine*.

⁴³⁸ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.33, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit *Naletiliq dhe Martinoviq*, paragrafi 441; Aktgjykimi, paragrafët 53-65 dhe 277.

⁴³⁹ Aktgjykimi, paragrafi 547.

kohore relativisht e gjatë kontakti” që “fare mirë mund të vërtetonte identifikimin e mëvonshëm të saktë të komandantit.”⁴⁴¹

173. Prokuroria argumenton më tej se pas burgimit të tij, Ivan Bakraçi e njohu Fatmir Limajn në televizion dhe në internet si “komandantin” që e kishte njohur në kamp-burg.⁴⁴² Dhoma Gjyqësore gaboi kur refuzoi të pranonte besueshmërinë e identifikimit të Fatmir Limajt nga Ivan Bakraçi në një fotografi në internet sepse fotografia ishte tepër e vogël që të dallohej,⁴⁴³ dhe nuk mori në konsideratë dëshminë e Ivan Bakraçit se kjo fotografi ishte shumë më e madhe kur ai e pa *për herë të parë* në internet.⁴⁴⁴ Prokuroria gjithashtu pretendon se Ivan Bakraçi e njohu Fatmir Limajn gjithashtu në sallën e gjyqit në një sekuençë filmike e cila tregon një kolonë ushtarësh të UÇK-së duke marshuar, ndër të cilët edhe Fatmir Limajn.⁴⁴⁵

174. Prokuroria pretendon gjithashtu se Dhoma Gjyqësore gaboi kur u përqëndrua mbi mosidentifikimin e Fatmir Limajt prej tij në fotografinë e përfshirë në fotomontazhin e treguar atij në gjyq: Kjo fotografi e tregoi Fatmir Limaj pa mjekër, të cilën ai e kishte në televizion dhe në internet dhe që është një portret i cili përputhet më së shumti me kujtesën e Ivan Bakraçit.⁴⁴⁶

175. Fatmir Limaj përgjigjet se Ivan Bakraçi pati mundësi ta shihte “komandantin” që ai përshkruan, dhe të kalonte kohë me të. Gjithsesi ai nuk e identifikoi Fatmir Limajn, apo “Komandant Çeliku” si pjesëmarrës në kamp,⁴⁴⁷ megjithëse iu tregua dy herë fotomontazhi i Fatmir Limajt.⁴⁴⁸ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore i kushtoi rëndësinë e duhur faktit se në asnjë prej deklaratave të mëparshme për Prokurorinë Ivan Bakraçi nuk përmendi se e kishte parë “Komandant Çeliku”.⁴⁴⁹

176. Për sa i përket identifikimit të Fatmir Limajt në një pjesë të sekuençës filmike, Dhoma e Apelit vë në dukje se Dhoma Gjyqësore vuri re se emri i Fatmir Limajt u përmend në nëntitullin në fund të filmit të treguar në sallën e gjyqit. I pyetur nëse kishte nëntituj kur hetuesit e TPNJ-së ia

⁴⁴⁰ Dhoma Gjyqësore mori parasysh edhe pretendimin e Dëshmitarit L07 se e kishte parë Fatmir Limajn para burgimit të tij, mungesën e provës se “komandanti” të cilën Dëshmitari L07 e takoi në kamp ishte vërtet “Komandant Çeliku,” si dhe mundësinë e një identifikimi të gabuar në sallën e gjyqit për shkak të mjedisit sugjestionues të sallës së gjyqit.

⁴⁴¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.68, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 537. *Shih edhe* AT 104-105 (6.6.2007).

⁴⁴² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.69, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 533.

⁴⁴³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.120.

⁴⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁴⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.69, 2.119-2.121, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 533, 536-537. Dhoma e Apelit vëren se sekuenca filmike e treguar Ivan Bakraçit në gjyq thuhet se ishte e njëjta me atë që e kishte parë në televizion dhe në internet.

⁴⁴⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.122. *Shih edhe* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.18-2.19. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore përdori këtë shpjegim të gabuar për të zmadhuar rëndësinë e faktit që Ivan Bakraç nuk njohu fotografinë e Fatmir Limajt në një fotomontazh, duke thënë se kjo ndodhi edhe pse në fotografi, Fatmir Limaj ishte “i rruar” [Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.102, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 537]. *Shih edhe* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.17.

⁴⁴⁷ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 52-56, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 531-537.

⁴⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 53, 76.

treguan videon, Ivan Bakraç u përgjigj: “Jo, jo. Nuk besoj se kishte nëntituj. *Megjithatë, nuk i kushtova vëmendje.*”⁴⁵⁰

177. Për sa i përket identifikimit të Fatmir Limajt në një fotografi në internet, Dhoma e Apelit është e mendimit se ishte e arsyeshme që Dhoma Gjyqësore të mos shfrytëzonte vetëm referencën e Prokurorisë ndaj dëshmisë së Ivan Bakraçit, se kjo fotografi ishte shumë më e madhe kur ai e pa për herë të parë në internet, duke qenë se kjo fotografi më e madhe nuk u paraqit si provë.⁴⁵¹ Më tej, duke marrë parasysh përmasat e vogla të fotografisë në të cilën pretendohet se Ivan Bakraçi identifikoi Fatmir Limajn, Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria nuk ka vërtetuar se mospranimi i kësaj pjese të dëshmisë prej Dhomës Gjyqësore, është i paarsyeshëm.

178. Për më tepër, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk veproi në mënyrë të paarsyeshme kur hodhi poshtë dëshminë identifikuese të Ivan Bakraçit pasi ai nuk mundi të identifikonte fotografinë e Fatmir Limajt në fotomontazhin që iu tregua në sallën gjyqësore si personi që ai e njihte si “komandanti” në kamp-burgun e Llapushnikut. Kjo vlen në mënyrë të veçantë prej faktit se Ivan Bakraçi iu tregua një fotografi e Fatmir Limajt në fotomontazh që duhej të kishte qenë mjaft e dallueshme për të, ku ai dukej i rruar, pikërisht si përkrahësi i individit të cilin dëshmitari e kishte parë në kamp-burg.⁴⁵²

179. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore konkludoi në mënyrë të arsyeshme se nuk mund të pranonte saktësinë e identifikimit të pretenduar të Fatmir Limajt nga Ivan Bakraç.⁴⁵³

180. Në lidhje me Vojko Bakraçin, Prokuroria pretendon se kur ishte në kamp, ai pa Fatmir Limajn në televizion dhe e njohu si “komandantin” që e kishte takuar më herët gjatë burgimit.⁴⁵⁴ Prokuroria argumenton se kjo dëshmi konfirmon jo vetëm të tërë dëshmitarët identifikues, por edhe dëshminë e djalit të tij, Ivan Bakraçit se ai dhe i ati e kishin parë në televizion “komandantin” që kishin takuar në kamp-burg.⁴⁵⁵ Prokuroria pretendon se identifikimi i Fatmir Limajt nga Vojko Bakraçi mbështetet gjithashtu nga dëshmia e tij se personi të cilin ai e takoi në kamp tha se ishte jurist dhe në të vërtetë, Fatmir Limaj është jurist.⁴⁵⁶ Më tej Prokuroria argumenton se Dhoma

⁴⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 57, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 533. *Shih edhe* AT 159-161 (6.6.2007).

⁴⁵⁰ Ivan Bakraç, T. 1438 (3.12.2004) (theksimi i shtuar).

⁴⁵¹ Prova materiale P80 “Photo from Website www.kosovo.com, Marked by the Witness in Court /Foto nga faqja e internetit www.kosovo.com, shënuar nga dëshmitari në sallën e gjyqit/.”

⁴⁵² *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 533 *in fine*.

⁴⁵³ *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 537.

⁴⁵⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.73. *Shih edhe* AT 105-106 (6.6.2007).

⁴⁵⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.73. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.8 dhe 2.13.

⁴⁵⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.73, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 532.

Gjyqësore gaboi kur nxorri konkluzion negativ nga mosidentifikimi i fotografisë së Fatmir Limajt në fotomontazh nga ana e Vojko Bakraçit, kur konkludoi se ishte “një fotografi tepër e qartë e Fatmir Limajt, megjithëse i rruar, dhe jo me mjekër të shkurtër siç e kishte përshkruar dëshmitari.”⁴⁵⁷ Duke qenë se dëshmitë e dëshmitarëve dhe fotografitë në mediat e periudhës përkatëse e përshkruajnë dhe e tregojnë Fatmir Limaj me një mjekër të shkurtër dhe jo “të rruar”, kjo me gjasë shpjegon pse Vojko dhe Ivan Bakraçi nuk e njohën Fatmir Limajn në fotomontazh.⁴⁵⁸

181. Gjithashtu Prokuroria pretendon se palët ranë dakord për pranimin si provë të deklaratës së Vojko Bakraçit dhënë autoriteteve serbe më datën 8 korrik 1998, ku ai pohoi se kishte parë ushtarë të UÇK-së në televizion duke marshuar dhe e kishte identifikuar njërin prej tyre si “komandanti” nga kampi. Si pasojë Dhoma Gjyqësore gaboi ku hodhi poshtë këtë dëshmi me arsyetimin se nuk u dha në sallën e gjyqit. Gjithashtu Dhoma nuk mori në konsideratë faktin se në deklaratën e tij për TPNJ-në, të 22 janarit 2005, Vojko Bakraçi konfirmoi përmbajtjen e deklaratës së tij dhënë autoriteteve serbe.⁴⁵⁹ Për më tepër shënimet e deklaratës dhënë autoriteteve serbe përputhen me hollësitë e tjera të rrëfimit të Vojko Bakraçit në sallën e gjyqit për burgimin e tij, për shembull, që “komandanti” u tha atij dhe djalit të tij se do të liroheshin.⁴⁶⁰

182. Fatmir Limaj përgjigjet se Vojko Bakraç nuk e përmend emrin e tij në dëshminë e tij, apo që një “Komandant Çeliku” ishte përfshirë në kamp-burg.⁴⁶¹ Madje kur e pa fotografinë e Fatmir Limajt, Vojko Bakraç deklaroi se individi në fotografi nuk kishte lidhje me kampin.⁴⁶² Përveç kësaj, kur e pa sekuencën filmike me Fatmir Limajn me mjekër,⁴⁶³ Vojko Bakraç as nuk e identifikoi si “komandantin” që e kishte parë në Llapushnik, as nuk e identifikoi si sekuencën filmike që pretendon se e kishte parë në *odë*.⁴⁶⁴

183. Dhoma Gjyqësore përfundoi se në janar 2002, gjatë një interviste, hetuesit e CCIU-së i treguan Vojko Bakraçit një sërë fotografish. Njëra prej tyre, sipas mendimit të Dhomës Gjyqësore, ishte një foto tepër e qartë e Fatmir Limajt, por i rruar dhe jo me mjekër të shkurtër të përshkruar nga dëshmitari. Në lidhje me këtë fotografi, Vojko Bakraç deklaroi: “Numri 2 duket i njohur, por nuk di ku dhe nuk mund ta lidh me këtë proces.”⁴⁶⁵ Numri 2 ishte fotografia e Fatmir Limajt.⁴⁶⁶

⁴⁵⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.116, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 532. *Shih edhe* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.9.

⁴⁵⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.116.

⁴⁵⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.74 dhe 2.121-2.125 dhe Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.6-2.7, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 536.

⁴⁶⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.11.

⁴⁶¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 44-45 dhe 76.

⁴⁶² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 45, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 532.

⁴⁶³ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 50. Fatmir Limaj argumenton gjithashtu se bazuar në Provën materiale P202, mund të hidhen poshtë pretendimet e Prokurorisë për mosidentifikim për shkak të mungesës së mjekrës në fotomontazh.

⁴⁶⁴ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 49. *Shih edhe* AP 159-161 (6.6.2007).

⁴⁶⁵ Fakt i Pranuar, T. 1370-1371 (2.12.2004); Prova materiale DB1 (fotomontazh A1).

⁴⁶⁶ Aktgjykimi, paragrafi 532.

Duke qenë se Vojko Bakraçi nuk e identifikoi Fatmir Limajn gjatë intervistës me CCIU-në, Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme refuzoi të pranonte këtë pjesë të dëshmisë identifikuese të Vojko Bakraçit.

184. Dhoma Gjyqësore konkludoi gjithashtu se në dëshmitë e Ivan dhe Vojko Bakraçit dolën disa mospërputhje.⁴⁶⁷ Dhoma Gjyqësore në veçanti shqyrtoi nëse Vojko Bakraç e identifikoi personin që kishte takuar gjatë burgimit si Fatmir Limaj, *gjatë kohës kur ishte ende në kamp*, siç pretendoi Prokuroria, apo *më vonë* gjatë javëve pas lirimit, siç dëshmoi i biri, Ivan Bakraç.⁴⁶⁸ Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë gjithashtu shënimet e marra gjatë deklaratës së Vojko Bakraçit dhënë autoriteteve serbe më 8 korrik 1998, dhe të mbështetura në deklaratën e tij të 22 janarit 2005 për TPNJ-në. Deklarata e datës 8 korrik 1998 përmend faktin se në një rast *gjatë burgimit të tyre*, Vojko Bakraç dhe i biri, Ivani panë në televizion një kolonë ushtarësh duke marshuar dhe identifikuan personin që e njihnin si “komandanti.”⁴⁶⁹

185. Dhoma e Apelit gjykon se pranimi si prova i këtyre deklaratave me miratimin e palëve,⁴⁷⁰ nuk e pengoi Dhomën Gjyqësore që të vlerësonte besueshmërinë e dëshmitarit dhe saktësinë dhe vlerën provuese të deklaratave të tij duke marrë parasysh dëshminë në tërësi. Për më tepër, shënimet e bëra gjatë deklaratës së datës 8 korrik 1998 nuk u hodhën poshtë për shkak se nuk përbënin tekstin fjalë për fjalë të bisedës, por për shkak se ishin bërë nga një individ i panjohur i cili nuk u thirr për të dëshmuar në gjyq. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore përfundoi se Vojko Bakraç nuk e nëshkroi këtë dokument dhe se nuk përputhet me dëshminë e Ivan Bakraçit që ai dhe babai i tij e njohën në televizion personin që e njihnin si “komandanti” pas periudhës së burgimit të tyre. Së fundi Dhoma Gjyqësore konkludoi se në dëshminë e Vojko Bakraçit nuk u përmend fakti se ai njohu dikë në televizion kur ishte i burgosur, me gjithë pyejtjet e shumta për kujtesën e tij lidhur me personin që ai e njihnte si “komandanti.”⁴⁷¹

186. Dhoma e Apelit gjykon se do të ishte e paarsyeshme që Dhoma Gjyqësore të hidhte poshtë shënimet e marra gjatë dhënies së deklaratës më 8 korrik 1998 për shkak se nuk u nënshkruan nga Vojko Bakraçi apo se janë bërë nga një individ i panjohur. Faktikisht Vojko Bakraç vërtetoi shprehimisht këto shënime gjatë deklaratës së tij për TPNJ-në, më 22 janar 2005.⁴⁷² Mirëpo në këto shënime Vojko Bakraç nuk e përmend Fatmir Limajn as me emër, as me pseudonimin “Çeliku,”

⁴⁶⁷ Aktgjykimi, paragrafi 535.

⁴⁶⁸ Ivan Bakraç, T. 1561-1562 (6.12.2004).

⁴⁶⁹ Aktgjykimi, paragraf 536; Prova materiale P202, “(1) Intervistë me Vojko Bakraçin në zyrat e Prishtinës CRDB më 8 korrik 1998, dhe (2) Deklarata e Vojko Bakraçit më 22 janar 2005, f. 5.

⁴⁷⁰ Prova materiale P202, “(1) Intervistë me Vojko Bakraçin në zyrat e Prishtinës CRDB më 8 korrik 1998, dhe (2) Deklarata e Vojko Bakraçit më 22 janar 2005.

⁴⁷¹ Aktgjykimi, paragrafi 536.

⁴⁷² Prova materiale P202, “(2) Deklarata e Vojko Bakraçit më 22 janar 2005.”

megjithëse përmenden emra të tjerë si Shala, Ramiz dhe Hoxha. Kurse Vojko Bakraçi përmend vetëm “komandantin” pa hollësi të tjera. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme refuzoi të pranonte se fjala “komandanti” e përdorur nga Vojko Bakraçi ishte pa dyshim në lidhje me Fatmir Limajn i njohur gjithashtu si “Komandant Çeliku,” Si pasojë Prokuroria nuk provoi se gabimi i Dhomës Gjyqësore shkaktoi dështim të drejtësisë.

187. Për më tepër, në deklaratën e tij për TPNJ-në, më 22 janar 2005, Vojko Bakraç deklaroi shprehimisht se nuk e mbante mend fytyrën e “komandantit” që kishte parë në televizion në fillim të kolonës.⁴⁷³ Gjithashtu Vojko Bakraç nuk identifikoi sekuencën filmike e cila tregoi kolonën, megjithëse thuhet se kjo sekuencë ishte e njëjtë me atë që kishte parë në televizion gjatë burgimit të tij.⁴⁷⁴ Është e logjikshme të nxirret përfundimi se pikërisht, këto janë arsytet e pamundësisë së tij për identifikimin e Fatmir Limajt në fotomontazh. Si pasojë Prokuroria nuk arriti të provonte se Dhoma Gjyqësore ishte e paarsyeshme kur hodhi poshtë dëshminë identifikuese të Vojko Bakraçit.⁴⁷⁵

188. Lidhur me pretendimin e Prokurorisë se rrëfimi i Vojko Bakraçit konfirmon rrëfimin e Ivan Bakraçit, Dhoma e Apelit përfundon se Prokuroria nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk përfundoi se dëshmitë e tyre të identifikimit, hedhur poshtë në mënyrë të arsyeshme, mund të ndërkonfirmoheshin.⁴⁷⁶

189. Prokuroria pretendon më tej se Dhoma Gjyqësore gaboi kur hodhi poshtë identifikimin prej Dëshmitarit L10, të Fatmir Limajt si personi që e kishte takuar dy herë në fllanikun e kamp-burgut dhe i cili urdhëroi lirimin e tij.⁴⁷⁷ Pas burgimit të tij, Dëshmitari L10 njohu “Çeliku” në televizion si të pranishëm në kamp, zbuloi se emri i tij ishte Fatmir Limaj, dhe e identifikoi në sallën e gjyqit.⁴⁷⁸ Po kështu, pas burgimit të tij, Dëshmitari L06 njohu në televizion burrin që e kishte takuar dy herë në fllanikun e kamp-burgut dhe i cili i tha se mund të kthehej në shtëpi,⁴⁷⁹ dëgjoi se quhej Fatmir Limaj,⁴⁸⁰ dhe e identifikoi në sallën e gjyqit.⁴⁸¹ Gjithashtu, duke shikuar televizion pas lirit të tij, Dëshmitari L04 e njohu Fatmir Limaj në një fotografi si person të cilin ai e kishte takuar në kamp⁴⁸² dhe i cili i kishte dhënë dokumenta të lirit ku shkruhej se “Komandant Çeliku” kishte urdhëruar lirimin e tij.⁴⁸³

⁴⁷³ Prova materiale P202, “(2) Deklarata e Vojko Bakraçit më 22 janar 2005,” paragrafi 9.

⁴⁷⁴ *Po aty*, paragrafi 12. Vojko Bakraç deklaroi: “ngjan shumë me kolonën që pamë në televizionin shqiptar, por nuk mund të them nëse është e njëjtë. Ushtarët ecnin kështu, por nuk e mbaj mend me siguri.”

⁴⁷⁵ Aktgjykimi, paragrafët 535, 539.

⁴⁷⁶ *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 535.

⁴⁷⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.70, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 539. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.22. *Shih edhe* AT 106 (6.6.2007).

⁴⁷⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.70, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 539-540.

⁴⁷⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.71, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 538. *Shih edhe* AT 106 (6.6.2007).

⁴⁸⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.71, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 538.

⁴⁸¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.71, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 540.

⁴⁸² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.72, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 543.

⁴⁸³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.72. *Shih edhe* AT 106 (6.6.2007).

190. Fatmir Limaj përgjigjet se Dhoma Gjyqësore trajtoi në mënyrë të duhur dëshminë e Dëshmitarëve L10, L06 dhe L04.⁴⁸⁴ Në veçanti, ai argumenton se, megjithëse Dëshmitari L10 deklaroi se kishte dëgjuar emrin “Çeliku” dy herë në Llapushnik,⁴⁸⁵ ai nuk përmendi asgjë për “Çelikun” apo “Fatmir Limajn” kur u mor në pyetje nga hetuesit e CCIU-së⁴⁸⁶ dhe nga autoritetet serbe⁴⁸⁷ para procesit. Ai përgjigjet gjithashtu se dëshmia e Dëshmitarit L04 është e pabesueshme: Ai pretendon se, megjithëse Dëshmitari L04 “nuk mund të lexonte emrin e vetë në gjyq,” ai dëshmoi se kishte marrë një copë letër mbi të cilën ishte shkruar se ai ishte liruar me urdhër të “Komandant Çelikut.”⁴⁸⁸ Fatmir Limaj pretendon se kjo dëshmi është e pabesueshme edhe për shkak të dëshmisë së Dëshmitarit L06, i cili tha se dokumenti i lirimimit mbante vetëm emrin dhe mbiemrin e tij,⁴⁸⁹ dhe të dëshmive të Vojko dhe Ivan Bakraçit, se leja e dhënë atyre pohonte vetëm se ishin liruar “nga UÇK-ja.”⁴⁹⁰ Fatmir Limaj përgjigjet më tej se Dhoma Gjyqësore vlerësoi në mënyrë të kujdesshme besueshmërinë e Dëshmitarit L04⁴⁹¹ dhe vuri re në mënyrë të duhur se “L04 theksoi se çfarë mbrese i kishte lënë takimi me Komandant Çelikun [...]. Mirëpo [...] ai nuk e përmendi fare takimin kur u mor në pyetje për herë të parë nga hetuesi i CCIU-së për këto ngjarje në janar 2002.”⁴⁹²

191. Prokuroria përgjigjet se Dëshmitari L04 tregoi se dinte të lexonte një listë emrash.⁴⁹³ Prokuroria përgjigjet më tej se nuk mund të arsyetohet kritika e Fatmir Limajt për mospërmendjen e Çelikut nga ana e Dëshmitarit L10 në deklaratën e tij për CCIU-në,⁴⁹⁴ duke qenë se dëshmitari shpjegoi mospërmendjen gjatë fazës së pyetjeve nga pala kundërshtare si më poshtë:

Kam thënë se mu dha një fletë lirimi. Këtë e di shumë mirë Ai më pyeti nëse mbaja mend [...], mbase përkthyesi nuk e përktheu si duhet. Prandaj nuk shkruhet që nuk kam shkruar Çeliku. Mbase është gabimi i interpretit apo përkthyesit. [...] Mbase kur u përktheu, nuk u përktheu “Çeliku.”⁴⁹⁵

Dëshmitari L10 dëshmoi se thelbi i intervistës ishte të hulumtohej për fatin e anëtarëve të familjes. Rrjedhimisht, deklaratat e tij nuk devijon prej dëshmisë së tij, konfirmuar prej Dëshmitarit L04, se ata morën fletëlirime të nënshkruara nga “Komandant Çeliku.”⁴⁹⁶ Prokuroria argumenton më tej se dëshmitë e Vojko dhe Ivan Bakraçit për lirimin e tyre me urdhër të “komandantit” konfirmojnë

⁴⁸⁴ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 58-59, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 538-544.

⁴⁸⁵ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 60, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 539.

⁴⁸⁶ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 60.

⁴⁸⁷ *Po aty.*

⁴⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 62.

⁴⁸⁹ *Po aty.*

⁴⁹⁰ Dosja e Përgjigjes së Limajt, shënimi 61 i paragrafit 62.

⁴⁹¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 63-64, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 541-544.

⁴⁹² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 63, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 543.

⁴⁹³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.25.

⁴⁹⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.22.

⁴⁹⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.22-2.23, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 539.

⁴⁹⁶ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.24 dhe 2.32, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 539.

dëshmitë e Dëshmitarit L10 dhe të Dëshmitarit L04, lidhur me lirim të tyre me urdhër të Komandant Çelikut”.⁴⁹⁷

192. Lidhur me Dëshmitarët L06 dhe L10, Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore shprehu dyshime të arsyeshme për besueshmërinë e dëshmitëve të tyre për çështjet e lartpërmendura. Këto dyshime bazoheshin mbi dëshmitë e tyre se takimet e tyre në kamp-burg me njeriun i cili pretendohet se ishte Fatmir Limaj, zgjatën vetëm disa minuta. Këto takime ndodhën kur Dëshmitari L06 dhe Dëshmitari L10 ishin ulur në brenda fllanikut, kurse njeriu i cili pretendohet se ishte Fatmir Limaj, qëndroi jashtë dhe fliste “nëpërmjet dritares dhe derës.”⁴⁹⁸ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore përfundoi në mënyrë të arsyeshme se Dëshmitarët L06 dhe L10 mund të jenë ndikuar në mënyrë të pavetëdijshme nga mediat kur e njohën Fatmir Limaj në televizion si njeriun të cilin e kishin takuar në kamp, veçanërisht duke qenë se nuk kishte patur dëshmi lidhur me natyrën e programeve televizive që mund të kishte nxitur identifikimin.⁴⁹⁹ Së fundi, Dhoma Gjyqësore theksoi se Dëshmitari L06 dhe Dëshmitari L10 dhanë përshkrime të ndryshme të njeriut të cilin ata më vonë e identifikuan si Fatmir Limaj, duke konkluduar se Dëshmitari L10 mbante mend një njeri me mjekër me shtatlartësi 200 cm, kurse Dëshmitari L06 përshkroi një njeri pa mjekër, i cili ishte më i gjatë se ai vetë.⁵⁰⁰

193. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore logjikisht refuzoi të pranonte dëshminë e Dëshmitarit L10 i cili tha se njeriu që e kishte takuar në kamp ishte “Çeliku.”⁵⁰¹, duke e bazuar përfundimin e vet në faktin se Dëshmitari L10 nuk e përmendi “Komandant Çeliku” kur u mor në pyetje, në gusht 2001⁵⁰² nga hetuesit e CCIU-së dhe nga “serbët” në vitin 1998⁵⁰³, për ngjarjet e kamp-burgut.

194. Lidhur me Dëshmitarin L04, Dhoma Gjyqësore përfundoi se ai nuk përmendi faktin se u dërgua për t’u takuar me “komandantin,” në veçanti “Komandant Çeliku,” kur u mor në pyetje nga hetuesi i CCIU-së në janar 2002; ai shpjegoi këtë harresë me pretendimin se përkthyesit mund të mos e kishin kuptuar.⁵⁰⁴ Mirëpo, Dhoma Gjyqësore përfundoi se në vende të shumta të dëshmisë së tij, Dëshmitari L04 kishte theksuar se sa i paharueshëm kishte qenë takimi me Komandant Çeliku duke qenë se rezultoi në urdhrin për lirim të tij. Si pasojë, ajo përfundoi se mospërmendja e takimit

⁴⁹⁷ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.27, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 532-533. Prokuroria argumenton gjithashtu se Dëshmitari L96 e mbështet dëshminë se Fatmir Limaj luajti një rol në vendimet e burgimit dhe të liritimit (*shih* Dosjen e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.75 dhe 2.90, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 551. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.29. *Shih edhe*, Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 65, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 538-540). Kjo çështje do të trajtohet në kuadrin e arsyesjes të dytë të apelit.

⁴⁹⁸ Aktgjykimi, paragrafi 540, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 2996-2997 (4.2.2005, seancë private).

⁴⁹⁹ Aktgjykimi, paragrafi 540.

⁵⁰⁰ *Po aty*. Dhoma Gjyqësore vëren se “u ra dakord midis palëve se lartësia e L06 ishte 175.5 cm. T. 5187-5188.”

⁵⁰¹ Aktgjykimi, paragrafi 539.

⁵⁰² Dëshmitari L10, T. 2957 (3.2.2005).

⁵⁰³ Dëshmitari L10, T. 2975 (3.2.2005).

⁵⁰⁴ Aktgjykimi, paragrafi 542, i cili i referohet Dëshmitarit L04, T. 1209-1210 (30.11.2004).

gjatë intervistës së janarit 2002 mbeti e pashpjegueshme. Dhoma Gjyqësore konkludoi gjithashtu se para kësaj interviste, Dëshmitari L04 e kishte parë Fatmir Limajn shpesh në televizion dhe kishte menduar se ai ishte Komandant Çeliku.⁵⁰⁵ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të arsyeshme, hodhi poshtë dëshminë e Dëshmitarit L04, se “komandanti” që e kishte takuar në kamp-burg, ishte Fatmir Limaj.⁵⁰⁶

195. Për sa i përket mundësisë të ndikimit të pavetëdijshëm, Prokuroria pretendon se ky parim nuk vlen për dëshmitarët identifikues, Ivan dhe Vojko Bakraçin, Dëshmitarin L04, Dëshmitarin L06, Dëshmitarin L10 dhe Dëshmitarin L96, sepse asnjëri prej tyre nuk e pa “komandantin” *për herë të parë* në vendin e krimit dhe pastaj në media.⁵⁰⁷

196. Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur përfundoi se, pas ngjarjeve në kamp-burg, të gjithë këta dëshmitarë e panë Fatmir Limajn në media. Për më tepër, asnjë dëshmi identifikimi e këtyre dëshmitarëve nuk u hodh poshtë vetëm në bazë të ndikimit të mundshëm të pavetëdijshëm. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë, në mënyrë të arsyeshme, këtë mundësi kur hodhi poshtë dëshmitë identifikuese të këtyre dëshmitarëve.⁵⁰⁸

197. Prokuroria pretendon më tej se Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë ndërkonfirmimet midis Dëshmitarit L07, Ivan Bakraçit dhe Vojko Bakraçit lidhur me takimin e këtyre dy të fundit me Komandant Çeliku.⁵⁰⁹ Dëshmitari L07 dëshmoi se Komandant Çeliku foli me “dy kroatët,” d.m.th. Ivan dhe Vojko Bakraç,⁵¹⁰ për rreth dhjetë minuta lidhur me lirimin e tyre,⁵¹¹ gjë që përputhet me përshkrimin e Ivan dhe Vojko Bakraçit për takimin e tyre me personin të cilin ata e njihnin si “komandanti.”⁵¹² Prokuroria argumenton gjithashtu se nuk duhet t’i kushtohet rëndësi e veçantë mospërmendjes prej Ivan dhe Vojko Bakraçit të faktit se Dëshmitari L07 u lirua në praninë e tyre, siç dëshmoi Dëshmitari L07, sepse ata nuk e njihnin përpara.⁵¹³

198. Fatmir Limaj përgjigjet se, megjithëse Ivan dhe Vojko Bakraçi kishin mundësi për të parë dhe për të kaluar kohë me “komandantin,” ata nuk thanë se ky person quhej “Komandant Çeliku,” as nuk e identifikuan Fatmir Limajn në fotomonazhët e treguar atyre si ky njeri.⁵¹⁴

⁵⁰⁵ Dëshmitari L04, T. 1218-1219 (30.11.2004, seancë private).

⁵⁰⁶ Aktgjykimi, paragrafi 544.

⁵⁰⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.111-2.114. *Shih edhe* AT 106-107 (6.6.2007).

⁵⁰⁸ *Shih* Aktgjykimi, paragrafët 534 (Ivan dhe Vojko Bakraç), 540 (Dëshmitarët L06 dhe L10) dhe 544 (Dëshmitari L04).

⁵⁰⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.78-2.79, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 522-537 dhe 548.

⁵¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.79, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 548.

⁵¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.79.

⁵¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.79, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 533, shënimi 1753; Aktgjykimit, paragrafët 549-550.

⁵¹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.80.

⁵¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 76.

199. Dhoma Gjyqësore vetëm “vuri re” faktin se Ivan dhe Vojko Bakraçi nuk përmendën se Dëshmitari L07 u lirua në praninë e tyre, pa formuluar shprehimisht asnjë përfundim dhe pa nxjerrë shprehimisht ndonjë deduksion. Rrjedhimisht, Prokuroria nuk ka treguar se Dhoma Gjyqësore nxorri përfundim të paarsyeshëm lidhur me atë pjesë të dëshmisë së Dëshmitarit L07.⁵¹⁵

200. Lidhur me takimin me komandantin e kampit,⁵¹⁶ i cili zgjati rreth dhjetë minuta, Dhoma Gjyqësore përfundoi se as Ivan as Vojko Bakraç nuk e identifikoi “komandantin” që folën si Fatmir Limaj apo “Komandant Çeliku.” Prandaj, Prokuroria nuk provon se, në mënyrë të paarsyeshme Dhoma Gjyqësore nuk arriti të përfundonte se dëshmitë e tyre konfirmuan dëshminë e Dëshmitarit L07 lidhur me takimin me Fatmir Limajn, i njohur gjithashtu si “Komandant Çeliku” në atë rast.

201. Prokuroria pretendon më tej se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori në konsideratë, në mënyrë të duhur, faktin se dëshmia e Dëshmitarit L07 u konfirmua nga dëshmitarë të tjerë të cilët e identifikuan Fatmir Limaj si personin që ata e njihnin nga kamp-burgu ose, si në rastin e Dëshmitarit L96, nga Malet e Berishës.⁵¹⁷ Madje, sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë “përkimin e habitshëm” që shtatë dëshmitarë⁵¹⁸ dëshmuan se kishin takuar Fatmir Limajn – dhe asnjë figurë tjetër të njohur gjatë dhe pas luftës⁵¹⁹ - gjatë kohës së burgimit.⁵²⁰

202. Fatmir Limaj u përgjigj se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dëshmitë me kujdes,⁵²¹ veçazi dhe bashkërisht.⁵²² Ai pretendon se Prokuroria bëri pohime të pasakta për shqyrtimin e dëshmisë nga Dhoma Gjyqësore sepse, për shembull, Vojko dhe Ivan Bakraçi dhe Dëshmitari L96 nuk pohuan se e kishin takuar Fatmir Limajn gjatë kohës së burgimit.⁵²³ Për këtë, Prokuroria u përgjigj se nuk keqinterpretoi dëshmitë e Vojko Bakraçit dhe të Ivan Bakraçit dhe të Dëshmitarit L96 lidhur me personin që e takuan në kamp-burg,⁵²⁴ por përdori një shprehje përmbledhëse për të shpjeguar se këta dëshmitarë e njohën më vonë si Fatmir Limaj, “komandantin” që e takuan në burg.⁵²⁵

203. Dhoma e Apelit konkludon së pari, se pohimi i Prokurorisë është një mënyrë mjaft shkurtuese për paraqitjen e dëshminë. Madje siç u konkludua më lart, Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur shprehu dyshime të arsyeshme për besueshmërinë e dëshmive identifikuese të Vojko Bakraçit,

⁵¹⁵ Aktgjykimi, paragrafi 548 *in fine*.

⁵¹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.78-2.79, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 522-537 dhe 548.

⁵¹⁷ Njoftim për Apel i Prokurorisë, paragrafët 5(3) dhe 6(3); Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.55 dhe 2.92.

⁵¹⁸ Vojko Bakraç, Ivan Bakraç, Dëshmitari L10, Dëshmitari L07, Dëshmitari L06, Dëshmitari L04 dhe Dëshmitari L96.

⁵¹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.76-2.77.

⁵²⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.33. *Shih edhe* AT 101 (6.6.2007).

⁵²¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 90-92.

⁵²² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 92, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 560-561.

⁵²³ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 41, 43.

⁵²⁴ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.2.

⁵²⁵ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.3.

Ivan Bakraçit, Dëshmitarit L10, Dëshmitarit L07, Dëshmitarit L06, dhe Dëshmitarit L04. Ajo gjithashtu konkludoi logjikisht se kishte dyshime për besueshmërinë e Dëshmitarit L96 për çështje materiale dhe se duhej konfirmim.⁵²⁶ Për më tepër, konfirmimi i dëshmive, edhe pse prej shumë dëshmitarëve, nuk vërteton automatikisht besueshmërinë apo peshën e dëshmive.⁵²⁷ Konfirmimi nuk është as kusht, as garanci e besueshmërisë së cilësdod dëshmie të veçantë.⁵²⁸ Ky është një element të cilin një gjykues i arsyeshëm faktesh mund ta marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të dëshmisë. Mirëpo marrja ose mosmarrja në konsideratë e konfirmimeve i lihet kompetencës ë së tij gjykuese.

204. Si përfundim, Prokuroria nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore gaboi duke mos përfunduar se dëshmia e Dëshmitarit L07 ishte konfirmuar.

(b) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur shqyrtoi përshkrimet fizike të dëshmitarëve për personin që ata pretendojnë se e identifikuan si Fatmir Limaj⁵²⁹

205. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore shpërfilli në mënyrë të paarsyeshme ngjashmëritë e dëshmive të dëshmitarëve për sa u përket moshës, shtatlartësisë dhe veshjes së personit që e identifikuan si Fatmir Limaj, duke parapëlqyer të theksonte mospërputhje të vogla.⁵³⁰ Ndërsa Fatmir Limaj, në kohën në fjalë, ishte 27 vjeç dhe 181 cm i gjatë,⁵³¹ Ivan Bakraçi dëshmoi se personi që ai e njohte si “komandantin” ishte rreth 180-185 cm. Dëshmitari L06 deklaroi se personi që ai e njohte si “Komandant Çeliku”, ishte më i gjatë se ai vetë (ai ishte 175.5 cm lartë). Vetëm vlerësimi i Dëshmitarit L10 – rreth 200 cm – nuk përputhej me lartësinë e përafërt të personit që ai e njohte si “Komandant Çeliku.”⁵³²

206. Lidhur me veshjen, Prokuroria pretendon se personi i identifikuar si Fatmir Limaj u përshkrua si i veshur me një uniformë të pastër kamuflimi dhe se kishte një çantë oficeri (sipas Vojko Bakraçit), një çantë dhe uniformë (sipas Dëshmitarit L96) dhe një çantë oficeri (sipas Dëshmitarit L07).⁵³³ Lidhur me moshën e tij, Vojko Bakraç dëshmoi se “komandanti” ishte rreth 30-

⁵²⁶ Aktgjykimi, paragrafi 26.

⁵²⁷ *Shih* Aktgjykimin *Musema*, paragrafi 46, mbështetur nga Aktgjykimi i Apelit *Musema*, paragrafët 37-38; Aktgjykimi *Kamuhanda*, paragrafi 40.

⁵²⁸ *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Aleksovski*, paragrafët 62-63, i cili i referohet Aktgjykimit të Apelit *Tadiq*, paragrafi 65; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 492 dhe 506; Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*, paragrafi 72; Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, paragrafi 153; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema* dhe *Ruzindana*, paragrafët 154 dhe 229.

⁵²⁹ Njoftim për Apel i Prokurorisë, paragrafët 6(2)(d) dhe 6(3)(b) dhe (d).

⁵³⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.81-2.82, 2.86, 2.99, 2.106 (i cili i referohet Aktgjykimit, paragrafët 561 dhe 562), dhe 2.100. *Shih edhe* AT 113-114 (6.6.2007)

⁵³¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.85.

⁵³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.83, i cili i referohet Aktgjykimit, paragrafi 533.

⁵³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.84.

35 vjeç, kurse Ivan Bakraçi tha se “komandanti” ishte në mes të tridhjetave”, “mbase 35, 36” dhe Dëshmitari L96 tha se “Komandant Çeliku” ishte “mjaft i ri.”⁵³⁴

207. Prokuroria argumenton më tej se Dhoma Gjyqësore ishte e paarsyeshme kur theksoi se Dëshmitari L04 kishte folur për një “mjekër mesatare” dhe kur tha se “mjekra nuk ishte shumë e gjatë,” dhe më vonë sqaroi se ishte “2-3 cm e gjatë.”⁵³⁵ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë faktin se Dëshmitarët L10, L07, L97, Shefqet Kabashi⁵³⁶ dhe Ivan Bakraçi e përshkruan Fatmir Limajn ose si me një mjekër të shkurtër ose pa mjekër.⁵³⁷ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore nuk theksoi faktin se vëzhgimet e dëshmitarëve ishin bërë në kohë të ndryshme.⁵³⁸ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore duhej të kishte pranuar dëshmitë për mjekrën e Fatmir Limajt si tepër konfirmuese për paraqitjen e tij personale dhe për pjesëmarrjen e tij në kamp-burg.⁵³⁹

208. Dhoma Gjyqësore konkludoi se, megjithëse Dëshmitari L60 dhe Dëshmitari L10 u burgosën bashkërisht në kamp-burg,⁵⁴⁰ përshkrimet e tyre të “Komandant Çelikut” treguan shumë ndryshime.⁵⁴¹ Dhoma Gjyqësore përfundoi gjithashtu⁵⁴² se Ivan dhe Vojko Bakraçi, të cilët duket se kishin kontakte më të shpeshta me personin që ata e njihnin si “komandanti,”⁵⁴³ dhanë përshkrime fizike të këtij personi që nuk përputheshin me njëri-tjetrin.⁵⁴⁴ Duke marrë parasysh rezervat e lartpërmendura të Dhomës Gjyqësore lidhur me dëshmitë identifikuese të këtyre dëshmitarëve, Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore veproi logjikisht, kur nga dëshmitë e përshkrimit fizik, nuk përfundoi se dëshmitarët e kishin identifikuar Fatmir Limajn në kamp.

209. Dhoma e Apelit vëren se përfundimi i Dhomës Gjyqësore për “mospërputhje penguese” në përshkrimin fizik të personit të njohur si “komandant” apo “Komandant Çeliku” bazohet mbi një vlerësim të shumëfishtë të të gjitha përshkrimeve të dhëna nga dëshmitarët.⁵⁴⁵ Dhoma e Apelit vëren gjithashtu se dëshmitarët u mbajtën bashkë, të paktën për një pjesë të periudhës së burgimit:

⁵³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.85.

⁵³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.107.

⁵³⁶ Gjatë procesit, Shefqet Kabashi dëshmoi me masa mbrojtëse. Dhoma e Apelit e hoqi shumicën e masave mbrojtëse lidhur me pseudonimin e tij “Dëshmitar L95” (Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Masave Mbrojtëse, 30 maj 2007. *Shih edhe* Urdhëresën lidhur me Vendimin e Datës 30 maj 2007 në të cilin ndër të tjera u shfuqizua statusi konfidencial i vendimit të mëparshëm).

⁵³⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.108.

⁵³⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.107.

⁵³⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.108. Për Limaj, *shih* AT 194 (6.6.2007).

⁵⁴⁰ Aktgjykimi, paragrafi 539, i cili i referohet Aktgjykimit, paragrafët 270 dhe 279.

⁵⁴¹ Aktgjykimi, paragrafi 540: “L10 mban mend një njeri me mjekër dhe gjatësi spikatëse, afërsisht 2 metra, kurse L06 e përshkroi të njëjtin person pa mjekër, dhe thjesht pohoi se ishte më i gjatë se ai.” Dëshmitari L04 foli për një “mjekër mesatare,” “mjekër jo shumë të gjatë” dhe më vonë sqaroi se ajo ishte “2-3 cm gjatë.” *Shih* Aktgjykimi, paragrafi 544.

⁵⁴² Aktgjykimi, paragrafi 562.

⁵⁴³ Dhoma e Apelit vëren se Dhoma Gjyqësore konkludoi se Ivan Bakraç dëshmoi se takimi i parë me “komandantin” zgjati rreth 10-15 minuta. [Ivan Bakraç, T. 1431 (3.12.2004)] dhe takimi i dytë zgjati rreth 15-20 minuta [Ivan Bakraç, T. 1432-1433 (3.12.2004); *shih edhe* Aktgjykimin, paragrafët 533-537]; Vojko dëshmoi se takimi i dytë me “komandantin” zgjati “rreth gjysëm ore, 45 minuta, jo më shumë se një orë” [Vojko Bakraç, T. 1342 (2.12.2004)]; *shih edhe* Aktgjykimin, paragrafi 532].

⁵⁴⁴ Dhoma e Apelit vëren se Vojko Bakraç e përshkroi njeriun si me një uniformë me lara, me një mjekër të shkurtër, dhe një çantë oficeri, tha që ishte në mes të tridhjetave dhe më i gjatë se ai vetë [Vojko Bakraç, T. 1334-1335 (2.12.2004)]; Ivan Bakraç e përshkroi komandantin si me uniformë me lara, “i rruar, por nuk ishte i saporruar, nuk kishte qime në fytyrë,” rreth 35 vjeçar, rreth 180-185 gjatë, shtat i mesëm, me flokë pak më të gjata, pjesërisht të thinjura dhe tërhequra nga mbrapa. [Ivan Bakraç, T. 1430 (3.12.2004)]; *shih* Aktgjykimin, paragrafi 532.

⁵⁴⁵ Aktgjykimi, paragrafi 562.

Dëshmitarët L06 dhe L10 u mbajtën bashkë nga 13 ose 14 qershor 1998 deri me 25 ose 26 korrik 1998. Dëshmitari L04 nga 28 qershor deri më 25 ose 26 korrik 1998, Vojko dhe Ivan Bakraç nga 29 qershor deri më 6 korrik 1998, Dëshmitari L07 për tri ditë në korrik 1998 dhe Dëshmitari L96 nga 18 deri më 25 ose 26 korrik 1998.⁵⁴⁶ Kjo mundëson interpretimin e arsyeshëm që vëzhgimet e përshkrimit fizik të personit të njohur si “komandant” apo “Komandant Çeliku” lidhen me të njëjtën periudhë.

210. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore nuk ishte e paarsyeshme kur konkludoi se dëshmitë lidhur me përshkrimin fizik të njeriut që pretendohet se u identifikua si Fatmir Limaj, tregoi “mospërputhje penguese.”⁵⁴⁷

211. Prokurorua parashtroi më tej se Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë, në mënyrë të paarsyeshme, identifikimin e Fatmir Limajt nga Ivan Bakraç pa pranuar se fotomontazhi që iu treguar Ivan Bakraçit (Prova materiale DL1) përmbante një fotografi të Fatmir Limajt me mjeker, e cila thuhet se ndryshon nga përshkrimi nga Ivan Bakraçi i personit që ai pa në kamp, d.m.th. “jo të saporruar.”⁵⁴⁸

212. Dhoma e Apelit përfundon se Prokuroria shtrembëroi dëshminë duke qenë se Ivan Bakraçi *mbante mend* se Fatmir Limaj ishte “i rruar, por jo i saporruar, nuk kishte qime në fytyrë” dhe Prova materiale DL1 në fotografinë numër 5, tregon Fatmir Limajn të rruar /jo të saporruar, siç konkludoi Dhoma Gjyqësore.⁵⁴⁹

213. Si pasojë, Prokuroria nuk vërtetoi se Dhoma Gjyqësore gaboi kur shqyrtoi përshkrimet e dëshmitarëve për personin që ata pretendojnë se e identifikuan në kamp-burg si Fatmir Limaj.

(c) A gaboi Dhoma Gjyqësore kur nuk mori parasysh praninë e shpeshtë të Fatmir Limajt në fshatin Llapushnik dhe në afërsi të kamp-burgut

214. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh praninë e shpeshtë të Fatmir Limajt në fshatin Llapushnik gjatë muajve qershor dhe korrik 1998, kur shqyrtoi nëse ai kishte marrë pjesë në kamp-burg. Ajo pretendon se Fatmir Limaj pranoi se kishte vizituar Llapushnikun rreth dy herë në javë gjatë atyre muajve,⁵⁵⁰ dhe se ishte atje të paktën gjatë një

⁵⁴⁶ Aktgjykimi, paragrafi 279.

⁵⁴⁷ Aktgjykimi, paragrafi 562.

⁵⁴⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.102-2.106 dhe 2.120-2.122, i cili i referohet Aktgjykimit, paragrafi 537; Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.17-2.19, i cili i referohet Aktgjykimit, paragrafi 533 dhe shënimi 1750.

⁵⁴⁹ Prova materiale DL1 “fotomontazh.” *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 533, i cili i referohet Ivan Bakraçit, T. 1573 (6.12.2004).

⁵⁵⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.43, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 598.

ceremonie betimi në qershor apo korrik 1998,⁵⁵¹ gjatë luftimeve të madhe,⁵⁵² dhe si pjesë e një vizite mbikëqyrëse me komandantët të lartë ushtarakë të UÇK-së.⁵⁵³ Ai pranoi gjithashtu se ishte i pranishëm në klinikë apo afër saj,⁵⁵⁴ si dhe në selinë e shtabit të UÇK-së, vetëm 200 metra larg kampit.⁵⁵⁵ Prokuroria argumenton se prania e tij në fshat vërteton dëshminë e dëshmitarit se ai ishte personi i quajtur “Komandant Çeliku”, i parë në kamp.⁵⁵⁶ Prokuroria argumenton më tej se pretendimi i Fatmir Limajt se nuk dinte për kamp-burgun, nuk është i besueshëm sepse fshati Llapushnik është i vogël.⁵⁵⁷

215. Fatmir Limaj përgjigjet se fakti që ai ishte afër kamp-burgut, nuk sjell përfundimin e arsyeshëm se ai ishte i përfshirë në të.⁵⁵⁸ Gjithashtu, në Dosjen Paragjyqësore, Prokuroria deklaroi se “largësia e kampit prej rrugës kryesore dhe vendndodhja e tij në një oborr të rrethuar (gjithmonë me roje) bëri të mundur që kampi të mbetej relativisht i padukshëm, edhe për ushtarët e UÇK-së në fshat dhe në vijat e afërta të frontit.”⁵⁵⁹

216. Prokuroria kundërpërgjigjet se Dosja Paragjyqësore nuk sugjeron se kampi nuk mund të shihej nga Fatmir Limaj kur ishte i pranishëm në shtabin e UÇK-së, i cili ndodhet në afërsi të kampit dhe shihet me sy, apo kur mori pjesë në ceremoninë e betimit disa metra nga kampi.⁵⁶⁰

217. Dhoma Gjyqësore konkludoi se për shkak të betejës më 29 maj 1998, shtabi i njësisë Çeliku 3 u zhvendos në oborrin e Gzim Gashit, i njohur gjithashtu si “Gzim Vojvoda,”⁵⁶¹ për disa ditë, i cili ndodhej përtej rrugicës së kamp-burgut.⁵⁶² Gjithashtu ajo mori shënim pretendimin se Fatmir Limaj kishte marrë pjesë në ceremoninë e betimit të UÇK-së në një vend tjetër, në oborrin e Bali Vojvodës, i cili ndodhet ngjitur me kamp-burgun.⁵⁶³

218. Dhoma e Apelit vëren se Dhoma të tjera Gjyqësore kanë konkluduar se afërsia e të akuzuarit me një zone të veprimtarisë kriminale mund të përbëjë një faktor prej të cilit mund të nxirret

⁵⁵¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.44, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 591. *Shih edhe* AT 97 (6.6.2007).

⁵⁵² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.44.

⁵⁵³ *Po aty.*

⁵⁵⁴ *Po aty.*

⁵⁵⁵ *Po aty.*

⁵⁵⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.46.

⁵⁵⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.45. *Shih edhe* AT 99-101 (6.6.2007).

⁵⁵⁸ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 85.

⁵⁵⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 86-87 dhe 98.

⁵⁶⁰ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.41-2.42.

⁵⁶¹ Ruzhdi Karpuzi, T. 3091 (7.2.2005).

⁵⁶² Aktgjykimi, paragrafi 6, i cili i referohet Elmi Sopit, T. 6767-6768 (1.6.2005); Ruzhdi Karpuzit, T. 3096-3098 (7.2.2005), T. 3175 (8.2.2005); Prova materiale P128 (“Fotografi e qendrës bujqësore të Llapushnikut, përkthimi i shënuar nga Dëshmitari”). *Shih edhe* Aktgjykimin, paragrafët 693 dhe 714, i cili i referohet Dëshmitarit L64, T. 4380 (15.3.2005) dhe përmend “Në të njëjtën hartë ajrore mbi të cilën ai shënoi pesë pozicionet luftarake të Çelikut 3, L64 shënoi gjithashtu tri vendet ku ndodheshin shtabet e Çelikut 3, Prova material P170.”

⁵⁶³ Aktgjykimi, paragrafi 6, i cili i referohet Elmi Sopit, T. 6767-6768 (1.6.2005); Ruzhdi Karpuzit, T. 3096-3098 (7.2.2005), T. 3175; Prova materiale P128 (“Fotografi e qendrës bujqësore të Llapushnikut, përkthimi i shënuar nga Dëshmitari”).

deduksioni se i akuzuari ishte në djjeni për krimet.⁵⁶⁴ Mirëpo, në këtë rast, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të arsyeshme, refuzoi të konkludonte se prania e pretenduar e herëpashershme e Fatmir Limajt shumë afër kamp-burgut të Llapushnikut gjatë betejës së 29 majit 1998 pas saj, si edhe në një ceremoni betimi në qershor-korrik 1998,⁵⁶⁵ provoi dijeninë e tij për ekzistencën e kamp-burgut apo për pjesëmarrjen e tij në të.

3. Përfundim

219. Si pasojë, pika e parë e apelit të Prokurorisë hidhet poshtë në lidhje me pretendimet e diskutuara më lart të Prokurorisë. Pretendimet e tjera – se Dhoma Gjyqësore gaboi që nuk mori parasysh pozitën e pretenduar komanduese të Fatmir Limajt dhe aftësinë e tij për marrjen e vendimeve të liritimit/burgimit, gjatë shqyrtimit nëse mori pjesë personalisht në kamp-burg – do të shqyrtohen në kuadrin e pikës së dytë të apelit.

B. Pika e dytë e apelit: pozita e pretenduar komanduese dhe kontrolluese e Fatmir Limajt

220. Prokuroria pretendon gjithashtu se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor duke keqzbatuar standardin e provës “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”⁵⁶⁶ dhe/ose gabim faktual, nëpërmjet vlerësimit të gabuar të provave dhe mosshqyrtimit të tëra provave përkatëse lidhur me pozitën e pretenduar komanduese të Fatmir Limajt.⁵⁶⁷ Prokuroria pretendon se prej tërësisë së provave buron vetëm një përfundim i arsyeshëm: Gjatë majit deri në fund të korrikut 1998, Fatmir Limaj pati një pozitë komanduese e cila përfshinte komandën mbi UÇK-në në kamp-burgun e Llapushnikut.⁵⁶⁸

221. Fatmir Limaj përgjigjet se Prokurori përpiqet të rihapë çështje tashmë të shqyrtuara plotësisht në Aktgjyjm.⁵⁶⁹ Pas rishqyrtimit të kujdesshëm të provave lidhur me pozitën e tij komanduese, dhe duke marrë parasysh “tërësinë e provave,”⁵⁷⁰ Dhoma Gjyqësore përfundoi se:

Pasi janë shqyrtuar të gjitha pikat në lidhje me të Akuzuarin Fatmir Limaj të përmendura më herët dhe pas shqyrtimit edhe të akuzës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Prokuroria nuk ka provuar se Fatmir Limaj është fajtor për ndonjë prej akuzave të ngritura në Aktakuzë, si në bazë të Nenit 7(1) po ashtu edhe në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit.⁵⁷¹

⁵⁶⁴ *Shih* Aktgjykimin *Bllagojeviq* dhe *Jokiq*, paragrafët 483, 748; Aktgjykimi *Aleksovski*, paragrafi 80; Aktgjykimi *Bagilishema*, paragrafi 925.

⁵⁶⁵ Aktgjykimi, paragrafët 569 dhe 591; Ruzhdi Karpuzi, T. 3096-3104 (7.2.2005), T. 3175-3176 (8.2.2005) (ai dëshmoi për një ceremoni betimi në oborrin e shtëpisë së Balit në fund qershori / fillim korriku); Zeqir Gashi, T. 5618 (11.4.2005) (ai dëshmoi për një ceremoni betimi diku në Llapushnik); Dëshmitari L64, T. 4386 (15.3.2006), T. 4420-4421 (16.3.2005), (ai dëshmoi për dy ceremoni të betimit në fillim qershori /mes qershori rreth guzhinës së shtabit të dytë, i cili, sipas Aktgjykimit, paragrafi 693, ndodhej në oborrin e Vojvodës, apo të Gëzim Gashit, të njohur gjithashtu si Gëzim Vojvoda. *Shih edhe* Aktgjykimin, paragrafi 714, dhe Ruzhdi Karpuzi, T. 3091 (7.2.2005).

⁵⁶⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.129, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 568-602.

⁵⁶⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.137 dhe 2.172, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 568-602.

⁵⁶⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.129, 2.138 dhe 2.150 dhe 2.227-2.229. *Shih edhe* AT 90 (6.6.207).

⁵⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 102.

⁵⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 103, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 10.

⁵⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 103 (theksimi i shtuar), e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 602.

Sipas Fatmir Limajt, Prokuroria nuk ka provuar se përfundimet e Dhomës Gjyqësore për përgjegjësinë e tij të pretenduar komanduese ishin “të paarsyeshme”.⁵⁷²

222. Duke qenë se gabimi i pretenduar ligjor dhe gabimet faktuale janë të ngërthyer ngushtë, Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë bashkërisht në momentin e duhur.

1. A gaboi Dhoma Gjyqësore me mosshqyrtimin e të tëra provave përkatëse

223. Prokuroria pretendon se për shkak të qasjes së saj fragmentare ndaj provave,⁵⁷³ Dhoma Gjyqësore gaboi gjatë shqyrtimit të pushtetit të tij komandues, kur nuk mori në konsideratë dëshmitë e dhëna nga disa dëshmitarë të cilët e identifikuan Fatmir Limajn si personi që kishin takuar në kamp-burg.⁵⁷⁴ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë dëshmitë e dëshmitarëve okularë në kamp si të rëndësishme thjesht për çështjen e identifikimit, edhe pse ata dëshmuan për funksionet e tij komanduese në kamp.⁵⁷⁵ Prokuroria pretendon gjithashtu se Dhoma Gjyqësore pranoi deklaratën e Fatmir Limajt se ai ishte komandanti i njësisë Çeliku 1 në Kleçkë gjatë periudhës së Aktakuzës,⁵⁷⁶ dhe përfundoi se “prej dëshmimeve duket se ekziston një gjasë e fortë se Fatmir Limaj vepronte si komandant në kamp-burg në kohën që ka lidhje me Aktakuzën [...]”⁵⁷⁷ Rrjedhimisht Prokuroria pretendon se ajo duhej të kishte marrë parasysh këtë dëshmi bashkë me dëshmitë e dëshmitarëve të cilët deklaruan se kishin takuar “Komandant Çelikun” dhe kishin zbuluar se emri i tij i vërtetë ishte Fatmir Limaj.⁵⁷⁸

224. Fatmir Limaj përgjigjet se, duke marrë parasysh të gjitha provat, përfshirë edhe dëshmitarët e Mbrojtjes të cilët dëshmuan se gjatë periudhës së Aktakuzës, zona e tij e përgjegjësisë përfshinte vetëm Kleçkën dhe njësinë Çeliku 1, Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur konkludoi se Prokuroria nuk vërtetoi përfshirjen e tij në funksionimin e kamp-burgut.⁵⁷⁹

225. Dhoma e Apelit përfundon se gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje Dhoma Gjyqësore përdori dëshmitë identifikuese të Dëshmitarëve L04, L06, L07, L10, L96 dhe të Ivan dhe Vojko Bakraçit.⁵⁸⁰ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore shqyrtoi me kujdes dëshminë identifikuese të Dëshmitarit L64 së

⁵⁷² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 105 dhe 107, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 569-602. *Shih edhe* AT 154-158 dhe 166-171 (6.6.2007).

⁵⁷³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.144.

⁵⁷⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.139 dhe 2.171, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 566-602.

⁵⁷⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.140-2.143, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 532-533, 538-541, 545, 551. *Shih edhe* pikën e parë të apelit: Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafë 2.47, 2.50, 2.88-2.90.

⁵⁷⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.48, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 598-599.

⁵⁷⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.51-2.52, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 601.

⁵⁷⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.49, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 531-550. *Shih edhe* Dosjen e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.87 dhe 2.90.

⁵⁷⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 89, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 598-602.

⁵⁸⁰ Aktgjykimi, paragrafët 598 dhe 600, i cili i referohet shënimit 2011 të Aktgjykimit, paragrafët 530-562.

bashku me dëshminë e tij për zonën e përgjegjesisë së Fatmir Limajt.⁵⁸¹ Si rezultat, Dhoma Gjyqësore i mori në konsideratë provat e identifikimit kur shqyrtoi pozitën komanduese dhe kontrolluese të Fatmir Limajt.

2. A gaboi Dhoma Gjyqësore me mosshqyrtimin e duhur të provave përkatëse

(a) Pretendimi për konfirmim midis dëshmive të Shukri Bujës, Ramadan Behlulit, Ramiz Qeriqit, Shefqet Kabashit dhe Dëshmitarit L64.

226. Prokuroria parashtron se dëshmitë e Shukri Bujës, Ramadan Behlulit, Ramiz Qeriqit, Shefqet Kabashit dhe Dëshmitarit L64 vërtetuan se Fatmir Limaj ishte komandant rajonal, zona e përgjegjesisë së të cilit përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut gjatë qershorit dhe korrikut 1998.⁵⁸²

227. Paraprakisht Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur hodhi poshtë deklaratat e mëparshme të Shukri Bujës dhe të Ramadan Behlulit dhënë Prokurorisë, për shkak se ata më vonë mohuan pjesët që prireshin të fajësonin Fatmir Limajn. Kjo, sipas Prokurorisë asgjëson efektin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore të datës 25 prill 2005 për pranimin e deklaratave.⁵⁸³

228. Mirëpo Dhoma e Apelit konkludon se me dhënien e Vendimit të datës 25 prill 2005, Dhoma Gjyqësore nuk hoqi dorë nga e drejta e saj për vlerësimin e mëvonshëm të besueshmërisë së kësaj dëshmie gjatë përcaktimit të fajësisë së të Akuzuarit.⁵⁸⁴ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk asgjësoi efektin e Vendimit të datës 25 prill 2005 kur vlerësoi besueshmërinë e intervistave të filmuara të Prokurorisë dhe diagramave të vizatuara nga Shukri Buja dhe Ramadan Behluli duke marrë në konsideratë provat e tjera.

229. Prokuroria argumenton më tej se Dhoma Gjyqësore tregoi se procesi i intervistës së mëparshme të Shukri Bujës kishte qenë i drejtë, se pyetjet kishin qenë të qarta⁵⁸⁵ dhe se ngatërresa të mundshme gjatë intervistës lidheshin me gabime në përkthim.⁵⁸⁶ Mirëpo, Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore vuri re se Shukri Buja “në mënyrë të vetëdijshme kishte qenë dredhues” gjatë dëshmisë në sallën e gjyqit dhe dukej se “u përpoq në mënyrë të vetëdijshme t’iu shmangej”

⁵⁸¹ Aktgjykimi, paragrafi 569.

⁵⁸² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.145 (e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 566-599), 2.146, 2.151-2.252, 2.159-2.160, 2.169, 2.173-2.191; Ramiz Qeriqi, T. 3579-3580 (28.2.2005); Prova materiale P121 “Video e intervistës së dëshmitarit me datën 26 qershor 2003,” ff. 9-10 dhe 51-52; Prova materiale P160.1 “Faqja e zbardhur e intervistës me datën 28 prill 2003,” f. 37; Prova materiale P159 “Diagramë e vizatuar nga dëshmitari”; Prova materiale P173 “Diagramë e vizatuar me dorë nga Dëshmitari L64”; Prova materiale P154 “Hartë.” *Shih edhe* AT 91-94 (6.6.2007).

⁵⁸³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.173, 2.175-2.176 dhe 2.192, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 13, 14, 568, 577-587, 601. *Shih edhe* AT 94-95 dhe 201-202 (6.6.2007).

⁵⁸⁴ Vendimi mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëparshme si Prova Thelbësore (“Vendimi i datës 25 prill 2005”), paragrafi 33. Aktgjykimi, paragrafi 580.

⁵⁸⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.180 (e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 582) dhe 2.181.

⁵⁸⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.181.

përgjigjeve ndaj pyetjeve për çështje materiale të procesit.⁵⁸⁷ Prokuroria argumenton më tej se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori në konsideratë deklaratën e mëparshme të Bujës për shkak se ai përshkroi rolin e Fatmir Limajt si atë të bashkërenduesit dhe jo të komandantit.⁵⁸⁸

230. Prokuroria pohon në veçanti se në deklaratën e tij, Shukri Buja tregoi se në Kleçkë ishte shtabi i komandës rajonale me zonën e përgjegjësisë që domosdoshmërisht do të kishte përfshirë kampin e Llapushnikut.⁵⁸⁹ Deklarata e tij tregoi gjithashtu se ai besonte se Fatmir Limaj ishte komandanti i zonës, me autoritet epror më të lartë se ai dhe se ushtarët e tij.⁵⁹⁰ Gjithashtu deklarata bënte të ditur se Buja “kishte marrë udhëzime [...] nga Komandant Çeliku” në Kleçkë.⁵⁹¹

231. Kur shqyrtoi deklaratën e mëparshme të Shukri Bujës dhënë Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ai kishte përshkruar rolin e Fatmir Limajt si rol “bashkërendues”⁵⁹² ose “këshillimor” dhe se

këto cilësime lënë të paqartë nëse Fatmir Limaj kishte rol komandues sipas kuptimit përkatës. Gjithashtu ka pjesë që lënë të pazgjidhur se kush ishte personi me përgjegjësi më të lartë në Kleçkë, Fatmir Limaj apo Ismet Jashari me pseudonimin Kumanova.⁵⁹³

Dhoma Gjyqësore nuk mundi të konkludonte prej deklaratës së tij se Fatmir Limaj kishte komandën e zonës e cila përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut gjatë periudhës së Aktakuzës,⁵⁹⁴ dhe Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria nuk ka vërtetuar se një gjykues i arsyeshëm i fakteve mund të kishte nxjerrë një interpretim të tillë nga kjo dëshmi. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk e hodhi poshtë deklaratën e mëparshme të Shukri Bujës vetëm e vetëm se ai e hodhi poshtë shprehimisht gjatë dëshmisë në sallën e gjyqit.

232. Prokuroria argumenton gjithashtu se në deklaratën për Prokurorinë, Ramadan Behluli tregoi se në pranverë të vitit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në këtë zonë ndodhej në Kleçkë, nën komandën e Fatmir Limajt.⁵⁹⁵ Ai tha se “Fatmir Limaj ishte komandanti i zonës atje,” duke e bërë të qartë se ai dinte se Fatmir Limaj ishte komandanti i Shukri Bujës dhe Ramiz Qeriqit.⁵⁹⁶ Ai shpjegoi gjithashtu se dinte se zona e përgjegjësisë së Shtabit të Përgjithshëm të Kleçkës e përfshinte zonën e

⁵⁸⁷ *Po aty*.

⁵⁸⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.183, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 582.

⁵⁸⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.153.

⁵⁹⁰ *Po aty*.

⁵⁹¹ *Po aty*. Për Limaj, *shih* AT 166-168 (6.6.2007).

⁵⁹² Aktgjykimi, paragrafi 582, i cili i referohet Provës materiale P160.1, “Faqja e zbardhur e intervistës së datës 28 prill 2003,” ff. 36-37 dhe 51.

⁵⁹³ *Po aty*, f. 43.

⁵⁹⁴ Aktgjykimi, paragrafi 582. Megjithatë nuk përmendet në Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim, më nënryrë të pashprehur, diagramën e Shukri Bujës (e cila është pjesa e deklaratës së tij) duke qenë se ajo përcaktoi në paragrafin 601 se kishte arritur përfundimin për pozitën e pretenduar komanduese të Fatmir Limajt në bazë të së cilës prove, të shqyrtuar veç e veç dhe bashkërisht (*shih edhe* Aktgjykimin, paragrafët 10, 17 dhe 20). Për më tepër, Dhoma Gjyqësore merret vetëm me provat të cilat janë të domosdoshme për Aktgjykimin (*shih* Aktgjykimin e Apelit *Kordiq* dhe *Çerkez*, paragrafi 382). Duke qenë se u vendos se dëshmia e Bujës për këtë çështje nuk kishte rëndësi për të vërtetuar nësi Fatmir Limaj mbajti një pozitë komanduese në kohën e duhur, duke përfshirë edhe në kamp-burgun e Llapushnikut, Dhoma Gjyqësore nuk ishte a paarsyeshme kur nuk përmendi diagramën shprehimisht në Aktgjykim.

⁵⁹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.155 dhe 2.166.

Llapushnikut ku ndodhej kampi.⁵⁹⁷ Më tej Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore u bind se Behluli ia kishte kishitë dhënë deklaratën Prokurorisë me vullnet të lirë⁵⁹⁸ dhe se nuk u bind prej shpjegimit të tij për arsyet e ndryshimit rrënjësor midis dëshmisë së tij gojore në pika kyçe të saj nga deklarata e tij e mëparshme lidhur me strukturën komanduese përkatëse midis majit dhe mesgushtit 1998.⁵⁹⁹ Në Vendimin e vet të datës 25 prill 2005, Dhoma Gjyqësore theksoi se arsyetimi i dëshmitarit tregoi një “mungesë vullneti për të treguar të vërtetën.”⁶⁰⁰

233. Dhoma Gjyqësore përfundoi se në deklaratën e tij të mëparshme të datës 25 prill 2003, Ramadan Behluli përcaktoi se Fatmir Limaj ishte komandanti i zonës së Pashtrikut, e cila e përfshinte fshatin Llapushnik dhe kamp-burgun.⁶⁰¹ Mirëpo, Dhoma Gjyqësore vuri re se ai përmendi gjithashtu Ramiz Qeriqin si komandant batalioni, gjë treguese për periudhën kohore pas periudhës së Aktakuzës.⁶⁰² Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se kjo ngrinte problemin nëse Ramadan Behluli e kuptoi drejt pyetjen për periudhën kohore në fjalë. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludoi se zona nën komandën e Kleçkës, që ai vizatoi në hartë, përfshinte pjesën përkatëse të fshatit Llapushnik, në anën jugore të rrugës Pejë-Prishtinë.⁶⁰³ Mirëpo, e dëshmitari vizatoi zonën para se të pyetej nëse situata në korrik 1998 ishte kështu.⁶⁰⁴ Për më tepër, kur u pyet konkretisht nëse situata në korrik 1998 ishte kështu, ai u përgjigj se “kjo është ... zona në komandën e Kleçkës.”⁶⁰⁵ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore ishte e mendimit se Ramadan Behluli deklaroi në intervistën e prillit 2003 se ai merrte urdhra vetëm nga Ramiz Qeriqi dhe jo nga Fatmir Limaj.⁶⁰⁶ Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore, logjikisht nxorri përfundimin nga këto dëshmi se zona e përgjegjësisë së Fatmir Limajt nuk përfshinte rrethinën e Llapushnikut ku ndodhej kampi. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore nuk e hodhi poshtë deklaratën e mëparshme të Ramadan Behlulit vetëm e vetëm për shkak se ai vetë e hodhi poshtë shprehimisht gjatë dëshmisë në sallën e gjyqit.⁶⁰⁷

⁵⁹⁶ Po aty.

⁵⁹⁷ Po aty.

⁵⁹⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.167, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 586. Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.186.

⁵⁹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.167. *Shih edhe* Dosjen e Apelimit të Prokurorisë, paragrafët 2.186-2.189.

⁶⁰⁰ Po aty.

⁶⁰¹ Aktgjykim, paragrafi 584, në lidhje me Provën materiale P121 “Video e intervistës së dëshmitarit me datën 26 qershor 2003,” ff. 22-23.

⁶⁰² Aktgjykim, paragrafi 584, në lidhje me Provën materiale P121 “Video e intervistës së dëshmitarit me datën 26 qershor 2003,” f. 22.

⁶⁰³ Aktgjykim, paragrafi 585, në lidhje me Provën materiale P119 “Hartë në bardhezi me shënime në ngjyrën e verdhë.”

⁶⁰⁴ Aktgjykim, paragrafi 585, në lidhje me Provën materiale P121 “Video e intervistës së dëshmitarit me datën 26 qershor 2003,” f. 51.

⁶⁰⁵ Po aty.

⁶⁰⁶ Aktgjykim, paragrafi 587, në lidhje me Provën materiale P121 “Video e intervistës së dëshmitarit me datën 26 qershor 2003,” ff. 23, 28.

⁶⁰⁷ Dhoma Gjyqësore nuk ishte e mendimit se dëshmia gojore e Bujës dhe të Behlulit asgjësuan deklaratat e tyre të mëparshme të filmuara me Zyrën e Prokurorisë, si pretendoi Prokuroria. Dhoma Gjyqësore vlerësoi në mënyrë të kujdesshme edhe dëshmitë gojore edhe intervistat e mëparshme të filmuara me Zyrën e Prokurorisë, dhe shpjegoi pse çdo provë nuk ishte e besueshme. U vendos se intervistat e mëparshme me Zyrën e Prokurorisë ishin të pabesueshme për shkaqet e lartëpërmendura; *shih edhe* Aktgjykimin, paragrafët 582, 584, 587 dhe u vendos se dëshmitë gojore ishin të pabesueshme për shkak se ndjenja e solidaritetit, me UÇK-në në përgjithësi dhe me Fatmir Limajn në veçanti, në dukje të dëshmitarët, mund të kishin ndikuar dëshmitë e tyre në sallën e gjyqit (*shih* Aktgjykimin, paragrafët 580 dhe 586).

234. Për të gjitha këto arsye, Prokuroria nuk ka mundur të tregojë se Dhoma Gjyqësore përfundoi në mënyrë të paarsyeshme se, me gjithë “dyshimet e forta” që kishte, nuk mund të arrinte në një përfundim të prerë bazuar në dëshminë e Shukri Bujës⁶⁰⁸ ose Ramadan Behlulit.⁶⁰⁹

235. Prokuroria pretendon se Ramiz Qeriqi dëshmoi se linja e komandës ishte Likoc (Shtabi i Përgjithshëm), Kleçkë (rajonal), dhe Kroimir (vendor), me Rexhep Selimin komandant në Likoc, Fatmir Limajn komandant në Kleçkë, dhe me atë vetë, komandant në Kroimir.⁶¹⁰ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur vlerësoi dëshminë e Ramiz Qeriqit⁶¹¹ dhe gjeti paqartësi sepse Qeriqi kishte deklaruar gjithashtu se zona ishte e njëjtë në kohën kur ishte komandant bataloni, gjë që ishte në fakt pas periudhës në fjalë të Aktakuzës. Mirëpo, Prokuroria pretendon se është e qartë se Qeriqi i mëshoi faktit se zona e përgjithshme e përgjegjesisë dhe struktura e UÇK-së mbetën njësoj edhe *para* edhe *pas* themelimit zyrtar të brigadave dhe se Qeriqi nuk e ngatërroi zonën e përgjegjesisë në të dy periudhat kohore, siç konkludoi Dhoma Gjyqësore.⁶¹²

236. Dhoma Gjyqësore përfundoi se Ramiz Qeriqi përshkroi linjën e organizimit nga Likoci në Kleçkë dhe në Kroimir.⁶¹³ Dhoma Gjyqësore përfundoi gjithashtu se ai deklaroi se Rexhep Selimi ishte komandant në Likoc, se Fatmir Limaj ishte komandant në Kleçkë dhe se Azem Sylja ishte komandanti i përgjithshëm i UÇK-së.⁶¹⁴ Mirëpo, Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë një numër paqartësish në dëshminë e Ramiz Qeriqit lidhur me pozitën e Fatmir Limajt para mesit të gushtit 1998: Ramiz Qeriqi dëshmoi se midis majit dhe korrikut 1998, ai shkoi shumë rrallë në Kleçkë dhe nuk merrte urdhra nga Fatmir Limaj sepse nuk ishte më komandant në Kroimir.⁶¹⁵ Dhoma Gjyqësore theksoi gjithashtu se ai dëshmoi se merrte urdhra nga Shukri Buja,⁶¹⁶ dhe kur e pyetën se prej kujt merrte urdhra Shukri Buja, ai u përgjigj se nuk e dinte.⁶¹⁷ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se kur vizatoi në Provën materiale P 154 kufijtë e zonës nën komandën e Kleçkës e cila përfshinte Llapushnikun,⁶¹⁸ përshkrimi i dëshmitarit për vizatimin duket se tregoi një ngatërrësë lidhur me periudhën kohore që ai kishte shfrytëzuar. Bile, ai përdori fjalën “batalionet” që, sipas Dhomës Gjyqësore, kishte një lidhje me kohën pas periudhës së Aktakuzës.⁶¹⁹

⁶⁰⁸ Aktgjykimi, paragrafi 581.

⁶⁰⁹ Aktgjykimi, paragrafi 586.

⁶¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.154.

⁶¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.200.

⁶¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.202, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 573. *Shih edhe* AT 92-93 (6.6.2007).

⁶¹³ Aktgjykimi, paragrafi 572.

⁶¹⁴ Aktgjykimi, paragrafi 572, në lidhje me Ramiz Qeriqin, T. 3579 (28.2.2005).

⁶¹⁵ *Po aty.*, T. 3579-3580 (28.2.2005), T. 3711 (3.3.2005).

⁶¹⁶ *Po aty.*, T. 3711 (3.3.2005).

⁶¹⁷ *Po aty.*, T. 3582 (28.2.2005), T. 3711-3712 (3.3.2005).

⁶¹⁸ Prova materiale P154 “Hartë.”

⁶¹⁹ Aktgjykimi, paragrafi 573, në lidhje me Ramiz Qeriqin, T. 3581 (28.2.2005). Dhoma Gjyqësore vendosi më përpara se: “Pas ofensivës së 25 dhe 26 korrikut 1998, u formuan brigada dhe batalone.” ŠAktgjykimi, paragrafi 64, në lidhje me Ramiz Qeriqin, T. 3692 (3.3.2005) dhe Bislim Zyrapin, T. 6824 (1.6.2005). Dhoma e Apelit vëren se këto përfundime duhet të konsiderohen në dritë të përfundimeve të Dhomës Gjyqësore që “Dhoma e konsideron Ramiz Qeriqin si dëshmitar me besueshmëri të pakët” (Aktgjykimi, paragrafi 29 *in fine*).

237. Dhoma e Apelit konkludon se kjo dëshmi lejon interpretimin e arsyeshëm se dëshmia e Ramiz Qeriqit lidhet me kohën pas periudhës së Aktakuzës.⁶²⁰ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur prej dëshmisë së Ramiz Qeriqit nuk nxorri përfundimin se gjatë periudhës së Aktakuzës Fatmir Limaj kishte pozitën e komandantit rajonal që përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut.

238. Më tej Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi si duhej dëshmitë tepër provuese se Fatmir Limaj ushtroi pushtet komandues mbi forcat e UÇK-së nga zonat fqinje kur këto forca dërgoheshin në zonën e tij të përgjegjësisë.⁶²¹ Prokuroria argumenton në veçanti se Shefqet Kabashi dëshmoi se gjatë periudhës së Aktakuzës, njësia e tij u dërgua për të ndihmuar njësinë e Fatmir Limajt nën komandën e Fatmir Limajt,⁶²² e cila shtrihej përtej Kleçkës dhe përfshinte fshatin Llapushnik.⁶²³ Dhoma Gjyqësore nuk e mori në konsideratë këtë dëshmi, me sa duket sepse Shefqet Kabashi dukej i pasigurtë për kufijtë e saktë të zonës së përgjithshme të përgjegjësisë së Fatmir Limajt.⁶²⁴ Prokuroria argumenton se kjo nuk ishte e habitshme për një ushtar të rangut të Shefqet Kabashit sepse njohuritë e tij për kufijtë e zonës së Fatmir Limajt ishin “të bazuara në çfarë kishte dëgjuar në transmetimet e televizionit dhe të radios dhe prej përshtypjeve të tija si anëtar i UÇK-së në një njësi fqinje.”⁶²⁵

239. Prokuroria pretendon se Shefqet Kabashi dëshmoi gjithashtu se u çua në një takim në shtabin e Fatmir Limajt në Kleçkë, ku morën pjesë Shukri Buja, Isak Musliu, udhëheqësi i njësisë Guri dhe komandantët e njësive të tjera. Gjatë takimit, Çeliku kërkoi që të pranishmit t’i raportonin mbi problemet që kishin në zonat e tyre të përgjegjësisë.⁶²⁶ Sipas Prokurorisë, kjo dëshmi mbështet, dhe mbështetet nga dëshmi të tjera për komandën e Fatmir Limajt në Llapushnik⁶²⁷ dhe si komandant rajonal.⁶²⁸

240. Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dëshminë e Shefqet Kabashit dhe përfundoi se ai “pohoi vetë se ishte i pasigurtë për kufijtë e zonës e cila, sipas tij, ishte nën komandën e Çelikut, dhe se dëshmia e tij në lidhje me këtë nuk ishte veçse mendimi i tij në atë kohë, bazuar në çfarë kishte dëgjuar në transmetimet e televizionit dhe të radios dhe prej përshtypjeve të tija si anëtar i UÇK-së në një njësi fqinje.”⁶²⁹

⁶²⁰ Aktgjykimi, paragrafi 573.

⁶²¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.145, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 566-500.

⁶²² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.146 and 2.148.

⁶²³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.148.

⁶²⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.147, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 593.

⁶²⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.147, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 593.

⁶²⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.149 dhe 2.164.

⁶²⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.148.

⁶²⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.149.

⁶²⁹ Aktgjykimi, paragrafi 593.

241. Mbi këtë bazë, Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmia e Shefqet Kabashit nuk tregon se Fatmir Limaj kishte pozitë komanduese dhe eprore e cila shtrihej gjeografikisht përtej komandës së njësisë së tij lokale në Kleçkë.⁶³⁰ Dhoma e Apelit përfundon se Prokuroria nuk tregon se ky konkluzion i Dhomës Gjyqësore ishte i gabuar.

242. Lidhur me argumentet e Prokurorisë në lidhje me takimin në shtabin e Fatmir Limajt në Kleçkë, Dhoma e Apelit përfundon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur nuk mori në konsideratë këtë dëshmi, duke qenë se ajo nuk mbështet pretendimin se Fatmir Limaj kishte pozitë komanduese që përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut.

243. Prokuroria pretendon gjithashtu se Dëshmitari L64 dëshmoi se Fatmir Limaj erdhi në Llapushnik për të mbajtur një fjalim, dhe u paraqit si përgjegjësi i zonës. Dëshmitari 64 dëshmoi më tej se Fatmir Limaj bëri të ditur se Çerçizi do të ishte përgjegjësi për pozicionet e luftimit në Llapushnik. Dëshmitari L64 dëshmoi gjithashtu se “Çerçizi i raportonte rregullisht Çelikut për gjendjen në Llapushnik.”⁶³¹

244. Dhoma Gjyqësore konkludoi se vetëm dëshmia e Dëshmitarit L64 mund të mbështeste pretendimin e Prokurorisë se, në periudhën në fjalë të Aktakuzës, Fatmir Limaj kishte pozitë komanduese që shtrihej edhe në kamp-burgun e Llapushnikut.⁶³² Mirëpo, Dhoma Gjyqësore përcaktoi se mund t’i kushtonte rëndësi dëshmisë së tij në lidhje me një çështje materiale vetëm nëse ishte konfirmuar në ndonjë material konkret nga provat e tjera të pranuar nga Dhoma Gjyqësore.⁶³³ Siç është përcaktuar më lart, Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë në mënyrë të logjikshme dëshmitë e Shukri Bujës, Ramiz Qeriqit, Ramadan Behlulit dhe të Shefqet Kabashit lidhur me pozitën e pretenduar komanduese të Fatmir Limajt mbi një zonë e cila përfshinte kamp-burgun. Rrjedhimisht, edhe po të merren në konsideratë bashkërisht, këto dëshmi nuk konfirmojnë dëshminë e Dëshmitarit L64 në lidhje me këtë pikë.

245. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore logjikisht refuzoi të nxirrte konkluzionin se dëshmitë e Shukri Bujës, Ramiz Qeriqit, Ramadan Behlulit, Shefqet Kabashit dhe të Dëshmitarit L64 konfirmuan rangun e pretenduar të Fatmir Limajt si komandant rajonal, zona e përgjegjësisë së të cilit përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut, gjatë periudhës së Aktakuzës, d.m.th. nga maji deri më 26 korrik 1998.

⁶³⁰ *Po aty.*

⁶³¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.156, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 569.

⁶³² Aktgjykimi, paragrafi 569.

⁶³³ *Shih* Aktgjykimin, paragrafët 28, 569 dhe 571.

(b) Dëshmia e Dëshmitarit L64, përfshirë ditarin e tij

246. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi edhe kur vlerësoi pjesë të veçanta të dëshmisë së Dëshmitarit L64 – në veçanti ditarin e tij – duke përdorur një standard palejueshmërisht të rreptë kur rishqyrtoi dëshminë e Prokurorisë në krahasim me dëshminë e Mbrojtjes.⁶³⁴ Prokuroria argumenton se, duke hedhur poshtë dëshminë e Dëshmitarit L64 lidhur me komandën e Fatmir Limajt, Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të paarsyeshme, konkludoi se ishte “bazuar kryesisht vetëm mbi informacion të dorës se dytë dhe të thashethemeve dhe se ai nuk kishte njohuri të besueshme të strukturës rajonale të UÇK-së.”⁶³⁵

247. Prokuroria argumenton në veçanti se Dhoma Gjyqësore anashkaloi faktin se dëshmia e Dëshmitarit L64 bazohej në njohuri të dorës së parë duke qenë se ai ishte anëtar i njësisë Çeliku 3 në Llapushnik.⁶³⁶ Rrjedhimisht ai dinte se “Çerçizi” komandonte njësinë Çeliku 3 dhe se Fatmir Limaj kishte autoritet për emërimin e “Çerçizit” si komandant njësie.⁶³⁷ Dëshmitari L64 pranoi gjithashtu se nuk dinte hollësi për strukturën e përgjithshme të UÇK-së *së gjerë* dhe të strukturës së UÇK-së *jashtë* grupit të njëjësive ku ai shërbeu dhe ndërveproi drejtpërsëdrejti. Prokuroria pretendon se ky pranim duhej të kishte shtuar dhe jo zvogëluar besueshmërinë e tij.⁶³⁸

248. Prokuroria parashtron edhe se Dhoma Gjyqësore nuk vlerësoi dëshminë e Dëshmitarit L64 lidhur me pjesëmarrjen e Fatmir Limajt në një ceremoni betimi në Llapushnik, megjithëse rrëfimi i tij u konfirmua nga Karpuzi. Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmia e Karpuzit në sallën e gjyqit ndryshoi nga intervista me Prokurorinë në korrik 2003 dhe gabimisht i konsideroi këto mospërputhje si zhvlerësuese të intervistës së tij të mëparshme me Prokurorinë.⁶³⁹

249. Dhoma Gjyqësore konkludoi se, kur vizatoi diagramën me një informacion të përafërt për organizimin e UÇK-së, Dëshmitari L64 nuk kishte njohuri të besueshme për strukturën rajonale të UÇK-së në kohën e Aktakuzës.⁶⁴⁰ Ky përfundim bazohej mbi dëshminë e Dëshmitarit L64 që ai “dinte disa emra” brenda UÇK-së dhe “nuk dinte për funksionet dhe gradat e tyre.” Ai tha gjithashtu se njohuritë e tij bazoheshin mbi “çfarë tha Luani apo dikush tjetër.”⁶⁴¹ Dhoma Gjyqësore konkludoi gjithashtu se besueshmëria e dëshmisë së Dëshmitarit L64 ishte e dyshimtë, duke marrë parasysh se rrëfimi i tij ndryshoi kur u pyet Prokurorisë dhe prej Mbrojtjes në gjyq mbi çështjen e

⁶³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.192 dhe 2.194.

⁶³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.192, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 570.

⁶³⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.193.

⁶³⁷ *Po aty.*

⁶³⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.193-2.194.

⁶³⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.195, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 592.

⁶⁴⁰ Aktgjykimi, paragrafi 570, i cili i referohet Dëshmitarit L64, T. 4707-4712 (23.3.2005).

çarmatosjes së Dëshmitarit L64 nga Çeliku.⁶⁴² Gjithashtu dëshmia e tij gojore ndryshoi prej deklaratave të tij të mëparshme në lidhje me sa herë Dëshmitari L64 e kishte parë Çelikun në Llapushnik.⁶⁴³

250. Duke marrë parasysh këta faktorë, Prokuroria nuk provon se prej dëshmisë së Dëshmitarit L64 Dhoma Gjyqësore nxorri një konkluzion që një gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund ta kishte nxjerrë. Për më tepër, Dhoma e Apelit kujton përfundimin e saj të mëparshëm që Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë në mënyrë të arsyeshme dëshmitë e Shukri Bujës, Ramadan Behlulit, dhe Ramiq Qeriqit lidhur me pozitën e pretenduar të Fatmir Limajt si komandant rajonal, përfshirë kamp-burgun e Llapushnikut. Si pasojë, diagrama e Dëshmitarit L64 nuk mund të konfirmohej nga ato të Shukri Bujës, Ramadan Behlulit dhe Ramiz Qeriqit, dhe Dhoma Gjyqësore pranoi dëshminë e Dëshmitarit L64 lidhur me një çështje materiale vetëm nëse kjo pjesë se dëshmisë së tij ishte “e konfirmuar në ndonjë element të caktuar material prej dëshmive të tjera, të pranuar nga Dhoma.”⁶⁴⁴

251. Gjithashtu, lidhur me ditarin e Dëshmitarit L64, Prokuroria argumenton se duket se Dhoma Gjyqësore e konsideroi me dyshime, pjesërisht sepse nuk përmbante rrëfimin e plotë të ngjarjeve të Llapushnikut nga maji deri në qershor 1998. Sipas Prokurorisë, ideja që një dokument i tillë mund të jepte një rrëfim të plotë është e paarsyeshme, në veçanti sepse shumë ngjarje të përmendura atje konfirmohen prej dëshmive të tjera.⁶⁴⁵

252. Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se ditari i Dëshmitarit L64 ishte një transkriptim i mëvonshëm i shënimeve të bëra gjatë luftës, megjithëse jo i shkruar në atë kohë.⁶⁴⁶ Më tej Dhoma Gjyqësore konstatoi se ai përfshinte një përmladhje të shkurtër të fëmijërisë dhe jetës së dëshmitarit, dhe më tej shënime më konkrete me data në maj dhe korrik 1998 si dhe gjatë vitit 1999.⁶⁴⁷ Mirëpo Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se ditari nuk përmendte ngjarje që mund të konsiderohen si të paharrueshme nga Dëshmitari L64, në veçanti fjalimin e pretenduar të Çelikut në fshatin Llapushnik rreth mesit të majit 1998, në të cilin ai bëri të ditur se ishte përgjegjës “për zonën.”⁶⁴⁸

⁶⁴¹ Aktgjykimi, shënimi 1897, i cili i referohet Dëshmitarit L64, T. 4707-4712 (23.3.2005).

⁶⁴² *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 569. Gjatë fazës së pyetjeve të Prokurorisë, Dëshmitari L64 dëshmoi se u thirr në Kleçkë për të dorëzuar armën pas një operacioni për të mbledhur armë, të ndërmar në Lladroc pa dijeninë e Çelikut, dhe se Çerçizi i tha për fletëthirrjen, por se ai refuzoi të shkonte në Kleçkë (Dëshmitari L64, T. 4400-4402, 16.3.2005); gjatë fazës së kundërpetjeve të Mbrojtjes, Dëshmitari L64 dëshmoi se ai u çarmatos nga Çeliku, por kjo u bë sepse u zbulua se ai kishte ndërmend të ikte prej Llapushnikut për të vrarë dikë (Dëshmitari L64, T. 4839-4840, 30.3.2005; T. 4842-4843, 30.3.2005, Seancë private; T. 4867-4869, 31.3.2005, Seancë private).

⁶⁴³ *Shih* Aktgjykimin, paragrafi 569, shënim 1887.

⁶⁴⁴ Aktgjykim, paragrafi 28

⁶⁴⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.198, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 28 dhe 571.

⁶⁴⁶ Aktgjykimi, paragrafi 571.

⁶⁴⁷ *Po aty.*

⁶⁴⁸ *Po aty.*

253. Dhoma e Apelit konkludon se bazuar në konstatimet e lartpërmendura të Dhomës Gjyqësore, Prokuroria nuk ka provuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të kishte përfunduar se ditari i Dëshmitarit L64 nuk ishte i besueshëm, veçanërisht duke marrë parasysh rezervat në përgjithësi që kishte Dhoma Gjyqësore lidhur me këtë dëshmitar.

(c) Dëshmia e Jan Kickert në lidhje me takimin e datës 30 korrik 1998

254. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur vlerësoi dëshmine e Jan Kickert lidhur me takimin me përfaqësuesit e Bashkësisë Evropiane më 30 korrik 1998,⁶⁴⁹ ku morën pjesë Jan Kickert i ambasadës austriake, David Slinn i ambasadës britanike në Beograd, Jakup Krasniqi, Ramë Buja dhe Fatmir Limaj.⁶⁵⁰

255. Prokuroria kujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se:

rëndësia e pranisë së Fatmir Limajt në takimin e tretë është çështje e diskutueshme. Prokuroria mbështetet në këtë fakt si provë e pozitës së tij të lartë në UÇK. Mirëpo, Dhoma thekson se ai nuk përdori numër hierarkik në takim. Fatmir Limaj e shpjegon praninë e tij me arsyetimin se në atë kohë ai ishte komandant i njësisë së vendit ku u mbajt takimi, d.m.th. në Kleçkë.⁶⁵¹

256. Prokuroria parashtron se pas takimit, Kickert hartoi një raport ku tha se kishte takuar “zëdhënësin e UÇK-së, Jakup Krasniqi, komandantin rajonal Çeliku dhe Ramë Bujën, ish-sekretar i LDK-së dhe tani anëtar i shtabit të UÇK-së.”⁶⁵² Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të paarsyeshme, hodhi poshtë këtë dëshmi të bazuar mbi pohimin e Fatmir Limajt se ai ishte vetëm komandanti i njësisë së Kleçkës për shkak se takimi u mbajt në Kleçkë dhe për shkak të deklaratës së Kickert se Fatmir Limaj nuk u përmend me numër (në ndryshim me të tjerët në hierarkinë e UÇK-së).⁶⁵³

257. Dhoma Gjyqësore konkludoi se më 30 korrik 1998 u mbajt një takim i tretë midis përfaqësuesve të misionëve të huaja të shteteve të Bashkësisë Evropiane dhe të UÇK-se në Kleçkë.⁶⁵⁴ Në këtë takim morën pjesë Jan Kickert i ambasadës austriake dhe David Slinn i ambasadës britanike në Beograd. UÇK-ja u përfaqësua nga Jakup Krasniqi (zëdhënësi i UÇK-së), Ramë Buja (përgjegjësi për organizimin e pushtetit civil në të ashtuquajturat territore të lira) dhe Fatmir Limaj.⁶⁵⁵ Lidhur me rëndësinë e pranisë së Fatmir Limajt në këtë takim. Dhoma Gjyqësore konstatoi se ai nuk përdori numër hierarkik (si anëtarë të tjerë të UÇK-së) dhe shpjegoi praninë e tij

⁶⁴⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.209, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 128.

⁶⁵⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.210. *Shih edhe* AT 97 (6.6.2007).

⁶⁵¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.211, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 130.

⁶⁵² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.213 (theksimi i shtuar).

⁶⁵³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.214, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 130.

⁶⁵⁴ Aktgjykimi, paragrafi 128, në lidhje me Jan Kickert, T. 677 (23.11.2004), T. 749-750 (23.11.2004); Jakup Krasniqi, T. 3406-3408 (14.2.2005).

⁶⁵⁵ *Po aty.*, në lidhje me Jan Kickert, T. 680 (23.11.2004), T. 749 (23.11.2004); Jakup Krasniqi, T. 3406-3408 (14.2.2005).

me arsyetimin se në atë kohë ai ishte komandant i një njësisë në vendin ku u mbajt takimi, d.m.th. Kleçkë.⁶⁵⁶

258. Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim dëshminë e Jan Kickert se në fund të qershorit 1998 ai “nuk kishte dijeni për strukturën e [UÇK-së]” dhe se misionet e huaja kishin vështirësi në identifikimin e bashkëbiseduesve të tyre në UÇK.⁶⁵⁷ Gjithashtu Dhoma Gjyqësore përmendi një pjesë të dëshmisë së Jakup Krasniqit ku ai tha se Fatmir Limaj mori pjesë sepse takimi u mbajt në zonën ku ishte dislokuar njësia e tij, pra në Kleçkë. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore logjikisht refuzoi të konsideronte se kjo dëshmi provonte që Fatmir Limaj kishte pozitën e komandës rajonale që përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut.

(d) Prova materiale P34

259. Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të paarsyeshme, refuzoi të pranonte përmbajtjen e Provës materiale P34 (një dokumentar pro UÇK -së në përkujtim të luftëtarit të rënë të UÇK-së, Sadik Shala) ku thuhej se Fatmir Limaj ushtroi komandë mbi njësinë Çeliku në Llapushnik në fillim të majit 1998.⁶⁵⁸ Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur mori në konsideratë natyrën *ex post facto* të dokumentarit dhe përdorimin e ndërkëmbyeshëm të shprehjeve “njësia Çeliku” dhe “Brigada 121.”⁶⁵⁹ Prokuroria argumenton se struktura e Brigadës 121 ekzistonte kohë më parë dhe thjesht *u formalizua* në gusht të vitit 1998.⁶⁶⁰ Kjo u bë e qartë nga fakti se Sadik Shala, i cili ishte subjekti i dokumentarit, vdiq më 19 korrik 1998.⁶⁶¹ Gjithashtu Prokuroria argumenton se në këtë dokumentar Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë se Lahi Brahimaj deklaroi se Sadik Shala kishte për detyrë furnizimin e *njësive* Çeliku në zonën e Pashtrikut. Ajo pretendon se kjo mbështet dëshminë se Fatmir Limaj ishte në komandën e më shumë se një njësie në Kleçkë.⁶⁶²

260. Dhoma Gjyqësore konstatoi se megjithëse nuk ka dyshim se periudha kohore në dokumentar ishte maj deri në korrik 1998, ushtarët e Fatmir Limajt përmenden herë pas here si ushtarë të “njësisë Çeliku” apo të “Brigadës 121.” Dhoma Gjyqësore konkludoi pa hasur kundërshtim se Brigada 121 nuk ishte formuar në kohën që ka lidhje me Aktakuzën,⁶⁶³ dhe pohoi se dëshmi të tjera

⁶⁵⁶ Aktgjykimi, paragrafi 130.

⁶⁵⁷ Aktgjykimi, paragrafi 131, në lidhje me Jan Kickert, T. 708 (23.11.2004),

⁶⁵⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.215-2.216 dhe 2.121, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 595.

⁶⁵⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.217, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 595.

⁶⁶⁰ *Shih edhe* AT 90, 96-97, 200-201 (6.6.2007).

⁶⁶¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.217.

⁶⁶² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.219-2.220.

⁶⁶³ Aktgjykimi, paragrafi 595.

e përshkruan strukturën komanduese të UÇK-së si “mister” dhe “më shumë si strukturë komanduese dhe bashkërenduese të shperndarë dhe horizontale.”⁶⁶⁴

261. Dhoma e Apelit është e bindur se si pasojë Dhoma Gjyqësore logjikisht gjykoj se përdorimi i shprehjes “Brigada 121” për periudhën midis majit dhe korrikut 1998 ngriti një dyshim të arsyeshëm se, para gushtit 1998, organizimi i Brigadës 121 nuk kshihte arritur në atë nivel që Fatmir Limaj të ishte në pozitën e komandës rajonale e cila përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut.

262. Lidhur me dëshminë e Lahi Brahimajt, Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria e keqinterpretoi atë. Dëshmitari deklaroi se “Sadik Shala furnizoi *njësinë* Çeliku në zonën operative të Pashtrikut,”⁶⁶⁵ pra vetëm një njësi Çeliku. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur refuzoi të nxirrte konkluzionin se kjo dëshmi mbështeti dëshmitë e tjera që pretendonin se Fatmir Limaj ishte në komandën e më shumë se një njësie në Kleçkë.

(e) Provat lidhur me fletëlirimet e të burgosurve

263. Prokuroria parashton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori në konsideratë dëshmitë e dhëna nga Vojko dhe Ivan Bakraç dhe nga Dëshmitarët L04, L06, L10 dhe L96 në lidhje me fletëlirimet me autorizimin e “Komandant Çelikut.”⁶⁶⁶ Prokuroria argumenton se kjo tregon që Fatmir Limaj ushtroi funksion komandues në kamp.⁶⁶⁷ Prokuroria pretendon në veçanti se Dëshmitari L96 konfirmoi dëshmitë se Fatmir Limaj luajti rol në vendimet e burgimit dhe të lirimimit.⁶⁶⁸

264. Fatmir Limaj përgjigjet konkretisht se Dëshmitari L96 nuk e identifikoi para procesit gjyqësor dhe se Dhoma Gjyqësore logjikisht konkludoi se identifikimi i tij i mëvonshëm prej këtij dëshmitari në televizion ishte i pabesueshëm.⁶⁶⁹ Më tej Fatmir Limaj përgjigjet se Dëshmitari L96 nuk përmendi as “Çelikon” as “Fatmir Limajn” në deklaratat e tij të para⁶⁷⁰ dhe deklaroi se nuk e pa Fatmir Limajn apo Komandant Çelikon gjatë kohës së burgimit.⁶⁷¹ Gjithashtu nuk ka dëshmi konfirmuese sepse Dëshmitari L96 është i vetmi dëshmitar okular i cili e pa Fatmir Limajn apo Komandant Çelikon në malet e Berishës.⁶⁷²

⁶⁶⁴ Aktgjykimi, paragrafi 131, në lidhje me Provën materiale P64 “Raporti i Ambasadës i përgatitur nga Dëshmitari Kickert, me datën 27 korrik 1998,” f. 1; Jan Kickert, T.708 (23.11.2005)..

⁶⁶⁵ Prova materiale P34.1 “Faqja e zbardhur e videos dokumentare,” f. 4 (theksimi i shtuar).

⁶⁶⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.222. Prokuroria pretendon se në shënimin 369, Dhoma Gjyqësore gaboi mëtej kur hodhi poshtë dëshminë për dokumentat e lirimimit sepse nuk ishin prova.

⁶⁶⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.222.

⁶⁶⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.75, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 551. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.29.

⁶⁶⁹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 65, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 538-540.

⁶⁷⁰ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 69, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 553.

⁶⁷¹ Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 66, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 557.

⁶⁷² Dosja e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 68, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 554. *Shih edhe* Dosjen e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 69, shënim 76, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 557. Limaj theksoi se, lidhur me pikat 9-10 të Aktakuzës dhe pretendimin për praninë e Fatmir

265. Dhoma Gjyqësore mori parasysh se në gusht 2001 Dëshmitari L10 nuk përmendi para një hetuesi të CCIU-së/Seksioni për Hetimin e Krimeve/ se ishte pajisur me fletëlibrim, pa folur se në dokument figuronte togfjalëshi “Komandant Çeliku.”⁶⁷³ Gjatë fazës së pyetjeve nga pala kundërshtare, ai deklaroi se kjo mospërmendja ishte një gabim i mundshëm i përkthyesit.⁶⁷⁴ Për sa i përket Dëshmitarit L06, Dhoma e Apelit vëren se ai dëshmoi se fletëlibrimi i tij përmbante vetëm emrin dhe mbiemrin e tij.⁶⁷⁵ Për më tepër, Vojko Bakraçi, në deklaratën e tij të 8 korrikut 1998 dhënë autoriteteve serbe dhe pranuar nga Dhoma Gjyqësore, thjesht pohoi se ai dhe i biri, Ivan Bakraç, u liruan “nga UÇK-ja.”⁶⁷⁶ Së fundi, lidhur me dëshminë e Dëshmitarit L04, Dhoma Gjyqësore përfundoi se mospërmendja e “Komandant Çelikut” apo të ndonjë komandanti tjetër nga ana e tij gjatë intervistës me hetuesit të CCIU-së në vitin 2002 “mbetet e pashpjeguar.”⁶⁷⁷ Dhoma Gjyqësore mori parasysh në veçanti se gjatë gjithë dëshmisë, ai theksoi se sa i paharrueshëm kishte qenë takimi i tij me komandant Çelikon sepse, si pasojë e këtij takimi, u urdhërua lirimi i tij.⁶⁷⁸ Dhoma e Apelit përfundon se dëshmia e lartpërmendur u vlerësua në mënyrë të duhur nga Dhoma Gjyqësore. Për më tepër, lidhur me dëshminë e Dëshmitarit L96 sipas së cilës Fatmir Limaj kishte luajtur në rol në vendimet e burgimit dhe të lirim, ⁶⁷⁹ Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të pakundërshtueshme,⁶⁸⁰ konkludoi se besueshmëria e tij ishte e dyshimtë lidhur me çështje materiale, dhe se ajo duhej vërtetuar në lidhje me ato çështje.⁶⁸¹ Duke marrë parasysh këto përfundime, dëshmia e Dëshmitarit L96 nuk konfirmohet në lidhje me këtë pikë. Rrjedhimisht Prokuroria nuk tregon se Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të paarsyeshme nuk konkludoi se, ose dëshmitë lidhur me fletëlibrimet vërtetuan se Fatmir Limaj kishte marrë pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut, ose se ai kishte një pozitë komanduese, përfshirë kamp-burgun, në zonën e përgjegjesisë së tij.⁶⁸²

(f) Dëshmia e Fatmir Limajt

266. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur vlerësoi dëshminë e Fatmir Limajt,⁶⁸³ duke pranuar se zona e përgjegjesisë së tij nuk përfshinte kamp-burgun e Llapushnikut.⁶⁸⁴

Limajt në malet e Berishës dhe përgjegjësinë për vrasjet e kryera aty, Prokuroria nuk argumentoi, nuk kundërshtoi apo ndryshe nuk u shpreh kundër ndonjë aspekt të dëshmisë së Limajt në lidhje me këtë gjatë fazës së kundërpvetjeve.

⁶⁷³ Aktgjykimi, paragrafi 539, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 2974-2980 (3.2.2005), T. 3002 (4.2.2005).

⁶⁷⁴ Dëshmitari L10, T. 2980 (3.2.2005).

⁶⁷⁵ Dëshmitari L06, T. 1030 (26.11.2004); *Shih edhe* Aktgjykimin, paragrafi 450.

⁶⁷⁶ Aktgjykimi, paragrafi 536, në lidhje me Proven materiale P202, f. 7. *Shih edhe* Dosjen e Përgjigjes së Limajt, shënim 61 i paragrafit 62.

⁶⁷⁷ Aktgjykimi, paragrafi 543.

⁶⁷⁸ *Po aty*.

⁶⁷⁹ Aktgjykimi, paragrafi 553.

⁶⁸⁰ *Shih* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 2.29. “Limaj përsërit përfundimin e Dhomës Gjyqësore për besueshmërinë e L96 që nuk kundërshtohet nga Prokuroria.” *Shih edhe* Dosjen e Përgjigjes së Limajt, paragrafët 67-69.

⁶⁸¹ Aktgjykimi, paragrafi 26.

⁶⁸² *Shih* më lartë, paragrafi 219.

⁶⁸³ Kjo dëshmi përfshin atë të dëshmitarëve të Mbrojtjes Rexhep Selimi, Bislim Zyrapi dhe Elmaz Sopi. Për dëshminë e këtyre dëshmitarëve, *shih* Dosjen e Përgjigjes së Limajt, paragrafi 106, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 598-599, *shih edhe* Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 2.43-2.63, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 591-592, 599. *Shih edhe* AT 98 (6.6.2007). Për përgjigjen e Limajt, *shih* AT 170 (6.6.2007).

267. Prokuroria pretendon në veçanti se Dhoma Gjyqësore pranoi se pozicionet e luftimit të Çelikut 3 ishin “në rrethinën e përgjithshme” të kamp-burgut të Llapushnikut.⁶⁸⁵ Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim gjithashtu dëshmitë që vërtetuan njëra-tjetrën për vendndodhjen e pozicioneve të luftimit në një hartë ajrore të shënuar nga Ruzhdi Karpuzi, Dëshmitari L64 dhe Fatmir Limaj.⁶⁸⁶ Lidhur me pozicionet e shënuara nga Fatmir Limaj, Dhoma Gjyqësore përfundoi se “kamp-burgu nuk është shënuar nën komandën e njësisë Çeliku 3.” Si pasojë, sipas Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore gabimisht interpretoi faktin se Fatmir Limaj preferoi të mos ndërlikonte veten duke mos shënuar vendndodhjen e kamp-burgut në fotografinë ajrore si veprim që mund të hidhte poshtë masën e madhe të dëshmive të Prokurorisë që tregojnë të kundërtën.⁶⁸⁷

268. Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk mori në konsideratë shprehimisht arsyen e mundshme të mosshënimit të vendndodhjes së kamp-burgut në fotografi prej Fatmir Limajt. Mirëpo kjo ishte e logjikshme me marrjen parasysh të dëshmive të dhëna nga Ruzhdi Karpuzi dhe Dëshmitari L64, të cilët, që të dy, nuk e përcaktuan vendndodhjen e pozicioneve të luftimit të njësisë Çeliku 3 brenda kampit apo shi jashtë tij, por në rrethinën e përgjithshme të kampit. Rrjedhimisht dëshmitë e tyre konfirmojnë dëshminë e Fatmir Limajt për këtë çështje, dhe Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në vlerësimin e kësaj dëshmie.

3. A kreu Dhoma Gjyqësore gabim ligjor ose faktual kur vlerësoi dëshminë lidhur me pretendimin mbi aftësinë e Fatmir Limajt për imponimin e disiplinës ndaj ushtarëve të UÇK-së në kamp

269. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gjithashtu keqzbatoi standardin e vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe gaboi kur vlerësoi në mënyrë të gabuar dëshmitë se Fatmir Limaj çarmatosi ushtarë dhe si pasojë gaboi kur konkludoi në mënyrë të paarsyeshme se nuk u vërtetua ushtrimi i pushtetit komandues prej tij.⁶⁸⁸

270. Prokuroria parashtron më tej se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk përfundoi se çarmatimi i një ushtari përbën një funksion thelbësor disiplinor të komandantit, siç e bëri të qartë Dëshmitari i Mbrojtjes Sylejman Selimi.⁶⁸⁹ Ajo argumenton se Dhoma Gjyqësore duket se nuk e mori këtë në

⁶⁸⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.223.

⁶⁸⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.224, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 692.

⁶⁸⁶ Po aty.

⁶⁸⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.225-2.226, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 692.

⁶⁸⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.131 dhe 2.206, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafët 569, 589-590. *Shih edhe* AT 97 (6.6.2007).

⁶⁸⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.207 në lidhje me Sylejman Selimin, T. 2084-2085 (17.1.2005). Ky dëshmitar ishte në fakt një dëshmitar i Prokurorisë: siç kujtoi Dhoma Gjyqësore, “Gjatë parashtrimit të argumenteve të saj, Prokuroria kërkoi që katër dëshmitarë të Prokurorisë, të gjithë

konsideratë kur i vlerësoi dëshmitë e Dëshmitarit L64 dhe të Fadil Kastratit, të cilët, që të dy, dëshmuan për faktin se Fatmir Limaj i çarmatosi si masë disiplinore.⁶⁹⁰ Fatmir Limaj kishte pushtet për zbatimin e masave disiplinore dhe e ushtroi pushtetin e tij, dhe nuk kishte rëndësi *arsyeja* e marrjes së masës disiplinore.⁶⁹¹ Për më tepër, Prokuroria argumenton se dëshmia jo e besueshme e Fatmir Limajt nuk duhej të ishte përdorur për të kundërshtuar dëshminë e besueshme të Fadil Kastratit se Fatmir Limaj e çarmatosi dhe tha se kjo ndodhi “sepse UÇK-ja kishte rregulla dhe disiplinë.”⁶⁹²

271. Prokuroria pretendon gjithashtu se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se dëshmia e Dëshmitarit L64 tregoi se aftësia e Fatmir Limajt për të disiplinuar ishte “e kufizuar dhe jo e pajtueshme me atë që pritet prej një komandanti.”⁶⁹³ Lidhur me çarmatimin e Kastratit, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ajo nuk mund të përcaktonte nëse veprimi i Fatmir Limajt “pasqyronte autoritet të vërtetë disiplinor apo thjesht ndikim personal [...], apo varej prej referimit të urdhrit të pretenduar nga lart.”⁶⁹⁴ Prokuroria argumenton se vetë Fatmir Limaj pranoi se ai e çarmatosi Kastratin, megjithëse e zvogëloi arsyen.⁶⁹⁵ Prokuroria argumenton se kjo dëshmi sugjeron se Fatmir Limaj kishte aftësinë materiale për të çarmatosur ushtarë të UÇK-së dhe këtë e bëri më shumë se një herë.⁶⁹⁶

272. Dhoma e Apelit bindet se Dhoma Gjyqësore konkludoi në mënyrë të arsyeshme se dëshmia e Dëshmitarit L64 ishte e pabesueshme për shkak të mospërputhjeve midis seancës kryesore të pyetjeve dhe seancës së kundërpvetjeve.⁶⁹⁷ Duke qenë se kjo ishte arsyeja kryesore për mospranimin e dëshmisë së Dëshmitarit L64, nuk ka rëndësi të shqyrtohet nëse Dhoma Gjyqësore interpretoi gjithashtu në mënyrë të arsyeshme nga dëshmia e tij nëse aftësia materiale e Fatmir Limajt për të disiplinuar vartësit ishte faktikisht e kufizuar dhe jo e pajtueshme me atë që pritet prej një komandanti.

273. Lidhur me Fadil Kastratin, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi dëshminë e tij për të vendosur nëse Fatmir Limaj ushtroi “autoritet të vërtetë disiplinor” apo thjesht ndikim personal mbi të.⁶⁹⁸ Dhoma e Apelit kujton se, sipas dispozitave të Nenit 7(3) të Statutit, kontrolli efektiv mbi vartësit përkthehet

ish-anëtarë të UÇK-së, të shpallehin dëshmitarë armiqësorë. Š...Ć Dhoma hodhi poshtë kërkesën lidhur me Sylejman Selimin Š...Ć” (Aktgjykimi, paragrafi 768, në lidhje me Vendimin Gojor të Dhomës Gjyqësore, 18 janar 2005. *Shih edhe* AT 97 (6.6.2007).

⁶⁹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.196.

⁶⁹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.133.

⁶⁹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.130, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 588. Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.135.

⁶⁹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.208, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 569.

⁶⁹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.208 dhe 2.212, e cila i referohet Aktgjykimit, paragrafi 590.

⁶⁹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.196.

⁶⁹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 2.208, e cila i referohet Aktgjykimit të Apelit *Bllashkiq*, paragrafi 69.

⁶⁹⁷ Aktgjykimi, paragrafi 569. Kjo duhet të merret parasysh në dritë të vendimit se Dhoma Gjyqësore kishte një përshtypje “tepër” negative të besueshmërisë së Dëshmitarit L64 (*shih* Aktgjykimin, paragrafi 28).

në aftësinë materiale për parandalimin e shkeljeve të vartësve dhe për ndëshkimin e vartësve keqbërës; ndikimi thelbëro i cili nuk përmbush kriterin e kontrollit efektiv nuk është i mjaftueshëm.⁶⁹⁹ Dhoma e Apelit është bindur se Prokuroria nuk provoi se asnjë gjykues i arsyeshëm i fakteve nuk do të kishte nxjerrë përfundimin nga dëshmia e Fadil Kastratit, se çarmatosja e tij pasqyroj thjesht ndikimin personal të Fatmir Limajt dhe jo autoritet të vërtetë disiplinor në kuptimin e kontrollit efektiv të kërkuar për të provuar përgjegjësinë penale sipas Nenit 7(3) të Statutit.⁷⁰⁰

274. Për arsyet e lartpërmendura, Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk keqzbatoi standardin e provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm dhe nuk ishte e paarsyeshme kur konkludoi, pas “një analize përfundimtare tepër të kujdesshme” se gjatë periudhës së Aktakuzës, Fatmir Limaj nuk kishte pozitën e komandantit në UÇK, e cila përfshinte komandën mbi ushtarët e UÇK-së në kamp-burgun e Llapushnikut.⁷⁰¹

4. Përfundime

275. Dhoma e Apelit bindet se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur zbatoi standardin e provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me tërësinë e provave. Duke marrë parasysh tërësinë e provave dhe përfundimet përkatëse të Dhomës Gjyqësore, Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore përfundoi në mënyrë të arsyeshme se Fatmir Limaj nuk mban përgjegjësi penale për akuzat në Aktakuzë, qoftë sipas Nenit 7(1) qoftë sipas Nenit 7(3) të Statutit. Rrjedhimisht, pjesa e mbetur e pikës së parë të apelit dhe pika e dytë të apelit të Prokurorisë hidhen poshtë.

C. Pika e tretë e apelit: ndërmarrja e përbashkët kriminale

276. Parashtrimet e Prokurorisë për pikën e tretë të apelit u trajtuan lart bashkë me pikën e parë të apelit të Prokurorisë në lidhje me Haradin Balën.⁷⁰² Dhoma e Apelit kujton përfundimet e saj se Dhoma Gjyqësore, në mënyrë të arsyeshme, konkludoi se Fatmir Limaj nuk kishte marrë pjesë personalisht në kamp-burgun e Llapushnikut dhe se nuk kishte pozitën e komandës mbi kampin apo mbi rojet të cilët punonin aty. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se pretendimet e Prokurorisë për pikën e tretë të apelit në lidhje me Fatmir Limajn, tashmë janë trajtuar.

⁶⁹⁸ Aktgjykimi, paragrafi 590.

⁶⁹⁹ *Shih* Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 266; *shih edhe Po aty.*, paragrafi 192.

⁷⁰⁰ Prokuroria as nuk pretendon, as nuk provon se Fadil Kastrati ishte ushtar i UÇK-së nga kamp-burgu i Llapushnikut; Dhoma Gjyqësore përfundoi se ai ishte në Blinajë kur u çarmatos nga Fatmir Limaj.

⁷⁰¹ Aktgjykimi, paragrafi 601.

⁷⁰² *Shih* më lart, paragrafët 90 dhe mëtej.

VI. APELI I PROKURORISË NË LIDHJE ME ISAK MUSLIUN

277. Prokuroria argumenton se shpallja e pafajësisë së Isak Musliut prej Dhomës Gjyqësore ishte pasojë e keqzbatimit të standardit të vërtetimit. Së pari Dhoma Gjyqësore adoptoi një qasje të gabuar fragmentare në lidhje me vlerësimin e provave dhe zbatoi standardin e vërtetimit të fakteve të veçanta për të cilët nuk ishte e nevojshme të vërtetoheshin “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”. Së dyti ajo zbatoi një standard shqyrtues që nuk ishte “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm” por jashtë çdo dyshimi, duke përfshirë gabime të pabazuara në prova, logjikë dhe gjykimin e shëndoshë. Prokuroria argumenton se këto gabime bënë që Dhoma Gjyqësore të nxirrte një numër të konsiderueshëm përfundimesh faktuale të cilat duke marrë parasysh tërësinë e provave ishin krejt të palogjikshme.⁷⁰³ Këto përfundime të Dhomës Gjyqësore janë të njëjta, *mutatis mutandis*, si ato të përmendura nga Prokuroria në apelin e saj kundër Fatmir Limajt.⁷⁰⁴

278. Isak Musliu përgjigjet nëpërmjet argumenteve pak a shumë të njëjta me Fatmir Limajn në përgjigjen e tij ndaj apelit të Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë së tij.⁷⁰⁵ Gjithashtu Isak Musliu argumenton se apeli i Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë së tij është “pervers”, se cënon ndershmërinë e procesit gjyqësor dhe të Tribunalit Ndërkombëtar, dhe se është shpërdorim i kompetencës prokuroriale.⁷⁰⁶

A. Pika e parë e apelit e apelit: Pretendim për pjesëmarrjen personale të Isak Musliut në kamp-burgun e Llapushnikut

279. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore keqzbatoi standardin e vërtetimit “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm” dhe bëri gabim ligjor kur konkludoi se Isak Musliu nuk mori pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut.⁷⁰⁷

1. A bëri Dhoma Gjyqësore gabim ligjor dhe/ose faktual nëpërmjet fragmentimit artificial të provave

280. Prokuroria argumenton se qasja fragmentare e Dhomës Gjyqësore ndaj vlerësimit të provave ishte larg analizës së duhur ligjore që vërteton se prova të caktuara rrethore të veçanta mund të jenë të pamjaftueshme për vërtetimin e një fakti, por kur merren në konsideratë në tërësi mund të

⁷⁰³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 1, 4. Shih edhe AT 87-89 (6.6.2007).

⁷⁰⁴ Shih më sipër paragrafi 147.

⁷⁰⁵ Shih më sipër paragrafi 148. Shih edhe Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 42; *po aty.*, paragrafi 13 që i referohet Aktgjykimit të Apelit *Tadiq*, paragrafi 64; *po aty.*, paragrafi 16, që i referohet Aktgjykimit të Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 434, Shih edhe AT 190-191 (6.6.2007).

⁷⁰⁶ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 5. Shih edhe AT 176-178 (6.6.2007). Dhoma e Apelit thekson se Dhoma e Apelit e TPNR-së në çështjen *Ndindabahizi* deklaroi se përdorimi i fjalës “pervers” është i përshtatshëm në disa sisteme ligjore (Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*)

jenë vendimtare.⁷⁰⁸ Prokuroria argumenton në veçanti se Dhoma Gjyqësore e përqëndroi vlerësimin e saj në lidhje me pjesëmarrjen e Isak Musliut në kamp-burg vetëm ndaj një pjese të kufizuar të provave, gjegjësisht identifikimet e drejtpërdrejta pamore. Si pasojë ajo nuk shqyrtoi në mënyrën e duhur provat se Isak Musliu ishte personi i njohur si Çerçizi⁷⁰⁹ dhe se dëshmitarët dëshmuan se panë një person të cilin e njihnin si Çerçizi në kamp-burg, shpesh duke rrahur njerëz. Gjithashu ajo nuk mori në konsideratë praninë thuajse të vazhdueshme të Isak Musliut në fshatin Llapushnik në atë kohë, afërsinë e tij të shpeshtë dhe herë pas here vizita në kamp dhe komandën prej tij të së vetmes forcës së armatosur që vepronte në atë zonë.⁷¹⁰

281. Veçanërisht, Prokuroria argumenton se qasja fragmentare e Dhomës Gjyqësore në vlerësimin e provave çoi në konkluzionin e gabuar se “i vetmi dëshmitar që pretendon ta ketë identifikuar Isak Musliun brenda kamp-burgut të Llapushnikut është L96”.⁷¹¹ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur nuk konkludoi se efekti i tërësishëm dhe përsëritës i dëshmive të Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12 vërtetoi praninë e Isak Musliut në kamp.⁷¹²

282. Isak Musliu përgjigjet se Dhoma Gjyqësore e parashtrroi drejt qasjen e vetë në lidhje me provat:

ajo ka përcaktuar në lidhje me çdo akuzë kundër secilit prej të Akuzuarve nëse është bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, *mbi bazën e tërësisë së provave*, se janë vërtetuar çdo element i atij krimi dhe format e përgjegjësisë së akuzuar në Aktakuzë.⁷¹³

283. Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore u kushtoi rëndësi të veçantë provave të identifikimit pamor dhe i shqyrtoi ato bashkë me të tëra provat e paraqitura në gjyq.⁷¹⁴ Ai pretendon se deklarata e Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore gaboi në adoptimin e qasjes fragmentare është e pabazuar dhe e kundërshtuar prej deklaratave të shumta të Dhomës Gjyqësore.⁷¹⁵

284. Shkurtimisht, Isak Musliu argumenton se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në zbatimin e standardit të vërtetimit dhe se vendimi i pafajësisë së tij ishte i vetmi vendim i qartë i mundshëm për një Dhoma Gjyqësore të arsyeshme.⁷¹⁶

⁷⁰⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 1.6(c), 3.1, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafët 672-688, 743.

⁷⁰⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 3, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore Bërdanin, paragraf 35. Prokuroria paraqiti argumente të mëtejshme që janë pak a shumë të njëjta *mutatis mutandis* si ato në çështjen Limaj. Shih edhe Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 1.4, 3.2, 2.2, 2.19, 2.21-2.23, 3.2 që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 10. Shih edhe AT 121-122 (6.6.2007).

⁷⁰⁹ Emrat “Çerçiz” dhe “Çerçizi” ose “Çerçiz(i)” përdoren në vend të njeri-tjetrit gjatë gjithë aktgjykimit.

⁷¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 3.4, Shih edhe AT 115-116 (6.6.2007)

⁷¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, para 3.8, që i referohet Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore, paragrafi 687

⁷¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.9, 3.6 (Dëshmitarët L04 dhe L10) dhe 3.7 (Dëshmitari L12).

⁷¹³ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 18, që citon Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 10 (theks i shtuar)

⁷¹⁴ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 20, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 20

⁷¹⁵ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafët 43-44.

⁷¹⁶ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 45. Shih edhe AT 178 - 182 (6.6.2007).

285. Dhoma e Apelit thekson se përveç provave të identifikimit pamor, Dhoma Gjyqësore mori parasysh dëshmitë e dëshmitarëve se në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, Isak Musliu njihej si “Çerçizi”,⁷¹⁷ se disa të burgosur dëgjuan emrin “Çerçizi” gjatë kohës kur u rrahën dhe se një person i quajtur “Çerçiz” ishte thujse vazhdimisht i pranishëm në kamp-burg afërsisht gjatë periudhës 28 qershor - 23 korrik 1998.⁷¹⁸ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk zbatoi standardin e vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm vetëm në lidhje me një pjesë të kufizuar të provave, gjegjësisht vetëm identifikimin e drejtpërdrejtë pamor të Isak Musliut në kamp. Përkundrazi, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi të tëra provat identifikuese të marra së bashku për nxjerrjen e përfundimit e saj se nuk ishte provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Isak Musliu mori pjesë personalisht në kamp-burgun e Llapushnikut.

2. A zbatoi Dhoma Gjyqësore standardin e “vërtetimit jashtë çdo dyshimi”

286. Prokuroria argumenton se në shumë raste gjatë përcaktimit nëse Isak Musliu u identifikua si pjesëmarrës në kamp-burg, standardi i vërtetimit zbatuar prej Dhomës Gjyqësore nuk ishte “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”, por jashtë *çdo* dyshimi, përfshirë dyshime të pabazuara në prova, logjike ose gjykim të shëndoshë.⁷¹⁹

287. Gjithashtu ose përndryshe, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim faktual së pari nëpërmjet mosshqyrtimit të duhur të provave qartësisht përkatëse; së dyti nëpërmjet mosmarrjes së duhur në konsideratë të ndikimit konfirmues të të gjitha provave se Isak Musliu mori pjesë personalisht në kamp; dhe së treti nëpërmjet vlerësimit të gabuar të provave.⁷²⁰ Argumentet e Prokurorisë në lidhje me gabimet e pretenduara ligjore⁷²¹ bëjnë pjesë në argumentet e saj në lidhje me gabimet e pretenduara faktuale.⁷²² Rrjedhimisht ato do të diskutohen së bashku më poshtë.

(a) Mosmarrje e duhur në konsideratë e faktit se Isak Musliu njihej si “Çerçizi”

288. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore adoptoi qëndrime kundërthënëse në lidhje me pikën nëse Isak Musliu ishte personi i njohur si Çerçizi. Megjithëse iu referua në mënyrë të përsëritur si “Isak Musliu, me pseudonimin Çerçizi” ndër të tjera në një kapitull të titulluar

⁷¹⁷ Aktgjykimii i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675

⁷¹⁸ Aktgjykimii i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675. Shih po aty, paragrafët 20, 683 dhe 688.

⁷¹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.2, 2.4, 3.2 dhe 3.10.

⁷²⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.15 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 672-688. AT 89 (6.6.2007)

⁷²¹ Në lidhje me pretendimin për gabim ligjor shih Dosjen e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.11 - 3.13. për pretendimin e gabimit faktual, po aty, paragrafët 3-15 - 3.16.

⁷²² Shih Dosjen e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.14. Shih edhe paragrafët 3.11 (3.59), 3.12 (3.54), dhe 3.13, 3.17-3.19.

“Përfundime”,⁷²³ Dhoma Gjyqësore kritikoi dëshminë e Dëshmitarit L04 se “nuk ofronte bazë të besueshme për konkluzionin se Çerçizi ishte Isak Musliu [...]”,⁷²⁴ pavarësisht identifikimit të Isak Musliut prej njërit nga të bashkëburgosurit e Dëshmitarit L04 i cili sipas dëshmisë së Dëshmitarit L04, dinte se emri i vërtetë i Çerçizit ishte Isak Musliu duke qenë se të dy ata ishin nga Reçaku.⁷²⁵ Gjithashtu Prokuroria argumenton se dëshmi të shumta vërtetuan pseudonimin e Isak Musliut jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁷²⁶

289. Isak Musliu përgjigjet se edhe sikur pseudonimi i tij të ishte Çerçizi, problemi në lidhje me Dëshmitarin L04 ishte nëse njeriu që ai mund të identifikonte ishte në fakt Isak Musliu. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore theksoi në Aktgjykimin e vetë paqartësinë në lidhje me përdorimin e pseudonimeve.⁷²⁷ Në lidhje me Dëshmitarët L10 dhe L12, Isak Musliu u referohet përfundimeve përkatëse të Dhomës Gjyqësore.⁷²⁸

290. Më tej Isak Musliu përgjigjet se fakti se ekzistonin prova që vërtetnin se ai njihej si Çerçizi nuk do të thotë se këto prova ishin në disponim të dëshmitarëve për t’i ndihmuar ata në përcaktimin se njeriu me maskë që ata pretendojnë se ishte Çerçizi, ishte në fakt ai.⁷²⁹ Në lidhje me argumentin e Prokurorisë se “nuk kishte prova se emri Çerçiz mund të ketë patur lidhje me dikë tjetër dhe jo Isak Musliun”, Isak Musliu argumenton se Prokuroria në gjyq nuk paraqiti prova se emri “Çerçizi” logjikisht mund t’i atribuohet vetëm atij.⁷³⁰

291. Në fillim, Dhoma e Apelit thekson se nuk ka kundërshti midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Isak Musliut se në periudhën përkatëse të përmendur në Aktakuzë Isak Musliu njihej edhe si Qeriqizi.⁷³¹ Gjithashtu Isak Musliu nuk kundërshtoi se ai ishte në Llapushnik⁷³² nga maj deri në korrik 1998, megjithëse pretendon se kaloi një farë kohe në Rahovec.⁷³³ Në lidhje me këtë Dhoma e Apelit do të shqyrtojë nëse Dhoma Gjyqësore gaboi kur hodhi poshtë dëshmitë e Ruzhdi Karpuzit dhe Dëshmitarëve L04, L10, L12, L64 dhe L96 ku ata identifikuan një person me pseudonimin Çerçiz në kamp-burg.

⁷²³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.12 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 712. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 3.12-3.13.

⁷²⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.12, 3.17 (në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675), 3.57.

⁷²⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.39 dhe 3.55 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675.

⁷²⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.17-3.19, 3.40, 3.55 në lidhje me Elmi Sopin, T.6754 (31.5.2005); Dragan Jashoviq, T.5207 (5.4.2005), Dëshmitari L64, T. 4358-4359 (13.3.2005), Ruzhdi Karpuzi, T.3075 (7.2.2005); pm P23 “Black Diray “Mldan GIPS 1984” me shënime me shkrim dore në shqip konfiskuar në banesën e Isak Musliut”, ff.2, 5. Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Mbrojtjes, paragraf 1062 (pm DM10, “Deklarata 92bis e Agim Kamerit”); T.5586 (11.4.2005). Shih edhe Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 3.14-3.15.

⁷²⁷ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 53 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 24. Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragraf 3.3. Shih edhe AT 183-184 (6.6.2007).

⁷²⁸ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragraf 24-25. Shih edhe AT 183-184 (6.6.2007).

⁷²⁹ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragraf 54. Shih edhe AT 184-187 dhe 191-192 (6.6.2007).

⁷³⁰ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragraf 55.

⁷³¹ AT 116-117 (6.6.2007), Mbrojtja e Prokurorisë) dhe 185 (6.6.2007), Mbrojtja e Musliut)

⁷³² Shih Dosjen Paragjyqësore të Musliut, paragraf 24.

⁷³³ Shih Dosjen e Përgjigjes së Musliut, paragraf 74.

(b) Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë së Karpuzit se kishte parë Isak Musliun në kamp

292. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore e shpërfilli dëshminë provuese të identifikimit pamor prej Karpuzit të Isak Musliut me pseudonimin Çerçizi në kamp-burg kur konkludoi se “L96 [ishte] i vetmi dëshmitar i cili dëshmoi se e kishte parë Isak Musliun në kamp-burgun e Llapushnikut pa maskë.”⁷³⁴ Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore nxorri konkluzion të gabuar “se nga oborri i Gzim Gashit Ruzhdi Karpuzi dëgjoi Isak Musliun me pseudonimin Çerçizi duke kënduar në odë përtej rrugicës në oborrin e kamp-burgut të Llapushnikut.”⁷³⁵ Prokuroria argumenton se Karpuzi dëshmoi se ai e pa personalisht Isak Musliun duke kënduar në pjesën e epërme të Ndërtesës A në kamp-burg më shumë se një herë.⁷³⁶

293. Isak Musliu përgjigjet se dëshmia e Karpuzit se Isak Musliu këndoi një herë në atë rrethinë nuk mbështet dëshminë e Dëshmitarit L96 se ai e pa Isak Musliun në kamp.⁷³⁷ Vetëm nëse Prokuroria mbështet seriozisht pretendimet se Isak Musliu këndoi kur po rrihte Dëshmitarin L96, gjë që nuk u dëshmuar prej Dëshmitarit L96, është e vështirë të kuptohet sesi mund të mbështeten akuzat shumë të rënda të Dëshmitarit L96 prej dëshmisë së Karpuzit.⁷³⁸ Fakti se Isak Muslim mund të ketë kënduar në kamp nuk do të thotë se ai mori pjesë në funksionimin e kampit personalisht.⁷³⁹

294. Dhoma e Apelit gjykon se shqyrtimi i dëshmisë së Ruzhdi Karpuzit tregon se ai deklaroi se në fakt ai e pa Isak Musliun duke kënduar në Ndërtesën A⁷⁴⁰ brenda territorit të kamp-burgut të Llapushnikut.⁷⁴¹ Mirëpo Dhoma e Apelit me përjashtim të mospajtit të Gjykatësit Schomburg gjykon se edhe sikur Isak Musliu të ketë kënduar në kamp burg në ndonjë rast, Prokuroria nuk vërteton se do të kishte qenë e palogjikshme që Dhoma Gjyqësore të mos kishte konkluduar se ai ishte përgjegjës për krimet e kryera në kamp. Për më tepër, Dhoma e Apelit thekson se Ruzhdi Karpuzi dëshmoi se ai nuk dinte gjë për ndonjë kamp-burg në Llapushnik.⁷⁴² Rrjedhimisht Dhoma e Apelit, me përjashtim të Gjykatësit Schomburg, nuk është bindur se Prokuroria ka provuar se

⁷³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.46, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 672, 679.

⁷³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.46, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 694 (theksi i shtuar)

⁷³⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.47 - 3.53. Shih edhe AT 118-120, 123-124 dhe 192-194 (6.6.2007).

⁷³⁷ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 60.

⁷³⁸ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 64

⁷³⁹ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafët 64, 68.

⁷⁴⁰ Numri i shënuar 2 në pm P6, f.1.

⁷⁴¹ Ruzhdi Karpuzi, T. 3089 (7.2.2005, theksi i shtuar). Shih edhe T. 3092-3096 (7.2.2005) dhe pm P6 “Broshurë e vendndodhjeve”, ff.1 (U003-2456) dhe 4 (U008-3669) [pm. P128 është pm. P6 me shënimet e Ruzhdi Karpuzit. Ndërtesa e shënuar me numrin 2 u identifikua prej Ruzhdi Karpuzit si “oda e ?” dhe përputhet me Ndërtesën A1]. Shih edhe Ruzhdi Karpuzi, T. 3247-3249 (9.2.2005).

⁷⁴² Ruzhdi Karpuzi, T. 3089 (7.2.2005): Ole, kur ai më tregoi këtë fotografi, më pyeti nëse e njihja këtë terren dhe unë thashë, Po. Pasi më bëri pyetje për një burg në Llapushnik, ai tha se burgu ishte këtu; dhe unë i thashë se nuk di asgjë për të ose them se unë kam qëndruar në këtë zonë. Kjo është shtëpia e Gëzimit, dhe atje është shënuar çdo gjë se çfarë është.”

përdorimi prej Dhomës Gjyqësore i fjalës “dëgjoj” në vend të “shikoj” ndikoi materialisht përfundimet e saj në lidhje me praninë e Isak Musliut në kamp-burg

(c) Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmive të Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12 se kishin parë Isak Musliun në kamp-burg

295. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore në mënyrë jo të logjikshme nuk përcaktoi një lidhje midis Isak Musliut dhe emrit “Çerçiz”⁷⁴³ dhe konkludoi se marrë së bashku dëshmitë e Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12 ishin të pamjaftueshme për identifikimin e Isak Musliut/ Çerçizit në kamp.⁷⁴⁴ Veçanërisht Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur nuk u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit L10 se Çerçizi e vendosi në fllanik dhe e keqtrajtoi, se Emin Eminin e nxorri Çerçizi nga fllaniku, dhe se Haradin Bala (me pseudonimin Shala) iu drejtua një personi që mbante gjithmonë maskë si Çerçiz.⁷⁴⁵ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore hodhi poshtë në mënyrë të paarsyeshme dëshminë e Dëshmitarit L12 se emri Çerçiz u përmend nga individët e mbajtur në ahurin e bagëtive.⁷⁴⁶

296. Isak Musliu përgjigjet se megjithëse Dëshmitarët L04, L10 dhe L12 e përmendën në ndonjë mënyrë apo tjetër, “një farë Çerçizi” asnjë prej tyre nuk e identifikoi Isak Musliun si personi i njohur si Çerçizi.⁷⁴⁷ Ai argumenton se Dhoma Gjyqësore vendosi të mos mbështetej në Dëshmitarin L04 i cili dëshmoi se nuk e kishte parë kurrë fytyrën e Çerçizit sepse personi të cilin ai e identifikoi se njihej si Çerçizi dhe për të cilin mësoi se ishte Isak Musliu, mbante gjithmonë maskë.⁷⁴⁸ Gjithashtu Dëshmitari L04 dëshmoi se ai mësoi prej një të bashkëburgosuri në kamp-burg i cili nuk u thirr si dëshmitar, se njeriu të cilin ai e njihte si Çerçizi, përdorte pseudonim dhe në fakt ishte Isak Musliu, kështu që Dhoma Gjyqësore nuk pati asnjë konfirmim të deklaratës së Dëshmitarit L04.⁷⁴⁹ Vetë Dëshmitari L04 mundi të japë vetëm një përshkrim mjaft të përgjithshëm të njeriut për të cilin iu tha se quhej Çerçiz,⁷⁵⁰ dhe ai nuk e përmendi Çerçizin në dy prej tri intervistave që u dha autoriteteve hetimore në lidhje me mbajtjen e tij në kamp-burg.⁷⁵¹

297. Prokuroria përgjigjet se Isak Musliu përzien dy pika të veçanta kur argumenton se provat për vërtetimin se ai njihej si Çerçizi nuk ishin në disponim të dëshmitarëve në atë kohë në kamp për ti ndihmuar të vërtetonin se njeriu i maskuar që ata pretendojnë se ishte Çerçizi, ishte në fakt ai

⁷⁴³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.19, 3.55.

⁷⁴⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.58.

⁷⁴⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.56, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677.

⁷⁴⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.57.

⁷⁴⁷ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 22.

⁷⁴⁸ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 23 (në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 674) dhe paragrafi 52.

⁷⁴⁹ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 23, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 674 - 675.

⁷⁵⁰ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 23, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675.

vetë: Së pari a ishte një person i quajtur “Çerçiz” në kamp-burg; dhe së dyti a ishte “Çerçizi”, Isak Musliu.⁷⁵² Sipas Prokurorisë, duket se Isak Musliu argumenton se Dhoma Gjyqësore do të duhej të përcaktonte se çdo dëshmitar dha dëshmi për të dyja pikat për të provuar se Isak Musliu ishte në kamp-burg, gjë që nuk kërkohet prej jurisprudencës së Tribunalit Ndërkombëtar.⁷⁵³

298. Dhoma e Apelit thekson se në lidhje me Dëshmitarin L10, Dhoma Gjyqësore konkludoi se megjithëse ai deklaroi se e identifikoi Çerçizin në kamp-burg si “keqbërësi me maskë” sepse “[Shala] iu drejtua atij si Çerçizi”⁷⁵⁴ dhe “më vonë ai mësoi se Çerçizi ishte Isak Musliu”⁷⁵⁵, Dëshmitari L10 “pranoi se ai nuk mund ta dallonte Çerçizin prej ushtarëve të tjerë në kamp për shkak të maskës që mbante.”⁷⁵⁶ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se Dëshmitari L10 nuk dha “dëshmi në bazë të së cilës Dhoma mund të konkludojë besueshmërisht se personi në kamp-burg për të cilin L10 thotë se e njohte si Çerçizi, është në fakt Isak Musliu.”⁷⁵⁷ Ky konkluzion ishte deduksion i logjikshëm bazuar në provat. Megjithëse përgjithësisht Dëshmitari L10 u gjykua i besueshëm,⁷⁵⁸ Dhoma e Apelit nuk është bindur se i vetmi përfundim i logjikshëm që mund të nxirret prej dëshmisë së tij është se “keqbërësi i maskuar” i cili vinte në flanak ishte Çerçizi. Sido që të jetë një përfundim i tillë nuk do të ndikonte mbi përgjegjësinë penale të Isak Musliut. Haradin Bala (me pseudonimin Shala) që sipas deklaratës iu drejtua “keqbërësit të maskuar” si Çerçizi, nuk dëshmoi në gjyq. Veç referencës së tij në lidhje me Shalën, Dëshmitari L10 dha një përshkrim fizik mjaft të mjegullt të “keqbërësit të maskuar”, kur dëshmoi se personi për të cilin ai mendoi se ishte Çerçizi, ishte “i bëshëm, jo shumë i gjatë, mbante uniformë kamuflimi (jo të zezë siç e përshkori L04) dhe mbante automatik”. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore deklaroi se ai nuk “shpjegoi si dhe prej kujt e mësoi emrin e vërtetë ose të plotë të Çerçizit”,⁷⁵⁹ veç faktit se “në mënyrë më të papërcaktuar L10 thotë se një herë Emin Emiri i tha se “ky person është nga Reçaku””.⁷⁶⁰ Për më tepër bazuar në përfundimet e veta në lidhje me paqartësinë e pseudonimeve⁷⁶¹ dhe së paku në mungesë të provave konkrete se sa i zakonit ose i pazakontit ishte pseudonimi “Çerçiz”, Dhoma Gjyqësore nuk ishte e detyruar të konkludonte jashtë çdo dyshimi rre arsyeshëm se çdokush që përmendej si “Çerçizi” në fakt ishte Isak Musliu. Për pasojë, Dhoma e Apelit me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Schomburg, gjykon se këto prova nuk garantojnë se i vetmi deduksion i logjikshëm ishte se Çerçizi/Isak Musliu ishte “keqbërësi i maskuar” i përmendur prej Dëshmitarit L10.

⁷⁵¹ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 23, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 676.

⁷⁵² Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 3.7 - 3.8.

⁷⁵³ Dosja e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafi 3.8, në lidhje me Vendimin *Kunarac* për Mocionin e Shpalljes së Pafajësisë, 3 korrik 2000, paragrafi 4.

⁷⁵⁴ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 2950-2951 (3.2.2005), T.3048 (4.3.2005).

⁷⁵⁵ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 2951 (3.2.2005).

⁷⁵⁶ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 2950 (3.2.2005).

⁷⁵⁷ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677.

⁷⁵⁸ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 35.

⁷⁵⁹ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677.

⁷⁶⁰ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 677, në lidhje me Dëshmitarin L10, T. 3048 (4.3.2005).

299. Në lidhje me Dëshmitarin L04, Dhoma Gjyqësore konkludoi se dëshmia e tij nuk ofroi “arsye të besueshme për përfundimin se Çerçizi ishte Isak Musliu”.⁷⁶² Dhoma e Apelit thekson se Dëshmitari L04 asnjëherë nuk dëshmoi se e kishte parë fytyrën e Isak Musliut.⁷⁶³ Për më tepër, Dhoma Gjyqësore e gjykoi si thashethem dëshminë e Dëshmitarit L04 në lidhje me bisedën e tij me një të burgosur tjetër gjatë së cilës I burgosuri tjetër identifikoi personin që e nxorri jashtë me pseudonimin Çerçizi dhe në fakt Isak Musliu. Dhoma e Apelit thekson se i burgosuri tjetër nuk u thirr për të dëshmuar dhe se Dhoma Gjyqësore nuk pati mundësi të shqyrtonte arsyet mbi bazën e të cilave thuhet se i burgosuri e identifikoi Musliun në kamp.⁷⁶⁴ Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludoi logjikisht se dëshmia e Dëshmitarit L04 nuk ofroi “bazë të besueshme për përfundimin se Çerçizi ishte Isak Musliu ose se Isak Musliu shërbeu në kamp-burgun e Llapushnikut.”⁷⁶⁵

300. Në lidhje me dëshminë e Dëshmitarit L12, Dhoma Gjyqësore konkludoi se

në ndryshim nga dëshmitarët L04 dhe L10 të cilët dëshmuar se e kishin parë Çerçizin në kamp-burg, L12 dëshmoi vetëm se ai kishte dëgjuar pseudonimin Çerçiz kur ishte i burgosur atje. Prej dëshmisë së tij duket se një herë Çerçizi u përmend nga një prej individëve të cilët e rrahën atë gjatë burgimit të tij në kamp-burgun e Llapushnikut.⁷⁶⁶

Dhoma e Apelit thekson se Dëshmitari L12 dëshmoi se ai u sulmua një herë në kamp-burg prej dy grave dhe dy burrave, dhe se njëra prej grave ia drejtua një personi si “Çerçizi” dhe “vëlla” kurse ai personiu drejtua asaj si “motër”. Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se dëshmia dhënë prej Dëshmitarit 12 ishte pjesërisht jopërrputhëse, veçanërisht në lidhje me identitetin e personit që e rrahu atë.⁷⁶⁷ Dhoma e Apelit gjithashtu thekson se Dëshmitari L12 në një moment thotë si “Rahman Çerçizi” në vend të “Çerçizi”⁷⁶⁸, gjë që e shton pështjellimin për faktin se emri “Rahman” nuk përmendet diku tjetër bashkë me emrin “Çerçizi” ose me Isak Musliun. Gjithashtu ashtu siç konkludoi Dhoma Gjyqësore, Dëshmitari L12 nuk dëshmoi se ai e pa vetë personin që thirrej Çerçiz. Dhoma e Apelit konkludon se deduksioni i nxjerrë nga dëshmia e Dëshmitarit L12 se “Çerçizi” ishte i pranishëm kur u rrah Dëshmitari L12 në këtë incident, nuk është i vetmi konkluzion logjik. Për pasojë, Dhoma Gjyqësore logjikisht nuk nxorri konkluzionin se Çerçizi mori pjesë në rrahjen e Dëshmitarit 12.

⁷⁶¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 24.

⁷⁶² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675.

⁷⁶³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 674.

⁷⁶⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 674 (në lidhje me Dëshmitarin L04, T. 1173-1174 (30.11.2005), 675.

⁷⁶⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 675.

⁷⁶⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 678 në lidhje me Dëshmitarin L12, T. 1808-1811 (13.12.2004).

⁷⁶⁷ Dëshmitari L12 fillimisht tha se Shala e rrahu, pastaj deklaroi se Shala nuk e rrahu dhe atë e rrahën katër persona dhe më tej ai tha se vetëm dy gratë e rrahën atë, jo burrat, T.1808 - 1810 (13.12.2004).

⁷⁶⁸ Dëshmitari L12, T.1808 (13.12.2004).

301. Përmbledhtasi, pasi janë shqyrtuar përfundimet e lartcituara të Dhomës Gjyqësore në lidhje me dëshmitë e Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12, përse i përket Dëshmitarit L10 Dhoma e Apelit me përjashtim të Gjykatësit Schomburg nuk është bindur se i vetmi deduksion logjik që mund të nxirret nga provat është se këta Dëshmitarë identifikuan Isak Musliun në kamp-burg.

(d) Pretendim për vlerësim të gabuar të dëshmisë së Dëshmitarit L64 se Isak Muslim mund të hynte dhe hyri në kamp-burg

302. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore konkludoi jologjikisht se “megjithëse Dëshmitari L64 mban mend se e ka parë atë [Çerçizin] të hyjë dy ose tri herë, ai nuk e pa asnjëherë në kamp-burg”, për faktin se është e vështirë të kuptohet ku saktësisht mendoi Dhoma Gjyqësore se Isak Musliu mund të ketë qenë gjatë hyrjes dhe daljes nga kampi, nëqoftëse “jo” në kamp.⁷⁶⁹ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk e shqyrtoi çështjen në tërësi kur konkludoi se “nuk kishte asnjë provë tjetër që konfirmon ose refuzon këtë aspekt të dëshmisë së L64”⁷⁷⁰.

303. Gjithsesi Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore nuk “mund të pranonte besueshmërinë dhe saktësinë e dëshmisë së L64-ës nëqoftëse dëshmia nuk konfirmohet *pavarësisht* në disa të dhëna materiale.”⁷⁷¹ Dhoma e Apelit më lart ka konkluduar se Dhoma Gjyqësore i hodhi poshtë logjikisht dëshmitë e Ruzhdi Karpuzit dhe dëshmitarëve L10, L04 dhe L12 në lidhje me praninë e Isak Musliut brenda kamp-burgut. Bazuar në këto përfundime, Dhoma e Apelit është bindur se dëshmia e Dëshmitarit L64 në lidhje me praninë e Isak Musliut në kamp është e pakonfirmuar prej dëshmive të tjera që janë të pranueshme, në disa pika materiale.

(e) Pretendim për vlerësim të gabuar të identifikimit të Isak Musliut prej Dëshmitarit L96 në kamp

304. Prokuroria parashtron se Dhoma Gjyqësore gaboi kur përshkroi dëshminë e Dëshmitarit L96 se ai e pa Isak Musliun pa maskë në kamp dy herë si “të pambështetur” dhe konkludoi se “nuk ekziston asnjë konfirmim për takimet e L96-ës me Isak Musliun dhe të rrahjes së tij të pretenduar në kamp-burg prej të burgosurve të tjerë që mbaheshin në fllanik”.⁷⁷²

⁷⁶⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.59, në lidhje me Dëshmitarin L64, T.4464-4465 (16.3.2005) dhe Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 686-687.

⁷⁷⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.60, 3.29-3.38. Shih edhe AT 202-204 (6.6.2007).

⁷⁷¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 687 (theksi i shtuar). Shih po aty., paragrafi 28.

⁷⁷² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.41 (pa përfshirë theksimin), në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 681-682. Shih edhe AT 119 dhe 202-204 (6.6.2007).

305. Prokuroria argumenton se Dëshmitari L96 nuk u mbajt në fllanik kur ai pa personin e identifikuar si Isak Musliu, por u dërgua në katin e epërm të Ndërtesës A.⁷⁷³ Kjo dëshmi u mbështet nga Karpuzi i cili tha se e pa Isak Musliun duke kënduar më shumë se një herë në një dhomë të katit të epërm në Ndërtesën A,⁷⁷⁴ si dhe prej provave të tjera rrethore.⁷⁷⁵ Për pasojë, Dhoma Gjyqësore kërkoi jologjikisht konfirmimin e dëshmisë së Dëshmitarit L96 prej një personi tjetër të mbajtur në fllanik. Sa i përket konfirmimit të mundshëm prej të burgosurve të mbajtur me Dëshmitarin L96 kur Isak Musliu hyri në Ndërtesën A1, Prokuroria parashtron se Shaban Hoti u vra,⁷⁷⁶ Bajrush Rexhaj dhe Sahit Beqaj hynë në UÇK,⁷⁷⁷ dhe Alush Luma dhe një person i paidentifikuar nga Varigofci nuk dëshmuuan.⁷⁷⁸ Prokuroria argumenton se si rezultat nuk është e befashme që dëshmitarët e mbajtur në ndërtesën A1, nuk mundën të konfirmonin takimet e Dëshmitarit L96 me Isak Musliun.⁷⁷⁹

306. Prokuroria sugjeron se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të paarsyeshme hodhi poshtë dëshminë e Dëshmitarit L96 se ai e njohte Isak Musliun nga fëmijëria kur ata jetonin në fshatrat fqinje dhe se për këtë arsye e njohu në kamp, kur konkludoi se nuk kishte asnjë provë të takimeve konkrete të drejtpërdrejta. ose një përshkrim konkret të “lidhjes” së tyre.⁷⁸⁰

307. Musliu përgjigjet se Dhoma Gjyqësore në mënyrë të arsyeshme gjykoi se takimet e Dëshmitarit L96 me atë nuk u konfirmuan, se ai mund të kenë qenë në Rahovec në atë kohë, dhe se Dëshmitari L96 nuk e kishte përmendur praninë e Isak Musliut në kamp kur u intervistua prej autoriteteve serbe dhe hetuesve të CCIU-së në gusht 1998.⁷⁸¹

308. Në lidhje me dëshminë e dhënë nga Dëshmitari L96, Dhoma Gjyqësore konkludoi se

nuk mund të bindej në masën e nevojshme se mund të pranojë dëshminë e [...] L96-ës [...] se Isak Musliu ishte në kamp-burg në Llapushnik në rrethanat përkatëse.⁷⁸²

dhe se

nuk ekziston asnjë konfirmim i takimeve të L96-ës me Isak Musliu dhe të rrahjes së tij të pretenduar në kamp-burg prej të burgosurve të tjerë të mbajtur në fllanik[.]

dhe për pasojë konkludoi se dëshmia e tij ishte “e pambështetur”.⁷⁸³

⁷⁷³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.42 në lidhje me Dëshmitarin L96, T.2301-2302, 2306, 2316 (24.1.2005)

⁷⁷⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.42, 3.46-3.53.

⁷⁷⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.42, 3.29-3.38.

⁷⁷⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.43 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragraf 474.

⁷⁷⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.43.

⁷⁷⁸ Po aty.

⁷⁷⁹ Po aty.

⁷⁸⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.44 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragraf 682.

⁷⁸¹ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafët 29-31. Gjithsesi në lidhje me argumentin e fundit shih, Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 684.

⁷⁸² Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 687.

⁷⁸³ Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 682.

309. Dhoma e Apelit nuk gjen asnjë gabim në këto përfundime të Dhomës Gjyqësore. Konkretisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur kërkoi konfirmimin e dëshmisë së Dëshmitarit L96 se ai pa Isak Musliun në kamp burg sepse Dhoma Gjyqësore konkludoi se

nuk mund të pranojë besueshmërinë dhe saktësinë e dëshmimeve të Dëshmitarëve L96 ose L64 nëqoftëse dëshmitë nuk konfirmohen pavarësisht në disa pika materiale.⁷⁸⁴

Megjithëse Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore konkludoi gabimisht se Dëshmitari L96 dëshmoi se hera e pare kur e pa Isak Musliun në kamp, ishte në fllanik- shqyrtimi i dëshmisë së Dëshmitarit L96 tregon se ai deklaroi se e pa Isak Musliun në ditën e parë të burgimit të tij në një dhomë të katit të epërm të Ndërtesës A1,⁷⁸⁵ përfundimet e mësipërme në lidhje me dëshmitë e Ruzhdi Karpuzit dhe Dëshmitarëve L04, L10 dhe L12 tregojnë se dëshmia e Dëshmitarit L96 se ai e pa Isak Musliun në kamp, nuk është e konfirmuar.

310. Rrjedhimisht, Dhoma e Apelit nuk është bindur se i vetmi deduksion që mund të nxirret nga provat se dëshmia e Dëshmitarit L96 se kishte parë Isak Musliun pa maskë dy herë në kamp u mbështet nga dëshmi të tjera, nuk është i vetmi deduksion logjik.

(f) Pretendim për mosmarrjen në konsideratë të pranisë së Isak Musliut në fshatin Llapushnik, në kamp-burg dhe rrethinë

311. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gjithashtu në mënyrë jologjike nuk mori parasysh provat për praninë thuajse të vazhdueshme të Isak Musliut në kamp-burgun e Llapushnikut, afërsinë e tij të shpeshtë prej kampit, dhe herë pas herë praninë e tij në kamp kur ajo konkludoi për pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen personale të Isak Musliut në kamp-burg.⁷⁸⁶ Veçanërisht, Prokuroria i referohet Dosjes Paragjyqësore të Isak Musliut në të cilën ai “pranoi se Isak Musliu e kishte bazën në Llapushnik prej majit deri në korrik 1998, por jo vazhdimisht”, dhe në një poshtëshënim ku pohohet se Isak Musliu “herë pas here kthehej në shtëpi për të parë familjen e tij dhe mori pjesë në operacione jashtë Llapushnikut.”⁷⁸⁷

312. Isak Musliu përgjigjet se prania në afërsi të kampit logjikisht nuk mund të çonte në konkluzionin e pjesëmarrjes së tij në të,⁷⁸⁸ duke iu referuar Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë:

⁷⁸⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 687. Shih po aty, paragrafi 26.

⁷⁸⁵ PM, P6 “Broshurë e Vendndodhjeve”, f.4, Dëshmitari L96, T.2294-2308, në veçanti T.2306 (24.1.2005).

⁷⁸⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.24, 3.26-3.28, 3-85-3.88. Shih edhe AT 116(6.6.2007)

⁷⁸⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.25, 3.26, 3.71-3.72 dhe 3.74. Shih edhe Dosjen e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, paragrafët 3.35-3.37.

⁷⁸⁸ Dosja e Përgjigjes së Musliut, paragrafi 66.

Largësia e kampit nga rruga kryesore dhe vendndodhja e tij në një oborr të rrethuar (dhe vazhdimisht të ruajtur) bëri të mundur që kampi të mos binte në sy edhe prej ushtarëve të UÇK-së në fshat dhe në vijën e afërme të frontit.⁷⁸⁹

313. Dhoma e Apelit rikujton përfundimet e veta të mëparshme se deduksioni i nxjerrë prej dëshmive të Ruzhdi Karpuzit dhe Dëshmitarëve L04, L10, L12, L64 dhe L96 se Isak Musliu ishte i pranishëm brenda kampit gjatë periudhës së Aktakuzës, nuk ishte i vetmi deduksion logjik. Bazuar në këto përfundime Dhoma e Apelit është bindur se për një gjykues të arsyeshëm faktesh ishte e logjikshme të konkludonte se thjesht afërsia ndaj pozicioneve të luftimit të njësisë Çeliku 3 nuk mbështeste përfundimin se Isak Musliu ishte i pranishëm dhe mori pjesë personalisht në funksionimin e kamp-burgut.⁷⁹⁰

3. Përfundim

314. Përmbledhtasi, Dhoma e Apelit me përjashtim të Gjykatësit Schomburg, është e bindur se pavarësisht disa gabimeve të vogla në arsyetimin e Dhomës Gjyqësore të cilat nuk kanë ndikim në vendim, Dhoma Gjyqësore vlerësoi në mënyrë të arsyeshme tërësinë e dëshmive dhe konkludoi se Isak Musliu nuk ishte i pranishëm brenda kamp-burgut dhe nuk mori pjesë në operacion.

315. Rrjedhimisht pika e parë e apelit të Prokurorisë hidhet poshtë

B. Pika e dytë e apelit: Pretendimi për komandën dhe kontrollin e Musliut ndaj ushtarëve të UÇK-së në kamp-burg

316. Më tej Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabim kur nuk konkludoi se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut, se anëtarët e kësaj njësie kryen detyra atje, dhe se Isak Musliu kishte pozitë të kontrollit efektiv ndaj ushtarëve të cilët morën pjesë në krimet në kamp-burg, ndër të cilët Haradin Bala dhe ushtarë të tjerë të Çelikut 3.⁷⁹¹ Sipas Prokurorisë, ky gabim bie ndesh me disa përfundime të Dhomës Gjyqësore, gjegjësisht se kamp-burgu administrohej dhe funksiononte prej ushtarëve të UÇK-së,⁷⁹² se ndodhej në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë dhe se pak a shumë, e vetmja njësi e UÇK-së në jug të asaj rruge ishte Çeliku 3.⁷⁹³ Prokuroria argumenton se meqenëse Dhoma Gjyqësore konkludoi se Isak Musliu ushtroi komandë dhe kontroll mbi njësinë Çeliku 3, do të kishte konkluduar edhe se ai ushtroi

⁷⁸⁹ Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, paragrafi 39.

⁷⁹⁰ Për të njëjtën arsye, Dhoma e Apelit nuk do të trajtojë argumentin e Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore nuk mori si duhet në konsideratë provat se Musliu ishte "komandant i drejtpërdrejtë i forcave të UÇK-së në Llapushnik, përfshirë edhe ato të kamp-burgut" gjatë shqyrtimit të çështjes nëse Musliu ishte i pranishëm në kamp. Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.29-3.30, 3.39, 3.76-3.142.

⁷⁹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.78 dhe 3.144(6). Shih po aty, paragrafi 3.76.

⁷⁹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.76 dhe 3.86 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 174, 273, 279, 282.

⁷⁹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.76 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 702, 713.

komandë dhe kontroll ndaj ushtarëve të UÇK-së në kamp, nëqoftëse nuk do të kishte gabuar në mosnxjerrjen e konkluzionit se Çeliku3 3 administronte kamp-burgun.⁷⁹⁴ Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se Isak Musliu ishte komandant i përgjithshëm i njësisë Çeliku 3, por konkludoi se ai ishte veç në “pozitë drejtuese” në atë njësi.⁷⁹⁵

1. Pretendime për gabime ligjore dhe faktuale

317. Ngjashmërisht me pikën e parë të apelit, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur zbatoi standardin e “vërtetimit jashtë çdo dyshimi”,⁷⁹⁶ dhe në adoptimin e një qasjeje të gabuar fragmentare ndaj provave⁷⁹⁷ dhe si rezultat u nxorrën përfundime të gabuara në lidhje me pozitën komanduese dhe kontrolluese të Isak Musliut.⁷⁹⁸

318. Dhoma e Apelit konstaton se në lidhje me të njëjtat përfundime, Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri gabime ligjore dhe faktuale.⁷⁹⁹ Rrjedhimisht Dhoma e Apelit do t’i shqyrtojë të dy llojet e gabimeve bashkërisht gjatë shqyrtimit të parashtrimeve të Prokurorisë. Së pari do të shqyrtojë pretendimet për gabime në vlerësimin e njësisë Çeliku 3 dhe anëtarët e saj në lidhje me kamp-burgun, dhe së dyti pretendimet për gabime në vlerësimin e kontekstit të saktë të pozitës komanduese të Musliut.

(a) A administrohej kamp-burgu i Llapushnikut nga njësi Çeliku 3

(i) Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e UÇK-së në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë

319. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore efektivisht konkludoi se Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e UÇK-së e stacionuar rregullisht në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë gjatë periudhës së Aktakuzës.⁸⁰⁰ Sipas tyre ky konkluzion rezulton prej dy përfundimeve të Dhomës Gjyqësore, konkretisht

se me përjashtim të një njësie Pëllumbi që ndodhej në largësi në jug të vendndodhjes së kamp-burgut të Llapushnikut për një periudhë në korrik 1998 dhe pozicioneve të Çelikut 3 që ndodheshin në rrethinën e përgjithshme të kamp-burgut të Llapushnikut, të gjitha njësitë e tjera ndodheshin në veri të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë.⁸⁰¹

⁷⁹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.76.

⁷⁹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.77, 3.83. Shih edhe AT 125-127 dhe 204-205 (6.6.2007). për përgjigjen e Musliut shih AT 188-189 (6.6.2007).

⁷⁹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 2.1-2.29, 3.79.

⁷⁹⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.3-3.9, 3.79 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 690-716.

⁷⁹⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.79-3.80.

⁷⁹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.80-3.81.

⁸⁰⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.85.

⁸⁰¹ Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 702.

dhe se

pjesa më e madhe e dëshmimeve shkon në dobi të pikëpamjes se në atë zonë ndodheshin disa njësi të UÇK-së secila me komandë të veçantë, por me një përjashtim për një kohë në korrik, jo në jug të rrugës kryesore [...]⁸⁰²

Prokuroria më tej rikujton se Dhoma Gjyqësore përcaktoi në mënyrë të përsëritur se kamp-burgu i Llapushnikut ishte “kamp-burg i drejtuar prej UÇK-së” dhe përdorej prej ushtarëve të UÇK-së,⁸⁰³ dhe se kishte prova të konsiderueshme se anëtarët e njësisë Çeliku 3 morën pjesë në funksionimin e kamp-burgut pa gjetur prova për ndonjë njësi tjetër në atë rol.⁸⁰⁴ Rrjedhimisht Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkudoi se njësia Çeliku 3 përdori kamp-burgun.⁸⁰⁵

320. Përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me këtë pikë janë të mjegullta. Megjithëse ajo konkludoi se gjatë periudhës përkatëse të tëra njësitë e UÇK-së ishin të vendosura në veri të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë me përjashtim të njësisë Pëllumbi (për një kohë në korrik 1998) dhe pozicionet e Çelikut 3 në rrethinën e përgjithshme të fshatit Llapushnik,⁸⁰⁶ më vonë konkludoi se disa njësi të UÇK-së u vendosën në rrethinën e fshatit Llapushnik, “por, me një përjashtim për një farë kohe në korrik, jo në jug të rrugës kryesore”.⁸⁰⁷ Megjithëse Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishte njësia Pëllumbi ajo që u vendos në jug të vendndodhjes së kamp-burgut të Llapushnikut për një kohë në korrik 1998,⁸⁰⁸ ajo nuk konkludoi se Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e UÇK-së e vendosur në jug të rrugës kryesore. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit konkludon se Prokuroria nuk provon se Dhoma Gjyqësore përcaktoi se njësia Çeliku 3 ishte e vetmja njësi e UÇK-së e cila gjatë periudhës së Aktakuzës u vendos rregullisht në jug të rrugës kryesore Pejë-Prishtinë ku ndodhej kamp-burgu.

(ii) As njësia Pëllumbi, as “vizitorë të rastësishëm” nuk mund ta kenë përdorur kampin

321. Prokuroria argumenton se nuk kishte prova se njësia Pëllumbi drejtoi kamp-burgun sepse Dhoma Gjyqësore konstatoi se njësia Pëllumbi ishte e pranishme në jug të rrugës kryesore vetëm për një kohë në korrik 1998 (megjithëse kamp-burgu funksionoi “më së voni prej mesit të qershorit 1998 deri më 25 ose 26 korrik 1998”),⁸⁰⁹ dhe në fshatin tjetër të Kishnarekës.⁸¹⁰ Gjithashtu përfundimi se ushtarët e njësisë në veri të rrugës kryesore “hanin dhe flinin [...] në jug [...] të rrugës kryesore herë pas here”⁸¹¹ nuk ka ndikim ndaj deduksionit kyç se Çeliku 3 veprroi në kamp-burg.

⁸⁰² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 713.

⁸⁰³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.86, 3.99, 3.103 me referime të tjera në Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore.

⁸⁰⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.87.

⁸⁰⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.105.

⁸⁰⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 702.

⁸⁰⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 713.

⁸⁰⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 702.

⁸⁰⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 282.

⁸¹⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.97 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 698, 701.

⁸¹¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.97 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 713.

Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur mori parasysh dëshminë e Sylejman Selimit, komandant i zonës së UÇK-së së cilës i përkiste njësia Pëllumbi, se ushtarët që largoheshin nga një zonë duhej të mernin lejë.⁸¹²

322. Gjithashtu Prokuroria argumenton se megjithëse Dhoma Gjyqësore konstatoi se Elmi Sopi “nuk saktësoi cilët ushtarë të UÇK-së hëngrën në kuzhinën e Gzim Gashit”,⁸¹³ Ruzhdi Karpuzi dhe Dëshmitari L64 bënë të qartë se si anëtarë të njësisë Çeliku 3, ata hanin atje.⁸¹⁴ Në asnjë prej dëshmive nuk u sugjerua se ushtarë të rastësishëm që hanin dhe flinin në jug të rrugës kryesore vepruan në kamp-burg.⁸¹⁵

323. Prokuroria argumenton se përfundimet në lidhje me detyrat e Haradin Balës brenda kamp-burgut që sugjerojnë një nivel organizimi, përputhen me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se kampi drejtohej prej UÇK-së. “Kushtet e mjerueshme të burgimit vareshin “në një masë të madhe prej veprimeve ose *mosveprimeve* të Haradin Balës”, dhe ishte Haradin Bala ai që “mbikëqyri” zbrazjen e kovave me jashtëqitje nga fllaniku dhe ahuri.⁸¹⁶ Niveli i organizimit provohet më tej nëpërmjet dëshmive përputhëse të dëshmitarëve-viktima “në lidhje me praninë e rojeve në atë oborr”,⁸¹⁷ “rrethanat e ngjashme” në të cilat u rrëmbyen dëshmitarët dhe identifikimi i ushtarëve konkretë të UÇK-së prej disa dëshmitarëve si dhe udhëzime të ngjashme që iu dhanë të burgosurve të liruar prej rojeve të UÇK-së.⁸¹⁸ Për më tepër Dhoma Gjyqësore konkludoi se

fakti se kamp-burgu funksionoi të paktën për gjashtë javë dhe mbi tridhjetë të burgosur u mbajtën atje, mund të sugjerojë se funksionimi i tij mbështetej në bashkëpunimin e një numri të caktuar personash [...].⁸¹⁹

324. Dhoma e Apelit është bindur se deduksioni i nxjerrë nga provat se njësia Çeliku 3 veproi në kamp-burg nuk është i vetmi deduksion i arsyeshëm duke qenë se mund të konkludohet logjikisht se ushtarët e njësisë Pëllumbi dhe/ose ushtarë e njësive në veri të rrugës kryesore mernin pjesë në funksionimin e kamp-burgut. Dhoma e Apelit vë në dukje përfundimet e Dhomës Gjyqësore se kamp-burgu i Llapushnikut ishte “kamp-burg i drejtuar nga UÇK-ja” dhe në të cilin vepronin ushtarët e UÇK-së.⁸²⁰ Prokuroria nuk demonstroi se funksionimi i kampit duhej të kryhej prej ushtarëve të një njësie konkrete të vetme si p.sh njësia Çeliku 3. Veçanërisht argumentet e Prokurorisë në lidhje me nivelin e organizimit brenda kampit që pretendohet se provoi se ai

⁸¹² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.104 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 107.

⁸¹³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.98 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 695.

⁸¹⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.98.

⁸¹⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.98.

⁸¹⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.100 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 692.

⁸¹⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.101 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276.

⁸¹⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.101 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 273, 280.

⁸¹⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.102 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 666.

⁸²⁰ Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 273, 276, 278-279.

drejtohej prej UÇK-së⁸²¹ nuk përjashtojnë konkluzionin logjik që kampi të jetë drejtuar nga ushtarë të UÇK-së prej njësive të tjera.

325. Për më tepër konkluzioni se asnjë ushtar prej njësive të tjera të UÇK-së që herë pas here hanin në truallin e shtëpisë së Gzim Gashit nuk mund të ketë qenë ndër ushtarët e UÇK-së që vepronin në kamp-burg, nuk është i vetmi konkluzion logjik që mund të nxirret prej provave. Së pari, Elmi Sopi “nuk saktësoi cilët ushtarë të UÇK-së hanin në kuzhinën e Gzim Gashit”,⁸²² duke mundësuar konkluzionin logjik se ushtarë të njësive në veri të rrugës kryesore hanin atje; së dyti, dëshmitë e Ruzhdi Karpuzit dhe Dëshmitarit L64 se ushtarët e njësisë Çeliku 3 hanin në kuzhinën e Gzim Gashit⁸²³ nuk e bënë të palogjikshëm konkluzionin se edhe ushtarë të njësive të tjera të UÇK-së e bënë këtë. Edhe ushtarët e njësisë Pëllumbi mund të kenë qenë ndër ushtarët të cilët hanin dhe flinin në shtëpinë e Gzim Gashit herë pas here veçanërisht gjatë një periudhe në korrik 1996, por jo vetëm në atë kohë, kur kjo njësi ndodhej në jug të rrugës kryesore në fshatin Kishnarekë. Konkretisht Prokuroria nuk ka provuar se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori parasysh dëshminë e Sylejman Selimit, komandat i zonës së UÇK-së të cilës i përkiste njësia Pëllumbi, i cili dëshmoi se ushtarët që largoheshin prej zonës duhej të mernin lejë. Kjo dëshmi nuk çon detyrimisht vetëm në një përfundim logjik se ushtarët e njësisë Pëllumbi nuk mund të kenë marrë pjesë në funksionimin e kamp-burgut, për faktin se nuk është paraqitur asnjë provë në lidhje me dhënien e këtyre lejeve.

(iii) Pretendim për gabim në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm: prova të drejtpërdrejta

326. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur kërkoi prova të drejtpërdrejta për përcaktimin e rolit të njësisë së Çelikut 3 në kamp-burg.⁸²⁴

Nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta që provojnë se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut ose se anëtarët e njësisë Çeliku 3 kryen detyra në kamp-burg.⁸²⁵ [...] Në mungesë të ndonjë dëshmie bindëse të drejtpërdrejtë [...] dëshmitë nuk janë të mjaftueshme për të provuar se i Akuzuari Isak Musliu ishte komandant i UÇK-së për kamp-burgun në fshatin Llapushnik ose se pati pozitë drejtuese apo ushtroi kontroll mbi kamp-burg”.⁸²⁶

327. Prokuroria pretendon se provat e tërthorta janë të mjaftueshme në vërtetimin e një fajësimi,⁸²⁷ se kushti i provave të drejtpërdrejta përbënte keqzbatim të standardit të vërtetimit jashtë

⁸²¹ Shih Dosjen e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.100-3.102

⁸²² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 695.

⁸²³ Ruzhdi Karpuzi, T.3090 (7.2.2005); Dëshmitari L64, T.4386 (15.3.2005, Seancë Private); T. 4421, T.4438, T.4443-4447 (16.3.2005).

⁸²⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.94.

⁸²⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.95 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

⁸²⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.95 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 715 (theksi i shtuar).

⁸²⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.96 në lidhje me Aktgjykimin e Apelit *Bagilishena*, paragrafi 37; Aktgjykimin e Apelit *Kërstiq*, paragrafët 34-35; Aktgjykimin e Apelit *Jelisiq*, paragrafi 47; Aktgjykimin e Apelit *Rutaganda*, paragrafët 547-548.

çdo dyshimi të arsyeshëm dhe se ky gabim ndërthuret me gabimin e qëmtimit artificial të provave.⁸²⁸

328. Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore nuk keqzbatoi ligjin kur konkludoi se “nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta që provojnë se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut”.⁸²⁹ Megjithëse përdorimi i shprehjes “prova te drejtpërdrejta” në dukje mund të sugjerojë se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi prova të tërthorta, prej Aktgjykimit del qartë se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi edhe prova rrethore ose të tërthorta, konkretisht “afërsinë relative të pozicioneve të luftimit të Çelikut 3 në lidhje me kamp-burgun”, “vetë afërsinë e shtëpisë së Gzim Gashit ndaj kamp-burgut.”, dhe “dëshmitë [...] se edhe ushtarët nga njësi të tjera të UÇK-së hanin në këtë oborr, të paktën herë pas here”.⁸³⁰ Rrjedhimisht konkluzioni i Dhomës Gjyqësore duhet kuptuar se Dhoma Gjyqësore nuk u bind se ekzistonin prova “të mjaftueshme” që tregonin se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut.

(iv) Pretendim për gabim në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm në lidhje me një pjesë të caktuar të provave

329. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk mori në konsideratë ose nuk vlerësoi provat apo nuk shqyrtoi vlerën provuese të dëshmive, duke adoptuar një qasje fragmentare ndaj zbatimit të standardit të vërtetimit.⁸³¹ Veçanërisht Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi vetëm dy pjesë provash në lidhje me “afërsinë” e njësisë Çeliku 3 ndaj kamp-burgut: së pari, se njësia ishte “e pozicionuar në rrethinën e përgjithshme” të kamp-burgut, dhe se pozicionet e veta të luftimit ishin në “afërsi relative” ndaj kamp-burgut; dhe së dyti “distanca shumë e afërt” e oborrit të Gzim Gashit - ku Çeliku 3 “kishte shtabin e vet” [...] së paku për periudhën që ka lidhje me Aktakuzën”- ndaj kamp-burgut.⁸³²

330. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi provat e “afërsisë së përgjithshme” të veçuar dhe vlerësoi veçasi dëshmitë e tjera, dhe deklaroi se “vetë distanca shumë e afërt e oborrit të Gzim Gashit nga kamp-burgu” nuk ofron bazë të mjaftueshme për përcaktimin e një lidhjeje midis njësisë Çeliku 3 dhe kamp-burgut.⁸³³ Për më tepër arsyeja e dhënë nga Dhoma Gjyqësore për eliminimin e atyre provave është e papërshtatshme, për faktin se u përqëndrua në arsyet për zhvendosjen e shtabit në oborrin e Gzim Gashit, duke anashkaluar pikën kyçe se shtabi i njësisë

⁸²⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.96.

⁸²⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714 (theksi i shtuar).

⁸³⁰ Po aty.

⁸³¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.89.

⁸³² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.90 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

Çeliku 3 dhe kamp-burgu ndodheshin derë më derë përkohësisht gjatë periudhës përkatëse.⁸³⁴ Gjithashtu Prokuroria rikujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se kuzhina e njësisë Çeliku 3 ishte përtej rrugës nga kampi, në oborrin e Gzim Gashit, që ofron një provë më bindëse se njësia Çeliku 3 mori pjesë në funksionimin e kamp-burgut.⁸³⁵

331. Dhoma e Apelit është e bindur se Dhoma Gjyqësore nuk pati qasje të gabuar fragmentare kur shqyrtoi dëshmitë në lidhje me afërsinë e njësisë Çeliku 3 ndaj kamp-burgut. Dhoma Gjyqësore konkludoi se

afërsia relative e pozicioneve të luftimit të Çelikut 3 me kamp-burgun, nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për supozimin e një lidhjeje midis njësisë Çeliku 3 dhe kamp-burgut, po kështu as distanca shumë e afërt e oborrit të Gzim Gashit nga kamp-burgu.⁸³⁶

Ky përfundim mund të tregojë se në të vërtetë Dhoma Gjyqësore vlerësoi prova të veçuara nga pjesa tjetër e provave. Mirëpo Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e saj të mëparshëm se Dhoma Gjyqësore shqyrtoi edhe prova të tjera së bashku para se të konkludonte se njësia Çeliku 3 nuk ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut, konkretisht “provat [...] se edhe ushtarë nga njësi të tjera të UÇK-së hanin në këtë oborr së paku herë pas here”.⁸³⁷

332. Në lidhje me argumentin e Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore nuk shqyrtoi bashkë me provat e lartpërmendura edhe dëshminë se kuzhina e njësisë Çeliku 3 ndodhej në oborrin e Gzim Gashit përtej rrugës nga kampi, Dhoma e Apelit gjykon se Prokuroria nuk ka demonstruar se i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret nga provat është se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut, sepse kuzhina përdorej edhe nga ushtarë të njësisë të tjera. Për më tepër nuk ka lidhje përshtatshmëria ose papërshtatshmëria e arsyetimit të Dhomës Gjyqësore për vendndodhjen e shtabit të njësisë Çeliku 3 në oborrin e Gzim Gashit së paku për një pjesë të periudhës së Aktakuzës “për shkak të granatimit të shtabit të mëparshëm prej serbëve”, për arsye se kjo nuk e nxjerr të gabuar përfundimin e Dhomës Gjyqësore se së paku për një pjesë të periudhës së Aktakuzës, vendndodhja e njësisë Çeliku 3 në vetvete ose bashkë me dëshmi të tjera nuk provon se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut.

333. Si rezultat, Dhoma e Apelit gjykon se Prokuroria nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor ose faktual kur nuk konkludoi se *njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse* për funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut pasi kishte shqyrtuar dëshmitë në lidhje me afërsinë e vendndodhjes

⁸³³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.91 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

⁸³⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.92 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

⁸³⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.92 (në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 638), dhe 3.93.

⁸³⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

së pozicioneve të luftimit të njësisë Çeliku 3 nga kamp-burgu, vogëlsinë e fshatit Llapushnik, përdorimin e kuzhinës prej njësisë Çeliku 3 në oborrin e Gzim Gashit ngjitur me kamp-burgun, vendndodhjen e përkohshme të shtabit të njësisë Çeliku 3 në oborrin e Gzim Gashit dhe dislokimin e njësisë Pëllumbi.

334. Më tej Dhoma e Apelit do të shqyrtojë argumentin alternativ të Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se *anëtarë të njësisë Çeliku 3 kryen detyra në kamp*.

(b) A morën pjesë në funksionimin e kampit ushtarët e njësisë Çeliku 3

335. Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore bëri vlerësim të gabuar të dëshmisë së Karpuzit në lidhje me praninë e zakonshme të ushtarëve të njësisë Çeliku 3 në *odë* që ndodhej brenda oborrit të burgut: dëshmia e Karpuzit se ai pa Isak Musliun duke kënduar në *odë* dhe se të pranishëm ishin dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së, vërtetoi se së paku dy ushtarë të Çelikut 3 ishin të pranishëm në kamp, Isak Musliu dhe Karpuzi.⁸³⁸ Pretendohet se kjo dëshmi shkon shumë më tej se thjesht “distance e afërt” e njësisë Çeliku 3 prej kampit.⁸³⁹ Së bashku me dëshmi të tjera si afërsia e vendndodhjes së pozicioneve të luftimit të njësisë Çeliku 3 nga kamp-burgu, vogëlsinë e fshatit Llapushnik, përdorimin e kuzhinës prej njësisë Çeliku 3, ngjitur me kamp-burgun në oborrin e Gzim Gashit, vendndodhjen e përkohshme të shtabit të njësisë Çeliku 3 në oborrin e Gzim Gashit, të tëra këto provojnë se njësia Çeliku 3 duhet të ketë marrë pjesë në funksionimin e kamp-burgut.⁸⁴⁰

336. Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk shqyrtoi faktin se prania e Isak Musliut si komandant apo zyrtar i rangut të lartë në kamp-burg do të konfirmonte përfundimin se njësia Çeliku 3 duhet të ketë marrë pjesë në funksionimin e kamp-burgut.⁸⁴¹

337. Po ashtu Prokuroria pretendon se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se Haradin Bala ishte anëtar i njësisë Çeliku 3.⁸⁴² Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fshatin Llapushnik vetëm dy persona kishin nofkën Shala, Ruzhdi Karpuzi dhe Haradin Bala.⁸⁴³ Një prej burimeve të cituara në mbështetje të këtij përfundimi ishte deklarata e Isak Musliut për UNMIK-un ku ai deklaroi se në “ekipin” e tij ishin dy persona “me nofkën Shala”.⁸⁴⁴ Rrjedhimisht të dy personat me pseudonimin

⁸³⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

⁸³⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.108-3.110.

⁸³⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.108-3.110.

⁸⁴⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.111.

⁸⁴¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.112 - 3.113.

⁸⁴² Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.115.

⁸⁴³ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.116, 3.122. Shih AT 126 (6.6.2007).

⁸⁴⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.118 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 622 dhe pm P32, “deklarata si dëshmitar e Isak Musliut për CCIU-në e datës 24 maj 2001”.

Shala ishin në njësinë e Isak Msuliut. Kjo ishte njësia Çeliku 3, sepse Karpuzi dha dëshmi të pakundërshtuar se ai ishte në njësinë Çeliku 3 dhe se Isak Musliu ishte komandanti i tij.⁸⁴⁵ Kjo dëshmi përputhet me përfundimin e Dhomës Gjyqësore se Isak Musliu ishte në pozitë drejtuese në njësinë Çeliku 3.⁸⁴⁶ Për më tepër Prokuroria argumenton se në Dosjen e tij Paragjyqësore Haradin Bala deklaroi se më 8 maj 1998 ose rreth kësaj date, ai “u bashkua me një njësi që njihej si Çeliku 3’ [dhe] njihej si Shala’.”⁸⁴⁷

338. Gjithashtu Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore theksoi se dëshmitarë të ndryshëm dëshmuan se ndër ushtarët e UÇK-së që morën pjesë në funksionimin e kampit ishin Shala, Çerçizi, Tamuli,⁸⁴⁸ dhe Salih, ⁸⁴⁹ dhe se pozita e Tamulit dhe Salihit në njësinë Çeliku 3 dëshmohet prej listës së pjesshme të paraqitur në Provën Materiale P244.1.⁸⁵⁰ Prokuroria argumenton se edhe Dëshmitari L64 deklaroi se ai ishte ushtar i Çelikut 3 dhe pranoi se kishte qenë në kamp-burg disa herë.⁸⁵¹

339. Në lidhje me Ruzhdi Karpuzin, Dhoma e Apelit rikujton se Prokuroria nuk ka vërtetuar se marrja në konsideratë prej Dhomës Gjyqësore e dëshmisë së tij se ai e dëgjoi dhe nuk e pa Isak Musliun në kamp, do të kishte ndikuar në përfundimin e Dhomës Gjyqësore në lidhje me praninë e Isak Musliut në kamp-burg. Po ashtu edhe sikur Isak Musliu të kishte qenë duke kënduar ndonjëherë në kamp-burg, Prokuroria nuk ka provuar se do të kishte qenë e palogjikshme që Dhoma Gjyqësore të mos kishte konkluduar se ai merrte pjesë në funksionimin e kampit. Rjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi në lidhje me këtë pikë.

340. Në lidhje me Haradin Balën Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore nuk nxorri përfundim nëse ai ishte anëtar i njësisë Çeliku 3. Megjithëse Dhoma Gjyqësore konkludoi “se në periudhën përkatëse, në fshatin Llapushnik ishin vetëm dy persona me pseudonimin Shala”,⁸⁵² Dhoma e Apelit është e bindur se përfundimi se të dy personat me pseudonimin Shala ishin anëtarë të njësisë Çeliku 3 gjatë periudhës së Aktakuzës, nuk është i vetmi përfundim i logjikshëm që mund të nxirrej prej provave. Dhoma e Apelit mban parasysh deklaratën e Isak Musliut për UNMIK-un ku ai deklaroi se ai “kishte në ekipin e tij dy persona me nofkën Shala”.⁸⁵³ Ai gjithashtu deklaroi se

⁸⁴⁵ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.118 në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 591.

⁸⁴⁶ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.118. Shih po aty, paragrafi 3.120.

⁸⁴⁷ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.121, në lidhje me Dosjen Paragjyqësore të Balës, paragrafi 5.

⁸⁴⁸ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafët 3.123-3.124, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafët 251, 541, dhe 311.

⁸⁴⁹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.124, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276 (“Të gjithë dëshmitarët dëshmuan se rojet në burg ishin Shala [...] dhe Murrizi, megjithëse disa dëshmitarë panë edhe [...] Tamulin, Çerçizin, Avdullahun, Salihin, Hoxhën dhe Dëshmitarin L64”).

⁸⁵⁰ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.124, në lidhje me pm. P244.9.

⁸⁵¹ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.124, në lidhje me Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276 dhe Dëshmitarin L64, T.4353-4356 (15.3.2005), T. 4461-4464 (16.3.2005).

⁸⁵² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 622.

⁸⁵³ Pm P32 “Deklarata si dëshmitar e Isak Musliut për CCIU-në e datës 24 mars 2001”.

nuk dinte “nëse një prej tyre ishte Haradin Bala.”⁸⁵⁴ Mirëpo ai nuk saktësoi periudhën gjatë së cilës dy personat me pseudonimin Shala, ishin anëtarë të këtij “ekipi”.

341. Më tej Prokuroria argumenton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se “Tamuli” dhe “Salih” ishin roje në kamp-burg dhe se Dhoma Gjyqësore gaboi kur nuk konkludoi se ata ishin anëtarë të njësisë Çeliku 3. Prokuroria sugjeron se kjo dëshmohet prej listës së pjesshme të ushtarëve të paraqitur në Provën Materiale P244.1. Gjithsesi Dhoma e Apelit konkludon se ky nuk është i vetmi përfundim i arsyeshëm që mund të nxirret prej provave. Së pari Dhoma Gjyqësore nuk konkludoi se “Tamuli” dhe “Salih” ishin roje në kamp. Përkundrazi ajo deklaroi se “disa dëshmitarë panë gjithashtu disa persona të tjerë me uniformë në kamp, konkretisht Tamulin [dhe] Salihin”.⁸⁵⁵ Për më tepër në paragrafin 11 të Provës Materiale P244.1 përmendet një listë personash në një fletore me titullin “Çeliku 3”, dhe megjithëse në këtë listë përmend një person të quajtur Skënder Salih, nuk jepen të dhëna të tjera nëse ky është personi i quajtur “Salih”, i cili në paragrafin 276 të Aktgjykimit përmendet si një nga personat me uniformë në kamp. Më tej në paragrafin 11 të Provës Materiale P244.1 lexohet vetëm se “është e mundshme që këta persona të jenë mobilizuar”.⁸⁵⁶ Në paragrafin 12 përmenden katër lista të “ndërrimeve të rojete të natës” me “pseudonimet e personave që funksionojnë dhe janë në pika”. Këto lista përfshijnë dy herë emrin “Salih” dhe një herë emrin “Tamuli”. Nuk jepen të dhëna të tjera konkrete që tregojnë se me të vërtetë këta emra janë të personave me uniformë “Salih” dhe “Tamuli” përmendur në paragrafin 276 të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore. Në këtë kontekst Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e Dhomës Gjyqësore se “gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, ishte e zakonshme që anëtarët e UÇK-së të përdornin pseudonime në vend të emrave të tyre. Për fat të keq, dëshmitë kanë qenë herë pas here pësjtjelluese për shkak të kësaj veçorie kulturore; Dhoma është përpjekur të minimizojë ndikimin e kësaj dukurie në këtë Aktgjykim.”⁸⁵⁷ Si rezultat, Dhoma e Apelit nuk është e bindur se përfundimi i nxjerrë nga Prova Materiale P244.1 se personat me uniformë të quajtur “Salih” dhe “Tamuli” të cilët përmenden në paragrafin 276 të Aktgjykimit ishin anëtarë të njësisë Çeliku 3 gjatë periudhës së Aktakuzës, është i vetmi përfundim logjik.

342. Në lidhje me Dëshmitarin L64, Dhoma e Apelit rikujton se ai dëshmoi se ishte ushtar në njësinë Çeliku 3 dhe se ishte në kamp-burgun e Llapushnikut afërsisht dy ose tri herë.⁸⁵⁸ Gjithashtu

⁸⁵⁴ Po aty. Në lidhje me këtë pikë, Dhoma e Apelit thekson se Dhoma Gjyqësore konkludoi se ishin individë të tjerë me pseudonimin “Shala” që vepronin në rrethinën e gjerë, si Ferat Shala, Haxhi Shala, Shaban Shala, Nexhmi Shala, dhe Ramiz Shala (shih Aktgjykimin e Dhomës Gjyqësore, paragrafi 622).

⁸⁵⁵ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276.

⁸⁵⁶ Theksi i shtuar.

⁸⁵⁷ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 24.

⁸⁵⁸ Aktgjykimin i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 276, në lidhje me Dëshmitarin L64, T. 4356-64 (16.3.2005).

Dhoma e Apelit rikujton se Dhoma Gjyqësore konkludoi se “L64 kishte qenë ushtar i Çelikut 3”.⁸⁵⁹ Më tej Dhoma e Apelit merr parasysh dëshminë e Naser Kastratit se një ditë ai takoi dëshmitarin L64 në kamp-burg.⁸⁶⁰ Dhoma e Apelit gjykon se përfundimi i nxjerrë prej këtyre provave se Dëshmitari L64 ishte ushtar i Çelikut 3 i cili mori pjesë në funksionimin e kamp-burgut, nuk është i vetmi përfundim i logjikshëm. Kastrati thjesht pohon se ai pa Dëshmitarin L64 një ditë jashtë në kamp-burg dhe Dëshmitari L64 dëshmoi se ai e vizitoi kamp-burgun afërsisht dy ose tri herë. Dhoma e Apelit gjykon se përfundimi i nxjerrë nga këto prova se Dëshmitari L64 merrte pjesë në funksionimin e kamp-burgut nuk është i vetmi përfundim i logjikshëm. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur refuzoi të deklaronte përgjegjësinë penale të Isak Musliut bazuar në çfarëdo veprimi të kryer prej dëshmitarit L64.

343. Përfundimisht, Dhoma e Apelit është e bindur se deduksioni i nxjerrë nga provat e lartpërmendura “se anëtarët e njësisë Çeliku 3 kryen detyra në kamp-burg”,⁸⁶¹ domethënë morën pjesë në funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut, nuk është i vetmi konkluzion logjik. Për më tepër Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e vet se Prokuroria nuk ka vërtetuar se Dhoma Gjyqësore bëri gabim ligjor apo faktual kur nuk vërtetoi se njësia Çeliku 3 ishte përgjegjëse për funksionimin e kamp-burgut të Llapushnikut. Për pasojë u është dhënë përgjigje argumenteve të Prokurorisë në lidhje me çështjen se a ishte Isak Musliu komandant i njësisë Çeliku 3 dhe a ushtroi “komandë ose drejtim të vetëm në njësinë Çeliku 3”.⁸⁶²

2. Përfundim

344. Dhoma e Apelit gjykon se deduksioni që njësia Çeliku 3 funksionoi në kamp burg ose se ushtarët e kësaj njësie kryen krime në kamp-burg në kohën kur Isak Musliu ushtronte komandë dhe kontroll efektiv ndaj ushtarëve të kësaj njësie, nuk është i vektmi konkluzion logjik i nxjerrë prej provave. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur nuk konkludoi se Isak Musliu ka përgjegjësi penale për krimet e kryera në kamp-burgun e Llapushnikut bazuar në Nenin 7(3) të Statutit.

345. Rrjedhimisht pika e dytë e apelit të Prokurorisë hidhet poshtë.

⁸⁵⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 690.

⁸⁶⁰ Pm P197, Deklarata 92bis e Naser Kastratit”, paragrafi 35.

⁸⁶¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 714.

⁸⁶² Po aty, paragraf 712.

C. Pika e tretë e apelit: ndërmarrje e përbashkët kriminale

346. Dhoma e Apelit rikujton përfundimin e vet me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Schomburg se prej tërësisë së provave nuk mund të nxirrej vetëm një konkluzion logjik se Isak Musliu ishte brenda kamp-burgut të Llapushnikut dhe mori pjesë në funksionimin e tij.⁸⁶³ Rrjedhimisht Dhoma e Apelit gjykon se Dhoma Gjyqësore nuk gaboi kur nuk konkuldoi se Isak Musliu ishte pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale sistemore për kryerjen e trajtimit mizor dhe torturave në kamp-burg.

347. Si rezultat, pika e tretë e apelit të Prokurorisë hidhet poshtë

⁸⁶³ Shih paragrafin e mësipërm 314

VII. VENDIM

Për arsyet e lartpërmendura, **DHOMA E APELIT**,

NË PËRPUTHJE ME Nenin 25 të Statutit dhe Rregullat 117 dhe 118 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave;

DUKE MARRË SHËNIM parashtimet përkatëse me shkrim të Palëve dhe argumentet e paraqitur prej tyre në seancat e datave 5 dhe 6 qershor 2007;

NË seancë të hapur;

HEDH POSHTË apelin e Haradin Balës në tërësi;

HEDH POSHTË apelin e Prokurorisë, me përjashtim të mendimit mospajtues të Gjykatësit Wolfgang Schomburg, në lidhje me pikën e parë të apelit për Isak Musliun;

LË NË FUQI vendimin e lëshuar nga Dhoma Gjyqësore kundër Haradin Balës, duke marrë në konsideratë, në përputhje me Rregullën 101(C), periudhën në të cilën Haradin Bala ka qenë në paraburgim deri tani; dhe

URDHËRON, në bazë të Rregullës 103(C) dhe të Rregullës 107 të Rregullores, që Haradin Bala të mbetet i burgosur nga Tribunali Ndërkombëtar, në pritje të përfundimit të masave për transferimin e tij në shtetin ku ai do të kryejë dënimin.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Fausto Pocar
Kryegjykatës

/nënshkruar në origjinal/
Mohamed Shahabuddeed
Gjykatës

/nënshkruar në origjinal/
Andrésia Vaz
Gjykatëse

/nënshkruar në origjinal/
Theodor Meron
Gjykatës

/nënshkruar në origjinal/
Wolfgang Schomburg
Gjykatës

Bashkëngjitur deklarata e Gjykatësit Mohamed Shahabuddeen.

Bashkëngjitur mendimi pjesërisht mospajtues i veçantë dhe deklarata e Gjykatësit Wolfgang Schomburg.

Sot, më 27 shtator 2007

Në Hagë, Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

VIII. DEKLARATA E GJYKATËSIT SHAHABUDDEEN

1. Jam dakord me vendimin e Dhomës Gjyqësore, por e gjykoj të arsyeshme të bëj këtë deklaratë. Lidhur me anëtarësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale (NPK), pranoj se aktgjykimi bazohet mbi jurisprudencën së provuar, së cilës i nënshtrohem. Mirëpo, si individ, dëshiroj të them se pranimi i heshtur i anëtarësisë në NPK, i personave të cilët fillimisht nuk ishin anëtarë të NPK-së mund të deduktohet prej pjesëmarrjes së tyre në NPK.¹ Për sa u përket vizitorëve “të rastësishëm”, nuk është i nevojshëm identifikimi i tyre për të vërtetësuar anëtarësinë e tyre në NPK.

2. Gjithashtu dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast për të shprehur një rezervë në lidhje me paragrafin 21 të Aktgjykimit të Dhomës së Apelit. Ky paragraf thotë “se parimi *in dubio pro reo* si rrjedhë e supozimit të pafajësisë dhe detyrimit të vërtetimit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, gjen zbatim në përfundimet e nevojshme për përcaktimin e fajësisë të tilla si përbërësit e elementëve të krimit të akuzuar”. Ky formulim është i gjerë aq sa prej tij të nënkuptohet se parimi vlen si për çështje faktuale po ashtu dhe për çështje ligjore. Nëse kuptohet ashtu, jam i kënaqur. Por ky interpretim mund të kundërshtohet në bazë të jurisprudencës të mëparshme të Tribunalit ku është konkluduar se parimi nuk vlen për çështje ligjore.

3. Nëse formulimi në fjalë kufizon zbatueshmërinë e parimit vetëm për çështjet faktuale, dëshiroj t’i referohem pohimit të Mettraux-it se “parimi i përgjithshëm i së drejtës penale është se kur ekziston një dyshim në interpretimin e ligjit, dyshimi duhet të interpretohet gjithmonë në dobi të të akuzuarit (*in dubio pro reo*)...’.² Në çështjen *Delaliq*,³ Dhoma Gjyqësore deklaroi:

Pasoja e interpretimit të ngushtë të dispozitave të një statuti penal është se, kur një fjalë e paqartë apo një fjali e dykuptimtë lejon një dyshim të arsyeshëm interpretimi të cilin parimet aksiomatike nuk mund ta zgjidhin, nga dyshimi duhet të përfitojë subjekti dhe jo ligjvënësi i cili nuk ka mundur të shpjegohet në mënyrë të duhur.⁴ Rrjedhimisht statutet e paqarta penale duhet të interpretohen *contra proferentem*.

Gjithashtu, vlen të përmendet konstatimi i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara se ekziston një “rregull i njohur se “ku ka paqartësi në një statut penal, dyshimet zgjidhen në dobi të mbrojtësit””.⁵ Ekziston një mori konstatimesh të tilla gjyqësore. Besoj se parimi ku mbështeten

¹ Shih Mendimin tim Pjesërisht Mospajtues në *The Prosecutor v. Radoslav Brdanin*, Case No. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007.

² Guénaél Mettraux, *International Crimes and the ad hoc Tribunals* (Oxford 2005), f. 226.

³ IT-96-21-T, 16 nëntor 1998, paragrafi 413 (i njohur gjithashtu si *Çelebiqi*).

⁴ *Shih R. v. Wimbledon JJ. ex p. Derwent* Š1953C 1 QB 380.

⁵ *Adams Wrecking Co. v. United States*, 434 U.S. 275, 284-285 (1978), i cili citon *United States v. Bass*, 404 U.S. 336, 348 (1971). *Shih edhe George P. Fletcher and Jens David Ohlin*, ‘Reclaiming Fundamental Principles of Criminal Law in the Darfur Case’. JICJ 3 (2005) 539, at 552.

është pjesë e parimit *in dubio pro reo*. Në këto pohime ky parim vlen si për çështje faktuale, po ashtu edhe për çështje ligjore.

4. Në ndryshim me sa më sipër, në [çështjen] *Stakiq*,⁶ Dhoma Gjyqësore, duke iu referuar parimit *in dubio pro reo*, tha se “ky parim vlen për përfundime faktuale dhe jo ligjore”. Fakti se nuk u cituan burime autoritative mund të nënkuptojë se nuk ishte e nevojshme, me gjasë ky përfundim ishte gjerësisht i pranuar në praktikën e së drejtës.

5. Megjithatë materiali që kam parë, nxit dyshimin nëse parimi vlen vetëm për çështje faktuale. Ka shumë mundësi që parimi përdoret më shpesh në lidhje me çështje faktuale, por nuk jam i bindur se nuk mund të përdoret për çështje ligjore. Sado të vetëmjaftueshme të jenë rregullat për interpretimin e dispozitave të zakonshme, në zbatimin e këtyre rregullave duhet mbajtur parasysh; gjithashtu, jashtë dispozitave të tilla, mund të ekzistojnë çështje ligjore.

6. E kuptoj mirë mendimin e kolegut të nderuar, Gjykatësi Schomburg. Natyrisht është “detyra dhe obligimi i lartë i vetë gjykatës për vërtetimin dhe zbatimin e ligjit përkatës sipas rrethanave të çështjes, sepse ligji është pjesë e njohurive juridike të gjykatës.” Mirëpo, për të patur “njohuri juridike” të ligjit, gjykata duhet “të vërtetojë” ligjin. Në vërtetimin e ligjit, gjykata udhëhiqet prej disa parimeve, ndër të cilat edhe parimi *in dubio pro reo*.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Sot, më datën 27 shtator 2007

Në Hagë, Holandë

/nënshkruar në origjinal/
Mohamed Shabahudeen

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]

⁶ IT-97-24-T, 31 korrik 2003, paragrafi 416.

IX. MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES DHE I VEÇANTË DHE DEKLARATA E GJYKATËSIT SCHOMBURG

1. Me respekt, shpreh mendimin tim mospajtuës me standardin e shqyrtimit apelues dhe si pasojë me lënien në fuqi prej Dhomës së Apelit të shfajësimit të Isak Musliut. Gjithashtu e gjykoj të nevojshme të shkruaj ndarazi në lidhje me arsyet e refuzimit të argumenteve të Prokurorisë kundër shfajësimit të pjesëshëm të Haradin Balës. Së fundi, duhet të reagoj nëpërmjet deklaratës sime ndaj formulimit në fund të Paragrafit 21 të Aktgjykimit të Apelit dhe ndaj deklaratës përkatëse të Gjykatësit Shahabuddeen.

A. Standardi i Shqyrtimit Apelues

2. Me respekt, shpreh mospajtimin tim me dallimin e bërë nga Dhoma e Apelit¹ midis apelit të paraqitur nga Prokuroria dhe apelit të dorëzuar nga Mbrojtja. Dhoma e Apelit është e mendimit se

duke marrë parasysh se Prokuroria ka detyrimin që gjatë gjyqit të provojë fajësinë e të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, rëndësia e gabimit faktual që shkakton dështim të drejtësisë është disi e ndryshme ndërmjet apelit të Prokurorisë kundër shpalljes së pafajësisë dhe apelit të Mbrojtjes kundër fajësimit. I Akuzuari duhet të provojë se gabimet faktuale të Dhomës Gjyqësore krijojnë dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë e tij. Prokuroria duhet të provojë se marrja parasysh e gabimeve faktuale të kryera prej Dhomës Gjyqësore, eliminon çdo dyshim të arsyeshëm të fajësisë së të akuzuarit.

Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar nuk lejon një dallim të tillë, duke pohuar në Nenin 25(1) se

Dhoma e Apelit shqyrton apelitë prej individëve të fajësuar nga Dhoma Gjyqësore ose prej Prokurorit...

3. Ndërsa në një sërë jurisdiksionesh, kryesisht ato nën ndikimin e traditës ligjore anglo-saksone, Prokuroria nuk ka të drejtë ose ka *de facto* vetëm një mundësi të kufizuar për të apeluar vendimet e shfajësimit, e drejta sipas Statutit tonë është tepër e qartë. Për arsye të forta, ligjvënësi u ka dhënë personit të shpallur fajtor dhe Prokurorit të drejtë të barabartë apeliti, veçanërisht duke marrë parasysh mandatin e Tribunalit Ndërkombëtar për zbulimin e së vërtetës, pavarësisht prej qasjeve të sistemeve shtetërore. Si pasojë, detyra e Dhomës së Apelit është e njëjtë për sa i përket si apelit të Prokurorisë po ashtu edhe apelit të Mbrojtjes.² Kushti i vërtetimit të apelit të Prokurorisë duhet të jetë i njëjtë me kushtin e vërtetimit të apelit të Mbrojtjes, pra si dy anët e medaljes: Dhoma e Apelit do të përmbysë një vendim pafajësie vetëm nëse asnjë Dhomë Gjyqësore e arsyeshme³ nuk mund të kishte arritur në atë vendim pafajësie në bazë të fakteve të paraqitura, d.m.th. kur shpallja e fajësisë është i vetmi përfundim i arsyeshëm.

¹ Aktgjykimi, paragrafi 13.

² Natyrisht duke marrë parasysh tërë hollësitë e jurisprudencës së pranuar dhe përputhëse lidhur me apelit e Mbrojtjes.

³ Nuk më pëlqen shprehja e pranuar "asnjë gjykoës i arsyeshëm faktesh" sepse çështja nuk shtrohet nëse gjykatësi është i arsyeshëm, por nëse mendim i tij ose i saj është i arsyeshëm *in concreto*. Mirëpo, nëse përdoret kjo shprehje, ajo duhet të përdoret gjithashtu kur kur apelon Prokuroria. Parapëlqej që në të dy rastet standardi të riformulohet si "asnjë gjykoës faktesh nuk mund të arrijë në këtë përfundim në mënyrë të arsyeshme."

4. Do të jetë gabim madje edhe krijimi i përshtypjes se detyra e Prokurorisë është më e vështirë. Në apelimin e saj, Prokuroria duhet të vërtetojë se dyshimet e Dhomës Gjyësore lidhur me fajësinë e të akuzuarit ishin të paarsyeshme dhe se ajo thjesht shprehu dyshime teorike aty ku priteshin dyshime të arsyeshme. Kuptohet se asnjë gjykatës i cili ballafaqohet me procese të tilla madhore *sui generis* nuk mund të hartojë një aktgjykim pa patur dyshime. Detyra e Dhomës Gjyësore kur shpall pafajësinë është të tregojë në mënyrë bindëse se dyshimet e mbetura janë me të vërtetë të arsyeshme dhe se ato përbëjnë një bazë për një vendim pafajësie. Lidhur me përfundimet faktuale, është detyra e Dhomës së Apelit të shqyrtojë Aktgjykimin e Dhomës Gjyësore, për atë pjesë të apeluar prej Prokurorisë, në mënyrë që të vërtetojë se dyshimet e Dhomës Gjyësore lidhur me fajësinë e të akuzuarit ishin me të vërtetë të arsyeshme, të marra parasysh në kontekst të materialit të procesit gjyqësor në tërësi.

5. Dhoma e Apelit mund të përmbysë një vendim pafajësie të apeluar për arsye faktuale vetëm nëse nuk ekziston një vendim i arsyetuar i cili shpjegon, me hollësi nëse duhet, pse sipas Dhomës Gjyësore, Prokuroria nuk ishte në gjendje të përmbushte detyrimin e provës. Shkurtimisht, Dhoma e Apelit duhet të vlerësojë nëse asnjë Dhomë Gjyësore nuk do të kishte arritur në këtë përfundim, në veçanti duke marrë parasysh ato pjesë të procesit që Prokuroria ka vënë në pah shprehimisht. Nëqoftëse Dhoma Gjyësore nuk arrin të ofrojë diskutimin e nevojshëm dhe të plotë në Aktgjykimin e saj, Dhoma e Apelit mund të urdhërojë rihapjen e çështjes. Nëse diskutimi i Dhomës Gjyësore konsiderohet i plotë, por Dhoma e Apelit është e mendimit se i vetmi përfundim i arsyeshëm është fajësia, atëherë Dhoma e Apelit duhet të zëvendësojë vendimin e shfajësimit me vendimin e fajësisë. Dhoma e Apelit mund të zëvendësojë vendimin e shfajësimit me një dënim fajësie edhe kur ajo është e mendimit se, me rihapjen e çështjes, nuk mund të pritët asnjë përfundim tjetër.

B. Përgjegjësia e Isak Musliut

6. Bazuar në kushtin e mësipërm, unë, me respekt shpreh mospajtim me vendimin e Dhomës së Apelit që lë në fuqi vendimet e pafajësisë së Isak Musliut lidhur me Pikën e Parë të Apelit të Prokurorisë. Sipas meje, në bazë të provave të paraqitura Dhomës Gjyësore, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të kishte dyshime të arsyeshme për fajësinë e Isak Musliut lidhur me kryerjen personalisht prej tij të krimeve si keqbërës, sipas tekstit të mirëfilltë të Nenit 7(1) të Statutit (“kryerjen”). Në bazë të argumentave bindëse të paraqitur nga Prokuroria në parashtrimet e saj dhe të mbështetura në paraqitjet e saj gojore,⁴ Dhoma e Apelit duhej të kishte miratuar Pikën e Parë të

⁴ Dosja e Apelit të Prokurorisë, paragrafi 3.1 *et seq.*, AT. 115-127 (6.6.2007).

Apelit të Prokurorisë apo të paktën duhej të kishte urdhëruar rihapjen e çështjes kundër Isak Musliut.

7. Suksesi i prituri i Pikës së Parë të Apelit të Prokurorisë mbështetet kryesisht mbi dy shtylla. Shtylla e parë është dëshmia e dëshmitarit Karpuzi. Aktgjykimin i mungon një diskutim i thelluar për deklaratat dhe dëshminë e Karpuzit,⁵ në veçanti lidhur me deklaratën e tij të parë.⁶ Parimisht, deklarata e parë është pjesa më e rëndësishme e dëshmisë.⁷ Kjo vlen akoma më shumë në këtë çështje sepse menjëherë pas kësaj, dëshmitari në mënyrë të vetëdijshme korrigjoi versionin e përkthyer të deklaratës së tij të parë.⁸ Mirëpo është me interes të theksohet se ai nuk e ndryshoi deklaratën e tij të parë lidhur me praninë e Isak Musliut në kamp. Unë nënvizoj se Karpuzi e njihte Isak Musliun që para pranisë së tij në kamp dhe e dinte që më parë nofkën e tij, Çerçizi. Shtylla e dytë është dëshmia e qartë e Dëshmitarit L10.⁹ Në bazë të kësaj dëshmie tepër bindëse dhe të pranuar si të besueshme nga Dhoma Gjyqësore, jam i bindur se Dhoma e Apelit nuk duhej të kishte lënë në fuqi vendimin e pafajësisë lidhur me kryerjen personalisht prej Isak Musliut të krimeve si keqbërës në kamp-burgun e Llapushnikut,¹⁰ kundër të cilit adresohet Pika e Parë e Apelit të Prokurorisë.

C. Përgjegjësia e Haradin Balës

8. Ka disa arsye pse nuk kundërshtoj verdiktin e Dhomës së Apelit lidhur me përgjegjësinë individuale të të Akuzuarit Haradin Bala.

9. Mirëpo, me gjithë respektin që kam, jam disi i shqetësuar lidhur me mungesën në Aktgjykimin e Apelit të një diskutimi të mjaftueshëm i cili do të ofronte një përgjigje bindëse ndaj argumenteve të Prokurorisë për një ndërmarrje të përbashkët kriminale.

10. Aktgjykimi i Apelit tregon në thelb se koncepti i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, në veçanti kategoria e tretë, nuk ofron përkufizime të qarta për përcaktimin e përpiktë të shtrirjes së përgjegjësisë individuale penale. Në një anë, teoria e ndërmarrjes së përbashkët kriminale është tepër e gjerë sepse *de facto* ajo lejon që individët të ndëshkohen vetëm për anëtarësinë e tyre në një

⁵ *Shih* në veçanti T. 3095 (7.2.2005).

⁶ *Shih* provën materiale 136a.

⁷ *Shih* për këtë mendim gjerësisht të pranuar, së fundi ROLF BENDER, ARMIN NACK & WOLF-DIETER TREUER, TATSACHENFESTSTELLUNG VOR GERICHT, *inter alia*, f. 28 et seq. (botimi i tretë 2007).

⁸ *Shih* provën materiale 137a.

⁹ *Shih* T. 2922, 2950-2951 (3.2.2005).

¹⁰ Siç pretendohet në Aktakuzë.

organizatë kriminale, pavarësisht nga përkufizimi i mjegullt i anëtarësisë.¹¹ Në anën tjetër, ajo mund të përdoret në mënyrë tepër kufizuese, siç shihet në këtë rast.

11. Interpretimi i fjalës “kryerje” në tekstin e Nenit 7(1) të Statutit nuk duhet të japë përshtypjen se është ose priret të jetë arbitrar: parimi *nullum crimen sine lege stricta* vlen gjithashtu për këtë pjesë të përgjithshme të së drejtës penale të mirëfilltë. Është e vërtetë se në nivel shtetëror, ekziston prirja për ndëshkimin thjesht të anëtarësisë në organizatë kriminale apo në organizatë të ngjashme. Mirëpo, kjo qasje nuk depërtoi në të drejtën statutore të Tribunalit. Duhet të theksohet edhe një herë se çdo interpretim i normës statutore kufizohet prej formulimit të saj. Shkurtimisht, Dhoma e Apelit ka humbur një rast unikal për të bërë atë që duhej bërë duke përcaktuar kufijtë e përgjegjësisë penale individuale dhe njëkohësisht duke pajtuar qasjen e saj me qasjen e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, pra, bashkëkryerja dhe koncepti i kontrollit mbi veprën,¹² qasje e pranuar gjerësisht në nivel botëror,¹³ dhe – me një rëndësi të veçantë për këtë Tribunal Ndërkombëtar – në ish-Jugosllavi. Në të drejtën penale ndërkombëtare të mirëfilltë mund të ketë vetëm një koncept përcaktues, i cili kërkon të pranohet botërisht.

12. Në këtë rast, fare thjesht mund të ishte arritur në një përfundim tjetër, edhe duke zbatuar konceptin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, por gjithsesi duke zbatuar konceptin më bindës të (bashkë)kryerjes si interpretim të bazuar të “kryerjes” sipas Nenit 7(1) të Statutit, dhe duke marrë parasysh të gjitha argumentet e Prokurorisë.

13. Megjithatë, duke qenë se interpretim i fjalës “kryerje” në Nenin 7(1) të Statutit është mënjeluar nga Dhoma e Apelit pa dhënë arsytim të mëtëjshëm,¹⁴ nuk ka kuptim të përpiqem të përfshij faktet e çështjes kundër Haradin Balës në kuadrin më të përkufizuar të (bashkë)kryerjes, në veçanti sipas kriterit objektiv të “kontrollit mbi veprimin,” që me të vërtetë ka epërsi sepse përcakton përgjegjësinë penale individuale *in abstracto* paraprakisht dhe jo mbi një bazë të paparashikueshme rast pas rasti (*nullum crimen sine lege stricta et praevia*).

¹¹ Shih në këtë kuadër *Bërgjanin*, Aktgjykimi i Apelit, Mendimi Pjesërisht Mospajtuës i Gjykatësit Shahabuddeed, paragrafi 14, dhe Deklarata e Gjykatëses van den Wyngaert.

¹² Shih *Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, Çështja Nr. ICC-01/04-01/06, Decision on the Confirmation of Charges, 29 January 2007, paras 317 et seq./Vendim në lidhje me Konfirmimin e Akuzave, 29 janar 2007, paragrafët 317 dhe në vijim.

¹³ Shih MAX PLANCK INSTITUTE FOR FOREIGN AND INTERNATIONAL CRIMINAL LAW, PARTICIPATION IN CRIME: CRIMINAL LIABILITY OF LEADERS OF CRIMINAL GROUPS AND NETWORKS, EXPERT OPINION, COMMISSIONED BY THE UNITED NATIONS – INTERNATIONAL CRIMINAL TRIBUNAL FOR THE FORMER YUGOSLAVIA, OFFICE OF THE PROSECUTOR, Ulrich Sieber, red. 2006) (aktualisht nëntë vëllime). Shih gjithashtu Aktgjykimin e Apelit *Gacumbitsi*, Separate Opinion of Judge Schomburg on the Criminal Responsibility of the Appellant for Committing Genocide/Mendim i Veçantë i Gjykatësit Schomburg në lidhje me Përgjegjësinë Penale të Apeluesit për Kryerjen e Gjenocidit; Aktgjykimi i Apelit *Simiq*, Dissenting Opinion of Judge Schomburg/Mendimi Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg.

¹⁴ Shih Aktgjykimin e Apelit *Stakiq*, paragrafi 62: “Kjo lloj përgjegjësie... nuk mbështetet në të drejtën zakonore ndërkombëtare...” Në këtë kuadër, i referohem vendimit të kohëve të fundit të Dhomës Paragjyqësore të Gjykatës Penale Ndërkombëtare Penale, e cila theksoi se “... Dhoma gjykon, po ashtu edhe Prokuroria, dhe, në ndryshim me jurisprudencën e tribunaleve *ad-hoc*, se Statuti adopton qasjen e tretë, e cila bazohet mbi konceptin e kontrollit mbi krimin” dhe “se koncepti i bashkëkryerjes... duhet të përputhet me zgjedhjen e konceptit të kontrollit mbi krimin si kriter për të dalluar midis kryesorëve dhe ndihmësve.” *Prosecutor v. Thomas Lubanga Dyilo*, Çështja Nr. ICC-01/04-01/06, Vendim në lidhje me Konfirmimin e Akuzave, 29 janar 2007, paragrafët 338 dhe 340. Më vjen keq që ky Tribunal nuk është përpjekur të përafrojë të dy qasjet, të paktën për t’iu afruar të drejtës penale ndërkombëtare të njëtrajtshme, në veçanti në pjesët e saj të përgjithshme.

14. Mirëpo unë nuk shfaq mospajtim në lidhje me vlerat e çështjes kundër Haradin Balës kryesisht për një arsye tjetër: kërkesat e ekonomisë gjyqësore, siç përcaktohen shprehimisht në Rregullat 73 *bis* (D) dhe (E) të Rregullores për fazën paragjyqësore dhe gjyqësore, se edhe apeli duhet të përqëndrohet vetëm mbi krimet kryesore.¹⁵ Nuk duhen shqyrtuar veprimet, të cilat nuk mbartin aq shumë rëndësi¹⁶ sa të kenë një ndikim të qenësishëm mbi rezultatin e procesit, një qasje e pranueshme për pikat e apeluara në këtë çështje.

D. Parimi *In Dubio Pro Reo*

15. Zbatimi i parimit *in dubio pro reo* vlen vetëm për përcaktimin e fakteve, duke përfshirë fakte ligjore, por nuk mund të përfshijë përfundime mbi çështje ligjore.¹⁷ Rrjedhimisht, në lidhje me këtë çështje, unë shpreh me respekt mospajtimin tim me Gjykatësin Shahabuddeen.

16. Është detyra and obligimi i lartë i gjykatës vetë të zbulojë dhe të zbatojë ligjin përkatës në rrethanat e dhëna të çështjes, sepse ligji përfshihet brenda njohurisë juridike të gjykatës.¹⁸ Nuk ka vend për dyshim në këtë konstatim.

17. Gjithashtu, në nivel shtetëror, pranohet gjerësisht në jurisprudencë¹⁹ se parimi *in dubio pro reo* “vlen vetëm për përcaktimin e fakteve.”²⁰ “*in dubio pro reo* est sans valeur pour l’interprétation des lois: son rôle est différent et a pour seul but d’imposer l’acquittement d’un délinquant contre lequel les preuves font défaut ou sont insuffisantes pour asseoir une condamnation.”²¹ Në një vendim të fundit, Gjykata e Lartë e Republikës Federale të Gjermanisë konkludoi se parimi “nuk ka lidhje me provat, por me marrjen e vendimeve, të cilin gjykata mund të pranojë vetëm nëse, pas marrjes në shqyrtim të të gjitha provave, ajo nuk bindet për ekzistencën e një fakti të lidhur

¹⁵ Shih Strafprozeßordnung [Kodi i Procedurës Penale], 7 prill 1987, i ndryshuar, §154a (Gjermani): “(1) Nëse pjesë të caktuara dhe të veçanta të një shkeljeje apo disa prej një sërë shkeljesh ligjore të kryera si pasojë e të njëjtës shkelje nuk janë veçanërisht të rëndësishme 1. për dënimin... e pritur, apo 2. përveç dënimin... të dhënë të akuzuarit në mënyrë të detyrueshme për një shkelje tjetër ose të cilin duhet të presë për një shkelje tjetër, Prokuroria mund të kufizohet në pjesë të tjera të shkeljes apo në shkelje të tjera ligjore. ... Kufizimi do të shënohet zyrtarisht. (2) Pas dorëzimit të aktakuzës, gjykata, me pëlqimin e zyrës së prokurorisë publike, mund të vendosë këtë kufizim në çdo fazë të procedurës. (3) Në çfarëdo faze të procedurës, gjykata mund të riprocedojë ato pjesë të shkeljes apo shkelje ligjore të cilat nuk u morën në shqyrtim. Kërkesa nga ana e zyrës së prokurorisë publike për riprocedim të miratohet. ...” (cituar nga përkthimi jozyrtar i Ministrisë Federale gjermane të Drejtësisë.) Sipas jurisprudencës së pranuar të Gjykatës së Lartë Federale të Gjermanisë, përqëndrimi i çështjes mbi pjesët më të rëndësishme mund të bëhet gjithashtu gjatë apelimit (*Rebuffing and Revision*) duke qenë se është pjesë – edhe në nivelin ndërkombëtar – e detyrës për të proceduar sa më shpejt që të jetë e mundur në çështje penale (*Konzentrationsmaxime als Ausfluß des Beschleunigungsgebotes*).

¹⁶ Për hir të procedurës penale dhe për shkak të burimeve të kufizuara të drejtësisë ndërkombëtare, por natyrisht jo për viktimat e familjet e tyre.

¹⁷ Shih Aktgjykimin, paragrafi 21, fjalja e parë dhe Deklarata e Gjykatësit Shahabuddeen.

¹⁸ Shih Fisheries Jurisdiction (UK. Ice), 1974, I.C.J. 9, paragrafi 17 (25 korrik); Fisheries Jurisdiction (F.R.G. v.Ice), 1974 I.C.J. 181 (25 korrik), paragrafi 18.

¹⁹ Ndër të tjera, Franca, Gjermania, Zvicra dhe Austria. Fatqeqësisht, nuk qe e mundur që të jepen prova të mëtejshme për atë që vetëkuptohet brenda disa orëve në dispozicion për shkrimin e kësaj deklaratë.

²⁰ Bundesgerichtshof [BGH] [(Gjykata e Lartë Federale e (Gjermanisë)], 16 dhjetor 1959, 14 Entscheidungen des Bundesgerichtshofs in Strafsachen [BGHSt] 68 (73), përkthim jozyrtar. Shih gjithashtu Bundesgerichtshof [BGH] [(Gjykata e Lartë Federale e (Gjermanisë)] 30 gusht 2006, 12 NStZ-RECHTSSPRECHUNGS-REPORT [NSZ-RR] 43-45 (2007).

²¹ ROGER MERLE & ANDRÉ VITU, TRAITÉ DE DROIT CRIMINEL 250 (botimi i shtatë 1997) me referenca të tjera.

drejtëpërsëdrejti me aspekte të fajësisë dhe të pasojave ligjore.”²² Edhe Gjykata Federale Zviceriane²³ edhe Gjykata e Lartë Austriake²⁴ kanë të njëjtën pikëpamje.

18. Interpretimi përfundimtar i të drejtës së gjykatës është detyrë e gjykatës (*jura novit curia*). Gjykata duhet të arrijë vetëm në një përfundim vendimtar. Gjykata mund të gabojë në këtë konstatim i cili mund të korrigjohet në apel. Mirëpo, gjykata nuk mund të lërë asnjë dyshim për interpretimin e saktë të ligjit përkatës. Kryerja e vlerësimit përfundimtar është *nobile officium* dhe detyrë e gjykatësit.

19. Në kuadrin e Tribunalit Ndërkombëtar kjo do të thotë se Tribunali Ndërkombëtar është interpretues përfundimtar i së drejtës së vetë, p.sh. në veçanti Statuti dhe Rregulloret.

20. Megjithatë, si përjashtim, ekzistojnë edhe çështje faktuale që lidhen me çështje ligjore, d.m.th. fakte ligjore. Fakte ligjore të tilla p.sh. ekzistenca e një statuti shtetëror, praktika shtetërore, e drejta zakonore ose e drejta e huaj në përgjithësi i nënshtrohen procesit të zakonshëm të përcaktimit të fakteve në gjyq, sepse kompetenca e interpretimit të këtyre normave nuk i përket Tribunalit Ndërkombëtar. Në rast dyshimesh në fakte të tilla ligjore, Tribunali Ndërkombëtar duhet të vendosë sërish në dobi të të akuzuarit.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Sot, me datën 27 shtator 2007

Në Hagë, Holandë

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Wolfgang Schomburg

Vula e Tribunalit Ndërkombëtar

²² Bundesgerichtshof [BGH] [(Gjykata e Lartë Federale e (Gjermanisë), 14 mars 2004, 49 Entscheidungen des Bundesgerichtshofs in Strafsachen [BGHSt] 112 (122), përkthim jozyrtar.

²³ Shih ROBERT HAUSER & ERHARD SCHWERI, SCHWEIZERISCHES STRAFPROZESSRECHT § 6.5, § 54.5 (botimi i tretë, 1997).

²⁴ Shih EGMONT FOREGGER ET AL., DIE ÖSTERREICHISCHE STRAFPROZESSORDNUNG 371 (botimi i shtatë, 1997).

X. SHTOJCA A: HISTORIA PROCEDURALE

A. Njoftime të apelit

1. Prokuroria dorëzoi Njoftimin e Apelit më 30 dhjetor 2005.¹ Lidhur me vendimin e shfajësimit të Fatmir Limajt dhe të Isak Musliut, Prokuroria ofron tri pika të apelit. Ajo kundërshton zbatimin e standardit të provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm nga ana e Dhomës Gjyqësore në lidhje me pjesëmarrjen personale të Fatmir Limajt dhe të Isak Musliut në kamp-burgun e Llapushnikut. Gjithashtu ajo kundërshton zbatimin e standardit të provës jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me pozitën e komandës dhe të kontrollit të Fatmir Limajt dhe të Isak Musliut në zonën në fjalë dhe në periudhën e Aktakuzës. Më tej Prokuroria kundërshton përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale në kamp-burg. Për sa i përket Haradin Balës, Prokuroria përsërit kundërshtimin e saj lidhur me ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe apelon dënimin e burgimit disaveçar.

2. Haradin Bala dorëzoi Njoftimin e Apelit më 30 dhjetor 2005 ku gjithashtu përfshiheshin nëntë pika të apelit për gabime të ndryshme ligjore dhe faktuale.² Më 9 maj 2006, Haradin Bala dorëzoi një njoftim në të cilin ai tërhoqi pikat tre, pesë, shtatë dhe nëntë të apelit.³

B. Përbërja e Dhomës së Apelit

3. Nëpërmjet urdhëresës së datës 12 janar 2006, Kryetari i Tribunalit, Gjykatësi Fausto Pocar, emëroi gjykatësit e mëposhtëm në përbërje të trupit gjykues së Dhomës së Apelit për çështjen: Kryegjykatësi Fausto Pocar, Gjykatësi Mohamed Shahabuddeen, Gjykatësja Andrévia Vaz, Gjykatësi Theodor Meron, dhe Gjykatësi Wolfgang Schomburg.⁴ Bazuar në Rregullën 65 *ter* dhe Rregullën 107 të Rregullores, Gjykatësi Theodor Meron u emërua Gjykatës Paraapelues.⁵

¹ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Njoftimi i Apelit të Prokurorisë, 30 dhjetor 2005.

² Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Njoftimi i Apelit prej Mbrojtjes së Haradin Balës të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore I [sic], lëshuar më 30 nëntor 2005, 30 dhjetor 2005. *Shih gjithashtu Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Korrigjim i "Njoftimit të Apelit prej Mbrojtjes së Haradin Balës të Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore I [sic], lëshuar më 30 nëntor 2005,"* 4 janar 2006.

³ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Njoftimi i Tërheqjes së Arsyeve të Apelit, 9 maj 2006.

⁴ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim për Emërimin e Gjykatësve në një Çështje para Dhomës së Apelit dhe për Caktimin e Gjykatësit Paraapelues, 12 janar 2006.

⁵ *Po aty.*

C. Dorëzimi i dosjeve të apelit

4. Prokuroria dorëzoi Dosjen e Apelit më 15 mars 2006⁶ dhe një mocion për ndryshimin e Njoftimit të Apelit sipas Rregullës 108 të Rregullores më 27 mars 2006.⁷ Fatmir Limajt⁸ dhe Isak Musliu⁹ u përgjigjën më 2 maj 2006. Pas miratimit të pjesshëm nga ana e Gjykatës Paraapelues të mocionit të parë¹⁰ dhe hedhjes poshtë të mocionit të dytë¹¹ për zgjatjen e afatit për dorëzimin e përgjigjes ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, Haradin Bala u përgjigj¹² më 8 maj 2006. Prokuroria dorëzoi Dosjen e Kundërpërgjigjes me 23 maj 2006.¹³

5. Pasi u miratua mocioni i tij për zgjatjen e afatit,¹⁴ Haradin Bala dorëzoi Dosjen e Apelit të tij më 9 maj 2006.¹⁵ Prokuroria u përgjigj më 19 qershor 2006.¹⁶ Haradin Bala dorëzoi Dosjen e Kundërpërgjigjes më 4 korrik 2006.¹⁷

D. Kërkesa për Lirim të Përkohshëm

6. Më 20 prill 2006, Haradin Bala dorëzoi një mocion tejet të ngutshëm për lirim të përkohshëm për të marrë pjesë në ceremoninë mortore të së bijës.¹⁸ Dhoma e Apelit miratoi kërkesën më 20 prill 2006, duke urdhëruar lirim të përkohshëm të tij nga 23 prilli 2006 deri më 27 prill 2006.¹⁹

⁶ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Apelit të Prokurorisë, 15 mars 2006. Më 29 mars 2006 u dorëzua një Version i Redaktuar Publik. Libri përkatës i Autoriteteve u dorëzua në të njëjtën ditë.

⁷ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Mocioni i Prokurorisë për Ndryshimin e Njoftimit të Apelit Sipas Rregullës 108, 27 mars 2006.

⁸ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Fatmir Limajt, 2 maj 2006.

⁹ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Isak Musliut, 2 maj 2006.

¹⁰ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim në lidhje me Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjes së Përgjigjes, 5 prill 2006.

¹¹ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatje të mëtejshme të Afatit për Dorëzimin e Përgjigjes ndaj Dosjes së Apelit të Prokurorisë, 26 prill 2006.

¹² Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Z. Haradin Bala, 8 maj 2006. Në të njëjtën ditë u dorëzuan edhe Tabela dhe Libri i Autoriteteve.

¹³ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, 23 maj 2006. Po atë ditë u dorëzua një Variant i Redaktuar Publik.

¹⁴ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim në lidhje me Zgjatjen e Afatit, 16 shkurt 2006.

¹⁵ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja e Apelit të Haradin Balës, 9 maj 2006. Në të njëjtën ditë u dorëzua edhe Libri i Autoriteteve.

¹⁶ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit të Haradin Balës, 19 qershor 2006. Më 3 korrik 2006 u dorëzua një Variant i Redaktuar Publik. Më 10 korrik 2006, Prokuroria dorëzoi një korrigjim të Përgjigjes, duke korrigjuar disa gabime shtypi në këtë të fundit, shih Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Korrigjim i Dosjes së Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit të Haradin Balës, 10 korrik 2006.

¹⁷ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Dosja Konfidenciale e Kundërpërgjigjes së Haradin Balës, 4 korrik 2006.

¹⁸ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Mocion Tejet i Ngutshëm në Emër të Haradin Balës për Lirim të Përkohshëm, 20 prill 2006.

¹⁹ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim për Miratimin e Lirimit të Përkohshëm të Haradin Balës për pjesëmarrjen e tij në ceremoninë mortore të së bijës, 20 prill 2006.

7. Më 31 gusht 2006, Haradin Bala dorëzoi një mocion urgjent për lirim të përkohshëm për të marrë pjesë në ceremoninë mortore të të vëllait.²⁰ Dhoma e Apelit miratoi kërkesën më 1 shtator 2006, duke urdhëruar lirim të përkohshëm të Haradin Balës nga 5 shtatori 2006 deri më 9 shtator 2006.²¹

E. Mocion për pranimin e një fakti të pranuar dhe për plotësimin e dokumentacionit të procesit

8. Më 5 tetor 2006, Prokuroria dorëzoi një “Mocion për Pranimin e një Fakti të Pranuar dhe për Plotësimin e Dokumentacionit të Procesit” lidhur me (shkakun e) vdekjes së Stamen Genovit, ish të burgosurit në kamp-burgun e Llapushnikut.²² Prokuroria mori mirëkuptimin e të tre të Akuzuarve. Ajo theksoi gjithashtu se nuk synon ta shfrytëzojë këtë fakt të pranuar në mbështetje të çfarëdo pike të apelit në këtë çështje.²³ Dhoma e Apelit e miratoi mocionin më 29 nëntor 2006.²⁴

F. Konferencat mbi Gjendjen

9. Në përputhje me Rregullën 65 *bis* të Rregullores u mbajtën Konferenca mbi Gjendjen më 4 maj 2006, 29 gusht 2006, 5 dhjetor 2006, 21 mars 2007 dhe 9 korrik 2007.

G. Seanca e Apelit

10. Bazuar në një Urdhëresë për Caktim Date të datës 10 maj 2007,²⁵ më 5 dhe 6 qershor 2007, u mbajt një seancë për meritat e apelit.²⁶

²⁰ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Mocion i Ngutshëm në Emër të Haradin Balës për lirim të përkohshëm, 31 gusht 2006.

²¹ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Vendim për Miratimin e Lirimit të Përkohshëm të Haradin Balës për Pjesëmarrjen e tij në Ceremoninë Mortore të të vëllait dhe Praninë e tij gjatë periudhën tradicionale të zisë, 1 shtator 2006.

²² Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Mocioni i Prokurorisë për Pranimin e një Fakti të Pranuar dhe për Plotësimin e Dokumentacionit të Procesit, 5 tetor 2006.

²³ Po aty, paragrafi 4.

²⁴ Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Çështja Nr IT-03-66-A, Korigjimi i Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore dhe Vendimi në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e një Fakti të Pranuar dhe Plotësimin e Dokumentacionit të Procesit, 29 nëntor 2006.

²⁵ Urdhëresa për Caktimin e Datës së Seancës së Apelit, 10 maj 2006.

²⁶ Më 6 qershor 2007, Mbrojtja e Limajt dorëzoi publikisht Përgjigjet ndaj Pyetjeve të paraqitura nga Dhoma e Apelit më 30 maj 2007. Më 7 qershor 2007, Prokuroria dorëzoi konfidencialisht një Listë Provash dhe Përfundimesh lidhur me Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Pyetjes nr. 3 të paraqitur nga Dhoma e Apelit më 30 maj 2007.

XI. SHTOJCA B: FJALORI

A. Lista e Vendimeve të Tribunalit dhe të Tjera

1. Tribunali Ndërkombëtar

ALEKSOVSKI

Prosecutor v. Zlatko Aleksovski, Case No. IT-95-14/1-A, Judgement, 24 March 2000 (“*Aleksovski Appeal Judgement*”)

Prokurori k. Zlatko Aleksovskit, Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*”)

BABIĆ

Prosecutor v. Milan Babić, Case No. IT-03-72-A, Judgement on Sentencing Appeal, 18 July 2005 (“*Babić Judgement on Sentencing Appeal*”)

BABIQ

Prokurori k. Milan Babiqit, Lënda Nr. IT-03-72-A, Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 18 korrik 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Babiq* për Dënimin”)

BLAGOJEVIĆ AND JOKIĆ

Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić, Case No. IT-02-60-A, Judgement, 9 May 2007 (“*Blagojević and Jokić Appeal Judgement*”)

BLLAGOJEVIQ DHE JOKIQ

Prokurori k. Vidoje Bllagojeviqit dhe Dragan Jokiqit, Lënda Nr. IT-02-60-A, Aktgjykim, 9 maj 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*”)

BLAŠKIĆ

Prosecutor v. Tihomir Blaškić, Case No. IT-95-14-T, Judgement, 3 March 2000 (“*Blaškić Trial Judgement*”)

BLASHKIQ

Prokurori k. Tihomir Blashkiqit, Lënda Nr. IT-95-14-T, Aktgjykim, 3 mars 2000 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Blashkiq*”)

Prosecutor v. Tihomir Blaškić, Case No. IT-95-14-A, Judgement, 29 July 2004 (“*Blaškić Appeal Judgement*”)

Prokurori k. Tihomir Blashkiqit, Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim, 29 korrik 2004 (Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*”)

BRĐANIN

Prosecutor v. Radoslav Brdanin, Case No. IT-99-36-A, Judgement, 3 April 2007 (“*Brdanin Appeal Judgement*”)

BËRGJANIN

Prokurori k. Radoslav Bërgjaninit, Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*”)

ČELEBIĆI

Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, a.k.a. “Pavo”, Hazim Delić and Esad Landžo, a.k.a. “Zenga”, Case No. IT-96-21-T, Judgement, 16 November 1998 (“Čelebići Trial Judgement”)

Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, a.k.a. “Pavo”, Hazim Delić and Esad Landžo, a.k.a. “Zenga”, Case No. IT-96-21-A, Judgement, 20 February 2001 (“Čelebići Appeal Judgement”)

ÇELEBIQI

Prokurori k. Zejnil Delaliqit, Zdravko Muciqit, me pseudonimin “Pavo”, Hazim Deliqit dhe Esad Lanxhos, me pseudonimin “Zenga”, Lënda Nr. IT-96-21-A, 20 shkurt 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Çelebiqi”)

DERONJIĆ

Prosecutor v. Miroslav Deronjić, Case No. IT-02-61-A, Judgement on Sentencing Appeal, 20 July 2005 (“Deronjić Sentencing Appeal Judgement”)

DERONJIQ

Prokurori k. Miroslav Deronjiqit, Lënda Nr. IT-02-61-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 20 korrik 2005 (“Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit Deronjiq”)

ERDEMOVIĆ

Prosecutor v. Dražen Erdemović, Case No. IT-96-22-T, Sentencing Judgement, 29 November 1996 (“Erdemović Sentencing Judgement”)

ERDEMOVIQ

Prokurori k. Drazhen Erdemoviqit, Lënda Nr. IT-96-22-T, Aktgjykimi për Dënimin, 29 nëntor 1996 (“Aktgjykimi i Dënimit Erdemoviq”)

Prosecutor v. Dražen Erdemović, Case No. IT-96-22-A, Judgement, 7 October 1997 (“Erdemović Appeal Judgement”)

Prokurori k. Drazhen Erdemoviqit, Lënda Nr. IT-96-22-A, Aktgjykim, 7 tetor 1997 (“Aktgjykimi i Apelit Erdemoviq”)

FURUNDŽIJA

Prosecutor v. Anto Furundžija, Case No. IT-95-17/1-A, Judgement, 21 July 2000 (“Furundžija Appeal Judgement”)

FURUNXHIIJA

Prokurori k. Anto Furunxhisë, Lënda Nr. IT-95-17/1-A, Aktgjykim, 21 korrik 2000 (“Aktgjykimi i Apelit Furunxhija”)

GALIĆ

Prosecutor v. Stanislav Galić, Case No. IT-98-29-T, Judgement and Opinion, 5 December 2003 (“Galić Trial Judgement”)

GALIQ

Prokurori k. Stanislav Galiqit, Lënda Nr. IT-98-29-T, Aktgjykim dhe Mendim, 5 dhjetor 2003 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Galiq”)

Prosecutor v. Stanislav Galić, Case No. IT-98-29-A, Judgement, 30 November 2006 (“Galić Appeal Judgement”)

Prokurori k. Stanislav Galiqit, Lënda Nr. IT-98-29-A, Aktgjykim, 30 nëntor 2006 (“Aktgjykimi i Apelit Galiq”)

JELISIĆ

Prosecutor v. Goran Jelisić, Case No. IT-95-10-A, Judgement, 5 July 2001 (“Jelisić Appeal Judgement”)

JELISHIQ

Prokurori k. Goran Jelisiqit, Lënda Nr. IT-95-10-A, Aktgjykim, 5 korrik 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Jelishiq*”)

JOKIĆ

Prosecutor v. Miodrag Jokić, Case No. IT-01-42/1-A, Judgement on Sentencing Appeal, 30 August 2005 (“*Jokić* Judgement on Sentencing Appeal”)

JOKIQ

Prokurori k. Miodrag Jokiqit, Lënda Nr. IT-01-42/1-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 30 gusht 2005 (“Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Jokiq*”)

KORDIĆ AND ČERKEZ

Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez, Case No. IT-95-14/2-T, Judgement, 26 February 2001 (“*Kordić and Čerkez* Trial Judgement”)

KORDIQ DHE ÇERKEZ

Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit, Lënda Nr. IT-95-14/2-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2001 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kordiq dhe Çerkez*”)

Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez, Case No. IT-95-14/2-A, Judgement, 17 December 2004 (“*Kordić and Čerkez* Appeal Judgement”) as corrected by *Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez*, Case No. IT-95-14/2-A, Corrigendum to Judgement of 17 December 2004, 26 January 2005

Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Aktgjykim, 17 dhjetor 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*”) korigjuar prej *Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit*, Lënda Nr. IT-95-14/2-A, Korigjues i Aktgjykimit të 17 dhjetorit 2004, 26 janar 2005

KRNOJELAC

Prosecutor v. Milorad Krnojelac, Case No. IT-97-25-A, Judgement, 17 September 2003 (“*Krnojelac* Appeal Judgement”)

KËRNOJELAC

Prokurori k. Milorad Kërnojelacit, Lënda Nr. IT-97-25-A, Aktgjykim, 17 shtator 2003 (“Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*”)

KRSTIĆ

Prosecutor v. Radislav Krstić, Case No. IT-98-33-A, Judgement, 19 April 2004 (“*Krstić* Appeal Judgement”)

KËRSTIQ

Prokurori k. Radislav Krstiqit, Lënda Nr. IT-98-33-A, Aktgjykim, 19 prill 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*”)

KUNARAC, KOVAČ AND VUKOVIĆ

Prosecutor v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovač and Zoran Vuković, Case Nos IT-96-23 and IT-96-23/1-T, Judgement, 22 February 2001 (“*Kunarac et al.* Trial Judgement”)

Prosecutor v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovač and Zoran Vuković, Case Nos IT-96-23 and IT-96-23/1-A, Judgement, 12 June 2002 (“*Kunarac et al.* Appeal Judgement”)

KUNARAC, KOVAÇ DHE VUKOVIQ

Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit dhe Zoran Vukoviqit, Lënda Nr IT-96-23 dhe IT-96-23/1-T Aktgjykim, 22 shkurt 2002 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kunarac dhe të tjerët*”)

Prokurori k. Dragolub Kunaracit, Radomir Kovaçit dhe Zoran Vukoviqit, Lënda Nr IT-96-23 dhe IT-96-23/1-A Aktgjykim, 12 qershor 2002 (“Aktgjykimi i Apelit Kunarac dhe të tjerët”)

Z. KUPREŠKIĆ, M. KUPREŠKIĆ, V. KUPREŠKIĆ, JOSIPOVIĆ, PAPIĆ AND ŠANTIĆ

Prosecutor v. Zoran Kupreškić, Mirjan Kupreškić, Vlatko Kupreškić, Drago Josipović, Dragan Papić and Vladimir Šantić, a.k.a. “Vlado”, Case No. IT-95-16-T, Judgement, 14 January 2000 (“Kupreškić et al. Trial Judgement”)

Prosecutor v. Zoran Kupreškić, Mirjan Kupreškić, Vlatko Kupreškić, Drago Josipović and Vladimir Šantić, Case No. IT-95-16-A, Appeal Judgement, 23 October 2001 (“Kupreškić et al. Appeal Judgement”)

Z. KUPRESHKIQ, M. KUPRESHKIQ, V. KUPRESHKIQ, JOSIPOVIQ, PAPIQ DHE SHANTIQ

Prokurori k. Zoran Kupreshkqit, Mirjan Kupreshkqit, Vllatko Kupreshkqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit i njohur edhe si “Vlado”, Lënda Nr. IT-95-16-T, Aktgjykim, 14 janar 2000 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore Kupreshkiq dhe të tjerët”)

Prokurori k. Zoran Kupreshkqit, Mirjan Kupreshkqit, Vllatko Kupreshkqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit, Lënda Nr. IT-95-16-A, Aktgjykimi i Apelit, 23 tetor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit Kupreshkiq dhe të tjerët”)

KVOČKA, KOS, RADIĆ, ŽIGIĆ AND PRCAĆ

Prosecutor v. Miroslav Kvočka, Mlado Radić, Zoran Žigić and Dragoljub Prcać, Case No. IT-98-30/1-A, Judgement, 28 February 2005 (“Kvočka et al. Appeal Judgement”)

KVOČKA, KOS, RADIQ, ZHIGIQ DHE PRCAQ

Prokurori k. Miroslav Kvočkës, Mllagjo Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Prcaqit, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005 (“Aktgjykimi i Apelit Kvočka dhe të tjerët”)

MILUTINOVIĆ, ŠAINOVIĆ AND OJDANIĆ

Prosecutor v. Milan Milutinović, Nikola Šainović and Dragoljub Ojdanić, Case No. IT-99-37-AR72, Decision on Dragoljub Ojdanić’s Motion Challenging Jurisdiction – Joint Criminal Enterprise, 21 May 2003 (“Ojdanić Appeal Decision on Joint Criminal Enterprise”)

MILUTINOVIQ, SHAINOVIQ DHE OJDANIQ

Prokurori k. Milan Milutinoviqit, Nikolla Shainoviqit dhe Dragolub Ojdaniqit, Lënda Nr. IT-99-37-AR72, Vendim në lidhje me Mocionin Kundërshtues ndaj Juridiksionit të Dragolub Ojdaniqit - Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale, 21 maj 2003 (“Vendimi i Apelit Ojdaniq në lidhje me Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale”)

NALETILIĆ AND MARTINOVIĆ

Prosecutor v. Mladen Naletilić, a.k.a. “Tuta” and Vinko Martinović, a.k.a. “Štela”, Case No. IT-98-34-A, Judgement, 3 May 2006 (“Naletilić and Martinović Appeal Judgement”)

NALETILIQ DHE MARTINOVIQ

Prokurori k. Mladen Naletiliqit i njohur edhe si “Tuta” dhe Vinko Martinoviqit i njohur edhe si “Shtelaa”, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006 (“Aktgjykimi i Apelit Naletiliq dhe Martinoviq”)

D. NIKOLIĆ

Prosecutor v. Dragan Nikolić, Case No. IT-94-2-S, Sentencing Judgement, 18 December 2003 (“Dragan Nikolić Sentencing Judgement”)

Prosecutor v. Dragan Nikolić, Case No. IT-94-2-A, Judgement on Sentencing Appeal, 4 February 2005 (“Dragan Nikolić Appeal Judgement”)

D. NIKOLIQ

Prokurori k. Dragan Nikoliqit, Lënda Nr. IT-94-2-S, Aktgjykimi i Dënimit, 18 dhjetor 2003 (“Aktgjykimi i Dënimit *Dragan Nikoliq*”)

Prokurori k. Dragan Nikoliqit, Lënda Nr. IT-94-2-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 4 shkurt 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Dragan Nikoliq*”)

M. NIKOLIĆ

Prosecutor v. Momir Nikolić, Case No. IT-02-60/1-A, Judgement on Sentencing Appeal, 8 March 2006 (“*Momir Nikolić* Judgement on Sentencing Appeal”)

M. NIKOLIQ

Prokurori k. Momir Nikoliqit, Lënda Nr. IT-02-60/1-A, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 8 mars 2006 (“Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit *Momir Nikoliq*”)

STAKIĆ

Prosecutor v. Milomir Stakić, Case No. IT-97-24-A, Judgement, 22 March 2006 (“*Stakić* Appeal Judgement”)

STAKIQ

Prokurori k. Milomir Stakiqit, Lënda Nr. IT-97-24-A, Aktgjykim, 22 mars 2006 (“Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*”)

DUŠKO TADIĆ

Prosecutor v. Duško Tadić a/k/a “Dule”, Case No. IT-94-1-AR-72, Decision on the Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction, 2 October 1995 (“*Tadić* Jurisdiction Decision”)

Prosecutor v. Duško Tadić a/k/a “Dule”, Case No. IT-94-1-T, Judgement, 7 May 1997 (“*Tadić* Trial Judgement”)

Prosecutor v. Duško Tadić, Case No. IT-94-1-A, Judgement, 15 July 1999 (“*Tadić* Appeal Judgement”)

Prosecutor v. Duško Tadić, Case No. IT-94-1-A and IT-94-1-Abis, Judgement in Sentencing Appeals, 26 January 2000 (“*Tadić* Sentencing Appeal Judgement”)

DUSHKO TADIQ

Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule, Lënda Nr. IT-94-1-AR-72, “Vendimi në lidhje me Mocionini e Mbrojtjes për Apelimin e Ndërkohshëm në lidhje me Jurisdikcionin” 2 tetor 1995 (“Vendimi i Juridiksionit *Tadiq*”)

Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule, Lënda Nr. IT-94-1-T, Aktgjykim, 7 maj 1997 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*”)

Prokurori k. Dushko Tadiqit i njohur edhe si “Dule, Lënda Nr. IT-94-1-A, Aktgjykim, 15 korrik 1999 (“Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*”)

VASILJEVIĆ

Prosecutor v. Mitar Vasiljević, Case No. IT-98-32-T, Judgement, 29 November 2002 (“*Vasiljević* Trial Judgement”)

Prosecutor v. Mitar Vasiljević, Case No. IT-98-32-A, Judgement, 25 February 2004 (“*Vasiljević* Appeal Judgement”)

VASILJEVIQ

Prokurori k. Mitar Vasiljeviqit, Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykim, 29 nëntor 2002 (“Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Vasiljeviq*”)

Prokurori k. Mitar Vasiljeviqit, Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykim, 25 shkurt 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Vasiljeviq*”)

2. TPNR

AKAYESU

Prosecutor v. Jean-Paul Akayesu, Case No. ICTR-96-4-A, Judgement, 1 June 2001 (“*Akayesu* Appeal Judgement”)

Prokurori k. Jean-Paul Akayesu, Lënda Nr. ICTR-96-4-A, Aktgjykim, 1 qershor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Akayesu*”)

GACUMBITSI

Prosecutor v. Sylvestre Gacumbitsi, Case No. ICTR-2001-64-A, Judgement, 7 July 2006 (“*Gacumbitsi* Appeal Judgement”)

Prokurori k. Sylvestre Gacumbitsi, Lënda Nr. ICTR-2001-64-A, Aktgjykim, 7 korrik 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Gacumbitsi*”)

KAJELIJELI

Prosecutor v. Juvénil Kajelijeli, Case No. ICTR-98-44A-A, Judgement and Sentence, 23 May 2005 (“*Kajelijeli* Appeal Judgement”)

Prokurori k. Juvénil Kajelijeli, Lënda Nr. ICTR-98-44-A, Aktgjykimi dhe Dënimi, 23 maj 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*”)

KAMBANDA

Jean Kambanda v Prosecutor, Case No. ICTR-97-23-A, Judgement, 19 October 2000 (“*Kambanda* Appeal Judgement”)

Jean Kambanda k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-97-23-A, Aktgjykim, 19 tetor 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Kambanda*”)

KAMUHANDA

Jean de Dieu Kamuhanda v. Prosecutor, Case No. ICTR-00-54A-A, Judgement, 19 September 2005 (“*Kamuhanda* Appeal Judgement”)

Jean de Dieu Kamuhanda k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-00-54A-A, Aktgjykim, 19 shtator 2005 (“Aktgjykimi i Apelit *Kamahunda*”)

KAYISHEMA AND RUZINDANA

Prosecutor v. Clément Kayishema and Obed Ruzindana, Case No. ICTR-95-1-A, Judgement (Reasons), 1 June 2001 (“*Kayishema and Ruzindana* Appeal Judgement”)

KAYISHEMA DHE RUZINDANA

Prokurori k. Clément Kayishema dhe Obed Ruzindana, Lënda Nr. ICTR-95-1-A, Aktgjykim (Arsyet), 1 qershor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*”)

MUSEMA

Prosecutor v. Alfred Musema, Case No. ICTR-96-13-A, Judgement, 16 November 2001 (“*Musema* Appeal Judgement”)

Prokurori k. Alfred Musema, Lënda Nr. ICTR-96-13-A, Aktgjykim, 16 nëntor 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Musema*”)

NDINDABAHIZI

Emmanuel Ndindabahizi, Case No. ICTR-01-71-A, Judgement, 16 January 2007 (“*Ndindabahizi Appeal Judgement*”)

Emmanuel Ndindabahizi, Lënda Nr. ICTR-01-71-A, Aktgjykim, 16 janar 2007 (“Aktgjykimi i Apelit *Ndindabahizi*”)

NIYTEGEKA

Prosecutor v. Eliézer Niyitegeka, Case No. ICTR-96-14-T, Appeal Judgement, 9 July 2004 (“*Niyitegeka Appeal Judgement*”).

Prokurori k. Eliézer Niyitegeka, Lënda Nr. ICTR-96-14-T, Aktgjykimi i Apelit, 9 korrik 2004 (“Aktgjykimi i Apelit *Niyitegeka*”)

NTAGERURA, BAGAMBIKI AND IMANISHIMWE

Prosecutor v. André Ntagerura, Emmanuel Bagambiki and Samuel Imanishimwe, Case No. ICTR-99-46-A, Judgement, 7 July 2006 (“*Ntagerura et al. Appeal Judgement*”).

NTAGERURA, BAGAMBIKI DHE IMANISHIMWE

Prokurori k. André Ntagerura, Emmanuel Bagambiki dhe Samuel Imanishimwe, Lënda Nr. ICTR-96-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerët*”)

RUTAGANDA

Prosecutor v. Georges Anderson Nderubunwe Rutaganda, Case No. ICTR-96-3-A, Judgement, 26 May 2003 (“*Rutaganda Appeal Judgement*”).

Prokurori k. Georges Anderson Nderubunwe Rutaganda, Lënda Nr. ICTR-96-3-A, Aktgjykim, 26 maj 2001 (“Aktgjykimi i Apelit *Rutaganda*”)

SEMANZA

Laurent Semanza v. Prosecutor, Case No. ICTR-97-20-A, Judgement, 20 May 2005 (“*Semanza Appeal Judgement*”).

Laurent Semanza k. Prokurorit, Lënda Nr. ICTR-97-20-A, Aktgjykim, 20 maj 2000 (“Aktgjykimi i Apelit *Semanza*”)

B. Lista e Shkurtimeve

Sipas Rregullës 2(B) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, gjinia mashkullore përfshin edhe femëroren si dhe njëjësi shumësin, dhe anasjelltas.

a.k.a	I njohur edhe si
AT	Faqja e zbardhur (transkripti) e seancës së apelit në këtë çështje. Të gjitha numrat e faqeve të transkriptit të përmendura këtu vijnë nga versioni jozyrtar i pakorrigjuar, nëse nuk përcaktohet ndryshe. Si pasojë mund të ketë ndryshime të vogla midis numërimit të faqeve këtu dhe numërimit të faqeve të transkriptit përfundimtar të publikuar. Në rast dyshimi, mund të konsultohet videoja e seancës.
Dosja e Apelit të Balës	Dosja Konfidenciale e Apelit të Haradin Balës, 9 maj 2006

Njoftimi i Apelit të Balës	Njoftim për Apel prej Mbrojtjes së Haradin Balës ndaj Aktgjykimit të Dhomës Gjyqësore I shqiptuar më 30 nëntor 2005, 30 dhjetor 2005
Dosja Paragjyqësore e Balës	Dosje Paragjyqësore e Haradin Balës Bazuar në Rregullën 65ter (F) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, 1 qershor 2004
Dosja e Kundërpërgjigjes së Balës	Dosje Konfidenciale e Kundërpërgjigjes së Haradin Balës, 4 korrik 2006
Dosja e Përgjigjes së Balës	Dosje Konfidenciale e Përgjigjes së Z. Haradin Bala, 8 maj 2006
CCIU	Njësia qendrore hetimore kriminale e policisë së UMIK-ut (UNMIK Police, Central Criminal Investigation Unit)
pm.	provë materiale
fn.	poshtëshënim
<i>Po aty.</i>	latinisht: <i>ibidem</i> , i njëjti burim si në citimin e mëparshëm.
Aktakuza	<i>Prokurori k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut, Lënda Nr. IT-03-66-PT, Vendim në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar, 13 shkurt 2004 (“Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë”</i>
Tribunali Ndërkombëtar	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991
KVM	Misioni Verifikues i Kosovës (Kosovo Verification Mission)
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
Dosja e Përgjigjes së Limajt	Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Fatmir Limajt, 2 maj 2006
Dosja Paragjyqësore	e Dosja Paragjyqësore e Isak Musliut, 1 qershor 2004

Musliut

Dosja e Përgjigjes së Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Isak Musliut, 2 maj 2006
Musliut

NPK Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale

UÇK Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Prokuroria Zyra e Prokurores

Dosja e Apelit të Dosja Konfidenciale e Apelit të Prokurorisë, 15 mars 2006
Prokurorisë

Njoftimi për Apel i Njoftimi për Apel i Prokurorisë, 30 dhjetor 2005
Prokurorisë

Dosja Paragjyqësore e Njoftim i Prokurorisë për Dorëzimin e Dosjes Paragjyqësore dhe
Prokurorisë Dokumenteve të Tjera Sipas Rregullës 65ter, 1 mars 2004. dhe
Korigjues i Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë, Lista e Përditësuar e
Dëshmitarëve dhe Bashkësia e Rishikuar e Përmbledhjeve të Rregullës
65ter, 30 shtator 2004

Dosja e Përgjigjes së Dosja Konfidenciale e Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Dosjes së Apelit
Prokurorisë të Haradin Balës, 3 korrik 2006

Dosja e Kundërpërgjigjes së Dosja Konfidenciale e Kundërpërgjigjes së Prokurorisë, 23 maj 2006
Prokurorisë

Rregullore Rregullorja e Procedurës dhe e Provave të Tribunalit Ndërkombëtar

SFOR Forca Shumëkombëshe e Stabilizimit (Multinational Stabilisation
Force)

RSFJ ish-Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë

Kodi Penal i RSFJ-së Kodi Penal i Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë miratuar
më 28 shtator 1976 dhe hyrë në fuqi më 1 korrik 1977

Statuti	Statuti i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, i themeluar nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 827 (1993)
SPB	Sekretariati i Punëve të Brendshme (Sekretariatit za Unutrašnje Poslove)
T.	Faqja e transkriptit të seancave në këtë çështje. Të gjitha numrat e faqeve të transkriptit të përmendura këtu vijnë nga versioni jozyrtar i pakorrigjuar, nëse nuk përcaktohet ndryshe. Si rezultat mund të ketë ndryshime të vogla midis numërimit të faqeve këtu dhe numërimit të faqeve të transkriptit përfundimtar të publikuar. Në rast dyshimi, mund të konsultohet videoja e seancës
TPNR	Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Gjenocid dhe për Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe për Qytetarë Ruandas Përgjegjës për Gjenocid dhe për Shkelje të Tilla të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinjë midis 1 janarit 1994 dhe 31 dhjetorit 1994.
	Njësia e Paraburgimit e Kombeve të Bashkuara (UN Detention Unit)
UNDU	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (United Nations Interim Administration Mission in Kosovo)
UNMIK	
UNPROFOR	Forcat e Mbrojtjes të Kombeve të Bashkuara (United Nations Protection Forces)
UJ	Ushtria Jugosllave (Vojska Jugoslavije)